

**MËSIMDHËNIA E HISTORISË MODERNE TË EUROPËS JUGLINDORE**  
Materiale Mësimore Plotësuese

## **Luftërat Ballkanike**

Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore. Materiale mësimore plotësuese. Redaktor për botimin në gjuhën shqipe: Helian Demiri

Titulli në origjinal: Teaching Modern Southeast European History, Alternative Educational Materials, The Balkan Wars  
(Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore, Luftërat Ballkanike), Selanik, 2009

Përkthyen nga anglishtja: Danjela Shkalla, Lumnis Çela, Sonila Danaj, Ymer Leksi

Redaktor gjuhësor: Prof. Dr. Tomor Plangarica

Recensentë për botimin në gjuhën shqipe: Prof. Dr. Xhevat Lloshi, Prof. Dr. Remzi Përnaska

Faqosja dhe botimi: Shtypshkronja „Obod” ad Cetinje

Numri i kopjeve: 700

### Ky botim është financuar nga Bashkimi European



The European Union's Instrument for  
Pre-accession Assistance (IPA)

“The contents of this publication are the sole responsibility of the author and can in no way be taken to reflect the views of the European Union.”

Përmbajtja e këtyre librave është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk mund të thuhet se paraqet pikëpamjet e Bashkimit European

Raportues i CDRSEE-së në bordin drejtues të *Projekti i Historisë së Përbashkët*: Costa Carras

Drejtor ekzekutiv: Nenad Šebek

Drejtor i programeve: Corinna Noack-Aetopoulos

Koordinatorë të projektit: Antonis Hadjiyannakis, Zvezdana Kovač, Jenny Demetriou & Susan Nadeau Bustamante

### Sponsorë për botimin në gjuhën shqipe:

THE PUBLICATIONS AND TEACHER TRAINING ACTIVITIES OF THE JOINT HISTORY PROJECT HAVE BEEN MADE POSSIBLE THROUGH THE KIND FINANCIAL BACKING OF THE FOLLOWING:



Copyright: Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe (CDRSEE)

Krispou 9, Ano Poli, 54634 Thessaloniki, Greece

Tel.: +30 2310 960820-1; Fax: +30 2310 960822

e-mail: info@cdrsee.org, web: www.cdrsee.org

ISBN: 978-9928-133-00-7

MËSIMDHËNIA E HISTORISË MODERNE TË EUROPËS JUGLINDORE  
**M a t e r i a l e M ë s i m o r e P l o t ë s u e s e**

LIBRI I PUNËS 3

## **Luftërat Ballkanike**

Redaktorë: VALERI KOLEV dhe KRISTINA KOULOURI  
Redaktore e përgjithshme e serisë: KRISTINA KOULOURI  
Redaktor për botimin në gjuhën shqipe: HELIAN DEMIRI

Botimi i dytë



Cetinë 2012



<b>Hyrje</b>	13
<b>Kronologji</b>	17
<b>KAPITULLI I: Ekonomia dhe shoqëria</b>	23
<b>Ia. Popullsia</b>	24
Tab. 1: <i>Rritja e popullsisë së Ballkanit në vitet 1878-1912</i>	24
Fig. 1. Manastiri/Bitola	24
Tab. 2: Popullsia e qyteteve dhe e kryeqyteteve në shtetet kombëtare të Ballkanit gjatë viteve 1860-1910	25
Fig. 2. Gra në Kostur, fillimi i shekullit të 20-të	26
Tab. 3: <i>Llogaritjet e popullsisë në provincat europiane të Perandorisë Osmane për vitin 1911</i>	26
Harta 1: Vilajeti i Kosovës, 1900.	27
Fig. 3. Një ditë e zakonshme në tregun e Selanikut	27
Fig. 4. Tregu i bagëtive në Stamboll	28
Tab. 4: Përbërja etnike e popullsisë së Stambollit në vitin 1897	28
Fig. 5. Një ditë e zakonshme në tregun e Prishtinës (fundi i shek. të 19-të)	29
Fig. 6. Barinj në Epir, viti 1912	29
Tab. 5: Emigrimi nga shtetet kombëtare ballkanike jashtë Europës, 1876-1915	30
I-1. Edit Durhami përshkruan pazarin e Prizrenit, 1909	30
I-2. Një emigrant grek në Shtetet e Bashkuara, Stiv Haxhisi tregon përvojën e tij	31
<b>Ib. Ekonomia</b>	32
Tab. 6: <i>Buxhetet e shteteve ballkanike, 1898-1912</i>	32
Tab. 7: <i>Struktura e shpenzimeve shtetërore për frymë në vitin 1911</i>	32
I-3. Bujqësia në Maqedoninë Osmane gjatë viteve 1900	33
Fig. 7. Manifaktura e tekstileve e vëllezërve Saias në Selanik.	33
Tab.8a: <i>Eksportet e Ballkanit 1901-1911</i>	34
Tab.8b: <i>Importet e Ballkanit 1901-1911</i>	34
Fig. 8. Mjetet e transportit në Shqipërinë e fillimshekullit të 20-të	35
Tab. 9: <i>Linjat hekurudhore funksionuese në Ballkan, 1870-1912</i>	36
I-4. Analizë e sistemit hekurudhor bullgar, kryer nga shefi i Shtabit të Ushtrisë Bullgare, gjenerali Fiçev	36
Tab.10: <i>Telegrafi në vitin 1910</i>	37
Fig. 9. Vila Allatini në Selanik, 1913	37
<b>Ic. Kultura</b>	38
Fig. 10. Orë historie në një shkollë të mesme për vajza, Athinë 1911	38
I-5. Një djalë hebre përshkruan përvojën e tij në shkollë, në Selanik, 1904	39
Tab.11: <i>Analfabetizmi në fillim të shekullit të 20-të</i>	40
Tab.12: <i>Shkollat fillore dhe nxënësit në Europë (fundi i shek. të 19-të – fillimi i shek. të 20-të)</i>	40

- Fig. 11. Gra hebreje duke kërcyer, Selanik 41
- Fig. 12. Gratë endëse, Avdela 1907 – filmi i parë në Ballkan 41

## KAPITULLI II: Politikat 43

<b>Ila. Ideologjitë paraprijëse</b>	44
Harta 1: Aspiratat kombëtare të vendeve të Ballkanit	44
Fig.13. <i>Sholla e Rumanisë</i> (karikaturë rumune, 1913)	44
Tab.13: <i>Statistika kontradiktore për Maqedoninë</i>	45
Il-1. Ajo çka priste një ushtar serb	45
Il-2. Ideologjia e sakrificës e një ushtari rumun	46
Il-3. Turqit dhe osmanizmi	46
Il-4. Ndjenjat e fshatarëve të krishterë ndaj Turqve te Rinj në Maqedoninë Osmane	46
Il-5. 14 Pikat e Hasan Prishtinës	47
Fig.14. Komitë në krahinën e Kosturit, në fillim të shekullit të 20-të.	48
Il-6. Ideja për një Lidhje Ballkanike nga Ivan Vazovi, poet bullgar	48
Il-7. Bashkimi Ballkanik sipas idesë së Partisë Socialdemokrate Serbe	49
A. Nga fjala e udhëheqësit të Partisë Socialdemokrate Serbe, Dimitrije Tucoviç, në një miting proteste kundër luftës, në vitin 1912	49
B. Nga fjala e deputetit socialdemokrat serb, D. Lapçeviç, në Asamblenë Kombëtare, më 7 (20) tetor 1912	49
Il-8. Raport i Komitetit Qendror të Partisë Socialdemokrate Punëtore Bullgare (krahu i majtë), drejtuar BNS-së, 1912	49
Il-9. Raport i Federatës Socialiste të Selanikut, dërguar BNS-së në vitin 1913	50
Tab.14: <i>Burimet njerëzore gjatë Luftërave Ballkanike 1912-1913</i>	51
Il-10. Artikull i një gazete malazeze, lidhur me qëllimet e luftës, 1912	51
Il-11. Gazeta bullgare e partisë në pushtet rreth konfliktit serbo-bullgar për Maqedoninë, 1913	51
Fig.15. Shqipëria duke mbrojtur Shkodrën dhe Janinën nga Mali i Zi-majmuni, Greqia – tigri, dhe Serbia - gjarpri	52
Fig.16. Rumania paraqitet si bartëse e qytetërimit europian	53
Il-12. Shpjegimi i interesave rumunë nga një historian profesionist bërë menjëherë pas Luftërave Ballkanike	54
<b>IIb. Çështja Lindore</b>	54
Il-13. Përshkrimi i Çështjes Lindore nga një historian francez, 1898	54
A. Islamizmi përballë krishterimit	54
B. Perandoria Osmane dhe popujt e Ballkanit	55
C. Koncerti europian	55
Fig.17. Dordoleci i shkëlqyer (karikaturë nga E. Muanovic, Beograd, 1912)	56
Fig.18. Lopa e qumështit (karikaturë osmane e vitit 1909).	57
Il-14. Roli i Fuqive të Mëdha, përshkruar nga një revolucionar maqedonas prej Velesit	57
Il-15. Qarkore e ministrit rus të Punëve të Jashtme, Sazonov, dërguar përfaqësuesve diplomatikë jashtë vendit, 18 tetor 1912	57
Il-16. Një "monark i mirë"	58
Il-17. Artikull në një gazetë rumune, 16 qershor 1913 – dita e sulmit bullgar kundër Serbisë	58
Il-18. Pjesë nga libri i një politikani rumun	58

Il-19.	Ndarja e plaçkës së luftës	59
Fig.19.	Europa dhe fëmijët e tërbuar (karikaturë rumune, 1913).	59
<b>Ilc. Pritja dhe shpallja e Luftës</b>		59
Il-20.	Perandoria Osmane nuk e priste luftën	59
Il-21.	Shpallja e luftës kundër Perandorisë Osmane nga mbreti grek George I, 5 tetor 1912	60
Il-22.	Mbreti Ferdinand i Bullgarisë shpall luftën kundër Perandorisë Osmane, 5 tetor 1912	60
Fig.20.	Udhëtim për qejf (karikaturë osmane, 5 tetor 1912)	61
Il-23.	Deklaratë drejtuar ushtarëve nga komandanti i Ushtrisë Lindore Turke, Abdullah pasha, 8 tetor 1912	61
Fig. 21.	Ballkani kundër tiranit, 5 tetor 1912 (litografi greke)	62
Il-24.	Në Serbi pritët lufta, 8 tetor 1912	62
Il-25.	Një bullgar përshkruan ndjenjat e popullit përpara luftës	62
Il-26.	Fragmente të shkëputura nga dy gazeta që botoheshin në shqip, jashtë vendit dhe që shprehin dy qëndrime të ndryshme ndaj Luftës së Parë Ballkanike	63
	A. Nga një gazetë e botuar në Boston	63
	B. Nga një gazetë që botohej në Sofje	63
Fig. 22.	Duke dhënë lamtumirën - në Sofje dhe në Stamboll	64
Il-27.	Pjesë nga Traktati i Aleancës ndërmjet Mbretërisë së Greqisë dhe Mbretërisë së Serbisë, nënshkruar më 19 maj (1 qershor) 1913	64
Fig. 23.	Malazet të gëzuar prej shpalljes së luftës, 1912	65
Il-28.	Deklaratë e mbretit Nikolla të Malit të Zi, 27 korrik 1913	65
Il-29.	Deklaratë e mbretit Konstandin të Greqisë, 21 korrik 1913	65
Il-30.	Gazetat dhe opinioni publik në Rumani në prag të pushtimit të Bullgarisë nga Rumania, gjatë Luftës së Dytë Ballkanike	66
	A. <i>Ne duam luftë</i>	66
	B. <i>Turma ishte gjigante</i>	66
Fig.24.	Hora – valle tradicionale rumune. Ushtarë rumunë që kërcëjnë gjatë rrugës për në Bullgari	66
Il-31.	Artikull në një gazetë rumune, ku bëhen përpjekje të shpjegohen arsyet dhe qëllimet e pushtimit të Bullgarisë nga Rumania	67
Il-32.	Deklaratë e kryeministrit bullgar, S. Danev, mbi pushtimin rumun të Bullgarisë	67

## KAPITULLI III: Shoqëritë gjatë Luftës 69

<b>IIIa. Frontet e Luftës</b>		70
Fig. 25.	Ushtria bullgare	70
III-1.	Përshkrim i fitores së ushtrisë serbe në Kumanovë	71
Fig. 26.	Përshëndetja e fundit (beteja e Kumanovës)	71
III-2.	Ushtria greke merr Selanikun	71
Fig. 27.	Princi trashëgimtar i fronit të Greqisë marshon në Selanik	72
Fig. 28.	Mbretit Nikolla të Malit të Zi i dorëzohet flamuri turk, pasi trupat e tij futen në Shkodër, prill 1913	73
Fig. 29.	Mbreti bullgar Ferdinandi, mbi gërmadhat e kalasë së Kavallës	73
Fig. 30.	'Vëllazëria' greko-bullgare, karikaturë rumune	74
III-3.	Një ushtar serb ndihmon fëmijët turq	74

Fig. 31.	Fëmijë turq duke nderuar ushtarët serbë, 1912	75
III-4.	Riza Nuri shpjegon shkaqet e humbjes së osmanëve	75
III-5.	Major Milovan Gavriloviçi përshkruan mënyrën se si e kapi Shukri pashën	76
III-6.	Raport i atasheut ushtarak francez në Sofje, ku shpallet marrja e kalasë së Edrenesë nga ushtria bullgare	77
III-7.	<i>Adrianopoja ra!</i> (artikull në një gazetë rumune)	77
Fig. 32.	Zgjidhja e konfliktit turko-bullgar (karikaturë rumune, 1913)	78
<b>IIIb. Jeta në front</b>		79
III-8.	<i>Nga Mali Starac në Manastir: Ditari i një ushtari në Njësinë Mjekësore Danubiane paraqet gjendjen e ushtrisë serbe (Beteja e Kumanovës)</i>	79
III-9.	Përshkrim i vuajtjeve të kuajve, bërë nga një toger turk	79
Fig. 33.	Transportimi i ushtarëve të plagosur nga porti i Selanikut	80
III-10.	Gjendja e ushtrisë bullgare në Traki, përshkruar nga një francez	80
Fig. 34.	Mjeku çek, dr. Jan Leviti, në spitalin "Rrethi i Motrave Serbe"	80
III-11.	Një mjek kroat shpreh ndjenjat e tij pas një vizite në fushën e betejës pranë lumit Marica	80
III-12.	Izet Fuad pasha përshkruan mungesën e bukës për ushtarët turq	81
III-13.	Fragment nga kujtimet e një ushtari rumun	82
Fig. 35.	Kamp grek në rrethinat e Ksanthit	82
III-14.	Fragment nga ditari i Vasilis Surapasis, vullnetar grek	82
III-15.	Morali i ushtrisë bullgare (Analizë e shefit të Shtabit të Ushtrisë Bullgare, disa vite pas luftës)	83
III-16.	Kalimi i një ure të varur ushtarake mbi Danub, në Korabia (Nga kujtimet e një oficeri rumun)	83
III-17.	Takimi i ushtarëve turq me ata malazez në Shkodër, pasi qyteti ishte dorëzuar	83
<b>IIIc. Lufta paralel</b>		84
III-18.	Letër nga Ipokrat Papavasiliu, dërguar gruas së tij, Aleksandrës	84
III-19.	Komisioni Karnegi për Paqe Ndërkombëtare komenton humbjet 'paralele' nga djegia e fshatrave dhe nga eksodi i njerëzve	85
Fig.36.	Rrënojat e Serresit	85
III-20.	Largimi i myslimanëve, tetor 1912	86
III-21.	Ekzarkati Bullgar përpiqet të konvertojë myslimanët bullgarishtfolës në të krishterë	86
Fig.37.	Një karvan i Kryqit të Kuq Bullgar	86
III-22.	Raport mbi konvertimin e myslimanëve në të krishterë në Malin e Zi, 1913	87
III-23.	Deklaratë zyrtare e Shtabit të Përgjithshëm Bullgar kundër akteve të dhunës	87
III-24.	Shkatërrimet e shkaktuara nga lufta në fshatrat pranë Shkodrës dhe vuajtja e njerëzve që përpiqen të gjejnë një arsye "bindëse" për mjerimin e tyre (Rrëfim nga Meri Edit Durham)	88
Fig.38.	Njerëz të varfër e të uritur, të cilët pushtuan kopshtin e Konsullatës Italiane në Shkodër	89
Fig.39.	Bullgarët shpërndajnë bukë për popullin e uritur të Andrianopojës, prill 1913	89
<b>IIId. Në prapavijat e frontit të luftës</b>		90
III-25.	Përshkrimi i Beogradit nga një korrespondent i një gazete kroate	90
III-26.	Përshkrim i Stambollit nga një gazetar francez	91



Fig.40.	Shpërndarje ndihmash për familjet e ushtarëve të mobilizuar në luftën rumuno- bullgare, 1913	92
III-27.	Situata në Shkodër gjatë rrethimit të qytetit, e përshkruar nga një gazetar italian	92
Fig.41.	Në Cetinjë – gra, fëmijë dhe ushtarë të plagosur	93
III-28.	“Gruaja serbe”	93
III-29.	Një grua greke e shtresës së lartë shërben si infermiere dhe shkruan për këtë përvojë	94
Fig.42.	Gra serbe që mësojnë përdorimin e armëve, 1912	94
Fig.43.	Infermiere me pacientë ushtarakë, rreth vitit 1913	94
Fig.44.	Gra turke që shërbejnë si infermiere në Stamboll, 1912	95
Fig.45.	Të burgosur shqiptarë në Beograd, 1912	95
III-30.	Incident midis civilëve bullgarë dhe ushtarëve të armatosur rumunë në një tavernë në Bullgari (Përshkruar nga një oficer rumun)	96
III-31.	Turqit dhe hebrenjtë në Beograd gjatë Luftës së Parë Ballkanike	96
III-32.	Fëmijë që luajnë luftash në Beograd	96
Fig.46.	Fëmijë që luajnë luftash në Vranjë, Serbi	97
Fig.47.	Fëmijë që shërbejnë si infermierë në Podgoricë	98
Fig.48.	Komiteti i grave serbe të Kryqit të Kuq në Nju-Jork, që u themelua për të ndihmuar në mbledhjen e ndihmave për të plagosurit	98
III-33.	Veprimtari për grumbullimin e parave në Kroaci, për “vëllezërit sllavë të jugut”	99
Fig.49.	Vullnetar qipriot në Luftërat Ballkanike	99
III-34.	Vullnetarë dhe ndihma në para nga Qiproja	99
III-35.	Shtësit bullgarë të qumështit në Stamboll	100
Fig.50.	Reklamë qumështi në Greqi	101

## KAPITULLI IV: Fushat e betejës dhe spektatorët 103

<b>IVa. Provincat ballkanike të Perandorisë Osmane</b>	103	
IV-1.	Vendime në lidhje me qëndrimin që duhet të mbajë Shqipëria në rast të një lufte ballkanike – 14 tetor 1912	104
IV-2.	Herbert Adams Gibonsi shkruan për qëndresën që bëri Shkodra	104
Fig.51.	Përpara se të largoheshin nga Shkodra: një nënë malazeze dhe i biri i saj përpara varrit të të atit	104
IV-3.	Telegram i Kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, drejtuar ministrave të Punëve të Jashtme të Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë, 29 nëntor 1912	105
Fig.52.	Kryengritës shqiptarë nga Mirdita që përgatiten të shkojnë në luftë kundër ushtrisë turke, 1912 (përpara Luftës Ballkanike)	105
IV-4.	Relacioni i konsullit austro-hungarez, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Perandorisë Austro-Hungareze, Vlorë, 30 Nëntor 1912	105
IV-5.	Rreziqet që mund të sillte për paqen në Europë përcaktimi i kufijve të Shqipërisë – këndvështrim francez	106
IV-6.	Memorandum i një grupi intelektualësh maqedonas që jetonin në Shën Peterburg, më 7 qershor 1913, drejtuar “Qeverive dhe shoqërisë së shteteve aleate të Ballkanit”	106
Fig.53.	Diplomatë dhe përfaqësues ushtarakë grekë e serbë në malin Kajmakçalan për të biseduar caktimin e kufijve për copëtimin e Maqedonisë.	107
IV-7.	Ideja e një Maqedonie autonome, e vënë në pikëpyetje nga një gazetar francez, gusht 1912	107

<b>IVb. Territoret ballkanike të Austro-Hungarisë</b>	108
IV-8. <i>“Lufta në Ballkan 1912/13”</i> , libër i botuar në vitin 1914, në Lubljanë, Slloveni	108
IV-9. Këndvështrim slloven mbi situatën në Maqedoni	108
IV-10. <i>“Obzor” (Horizonti)</i> , gazetë e përditshme në Zagreb, 10 tetor 1912	109
Fig.54. Karikaturë kroate, 1912	110
IV-11. Autoritetet vendore habsburgase morën masa të veçanta në Bosnjë-Hercegovinë	110
IV-12. Ndalim i manifestimeve për mbledhjen e vullnetarëve në Bosnjë-Hercegovinë	111
IV-13. Vullnetarë serbë në Bosnjë-Hercegovinë	111

## **KAPITULLI V: Pas Luftës** 113

<b>Va. Pasojat politike</b>	113
Tab.15: <i>Sipërfaqja dhe popullsia e shteteve të Ballkanit para dhe pas Luftës</i>	113
Harta 2 dhe 3: <i>Ndryshimet territoriale në Ballkan Traktati i Londrës dhe Traktati i Bukureshtit</i>	114
V-1. <i>Finis Turquiae?</i> – koment i një gazetari francez, shkurt 1913	115
V-2. Fragment i shkëputur nga një artikull i një gazete bullgare, 26 korrik 1913	115
V-3. Nga fjalimi i Jovan Skerliçit, shkrimtar dhe deputet në Asamblenë Kombëtare të Serbisë, më 18 tetor 1913	115
Fig.55. <i>Çlirimi i Greqisë së robëruar</i> (litografi greke)	116
Fig.56. Konferenca e Paqes e Bukureshtit (karikaturë rumune)	117
V-4. Pasojat e Luftërave Ballkanike për Rumaninë, sipas vlerësimit të historianit rumun Konstantin Kiritesku	117
Fig.57. Flamurët e Fuqive të Mëdha mbi Kalanë e Shkodrës, maj 1913	117
Fig.58. Ushtria serbe në Manastir	118
V-5. Kujtimet e Martulkovit në lidhje me kontaktin e parë që ushtria serbe pati me qytetarët e qytetit të tij të lindjes, Veles, në vjeshtë të vitit 1912	118
Fig.59. Ndryshimet e emrave: nga Uskub në Skopje	118
V-6. Mbreti Petar i Serbisë u premtonte të drejta të barabarta të gjithë njerëzve që jetojnë në territoret e aneksuara nga Serbia, pavarësisht se mund të kenë origjinë të ndryshme etnike	119
V-7. Mbreti Nikolla i Malit të Zi premtonte tolerancë fetare për katolikët dhe myslimanët, pas nënshkrimit të Traktatit të Londrës, më 21 Nëntor 1913	119
V-8. Artikull në një gazetë rumune që flet për reagimin e popullit në krahinën e sapoaneksuar të Dobruhës Jugore, në përfundim të Luftës së Dytë Ballkanike	119
V-9. Interesat kombëtarë bullgarë	120
<b>Vb. Pasojat ekonomiko-shoqërore</b>	121
Tab.16: <i>Të vrarët dhe viktimat në Luftën Ballkanike</i>	121
Fig.60. <i>Apoteza e Luftës Ballkanike</i> – karikaturë rumune	121
V-10. Humbjet e ushtrisë serbe në Luftërat Ballkanike	122
V-11. Lufta e Parë Botërore: Luftë e një lloji tjetër	122
V-12. Serbia e Re – Rezultatet nga regjistrimi i popullsisë	122
Fig.61 dhe fig.62. Refugjatë	123
V-13. Numri dhe sistemimi i refugjatëve në Bullgari, sipas raportit të Kryeministrit V. Radoslavov në Asamblenë e 17-të Kombëtare	123
V-14. Refugjatë myslimanë në Selanik	123

Tab.17: Emigrantët ballkanas në Turqi	124
V-15. Pasojat ekonomike për Selanikun, sipas këndvështrimit të "Federatës Socialiste të Selanikut", 1913	124
<b>Vc. Pasojat ideologjike</b>	125
V-16. Pjesë nga një libër për klasat e pesta të shkollës fillore, më 1914	125
<b>Fig. 63.</b> Kopertina e një libri shkollor për klasat e pesta	125
V-17. Koment kritik për librat shkollorë grekë, marrë nga një raport i pedagogut dhe mbështetësit të gjuhës së folur, D. Glinos, shkruar më 1926	125
V-18. Artikull në shtypin malazez rreth dorëzimit të Shkodrës tek Fuqitë e Mëdha, prill 1913	126
V-19. Radikalizimi i ndjenjave kombëtare në Bullgari sipas poezive të Ivan Vazovit	126
V-20. Fragment nga kujtimet e Mihail Magjarovit, politikan bullgar i Partisë Popullore, ku shpreh hidhërimin për vdekjen e djalit të tij	127
V-21. Shkrimtari shumë i njohur kroat, Antun Gustav Matos, bën një përshkrim të fillimit të Luftës së Parë, në të cilin përziën hidhërimin për humbjen e miqve të tij serbë që vdiqën në luftë, me interpretime ideologjike tepër të skajshme	128
V-22. Rezultatet e Luftës sipas Komisionit Ndërkombëtar për Hetimin e Shkaqeve dhe Zhvillimin e Luftërave Ballkanike	128
V-23. Rajoni i Kilkisit, pas Luftërave Ballkanike	129
A. Ndjenjat e një turku, Ibosh Agës	129
B. Takim me një bullgar	129
V-24. <i>Frika</i> . Roman nga Nexhati Xhumali, mbi pasojat e Luftërave Ballkanike	130
Harta 4: <i>Europa Juglindore pas Luftërave Ballkanike</i>	132
<b>Bibliografia</b>	133



Luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913 janë ngjarje me rëndësi të veçantë për historinë e Europës Juglindore të shekullit të 20-të. Pasojat afatgjata të këtyre luftërave kanë ndikuar në zhvillimet politike, ekonomiko-shoqërore dhe kulturore të rajonit për disa dhjetëvjeçarë me radhë dhe disa nga këto pasoja, janë ende edhe sot subjekt i diskutimeve akademike, madje edhe atyre publike. Historiografitë e shteteve të përfshira në këto luftëra kanë dhënë interpretime kontradiktore, të cilat ndryshojnë jo vetëm nga njëri shtet në tjetrin, por edhe brenda një shteti. Në shtete të tilla si Bullgaria dhe Turqia, trauma e humbjes bëri që të kërkoheshin 'përgjegjësitë' për këtë, ndërkohë që 'shkaqet' e luftës kërkoheshin tek politika. Për arsye të ndryshme, në Serbi dhe Greqi, si vende fituese të luftës, Luftërat Ballkanike u interpretuan si të integruara në ngjarjet e tjera të mëvonshme, si Lufta e Parë Botërore, në rastin e Serbisë, ose Lufta në Azinë e Vogël, në rastin e Greqisë.

Rrënjët e Luftërave Ballkanike shtrihen më herët në kohë, qysh te pasojat e luftës ruso-turke të vitit 1877-1878, e cila shënoi përfundimin e Krizës Lindore të viteve 1875-1878, krizë që ishte nga më të ashprat në historinë e së ashtuquajturës Çështje Lindore. Kjo Çështje pati tri shkaqe kryesore: përplasjet diplomatike midis Fuqive të Mëdha për ndikim në territoret osmane; rënien e shkallëshkallshme të Perandorisë së sulltanit; si dhe lëvizjet për çlirim kombëtar të popujve të Ballkanit, që synonin krijimin e shteteve të tyre kombëtare. Kriza e viteve 1875-1878 u zgjidh nga Fuqitë e Mëdha në Kongresin e Berlinit. Ky kongres shpalli pavarësinë e Malit të Zi, Rumanisë dhe Serbisë, që përfituan territore të reja, ashtu si edhe Greqia dhe, nga ana tjetër, u krijua Principata Bullgare dhe Provinca Autonome e Rumelisë Lindore. Gjithashtu, reforma dhe autonomia duhej të zbatoheshin në territoret e tjera europiane në zotërim të Portës së Lartë, si në Shqipëri, Maqedoni, Epir etj. Qiproja u la nën administrimin britanik, ndërkohë që Austro-Hungaria pushtoi Bosnjë-Hercegovinën dhe Novi-Pazarin.

Megjithatë, Kongresi i Berlinit krijoi një sërë konfliktesh dhe tensionesh midis kombeve të Ballkanit sepse, kur vendosi kufijtë e rinj, ai nuk ndoqi parimin modern të kombësisë. Në fakt, për shumë vende ishte e pamundur që ta ndiqje këtë parim, sepse disa kombësi kishin jetuar së bashku për shekuj me radhë, kështu që, asnjë nga kombet e Ballkanit nuk e arriti bashkimin kombëtar brenda një shteti dhe ky bashkim u bë qëllimi kryesor i politikave të jashtme të këtyre vendeve. Kjo dëshirë solli si pasojë një sërë krizash: bashkimin e Rumelisë Lindore me Bullgarinë dhe, si rrjedhojë, luftën serbo-bullgare të vitit 1885, luftën greko-turke të vitit 1897, kryengritjen në Maqedoni në vitin 1903, aneksimin e Bosnje-Hercegovinës nga Austro-Hungaria, shpalljen e pavarësisë së Bullgarisë më 1908, kryengritjet shqiptare të viteve 1910-1912 dhe tensione të tjera më të vogla.

Pavarësisht nga kjo, prirja kryesore në historinë e vendeve të Ballkanit ishte zhvillimi paqësor dhe modernizimi i tyre. U bënë përpjekje për vendosjen e institucioneve dhe sistemeve politike moderne, liberale e kushtetuese, u bënë përpjekje, gjithashtu, për krijimin e një rrjeti të gjerë komunikimi, duke u përqendruar në ndërtimin e hekurudhave dhe rrugëve, ngritjen e industrisë dhe vendosjen e lidhjeve funksionale tregtare, të brendshme dhe të jashtme. Në çdo këndvështrim, vendet e Ballkanit synonin integrimin e tyre në botën europiane. Kjo solli një shpirt konkurrence dhe përparimi. Zhvillimi i kulturës kombëtare ishte një nga fushat kryesore që duhej modernizuar; për më tepër, kultura ishte hapësira ku pati më shumë konkurrencë. Në këtë fushë shteti veproi si ndërtuesi kryesor i identitetit kombëtar. Ndërkohë që të gjitha kombet e Ballkanit i krijuan shtetet e tyre kombëtare, tashmë ishte koha që këto shtete të forconin vetë kombin. Ndër mjetet më të përdorura për këtë qëllim ishin arsimit publik, festat kombëtare, ceremonitë dhe festimet, shërbimi ushtarak dhe kishat kombëtare. Fryma kombëtare mbizotëronte në çdo ngjarje dhe veprimtari.

Në të njëjtën kohë, të gjitha shtetet e Ballkanit u përpoqën të forconin ekzistencën e tyre duke krijuar mundësi për përfitime territoriale në të ardhmen, në kurriz të fqinjëve dhe, kryesisht, të Perandorisë Osmane. Motivimi për këto veprime gjendej që nga realiteti etnografik, gjeopolitik, ekonomik dhe deri te të drejtat historike dhe kulturore. Mjetet më të efektshme të kësaj politike të nacionalizmit shtetëror ishin shkollat “milet” dhe institucionet shoqërore të provincave osmane në Europë; për këtë qëllim u shfrytëzua dhe përplasja midis Patriarkanës së Stambollit dhe Ekzarkatit Bullgar. Gjithashtu, këto veprime mbështeteshin nga lloje të ndryshme nismash qytetare dhe irredentiste.

Gjatë dhjetëvjeçarit të parë të shekullit të 20-të, situata në Europë e nxiti edhe më tej këtë zhvillim. Krijimi i dy blloqeve ushtarake kundërshtarë, Antantës dhe Fuqive të Qendrës, ndikoi thellë në marrëdhëniet ndërbalkanike. Gjithashtu, gara për armatim dhe militarizmi u bënë tipar karakteristik i shoqërisë në Europën Juglindore. Buxheti i luftës i qeverive në Europën Juglindore arriti një të tretën e të gjitha shpenzimeve të këtyre shteteve. Ushtritë u dyfishuan në numër dhe u blenë nga Europa armatime të reja. Çdo gjë ishte përgatitur për luftë. Nën një trysni të përhershme të ushtruar nga ana e Antantës, dhe kryesisht nga ana e Rusisë, ideja për krijimin e një *bashkimi ballkanik*, i cili mund të zgjidhte problemet e shteteve ballkanike nëpërmjet bashkëpunimit, u bë tepër e përhapur. Ndërkohë, lufta italo-turke e vitit 1911-1912, prej së cilës Italia pushtoi Libinë dhe Ishujt e Dodekanezit, si dhe paqëndrueshmëria e vazhdueshme në territoret e Perandorisë Osmane në Europë, i nxitën edhe më shumë politikanët ballkanas drejt luftës.

Shpërbërja e Perandorisë Osmane u përshpejtua pas revolucionit të Turqve të Rinj të vitit 1908. Nacionalizmi turk i Komitetit për Bashkim dhe Përparim shtoi më shumë urrejtjen e të krishterëve, madje armiqësoi edhe ata që tradicionalisht i kishin qëndruar besnikë regjimit, shqiptarët. Kryengritja shqiptare e vitit 1911 paralajmëroi ndryshime thelbësore në drejtpeshimin e pushtetit në Ballkan. Fuqitë e Mëdha, veçanërisht Italia dhe Austro-Hungaria ishin të interesuara për fatin e Shqipërisë, ndërkohë që shtetet fqinje në Ballkan kishin synime territoriale ndaj këtij vendi. Udhëheqësit shqiptarë, përpara tmerrit të ndarjes midis fqinjëve të tyre - gjë tepër e mundur pas humbjes së turqve në luftën italo-turke - vendosën të organizonin një kryengritje të përgjithshme, në mënyrë që të fitonin autonominë e tyre. Në mes të korrikut të vitit 1912, kryengritësit shqiptarë kishin dalë fitues ndaj trupave turke dhe, më 30 korrik, kërkuan shpërndarjen e parlamentit turk brenda 48 orëve.

Në shkurt të vitit 1912 u nënshkrua një aleancë midis Serbisë dhe Bullgarisë dhe në maj të po atij viti, një marrëveshje e ngjashme u nënshkrua midis Greqisë dhe Bullgarisë. Në gusht të vitit 1912, midis Bullgarisë dhe Malit të Zi u arrit një marrëveshje gojore. Përpjekjet për të përfshirë edhe Rumaninë në Lidhjen Ballkanike dështuan. Kjo lidhje u krijua nën kontrollin e rreptë të Antantës dhe planet e saj ishin që ajo të përdorej në luftën botërore që po përgatitej, por interesat e Lidhjes Ballkanike i ndryshuan këto plane. Këto shtete ndërmorën nismën të ushtronin trysni mbi qeverinë turke, për reforma dhe autonomi në Shqipëri dhe Maqedoni. Kur Porta e Lartë nuk i pranoi këto kërkesa, në fillim të tetorit të vitit 1912 nisi lufta, pavarësisht nga përpjekjet e Fuqive të Mëdha për ta shtyrë atë.

Deri në fillim të nëntorit, kur faza e parë e luftës kishte mbaruar, Lidhja Ballkanike kishte dalë fitimtare. Ushtria bullgare i ishte afruar Stambollit dhe Selanikut, ushtria greke hyri në qytetin e Selanikut dhe shtiu në dorë pjesë të Epirit dhe Maqedonisë, ushtria serbe mori Kosovën, Novi-Pazarin, Shqipërinë Veriore dhe pjesë të Maqedonisë. Ushtria malazeze mori pjesë të Sanxhakut, të Metohisë, si dhe Shkodrën. Flota greke bllokoi komunikimin osman në detin Egje, ndërsa flota bullgare bëri të njëjtën gjë në Detin e Zi. Në fund të nëntorit u vendos armëpushimi, por Greqia nuk e pranoi dhe vazhdoi luftën duke marrë ishujt Limnos, Lesbos, Kios dhe Samos, në Egjeun Lindor dhe përparoi në Shqipërinë Jugore.

Bisedimet për paqe nisën në fillim të dhjetorit 1912, në Londër, ku ambasadorët e Fuqive të Mëdha mbajtën një konferencë rreth kushteve të paqes. Aleatët ballkanikë u munduan të përfitonin të gjitha territoret osmane në Europë, në perëndim të vijës Midia-Rodosto, si dhe ishujt e Egjeut, duke përfshirë këtu edhe ishullin e Kretës. Porta e Lartë sugjeroi që t'i jepte autonominë Shqipërisë dhe Maqedonisë, por pa humbur territore. Marrëveshja e propozuar nga Fuqitë e Mëdha ishte e ngjashme me atë të propozuar nga

aleatët ballkanikë. Kjo gjë shkaktoi një grusht shteti në Stamboll dhe qeveria e re i ndërpreu negociatat dhe, në mes të janarit të vitit 1913, filloi përsëri veprimet luftarake.

Faza e dytë e luftës zgjati për gati tre muaj. Kundërsulmet turke në Trakinë Lindore u zbrapsën nga ana e ushtrisë bullgare; ushtria malazeze mori Kalanë e Shkodrës, ushtria greke Kështjellën e Janinës dhe ajo bullgare Adrianopojën.

Negociatat e paqes rifilluan në Londër dhe, më 17 maj 1913, u nënshkrua marrëveshja e paqes. Aleatëve iu dhanë të gjitha territoret turke në Europë, në përfundim të vijës Midia-Enos, gjithashtu edhe ishulli i Kretës. Aleatët tashmë duhet të ndanin midis tyre fitimet e luftës dhe ky problem thelbësor solli edhe shpërbërjen e Lidhjes Ballkanike. Ndërkohë, Rumania mëtonte të kompesohej me Dobrukhën Jugore. Në fillim, Bullgaria nuk pranoi t'ia përmbushte këtë kërkesë, por në prill të vitit 1913, në Konferencën e Shën Peterburgut pranoi t'i jepte asaj qytetin e Silistrës. Gjithsesi, ndarja e plaçkës së luftës ende nuk kishte përfunduar.

Burrat e shtetit në Ballkan përdorën të gjitha argumentet e mundshme për të fituar sa më shumë territore. Molla e sherrit ishte Maqedonia, ku vendosja e kufijve doli një problem pothuajse i pazgjydhshëm. Ndërkohë që ndarja midis Serbisë dhe Greqisë ishte më e lehtë, synimet e Bullgarisë cenonin zonat e pushtuara nga Greqia dhe Serbia. Në Ballkan, partitë opozitare ishin tepër radikale dhe kërkonin një luftë tjetër, por kësaj here kundër aleatëve të mëparshëm. Organizatat irredentiste kërcënuan me vdekje ministrat e tyre, nëse ata pranonin të bënin lëshime. Pavarësisht nga këto, qeveritë u munduan të merren vesh dhe të mundësonin marrëveshje midis ushtrive për caktimin e kufijve dhe, në shumë aspekte, qenë të suksesshme. Tensioni gjithmonë në rritje u shfaq në përplasje të vogla midis aleatëve.

Më 19 maj 1913, Greqia dhe Serbia nënshkruan një pakt për aleancë dhe rregullim të përgjithshëm të territoreve. Përpjekja ruse për të mbajtur një konferencë tjetër me kryeministrat ballkanas në Shën Peterburg, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve territoriale, ishte e vonuar dhe jo e efektshme. Më 16 qershor 1913, mbreti Ferdinand urdhëroi gjeneralin Savov të sulmonte frontin serb dhe atë grek në Maqedoni. Lufta e Dytë Ballkanike (midis aleatëve) filloi. Greqia, Serbia dhe Mali i Zi i shpallën luftë Bullgarisë dhe u mbështetën edhe nga Rumania. Gjithashtu, Perandoria Osmane i drejtoi ushtritë e saj kundër Bullgarisë. Pas më shumë se një muaji luftimesh të përgjakshme, Fuqitë e Mëdha ndërhyjnë përsëri dhe ndalën veprimet ushtarake. Traktatet e Bukureshtit dhe të Stambollit vendosën rregullimin e ri të territoreve në Europën Juglindore. Rumania mori Dobrukhën Jugore. Serbia mori Kosovën, Novi-Pazarin dhe Maqedoninë e Vardarit. Greqia mori Epirin dhe Maqedoninë e Egjeut dhe ishullin e Kretës. Mali i Zi aneksoi qytetet e mëposhtme: Pljevlja, Bijello Polje, Berane, Rozhaje, Plavë, Pejë dhe Gjakovë. Bullgaria mori Maqedoninë e Pirinit dhe Trakinë Perëndimore. Perandoria Osmane rimori Trakinë Lindore. Shqipëria u shpall shtet i pavarur.

Luftërat Ballkanike krijuan një situatë të re në gadishull. Asnjë nga këto shtete nuk ishte plotësisht i kënaqur me kufijtë e rinj, por kjo pakënaqësi ishte më e theksuar për Perandorinë Osmane, Bullgarinë dhe Shqipërinë. Greqia kërkonte ishujt e Egjeut, Serbia donte një dalje në det dhe Bosnjë-Hercegovinën; Mali i Zi kërkonte Shkodrën dhe Rumania kishte pretendimet e saj në Transilvani dhe Besarabi. Këto synime karakterizonin politikën e shteteve ballkanike në fillim të Luftës së Parë Botërore, e cila nisi në Ballkan dhe u konsiderua nga shumë bashkëkohës dhe historianë si lufta tjetër ballkanike, por kësaj here me përfshirjen e Fuqive të Mëdha.

Në të njëjtën kohë, Luftërat Ballkanike ngjallën urrejtje, dyshim dhe frikë tek popujt e Ballkanit. Rrëfenjat kombëtare zëvendësuan kujtimet vetjake dhe ndjenjat e përbashkëta dhe krijuan për kombet fqinjë imazhin e armikut. Trauma psikologjike e luftës, e cila kishte ekzistuar për shumë vite në të gjitha shtetet ndërluftuese, u përforcua nga një traumë e re, e cila u shkaktua nga Lufta e Parë Botërore dhe ishte tepër e fortë në Perandorinë Osmane dhe Bullgari. Ajo u mbryjt për dekada me radhë nga familjet e refugjatëve dhe ndikoi në kujtesën kolektive të çdo kombi në Ballkan. Në këtë kontekst, luftërat forcuan ndjenjat dhe identitetin kombëtar, duke forcuar idenë e solidaritetit kombëtar dhe fatit të përbashkët.

Qëllimi i këtij libri pune është që të ndryshojë mënyrën tradicionale të paraqitjes së Luftërave Ballkanike në shkollat dhe univeristete, si ngjarje kryesive politike, ku personazhet kryesorë janë mbretër, ministra dhe

gjeneralë. Sigurisht që ata luajtën rol të rëndësishëm, por veprimet ushtarake u zbatuan nga njerëz të rangjeve më të ulëta; njerëz të cilët në jetën normale ishin civilë. Gjithashtu, luftërat ndikuan në jetën e përditshme të të gjithë shoqërisë. Ideja e përgjithshme se lufta është diçka që ka të bëjë vetëm me beteja, fitore dhe humbje, është larg asaj që ndodh në realitet, ku njerëzit e zakonshëm vuajnë në kurriz vështirësitë e luftës, duke patur edhe frikën e humbjes së të afërmeve të tyre. Në ato kohë të vështira ka patur veprime mizore dhe krime, por, gjithashtu, akte humanizmi dhe solidariteti. Madje edhe në llogore, edhe gjatë armëpushimit, marrëdhëniet njerëzore zhvilloheshin midis vijave të luftimit, si pasojë e vuajtjes së përbashkët.

Ideja jonë është që të paraqesim krahasim për krahasim aspektet e ndryshme të luftërave dhe mënyrën me të cilën ato u perceptuan nga grupe të ndryshme në Europën Juglindore. Metoda krahasuese do të na bëjë të mundur të kuptojmë këndvështrimet e ndryshme për proceset historike, duke mbajtur parasysh jo vetëm qëndrimet e ndryshme të shteteve dhe kombeve, por, gjithashtu, edhe rrymat e ndryshme brenda një shoqërie që përkufizohet si "homogjene". Duke krahasuar këndvështrimet e ndryshme të përvijuara në atë kohë, por edhe ato më të vonshmet, më modernet, do të shmangim iluzionin e një historie të vetme, ku relativiteti i "së vërtetës" shihet si pengesë për të kuptuar të shkuarën.

Ky libër duhet të lexohet paralelisht me tre librat e tjerë dhe duke përqasur njohuritë që jepen. Së pari, sepse ai është vazhdimësi e librit të parë, i cili përshkruan fillimet e shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Së dyti, sepse ai ka ndërlidhje me librin e dytë, i cili ndjek procesin e krijimit të kombeve në Europën Juglindore. Luftërat Ballkanike ishin një episod i rëndësishëm në konsolidimin e shteteve kombëtare në Ballkan dhe në kulmimin e nacionalizmit antagonist. Së fundi, libri i katërt, i cili mbulon periudhën e Luftës së Dytë Botërore mund të përdoret si një pikë referimi, në mënyrë që të kuptohen më mirë dukuritë dhe përvojat e luftës në shekullin e 20-të.



## Kronologji

Viti	Muaji	Ngjarja
1911	Verë	Rigjallërimi i lëvizjes kombëtare shqiptare
	Mesi i korrikut	Sulmi i Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase (OBRM) në Shtip, Maqedoni. Raprezaljet osmane nxisin fillimin e bisedimeve midis Bullgarisë dhe Serbisë.
	16 shtator	Italia i shpall luftë Perandorisë Osmane që të marrë Libinë
1912	16 maj	Arrihet marrëveshja sekrete bullgaro-greke për aleancë mbrojtëse
	21-27 maj	Italia merr lshujt Dodekanezë
	19 korrik	Sulm i organizatës OBRM në Kozan, Maqedoni. Ndëshkimet osmane mbushin me zemërim shtetet e krishtera në Ballkan
	30 korrik	Kryengritësit shqiptarë kërkojnë që të shpërndahet brenda 48 orësh parlamenti osman dhe paraqesin kërkesat e tyre të veçanta për autonomi (katër vilajetet e Shkodrës, Kosovës, Janinës dhe Manastirit të bashkohen në një provincë; shqiptarët të kryejnë shërbimin ushtarak vetëm në vendin e tyre; gjuha e administratës dhe shkollave të jetë shqipja; të gjithë shqiptarët të kenë të drejtën e mbajtjes së armëve).
	(rreth) 15 gusht	Arrihet marrëveshja gojore midis Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi: Bullgaria i jep hua ushtarake Malit të Zi dhe paguan ushtrinë malazeze në kohë lufte. Mali i Zi pranon të sulmojë Portën e Lartë, pa u provokuar prej saj.
	15 shtator	Nga qeveria serbe, dërgohet në ambasadat e saj udhëzimi sekret me nr.5669, për përfshirjen e Ohrit dhe Prilepit në shtetin serb.
	17 shtator	Ultimatum i Lidhjes Ballkanike (Bullgarisë, Greqisë, Malit të Zi, Serbisë), drejtuar Portës: për autonomi të menjëhershme të Maqedonisë, sipas Traktatit të Berlinit. Shpallet gjendja e jashtëzakonshme në Turqi dhe në vendet e Ballkanit (më 18 shtator).
	18 shtator	Krijohen 70 çeta të vogla me veprimtarë të OBRM-së në Sofje, për aksione zbulimi dhe sabotimi në Maqedoni dhe Traki.
	22 shtator	Arrihet një pakt ushtarak sekret midis Bullgarisë dhe Greqisë.
	23 shtator	Nga refugjatë të udhëhequr prej gjeneralit Petar Darvingov, krijohen NJVN-të (Njësitë Vullnetare të Ndihmës) Maqedoni-Adrianopojë - rreth 14 600 veta.
	26 shtator	Ushtria malazeze sulmon forcat ushtarake të Portës së Lartë.
	28 Shtator	Ushtria malazeze merr Bijello Poljen.

Viti	Muaji	Ngjarja
1912	2 tetor	Nënskruhet Traktati i Paqes midis Italisë dhe Perandorisë Osmane në Uçi.
	3 tetor	Porta e Lartë nuk pranon ultimatumin dhe ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Bullgarinë, Malin e Zi dhe Serbinë, por përpiqet të përmirësojë marrëdhëniet me Greqinë.
	4 tetor	Perandoria Osmane u shpall luftë Aleatëve. Të nesërmen, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi dhe Serbia (më 7 tetor) i shpallin luftë Portës. Fillojnë veprimet ushtarake. Rumania shpallet asnjansë.
	7-15 tetor	Trupat bullgare marrin Rodopet Perëndimore dhe ndalin kundërmësymjen osmane (15-25 tetor).
	8-13 tetor	Armata e Parë dhe e Tretë Bullgare thyjnë vijën e parë të frontit osman në Eskipolos-Petra, marrin Lozengradin dhe Armata e Dytë Bullgare rrethon Adrianopojën. Më 13 tetor, ushtria serbe merr Shkupin, Kumanovën, Velesin dhe Shtipin, në Maqedoni.
	9-10 tetor	Ushtria greke fiton betejën e Sarantaporës.
	15 tetor	Në territoret e reja në Maqedoni dhe Kosovë vihet në zbatim sistemi administrativ serb; ushtria malazeze merr Pljevljën.
	16 tetor	Për herë të parë në historinë ushtarake, prej forcave ajrore bullgare bombardohet nga avionët fortësia e Adrianopojës.
	17 Tetor	Ushtria malazeze merr Pejën.
	17-20 tetor	Armata e Parë dhe e Tretë Bullgare thyjnë vijën e dytë mbrojtëse osmane Ljule-Burgas-Bunarhissar.
	19-20 tetor	Ushtria greke fiton betejën e Janicës.
	27 tetor	Në Rumani krijohet qeveria e re, e drejtuar nga Titu Maioresku.
	28 tetor	Ushtria greke hyn në Selanik (i cili u dorëzua më 27 tetor), në mëngjes, dhe Divizioni Bullgar Rila hyn në qytet, mbasdite. Fillon mosmarrëveshja për Selanikun.
	29 tetor	Porta e Lartë i kërkon Sofjes armëpushim, por qeveria bullgare, e detyruar nga mbreti Ferdinand I e shpërfill këtë propozim dhe ua mban të fshehur Aleatëve.
	1 nëntor	Në Rodope fillon procesi i konvertimit të Pomakëve në të krishterë. Në dhjetor dërgohet atje një mision kishtar bullgar.
	4-5 nëntor	Armata e Parë dhe e Tretë Bullgare sulmojnë pa sukses vijën e tretë të frontit mbrojtës osman në Çatalxha.

Viti	Muaji	Ngjarja
1912	4-9 nëntor	Deklaratat e Komitetit Qendror të OBRM-së kundër veprimtarisë serbe dhe asaj greke në Maqedoni.
	9 nëntor	Në territoret e reja fillon të veprojë administrata bullgare.
	14 nëntor	NJVN Maqedoni-Adrianopojë thyen forcat osmane në Trakinë Perëndimore.
	18 nëntor	Shoqata rumuno-maqedonase shtyn qeverinë që të veprojë.
	20 nëntor	Armëpushim ndërmjet Aleatëve dhe Portës. Greqia nuk pranon armëpushimin dhe vazhdon veprimet ushtarake në Epirin e Veriut
	20-21 nëntor	Konflikti i parë midis trupave bullgare dhe greke pranë Selanikut, i cili u zgjidh në fund të muajit.
	28 nëntor	Një kongres kombëtar, i mbledhur në Vlorë, shpall pavarësinë e Shqipërisë.
	3 dhjetor	Beteja greko-turke në det, pranë ishullit Elli.
	3-24 dhjetor	Konferenca e Paqes e Londrës. Aleatët kërkojnë të gjitha provincat osmane në Europë, në perëndim të vijës Midio-Rodosto, si dhe Kretën. Porta propozon t'i japë autonominë Maqedonisë dhe nuk pranon të lëshojë territore. Ditën e Krishtlindjeve, Porta e Lartë largohet nga negociatat; Fuqitë e Mëdha ushtrojnë trysni ndaj saj (nota e 4 janarit 1913) dhe propozimet e Aleatëve pranohen. Konferenca e Ambasadorëve në Londër shpall se Shqipëria duhet të bëhet shtet i pavarur (20 dhjetor).
	8-17 dhjetor	Në Kostandinopojë shkon një mision sekret bullgar, për të arritur paqe veçmas me Perandorinë Osmane.
1913	5 janar	Beteja greko-turke në det, në Limnos.
	16 janar	Protokolli bullgaro-rumun në Londër, për të rregulluar kufirin e dy vendeve në Dobrukhë. Nën trysninë e Ruisë, Sofja është e gatshme të rishikojë kufirin.
	21 janar	Porta e Lartë shkel armëpushimin dhe fillon veprimet luftarake me parullën "Sofjen ose vdekje!"
	26-28 janar	Fillojnë kundërsulmet osmane në Galipoli e Çatalxha dhe trupat bullgare zbrapsin zbarkimin në Sharkjoi.
	30 janar - 2 shkurt	Në Sofje, negociatat bullgaro-rumune për çështjen e Dobrukhës dalin pa sukses.
	5 shkurt	Përtërihet traktati i fshehtë midis Rumanisë dhe Austro-Hungarisë.

Viti	Muaji	Ngjarja
1913	21 shkurt	Ushtria greke merr Janinën. Ndodhin incidentet bullgare-greke në Nigrita.
	5 mars	Në Selanik vritet mbreti i Greqisë, Georgi i Parë.
	11-13 mars	Ushtria bullgare merr Adrianopojën.
	18 mars - 26 prill	Me Fuqitë e Mëdha zhvillohet Konferenca e Shën Peterburgut për çështjen e Dobruxhës. Bullgaria i lëshon Rumanisë, Silistrën dhe garanton privilegjet e vllëve në Maqedoni, porgjendja mbetet e tensionuar
	10 prill	Ushtria malazeze merr kalanë e Shkodrës.
	11 Prill	Ushtria malazeze pushton Shkodrën.
	13 prill	Armëpushim midis Portës dhe Lidhjes Ballkanike.
	22 prill	Nënshkruhet protokollin greko-serb, i cili pasohet nga një pakt ushtarak (1 maj 1913).
	1 Maj	Mali i Zi lëshon Shkodrën nën ultimatumin e forcave ushtarake të Fuqive të Mëdha.
	17 maj	Konferenca e Paqes në Londër.
	19 maj	Marrëveshja greko-serbe në Selanik.
	19-21 maj	Në Selanik, takimet e komisionit bullgare-grek për përcaktimin e kufijve arrijnë mirëkuptimin. Në fund të muajit përfundon caktimi i kufijve, me disa përjashtime.
	26 Maj	Mali i Zi mbështet Serbinë në luftën kundër Bullgarisë dhe dërgon një njësi me 12 000 ushtarë në ndihmë të saj.
	30 maj	Serbia shkëput lidhjet hekurudhore me Bullgarinë.
	1 qershor	Jep dorëheqjen kryeministri bullgar Iv. Ev. Geshov, i cili zëvendësohet nga Stojan Danev. Në Beograd jep dorëheqjen kryeministri N. Pashiq. Këto veprime bëhen për të ushtruar trysni mbi Rusinë, në lidhje me vendimin që do të merret në konferencën e paqes.
	5-13 qershor	Përplasje ushtarake midis forcave bullgare dhe atyre serbe në rrethinat e Zietovos.
	15 qershor	Në Tikvesht, pas shpinës së ushtrisë serbe fillon kryengritja e OBRM-së, me miratimin e Komandës së Përgjithshme Bullgare.
	16 qershor	Me urdhër të mbretit Ferdinand I, trupat bullgare sulmojnë ushtrinë serbe, në mënyrë që t'u vijnë në ndihmë kryengritësve. Trupa të tjera bullgare marrin portin e Lefteras dhe bombardojnë anijet greke që ndodhen atje. Fillon Lufta e Dytë Ballkanike.
	18 qershor	Qeveria bullgare ndërpret të gjitha veprimet ushtarake dhe zëvendëson gjeneralin kryekomandant, me gjeneralin prorus, Radko Dimitriev. Qeveria ruse propozon mbajtjen e një konference.
	19-21 qershor	Beteja midis Bullgarisë dhe Greqisë në Kukush/Kilkis.

Viti	Muaji	Ngjarja
1913	21 qershor - 11 korrik	Mësymja greke në Maqedoninë Lindore arrin në Simitle (13 korrik), ku ndalet nga ushtria bullgare. Më 15 korrik, ushtria greke merr Trakinë Perëndimore.
	22-28 qershor	Ushtria bullgare merr Pirotin e Serbisë.
	28 qershor	Rumania i shpall luftë Bullgarisë dhe më 5 korrik pushton Bullgarinë Veriore, pa hasur qëndresë. Më 11 korrik, Austro-Hungaria ndalon përparimin e forcave rumune.
	30 qershor	Porta e Lartë fillon përparimin e trupave në Trakinë Lindore dhe merr Adrianopojën (10 korrik).
	3 korrik	Ushtria rumune pushton Varnën e Bullgarisë më 6 korrik. Një njësi trupash kalorësie rumune arrin në Sofje.
	4 korrik	Në Bullgari krijohet një qeveri e re proaustriake, e udhëhequr nga Vasil Radoslavovi.
	13 korrik	Kryengritja e popullsisë myslimane në Trakinë Perëndimore kundër trupave bullgare që po tërhiqeshin – “Republika Gjurmurxhina/Komotini”
	15-17 korrik	Kundërmësymje e forcave bullgare kundër ushtrisë greke pranë Kresnas.
	29 korrik	Konferenca e Ambasadorëve vendosi që Shqipëria të bëhej “principatë e pavarur sovraane”. Fuqitë e Mëdha zgjedhin princin Vilhelm Vid, një kapiten ushtarak gjerman 35 vjeçar, për të qenë sundimtari i Shqipërisë. Më 3 shtator 1914, Princ Vidi largohet nga vendi.
	17 korrik - 16 gusht	Konferenca e Paqes në Bukuresht; armëpushimi arrihet më 18 korrik.
	25 korrik -15 gusht	Ushtria rumune largohet nga Bullgaria.
	16 shtator	Marrëveshja e Paqes e Stambollit ndërmjet Bullgarisë dhe Portës së Lartë. Kjo e fundit rimerr Trakinë Lindore, me rregullime të kufirit në dobi të Bullgarisë, ndërkohë që Bullgaria merr Trakinë Perëndimore.
	1 nëntor	Nënskruhet në Athinë Traktati i Paqes midis Greqisë dhe Portës së Lartë.
	19 nëntor	Protokolli i Firences. Komisioni i caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër për vendosjen e kufijve, përcakton kufirin jugor të Shqipërisë, duke i dhënë Shqipërisë Korçën dhe Gjirokastrën, të pushtuara nga Greqia.

Viti	Muaji	Ngjarja
1914	13 shkurt	Greqia merr të gjithë ishujt e Egjeut Lindor, përveç Imvros, Tenedos dhe Kastellorizos dhe tërheq trupat nga territoret që iu caktuan Shqipërisë.
	28 shkurt	Grekët e Shqipërisë së Jugut (quajtur prej tyre Epiri Verior) shpallin pavarësinë, nën udhëheqjen e G.Ch. Zografit, ish- ministër i jashtëm i Greqisë.
	28 korrik	Në Sarajevë, Bosnjë, vritet princi trashëgimtar, Franc Feridinandi. Vjena i dërgon Beogradit një ultimatum – fillon <i>kriza e korrikut</i> .
	1 gusht	Austro-Hungaria i shpall luftë Serbisë – shpërthen Lufta e Parë Botërore. Të gjitha shtetet e tjera ballkanike shpallen asnjane.

## KAPITULLI I: Ekonomia dhe shoqëria

Megjithëse luftërat e fillimshkullit të 20-të (Luftërat Ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore) janë interpretuar si ngjarje që erdhën si pasojë e kulmimit të nacionalizmit në Europë, ato nuk mund të kuptohen nëse shqyrtojmë vetëm politikat dhe ideologjitë e kësaj periudhe. Kuptimi më në thellësi i ndryshimeve ekonomike dhe shoqërore, si në planin global, edhe në atë rajonal, është më se i nevojshëm, që të kemi qëndrim të argumentuar në lidhje me këto luftëra që ndryshuan hartën e Europës Juglindore.

Në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të, të gjitha shtetet e Ballkanit, pavarësisht nga ndryshimet shoqërore, karakteristikat ekonomike dhe sistemet politike, ishin shembull i një zhvillimi të shpejtë ekonomiko-shoqëror. Rritja e popullsisë dhe zgjerimi i qyteteve, ndërtimet publike mbresëlënëse, zhvillimi i industrisë, zgjerimi i marrëdhënieve tregtare dhe shtrirja e sistemit arsimor ishin tiparet më të rëndësishme në procesin e modernizimit. Kjo prirje u shoqërua me ngritjen e ushtrive dhe flotave, si dhe me një garë të vërtetë armatimi përgjatë dekadës që parapriu Luftërat Ballkanike.

Ana tjetër e këtij zhvillimi ekonomik ishte marrja e huave dhe futja në borxhe e të gjitha shteteve të Ballkanit, çka solli kontrollin e ekonomive vendase nga shtete të huaja, për të shmangur falimentimin e tyre ose, ndonjëherë, ky kontroll erdhi si pasojë e falimentimit (siç ishte rasti i Greqisë në vitin 1893). Si Perandoria Osmane, ashtu edhe shtetet e Ballkanit pësuan vërshim të vrullshëm ekonomik perëndimor 'në epokën e imperializmit dhe kapitalizmit', siç thekson edhe L.S. Stavrianos, epokë e cila karakterizohej nga një 'garë për perandori' dhe këmbëngulja nga ana e Perëndimit të industrializuar për të përfutur tregje të jashtme.

Huatë e marra përdorshin kryesisht për të ndërtuar hekurudha, të cilat ishin në përputhje ose plotësonin interesat ekonomike dhe politike të Perëndimit në Europën Juglindore. Interesat britanikë favorizuan ndërtimin e hekurudhave që fillonin në portet bregdetare dhe shtriheshin në brendësi të Ballkanit, çka lehtësonte zhvillimin e tregtisë britanike në gadishull. Austria ndërkaq ishte e interesuar që të ndërtohej një linjë hekurudhore veri-jug, që do të kalonte nëpër Bosnjë dhe Serbi, deri në Selanik. Pas Luftës së Krimesë, në Ballkan nisi ndërtimi i hekurudhave, si shenjë e mbizotërimit të modelit perëndimor të zhvillimit ekonomik, por, gjithashtu, duke pasqyruar edhe interesat konfliktuale ekonomike dhe politike të Fuqive të Mëdha.

Për më tepër, ngritja e ekonomisë së tregut e, për pasojë, kalimi nga ekonomia tradicionale në një ekonomi të bazuar tek shkëmbimi me para, si dhe mbipopullimi, patën pasojat të pakëndshme për fshatarët ballkanas, të cilët vuanin nga mungesa e tokës dhe detyroheshin të emigronin. Zhvillimi industrial ishte disi i ngadaltë dhe të gjitha vendet e Ballkanit mbetën kryesisht bujqësore.

Megjithatë, urbanizimi, futja e teknologjive të reja dhe zhvillimi i transportit, si dhe zgjerimi i sistemit shkollor fillor, ndikuan ndjeshëm në jetën e njerëzve jo vetëm në qytet, por edhe në fshat. Ndryshimet në mentalitet, në jetën e përditshme dhe në mënyrën e jetesës, së bashku me vendosjen e shtetit modern burokratik po lëkundnin nga themelet shoqëritë tradicionale.

Në këtë kapitull hidhet një vështrim i përgjithshëm në shoqërinë ballkanike të paraluftës, duke vënë në dukje ndryshimet e kësaj shoqërie me shoqërinë e vendeve të ndryshme të Europës Perëndimore, Qendrore e Jugore në të njëjtën periudhë kohore. Nënkapitulli i parë trajton ndryshimet demografike dhe ato shoqërore, si dhe pasojat që lindin prej tyre: njerëz që jetojnë në qytete tradicionalisht multietnike, siç ishte Selaniku – një qytet-port tipik shumëgjuhësh i Perandorisë Osmane, njerëz që emigrojnë në Amerikë, në kërkim të ëndrrës për një jetë më të mirë, fshatarë që punojnë tokën e tyre ose rritin dhen. Nënkapitulli i dytë paraqet zhvillimin ekonomik, duke e dokumentuar në aspekte të ndryshme, si: buxhetet e shteteve, marrëdhëniet tregtare, bujqësia, industria dhe ndërtimi i hekurudhave. Së fundi, në nënkapitullin e tretë trajtohen ndryshimet kulturore dhe teknologjike, të cilat ndikuan ndjeshëm në jetën e njerëzve: shkollimi ose arsimimi, kinemaja dhe telegrafi, biçikletat dhe mënyrat e reja për të kaluar kohën janë vetëm disa nga çështjet që trajtohen dhe që mund të na ndihmojnë për të kuptuar më mirë dhjetëvjeçarin, i cili u parapriu Luftërave Ballkanike.

## Ia. Popullsia

**TABELA 1**  
**Rritja e popullsisë së Ballkanit në vitet 1878-1912**

	Rumania	Bullgaria	Serbia	Greqia
Data e regjistrimit	(në mijëra)			
1878-79	4 486			1 679
1880		2 823		
1884			1 902	
1887		3 154		
1889-90	5 038		2 162	2 187 <sup>1</sup>
1892		3 311		
1894	5 406			
1895-96			2 312	2 434
1899-1900	5 957	3 744	2 494	
1905		4 036	2 689	
1907				2 632
1910		4 338	2 912	
1912	7 235			

Burimi: Jackson-Lampe, f.166.

? Llogaritni përqindjen e rritjes së popullsisë për çdo shtet. Krahasoni rezultatet dhe përpikuni të shpjegoni ndryshimet nga njëri shtet në tjetrin. Cilët qenë faktorët që ndikuan në rritjen e popullsisë së shteteve të Ballkanit?

### ► Fig. 1. Manastiri / Bitola



Muzeu Historik Kombëtar, Athinë, K2 1581.

? Cilave besime fetare mendoni se u përkasin banorët e këtij qyteti?

<sup>1</sup> Në vitin 1881, Greqia aneksoi provincat e Thesalisë dhe Artës, çka shpjegon rritjen e popullsisë. Në mënyrë që të kuptohen më mirë ndryshimet demografike në përgjithësi, duhen marrë parasysh ndryshimet e bëra në kufijtë shtetërore në këtë periudhë.



**TABELA 2**  
**Popullsia e qyteteve dhe e kryeqyteteve në shtetet kombëtare të Ballkanit gjatë viteve, 1860-1910**

	Rumania		Bullgaria		Serbia		Greqia	
	Pop. Gjithsej (mijëra)	Urbane %	Pop. Gjithsej (mijëra)	Urbane %	Pop. Gjithsej (mijëra)	Urbane %	Pop. Gjithsej (mijëra)	Urbane %
1860-61	3 918	12						
1874					1 354	11		
1877-79	4 486				1 700		1 654	18
1884	4 862		3 024	18	1 902	12		
1889-90	5 318	17	3 232	19	2 162	13	2 187	
1895-96	5 710		3 441		2 312	14	2 434	
1899-1900	5 957	19	3 716	19	1 493	14		
1907	6 684						2 632	24
1910	6 996	18	4 306	19	2 912	14		
	Pop. Urbane	Bukuresht	Pop. Urbane	Sofje	Pop. Urbane	Beograd	Pop. Urbane	Athinë
1860-61	313	122						41
1874					174	27		
1877-79		177	543	20			293	63
1884					236	35		
1889-90		220	610	45	286	54	465	108
1895-96					319	59	526	
1899-1900	1 120	276	700	67	351	70		111
1907							628	167
1910	1 195	341	829	103	483	90		

Shënim: (a) Më së paku 2000 banorë

Burimi: Jackson-Lampe, f. 240.



Komentoni rritjen e popullsisë urbane, në krahasim me rritjen e popullsisë së përgjithshme të Ballkanit. Përse popullsia e kryeqyteteve kishte prirjen të rritej më shpejt sesa ajo e zonave të tjera? Krahasoni këto statistika me të dhëna bashkëkohore: Çfarë përqindjeje të popullsisë përbën pjesa urbane?

► **Fig. 2. Gra në Kostur, fillimi i shekullit të 20-të**

? Si janë veshur këto tri gra? Në ç'përfundim mund të dilni kur vëreni përdorimin në të njëjtën periudhë të veshjes tradicionale dhe asaj perëndimore?

Papazoglou<sup>2</sup>, f. 51.

**TABELA 3****Llogaritjet e popullsisë në provincat europiane të Perandorisë Osmane për vitin 1911**

Provincat	Myslimanë	Grekë	Bullgarë	Armenë	Katolikë	Hebrenj	Të tjerë	Gjithsej
Edrene (Adrianopojë)	795 706	395 872	171 055	33 650	12 783	9 034	44 552	1 426 632
Selanik	604 780	397 795	271 359	87		62 290	11 604	1 347 915
Janinë	244 638	311 032				3 990	1 175	560 835
Manastir (Bitola)	455 720	349 541	246 344	9		10 651	2 614	1 064 789
Shkodër	218 089	10 755			120 611			349 455
Kosovë	959 175	92 541	531 453		14 887	3 287	1 606	1 602 949
Gjithsej	3 242 108	1 557 536	1 220 211	33 746	148 281	89 162	61 531	6 352 575

Burimi: Cem Behar, f. 54.



Kategoritë etnolinguistike, të përcaktuara nga zyrtarët osmanë, kishin shumë përputhje me ndarjen fetare që lindi pas shpërbërjes së sistemit klasik të milletit. Të gjithë myslimanët klasifikoheshin si një grup i vetëm, pavarësisht nga ndryshimet etnike dhe gjuhësore midis tyre. Të krishterët ortodoksë konsideroheshin grekë, nëse përkrahnin Patriarkanën, ose bullgarë, nëse ishin anëtarë të kishës bullgare. Kjo shpjegon edhe faktin pse nuk ka shqiptarë ose serbë në tabelë (të cilët klasifikoheshin në bazë të besimit ose juridiksionit fetar dhe jo kombësisë). Përveç kësaj, disa grupe shoqërore, siç ishin gratë, nuk numëroheshin mirë. Regjistrimi i fundit osman i popullsisë u bë në vitin 1905/6. Çështja e besueshmërisë së regjistrimit osman është shumë e debatueshme. Në përgjithësi duhet të jemi tepër të kujdesshëm kur përdorim të dhëna statistikore të kësaj periudhe, madje edhe kur këto të dhëna nuk janë shtrembëruar qëllimisht për arsye politike (siç është rasti i tabelës 13).

<sup>2</sup> Fotografi Leonidhas Papazoglu (1872-1918) jetoi dhe punoi në Kostur. Kur ishte i ri, së bashku me prindët e tij dhe me vëllanë më të vogël, Pantelisin, u vendos në Stamboll, ku të dy vëllezërit mësuan artin e fotografimit. Ata e filluan karrierën si fotografë në Kostur, në vitin 1898 ose më 1899 dhe arritën ta monopolizonin këtë veprimtari në të gjithë rajonin.

Harta 1: Vilajeti i Kosovës, 1900.



► Fig. 3. Një ditë e zakonshme në tregun e Selanikut



❓ Vështroni me kujdes veshjet e njerëzve që po ecin në rrugë: si janë veshur ata? Çfarë kombësie mendoni se kanë? A e dini se çfarë kombësi bashkëjetonin në Selanikun osman, pak para Luftërave Ballkanike? A ju kujton kjo pamje e tregut ndonjë vend të ngjashëm që keni vizituar?

Megas, *Souvenir*, f. 50, fig. 49.

► Fig. 4. Tregu i bagëtive në Stamboll



Shoqëria Historike dhe Etnologjike  
e Greqisë, Athinë

**TABELA 4**  
**Përbërja etnike e popullsisë së Stambollit në vitin 1897**

Përkatësia etnike	Numri
Turq	597 000
Shqiptarë	10 000
Kurdë	5 000
Grekë	236 000
Armenë	162 000
Hebrenj	47 000
Serbë	1 000
Arabë të krishterë	1 000
Gjithsej	1 059 000

Burimi: Karpat, f. 104.

► Fig.5. Një ditë e zakonshme në tregun e Prishtinës (fundi i shek. të 19-të)



*Arkivi i Institutit të Historisë, Prishtinë, Fondi: Fotografitë.*

► Fig. 6. Barinj në Epir, viti 1912



*Boissonas, L'image de la Grèce [Pamje nga Greqia], Genève 1913, tek Hadjiiosif, vëll A1, f. 57.*

**TABELA 5**  
**Emigrimi nga shtetet kombëtare ballkanike jashtë Europës, 1876-1915**

Në vende jashtë Europës <sup>a</sup>	Rumania Gjithsej		Bullgaria Gjithsej		Serbia Gjithsej		Greqia Gjithsej	
1876-85	1 224						530	
1886-90	5 224						1 881	
1891-95	2 211						4 790	
1896-1900	10 541		160				11 189	
1901-05	37 225		6 661		42		51 479	
1906-10	20 707		37 643		228		122 275	
1911-15	15 295		35 836		1 117		127 811	
	Rumania		Bullgaria		Serbia <sup>b</sup>		Greqia	
Vetëm në SHBA	Gjithsej	Neto <sup>c</sup>	Gjithsej	Neto <sup>c</sup>	Gjithsej	Neto <sup>c</sup>	Gjithsej	Neto <sup>c</sup>
1876-85	1 224				530			
1886-90	5 135				1 881			
1891-95	2 209				4 790			
1896-1900	10 541		160		11 189			
1901-05	35 181		6 661	42	49 962			
1906-10	17 823	14 239	32 643	21 889	228		117 557	84 355
1911-15	11 187	9 057	21 487	1 575	1 052		118 916	46 577

Burimi: Jackson-Lampe, f. 196.

? Ç'illoje emigrimi njihni? Si do ta klasifikonit emigrimin jashtë Europës? Për shembull, për arsye ekonomike, kulturore, etnike, fetare; apo si të pavullnetshëm - shpërngulje me forcë (për shembull, refugjatë për shkak të një lufte ose prej ndryshimit të kufijve); apo për ndonjë arsye tjetër? Si ndikon tek emigrimi rritja e popullsisë dhe urbanizimi? Cilët faktorë ekonomikë ndikojnë për emigrimin e njerëzve?

### I-1. Edit Durhami përshkruan pazarin e Prizrenit, 1909

Ishte një ditë feste e përgjithshme dhe bandat luajtën gjithë natën. Të nxehtit ishte i madh dhe gjumi i pamundur. Të nesërmen dola në pazar vetëm pas orës 7.30 të mëngjesit, një orë tepër e vonë, në këto vende.

Është një pazar i madh. Ia vلente gjithë ky udhëtim, sepse nuk ka arritur ende të prishet nga *allafrënga*. Qëndisjet me ar që shiten aty, nuk i gjen dot gjëkund; dyqanet e rrobaqepësve të marrin sytë me shkëlqimin e ngjyrave dhe të dizenjove. Sikur të mos ishte vështirësia e transportit, do ta kisha shkatërruar veten nga ana financiare, ndërsa

kornizat e gdhendura me dru arre e të veshura me argjend janë punimet më të hijshme të këtij lloji që kam parë ndonjëherë. Pikërisht në Prizren lulëzonin dikur mjeshtrit më të mëdhenj të veshjes me ar dhe argjend, që prodhonin jataganë e tyta pushkësh për princat e hijshëm, dhe prej këtej ato u përhapën në Bosnjë. Të ashtuquajturat punime boshnjake me aplikacion, janë kryesisht me origjinë shqiptare dhe një pjesë e mirë e tyre prodhohen dhe sot nga artizanët shqiptarë.

Kërkesat për punime artistike të holla sot janë bërë të pakta, ka të ngjarë që së shpejti ta shkatërojnë edhe këtë art, por ende ka në Prizren mjeshtrë që mund ta ushtrojnë.

Shënim: a Përfshi Kanadanë, Zelandën e Re, Argjentinën, Brazilin dhe SHBA-në;

b Serbia dhe Mali i Zi të marra së bashku;

c 20 000-25 000 vetë emigruan nga Mali i Zi për në Shtetet e Bashkuara midis viteve 1903-1914: Pejovic, f. 376.

Sot tregtohen kryesisht zbukurime të lira e dosido për fshatarët. Argjendarët janë të gjithë të krishterë. Shëtita lart e poshtë dhe jashtë e brenda tuneleve të gjata të drunjtave të rrugëve të pazarit, të errëta e të nxehta, ndonëse në hije, që shndrisnin nga mallrat. Rrënjët e gentianës dhe të shpatores i gjen me pirgje te dyqani i barnatorit, si dhe arrat e zeza për ngjyrën e zezë të flokëve të të krishterëve, drurin për ngjyrën e kuqe për myslimanët dhe kënanë që përdoret për ngjyrosjen e duarve dhe të thonjve të gishtave.

Jashtë, në sheshe të hapura, nën dritën e artë, të zinte syri pirgje me rrush, pjeshkë, pjepra, kunguj të mëdhenj, grumbuj flakëruar me domate të kuqe, specat të shkëlqyeshëm, patëllxhanë me ngjyrë të kuqe të errët, bamje të gjata jeshile, lakra, sallatë marule, bathë – një bollëk si në netët arabe.

Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, f. 189-190.

## I-2. Një emigrant grek në Shtetet e Bashkuara, Stiv Haxhisi<sup>3</sup>, tregon përvojën e tij

Dy vëllezërit e mi shkuan fillimisht në Shtetet e Bashkuara dhe nisën të punonin në Çikago. Ne ishim gjashtë vëllezë. Dy vëllezërit që shkuan në Çikago nuk dërguan para, ashtu siç pritnim, në mënyrë që të paguanim borxhet e familjes në Greqi. Më pas, babai ynë u sëmur dhe u shkroi djemve në Çikago që të ktheheshin në Greqi, për ta parë për herë të fundit. Nga ata, vetëm njëri nga vëllezërit, Periklesi, më dorëlëshuari, mori para borxh dhe u kthye në Greqi. Kur vëllai u kthye në Greqi, babai u shërua. Pas një jave, babai donte të blinte një thes me miell për familjen. E pyeti vëllanë që erdhi nga Amerika: "Perikles, a ke para të më japësh për të blerë miell?" Pavarësisht se vëllai ishte kthyer nga Amerika, nuk kishte para. Më pas babai u detyrua të vinte vërdallë nëpër fshat, derisa, për të blerë miellin, i mori para borxh një xhaxhait tonë. Por në një fshat të vogël fjala përhapet shpejt: "djali i Haxhisis që rri në Amerikë, nuk kishte para". Periklesi, kur i dëgjoi thashethemet e fshatarëve, u turpërua

dhe i tha babait: "Ti eja me mua në Amerikë të bëjmë para dhe t'u tregojmë këtyre budallenjve se sa të zotët janë." Kështu, vendosëm edhe ne të tjerët të emigronim. [...]

Përpara se të largohesha nga Greqia, Amerika më ngjante si një pikturë shumëngjyrëshe, kaleidoskopike dhe e mbushur me para. S'e kisha menduar kurrë se do të shkoja atje. Ne dinim vetëm se kishte bollëk për çdo gjë.

Vlachos, f. 122.



Rreth vitit 1890, emigrimi nga Greqia u bë një dukuri masive dhe shumica e emigrantëve shkolin në SHBA. Megjithatë ky eksod nuk i arriti kurrë nivelet e disa vendeve të tjera europiane, llogaritet që rreth 500 000 grekë emigruan në Shtetet e Bashkuara nga dhjetëvjeçari i fundit i shekullit të 19-të deri në vitin 1924. Shkaqet që detyruan grekët të emigronin ishin të ngjashme me ato të popujve të tjerë europianë që shkuan në SHBA në të njëjtën periudhë: mundësia për të gjetur punë dhe përmirësimi i gjendjes ekonomike, gjatë industrializimit të vullshëm në Amerikë; po ashtu, kjo lidhej me kushtet e rënda ekonomiko-shoqërore në atdhe. Për shkak të hyrjes së tregut në sistemin tradicional të pronave të vogla, bujqësia e Peleponezit, veçanërisht në zonat që prodhonin stafidhe, pas një periudhe zhvillimi, ra në një krizë të rëndë, dhe shumë fermerë s'kishin mundësi të paguanin taksat, për shkak të interesave të larta, ngritjes së kostos së krahut të punës dhe kostos së prodhimit. Kjo situatë e vështirë shoqërohej edhe me faktin që Greqia nuk krijoi një sektor industrial; po ashtu kjo prirje përputhej edhe me dëshirën e fshatarëve për të emigruar - nga fjalët se në Amerikë kishte bollëk dhe nga mundësia për të udhëtuar - për shkak të transportit më të mirë. Këto ishin shkaqet kryesore që i detyruan grekët të linin fshatrat e tyre, për të shkuar në një vend të huaj, të largët. Shumica e emigrantëve ishin meshkuj, të cilët filluan të bënin punë krah në fabrika, manifaktura, miniera dhe hekurudha. Sidoqoftë, një pjesë e konsiderueshme e emigrantëve të parë, për të plotësuar nevojat e popullsisë urbane gjithmonë në rritje, u bënë pronarë të bizneseve të tyre.

<sup>3</sup> Stiv Haxhisi ishte një emigrant grek nga krahina e Peloponezit, i cili shkoi në SHBA në fillim të shekullit të 20-të. Haxhisi ishte një nga grekët e paktë që, pas pak vitesh në SHBA, u vendos në Anderson, në shtetin Indiana, i tërhequr nga mundësia për të hapur një dyqan të vogël, i cili do t'i shërbente popullsisë punëtore në rritje të qytetit.

❓ Përpikuni të shihni pjesë nga filmi “Amerika, Amerika” të E. Kazan; diskutoni mbi “ëndrrën amerikane” dhe mënyrën se si u përhap ajo në fshatrat e shteteve të ndryshme ballkanike; rolin e saj për të motivuar emigrantët dhe për t’i ndihmuar ata të përballen me frikën e emigrimit. Përpikuni të gjeni informacion rreth jetës në Amerikë, në fillim të shekullit të 20-të, të emigrantëve nga vendi juaj dhe krahasoni atë që ata shpresonin të gjenin, me përvojën e tyre gjatë viteve të para të vendosjes atje. Lexoni dokumentet III-19, III-20, V-11 dhe V-12 dhe krahasoni përvojën e njerëzve të cilët ishin të detyruar të emigronin, me përvojën e emigrimit të përshkruar në fragmentin e mësipërm.

❓ **Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin Ia**  
 Hulumtoni në lidhje me qytetin tuaj të periudhës së fillimshekullit të 20-të: A ishte ai një qytet osman apo qytet i një shteti kombëtar? A dini ndonjë roman që përshkruan jetën urbane të kësaj periudhe? Krahasoni qytetet multietnike (si Selaniku ose Stambolli), me kryeqytetet ose qendrat e tjera urbane të shteteve kombëtare: a ka ndonjë ndryshim në arkitekturë, jetën e përditshme, mënyrën si kalohej koha e lirë apo në ndonjë aspekt tjetër? Duke ndërthurur dokumente të ndryshme nga kapitujt e tjerë, me tabelat e mësipërme, përpikuni të ndani në grupe lëvizjet e popullsisë në Europën Juglindore përpara dhe gjatë Luftërave Ballkanike.

## Ib. Ekonomia

**TABELA 6**  
**Buxhetet e shteteve ballkanike, 1898-19124**

	Rumania			Bullgaria			Serbia			Greqia			Mali i Zi		
	Të ardhura	Shpenzime	Te ardhura-shpen.	Të ardhura	Shpenzime	Te ardhura-shpen.	Të ardhura	Shpenzime	Te ardhura-shpen.	Të ardhura	Shpenzime	Te ardhura-shpen.	Të ardhura	Shpenzime	Te ardhura-shpen.
1900	210	237	-27	81	96	-15	75	84	-9	120	109	+11			
1905	308	263	+45	128	125	+3	95	87	+8	130	116	+14	3.4	2.74	+ 0.66
1910	583	525	+58	81	198	-17	126	128	-2	175	141	+34	5.3	5.4	- 0.1
1911	644	533	+111	199	181	+18	140	125	+15	240	181	+59	5.6	5.75	-0.15

Burimi: Jackson-Lampe, f. 234; Gjurovic, f. 316-318 (të dhëna vetëm për Malin e Zi)

❓ Krahasoni shifrat për të katra shtetet. Çfarë vëreni?

**TABELA 7**  
**Struktura e shpenzimeve shtetërore për frymë në vitin 1915**

Shpenzimet	Gjithsej	Borxhi Publik	Ushtria	Infrastruktura	Edukimi Publik	Bujqësia dhe industria
<b>Rumania</b>	75	13	12	13	7	1
<b>Serbia</b>	43	12	10	5	3	1
<b>Bullgaria</b>	42	9	9	10	5	2
<b>Greqia</b>	67	28	11		2	
<b>Austro-Hungaria</b>	62	10			2	
<b>Gjermania</b>	55	5	16			
<b>Franca</b>	114	32	25		8	
<b>Britania e Madhe</b>	126		19		11	1

Burimi: Jackson-Lampe, f. 234.

<sup>4</sup> Në miliona lei, leva, dinarë, dhrahmi dhe perpers

<sup>5</sup> Të barasvlershme në franga



? Ju lutem, krahasoni dhe komentoni ndryshimet në shpenzimet buxhetore të këtyre vendeve. A përputhet natyra dhe sasia e shpenzimeve në shtetet e Ballkanit, me ato të Fuqive të Mëdha? Pse janë shpenzimet për ushtrinë kaq të mëdha?

### I-3. Bujqësia në Maqedoninë Osmane gjatë viteve 1900

Nga pikëpamja ligjore, shtresa e fermerëve përbëhet nga:

1. Pronarët e tokave
2. Çiftçinjtë (fshatarët që punonin tokën për pronarin, në këmbim të një pjese të prodhimit)
3. Punëtorët dhe shërbyesit

Grupi i parë, pronarë të çiftçinjtë, përbëhet nga bejlerët myslimanë; grupi i dytë përbëhet nga fshatarët e krishterë.

Ka edhe pronarë tokash të krishterë, por ata kanë prona të vogla, që nuk i kalojnë 200 dynymët (1 dynym rreth 1200 metra katrorë); mbi këtë shifër, toka është kryesisht në duart e bejlerëve. Pronat e vogla mbizotërojnë në zonat malore, ndërsa pronat e mëdha, në fusha. Të krishterët, pronarë të mëdhenj tokash, janë të rrallë, dhe ata përfaqësohen nga grekët, të cilët kanë prona të mëdha në kazatë e Seres, Dramas dhe Selanikut.

[...] Puna e çiftçit është një nga shkaqet kryesore të skamjes së thellë në të cilën gjendet popullsia fshatare e krishterë, sepse ajo lë shteg gjithmonë për arbitraritet dhe shpërdorim nga ana e beut, kundër të cilit nuk mund të bëhet asgjë. Në teori, puna e çiftçit funksionon kështu: beu, i cili zotëron tokën, ua jep atë të ndarë në ngastra familjeve në çiftlig – një familje lëron 60-100 dynym, në varësi të numrit të pjesëtarëve të familjes. Gjithashtu, beu siguron farën dhe strehën për fshatarët. Prodhimi, pasi i hiqet e dhjeta, ndahet në pjesë të barabarta midis pronarit dhe fshatarit. Një ndarje e tillë i siguron pronarit të tokës një përfitim që varion nga 18-25 % të kapitalit të tij. Por, në më të shumtën e rasteve, pronari nuk është i kënaqur me këtë ndarje dhe, si zot absolut i fatit të fshatarit të krishterë, punën e të cilit e shfrytëzon sipas dëshirës, arrin t'i marrë atij, nëpërmjet kërcënimeve dhe dhunës, pjesën më të madhe.

[...] Pronarët e krishterë janë kryesisht bullgarë. Siç e thamë dhe më parë, pronat e tyre rrallëherë i

kalojnë 200 dynymët. Ata e punojnë tokën vetë dhe do të gëzonin një farë mirëqenieje, nëse taksat do të vendoseshin më me drejtësi, do të mblidheshin me ndershmëri dhe, gjithashtu, nëse pasiguria nuk do të ishte një rrezik i vazhdueshëm për jetën dhe pronën e të krishterëve.

Draganof, *La Macedoine et les Reformes* Paris, 1906, f. 43-53 tek Issawi, f. 225-7.

? Në ç'gjendje ishin fshatarët e krishterë në Maqedoninë Osmane?

### ► Fig. 7. Manifaktura e tekstileve e vëllezërve Saias në Selanik



Megas, *Souvenir*, f. 86, fig. 92.

Manifaktura e tekstileve e vëllezërve Saias u hap në vitin 1873. Aty u punësuan rreth 470 punëtorë, nga të cilat 350 ishin vajza të reja hebreje, nga mosha 14 deri në 18 vjeç. Fabrika pësoi dëmtime nga një tërmet që lëkundti qytetin në vitin 1902. Më pas, u shkatërrua plotësisht, nga zjarri që ra në vitin 1917.

? Përse kishte kaq shumë vajza të reja që punonin në fabrikë? A e dini se si ishin kushtet e punës atje? Si do të ndiheshit, nëse do të punonit në një fabrikë tekstilësh, në vend që të shkonit në shkollë?

**TABELA 8a**  
**Eksportet e Ballkanit 1901-1911**

	Mesatarja e eksporteve	% me Austro-Hungarinë	% me Gjermaninë	% me Francën	% me Britaninë e Madhe	% me Belgjikën	% me Perandorinë Osmane
<b>Rumania</b>	(mil. lei)						
1901-05	361	13	7	3	9	29	
1906-10	501	10	6	7	10	30	
1911	692	9	5	7	8	28	
<b>Bullgaria</b>	(mil. lei)						
1901-05	120	10	9	6		16	19
1906-10	119	8	12	6	12	18	27
1911	185	6	12	6	13	28	16
<b>Serbia</b>	(mil. dinarë)						
1901-05	66	86	5	1			6
1906-10	84	28	25	1			10
1911	117	41	25	1			8
<b>Greqia</b>	(mil. drahmi)						
1901-05	87	14	8	10	27		6
1906-10	120	10	10	8	26		11
1911	141	10	11	10	24		4

Burimi: Jackson-Lampe, f. 174.

**TABELA 8b**  
**Importet e Ballkanit 1901-1911**

	Mesatarja e importeve	% nga Austro-Hungaria	% nga Gjermania	% nga Franca	% nga Britania e Madhe	% nga Perandoria Osmane
<b>Rumania</b>	(mil. lei)					
1901-05	299	27	28	6	17	
1906-10	409	25	34	5	15	
1911	570	24	32	6	15	
<b>Bullgaria</b>	(mil. leva)					
1901-05	95	27	15	6	17	14
1906-10	140	27	17	6	16	14
1911	199	24	20	13	15	8
<b>Serbia</b>	(mil. dinarë)					
1901-05	53	58	13		9	
1906-10	70	33	33		12	
1911	115	41	27		8	
<b>Greqia</b>	(mil. drahmi)					
1901-05	140	14	9	8	21	10
1906-10	149	12	9	7	22	9
1911	174	17	9	8	4	5

Burimi: Jackson-Lampe, f. 181.

❓ Cilat janë prirjet në tregtinë e jashtme të vendeve të Ballkanit? Ju lutem, komentoni ndryshimet<sup>6</sup>. Përse Rumania dhe Serbia kanë marrëdhënie tregtare më të kufizuara me Perandorinë Osmane sesa Bullgaria? Si ndikonte tregtia e jashtme në zhvillimin ekonomik?

<sup>6</sup> Gjithashtu, kini parasysh faktin se Greqia mund të ketë patur tepricë furnizimesh.

► Fig. 8. Mjetet e transportit në Shqipërinë e fillimshkullit të 20-të



*Gjurmë të historisë kombëtare në Fototekën e Shkodrës, f. 60.*

**TABELA 9**  
**Linjat hekurudhore<sup>7</sup> funksionuese në Ballkan, 1870-1912**

	Rumania	Bullgaria	Serbia	Greqia
<b>1870</b>	248	221	0	12
<b>1880</b>	921	224	0	12
<b>1885</b>	1 356	224	253	222
<b>1890</b>	2 424	803	540	697
<b>1895</b>	2 534	861	540	916
<b>1900</b>	3 100	1 566	571	1 033
<b>1905</b>	3 179	1 567	707	1 351
<b>1910</b>	3 437	1 897	892	1 573
<b>1912</b>	3 532	2 109	976	1 584

Burimi: Jackson-Lampe, f. 211.



A ishin hekurudhat mjete për arritjen e zhvillimit ekonomik apo shenjë e këtij zhvillimi; pse? A mund të ndërtoheshin ato për arsye që nuk kishin lidhje me interesat ekonomikë?

#### I-4. Analizë e sistemit hekurudhor bullgar, kryer nga shefi i Shtabit të Ushtrisë Bullgare, gjenerali Fiçev<sup>8</sup>

*Projektet e veprimeve luftarake në vitet 1911 dhe 1912*  
 Kontrolli i kohëve të fundit ka treguar se hekurudhat tona nuk do të jenë në gjendje t'u përgjigjen kërkesave ushtarake në rast lufte. Në këtë mënyrë, planet tona vepruese, lidhur me transportin e nevojshëm gjatë mobilizimit ushtarak dhe pozicionimin e ushtarëve në terren, nuk do mund të zbatohen.

Duke qenë se Mbretëria Bullgare ekziston prej një kohe të shkurtër, sistemi hekurudhor nuk është zhvilluar plotësisht, për të qenë një mjet i sigurtë për mbrojtjen kombëtare.

Dy linjat hekurudhore që përshkojnë Bullgarinë Veriore dhe Jugore, si dhe linja trans-ballkanike Gorna Orjahovica-Tërnovo-Stara Zagora, janë linjat

më të rëndësishme për transport ushtarak në kohë mobilizimi.

Nga pikëpamja teknike, linjat tona hekurudhore, të ndërtuara vetëm për nevoja tregtare, kanë shumë disavantazhe: pjerrësi të madhe, shtrirje të vogël, numër të vogël stacionesh, edhe ata të ngushtë, mungesë platformash për ngarkimin e trenave ushtarakë, furnizim jo të kënaqshëm me ujë në shumicën e stacioneve hekurudhore dhe pak vende për të kthyer trenat.

Fiçev, Избрани произведения [Vepra të zgjedhura]



Nga sa përshkruhet më lart, çfarë problemesh ushtarake dilnin nga gjendja e sistemit hekurudhor në Bullgari?

Ç'lidhje kanë hekurudhat, me mundësitë e fitores në luftë? Me çfarë mjetesh mund të zëvendësohen mungesat në sistemin hekurudhor?

<sup>7</sup> Në kilometra

<sup>8</sup> Gjenerali Ivan Fiçev (1860-1931) në vitin 1910 ishte shefi i Shtabit të Ushtrisë Bullgare; ai hartoi një plan lufte kundër Turqisë dhe kundërshtoi fillimin e Luftës së Dytë Ballkanike. Ishte një nga anëtarët e delegacionit bullgar që u dërgua të negociojë në Traktatin e Paqes në Bukuresht, në korrik 1913.

**TABELA 10**  
**Telegrafi në vitin 1910**

Shteti	Zyrat telegrafike	Rrjeti telegrafik	
		Gjatësia e linjave në km	Gjatësia e kablllove në km
Serbia	208	4 350	8 289
Bullgaria	350	5 935	12 760
Rumania	3 127	7 321	20 641
Rusia	8 423	199 502	705 752
Suedia	2 849	9 317	32 220
Danimarka	559	3 644	12 842
Holanda	1 393	7 526	36 884
Belgjika	1 634	7 880	41 858
Britania e M. dhe Irlanda	13 959	98 625	931 532
Franca	20 303	182 794	690 636
Spanja	1 902	42 935	92 109
Italia	7 664	49 443	203 711
Zvicra	2 361	3 614	26 021
Gjermania	45 116	274 593	2 050 332
Austria	6 970	46 952	235 493
Hungaria	4 592	23 068	144 124
Bosnja dhe Hercegovina	173	3 231	7 374
Mali i Zi	25	607	900

Burimi: Sundhaussen, f. 523. Pesëdhjetë vite të mbretërisë së Malit të Zi 1860-1910, f. 246. (të dhëna mbi Malin e Zi)

? A dini ndonjë pajisje tjetër teknike që ndryshoi komunikimin dhe jetën në tërësi në Europën e fundshekullit të 19-të dhe fillimshkullit të 20-të? Kur u shfaq për herë të parë telefoni në vendin tuaj? Sipas mendimit tuaj, si ishte reagimi i njerëzve ndaj këtyre shpikjeve?

► **Fig.9. Vila Allatini në Selanik, 1913**



Megas, *Souvenir*, f. 107, fig. 120.



Vila *Allatini* u ndërtua fillimisht si rezidencë private, në vitin 1895, nga Çarls *Allatini* dhe u projektua nga arkitekti italian, Vitaliano Poselli. Në vitin 1909 shtëpia u ble nga Armata e Tretë e Ushtrisë Osmane dhe, në vitin 1912, u mor nga ushtria greke. Abdul Hamidi II u detyrua të jetojë në Vilën *Allatini*, pas dështimit të kundërrevolucionit dhe rënies së tij nga froni, në prill të vitit 1909. Ai u kthye në Stamboll në tetor të vitit 1912, kur trupat greke po afroreshin. Familja hebreje *Allatini* ishte një ndër më të pasurat në Selanik dhe kishte në pronësi dy nga fabrikat më të mëdha të qytetit (Fabrikën e tullave *Allatini* dhe Mullirin e miellit *Allatini*), të ngritura respektivisht në vitet 1880 dhe 1882.



Cilët mund të shikoni në këtë fotografi? Si janë veshur ata? Në këtë kohë, në Europën Juglindore, a përdorej gjerësisht biçikleta? Cilat ishin përdorimet e saj – për argëtim apo për transport? A e dini se cili ishte reagimi kur gratë ngitnin biçikletën?



### Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin Ib

Bëni një kronologji për shpikjet teknologjike që hynë në vendin tuaj në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të, si p.sh.: elektriciteti, automobili, gazi, telefoni etj. Gjeni informacion mbi mjetet e transportit në vendin tuaj gjatë fundit të shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të.

## Ic. Kultura

### ► Fig. 10. Orë historie në një shkollë të mesme për vajza, Athinë 1911



*Statistiki tis Dimosias ekpaideuseos...*, Athinë, 1912, tek Koulouri, *Istoria*, f. 12.



Si janë veshur nxënësit në këtë foto? Në vendin tuaj, a ishin të ndara shkollat, veç për vajzat dhe veç për djemtë? A ngjason klasa juaj me këtë klasë në fotografi? Çfarë është varur në muret e klasës në foto?

## 1-5. Një djalë hebre<sup>9</sup> përshkruan përvojën e tij në shkollë, në Selanik, 1904

Le Petit Lycée Français hapi dyert e tij në fillim të vitit 1904. Ai gjendej në katin e parë të një banese të vogël, në Kampania, në zonën lindore të qytetit. Numri i fëmijëve të cilët ndoqën dy klasat e para paraqiste popullsinë heterogjene të Selanikut. Kursi më i ulët, në të cilin merrja pjesë edhe unë, përbëhej nga tre djem francezë, një grek, katër hebrej spanjollë, një serb, një mamin<sup>10</sup>, një armen, një turk dhe një djalë malazes, i cili kishte ardhur nga Cetinja enkas për të ndjekur shkollën.

Megjithëse që të gjithë flisnim frëngjisht rrjedhshëm, sepse kishim mësuar në shkolla shtetërore ose me mësues privatë, asnjëri prej nesh nuk kishte pasur kontakte, veçse të rastësishme, me fëmijë të kombësive të tjera. Dhe këtu, për herë të parë ne uleshim krah për krah njëri-tjetrit. Në bankat e reja, përballë dërrasës së zezë të vendosur mbi një këmbalec, dëgjonim Z. Tjerri, drejtorin me fytyrë të kuqe, sy bojëqielli dhe mustaqe të verdha, i cili na paraqiste lëndët që do të studionim. [...]

Interesi i tij i vërtetë për zakonet vendase bëri t'u zgjidhej gjuha atyre më të turpshmeve dhe të çliroheshin ata më të ndrojturit. Shpejt, Mehmeti, djali turk, doli me dëshirë të shpjegojë ritet e Kurban Bajramit, festës që vjen pas Ramazanit; Jovanoviçi, një i afërm i mbretit Nikolla të Malit të Zi, foli lirshëm

për banorët dhe malet e këtij vendi; dhe unë me Papopulosin pamë se grekët kanë shumë zakone të përbashkëta me serbët, kur Ivani, djali i konsullit, na tregoi rreth festimeve të Pashkëve në vendin e tij. Ndërkohë që bisedonim hapur me njëri-tjetrin, luanim së bashku, zumë miqësi, shkuam në shtëpitë e njëri-tjetrit dhe ndamë të fshehtat së bashku, u njohëm më nga afër me ato tradita të njëri-tjetrit, që të para nga larg mund të na dukeshin si të çuditshme dhe të pakuptimta.

Sciaky, f. 152-153, 154.



Në Selanik, në vitin 1908 kishte 48 shkolla çifute, 32 shkolla turke, 20 shkolla ortodokse greke, 7 shkolla franceze dhe disa institucione italiane, bullgare, serbe dhe rumune. Shkollat frëngjishtfolëse ishin: *Alliance Israélite Universelle* [Aleanca Universale Izraelite], *Mission Laïque* [Misioni Laik], *Lycée* [Liceu] dhe *Vëllezërit dhe Motrat e Shën Vincent de Paul*. Shumica e fëmijëve hebrej të qytetit u edukuan në institucione që nuk drejtoheshin nga autoritetet e besimit të tyre fetar.



Si ishte përbërja etnike e Selanikut në fillim të shekullit të 20-të? A ndikonte tek nxënësit përvoja e tyre në shkollë, dhe si ndikonte? Cila është përbërja etnike e klasës suaj? A keni shokë që u përkasin kombësive të ndryshme?

<sup>9</sup> Leon Sciaky, autori i kësaj pjese, lindi në Selanik në vitin 1893. Familja e tij e kishte prejardhjen nga hebrejtë që u dëbuan nga Spanja në vitin 1492, nga Italia në vitin 1493 dhe Portugalia më 1497. Hebrejtë e Selanikut flisnin një dialekt të spanjishtes të shekullit të 15-të, të quajtur *Ladino*. Në vitin 1915, Leoni emigroi në Nju-Jork. Familja e tij shkoi atje pak kohë më vonë (babai i tij, Salomoni, e ëma Paloma, motrat e tij, Elda dhe Laura dhe i vëllai, Maurice). Ata kishin ndërmend të ktheheshin kur të mbaronin trazirat politike në Turqi, por nuk u kthyen më. Leoni studioi për inxhinieri mekanike, në Institutin Pratt në Bruklin. Në vitin 1922 ai u martua me Frances Hillman nga Letonia dhe vdiq në qytetin e Meksikos, në vitin 1958. Për herë të parë, ai i botoi kujtimet e tij të fëmijërisë në Selanik, në vitin 1946.

<sup>10</sup> Ndjekës të Sabata Zevit, të cilët u kthyen në fenë islame.

**TABELA 11**  
**Analfabetizmi në fillim të shekullit të 20-të (përqindja e analfabetëve)**

Shteti **	Gjithsej	Burra	Gra	Fëmijë <sup>a</sup>
Franca (1901)	17,4	14,8	19,8	16,9
Austria (1900)	23,8	22,1	25,5	31,3 <sup>b</sup>
Hungaria (1900)	40,7	34,4	49,6	36,2
Greçia (1907)	60,8	41,8	79,8	55,0
Bullgaria (1900)	72,1	57,9	86,9	68,4
Pjesa europiane e Rusisë (1897)	73,0	62,5	83,1	77,5
Rumania (1899)	78,0		70,6	
Serbia (1900)	79,7	67,3	92,9	78,3
Bosnja dhe Hercegovina	87,8	82,9	93,4	87,3 <sup>c</sup>

Burimi: Mayer, f. 102.

\*\* Në këto vite shkollore,

a Fëmijë të moshës shkollore – zakonisht 5-14 vjeç,

b 6-10 vjeç,

c 7-20 vjeç.

? Si mendoni, përse ka një ndryshim kaq të madh midis shkollimit të burrave dhe grave?

**TABELA 12**  
**Shkollat fillore dhe nxënësit në Europë (fundi i shek. të 19-të – fillimi i shek. të 20-të)**

Shteti*	Shkolla	Nxënës për 1000 banorë	Nxënës për 1000 banorë (5-15 vjeç)
Serbia (1904)	1 267	46	175
Greçia (1902)	3 263	81	376
Bullgaria (1898)	4 686	96	436
Rumania (1903)	4 207	75	351
Rusia (1903)	84 500	44	187
Belgjika (1905)	7 144	121	608
Franca (1903)	85 437	155	899
Portugalia (1890)	5 339	47	238
Spanja (1901)	33 763	105	525
Italia (1901)	61 777	84	393
Austria (1903)	21 292	146	670
Hungaria (1905)	18 976	133	598
Bosnja dhe Hercegovina (1899)	293	18	76

\* Në këto vite shkollore

Burimi: Sundhaussen, f. 555.

? Krahasoni tabelat 11 dhe 12: a mund të gjeni një lidhje midis niveleve të arsimit dhe njohjes së shkrimit dhe këndimit? Krahasoni të dhënat për vendet e Europës Perëndimore, Jugore dhe Juglindore: a vërehen dallime në treguesit e shkollimit, në përputhje me këtë lloj ndarjeje?



► Fig. 11. Gra hebreje duke kërcyer, Selanik



Megas, *Souvenir*, f. 27, fig. 11.

🔑 Në Selanik kishte shumë grupe këngëtarësh profesionistë, të cilët këndonin në raste dasmash, synetllëku dhe ngjarjesh të tjera shoqërore. Muzikantët hebrej quheshin çallgixhi. Në prag të luftërave ballkanike, në Selanik kishte rreth 60 000 hebrej, kur e gjithë popullsia ishte 150 000 banorë.

► Fig. 12. Gratë endëse, Avdela 1907 – filmi i parë në Ballkan



Chr. K. Christodoulou, f. 39

🔑 Vëllezërit Jannis (1878-1954) dhe Miltiadis (1883-1964) Manakia, me origjinë vllahe, lindën në Avdela (zona e Grevenasë) dhe jetuan në Manastir deri në vitin 1905. Ata filmuan shumë ngjarje, njerëz, ceremoni dhe zakone në prag të shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe konsiderohen si themeluesit e artit kinematografik në Ballkan. Në vitin 1921/22 ata hapën sallën e parë të kinemasë në Manastir. Filmi i tyre "Gratë endëse" (1907) mbahet si filmi i parë i xhiruar në Ballkan.

❓ Krahasoni figurat 2, 10 dhe 11. Përpiquni të formuloni dy pyetje të përbashkëta për të tria figurat.

### ❓ Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin Ic

Mblidhni informacion rreth sistemit të arsimit në vendin tuaj në vitet 1900, si p.sh., për shkollat fillore dhe të mesme, programet mësimore, ndjekjen e shkollave, tekstet shkollore etj. Gjeni një tekst shkollor të fillimshkollit të 20-të dhe krahasojeni atë me tekstin tuaj shkollor. Përcaktoni ndryshimet dhe ngjashmëritë.



## KAPITULLI II: Politikat

Në shumicën e rasteve, luftërat kanë qenë rezultat i politikave të një shteti të caktuar ose të një grupi shtetesh me interesa të përbashkëta. Edhe Luftërat Ballkanike nuk bëjnë përjashtim nga ky rregull. Pas Traktatit të Berlinit në korrik të vitit 1878, problemi kryesor për kombet në Europën Juglindore ishte bashkimi kombëtar, ose “çështja kombëtare”, siç quhej në atë kohë. Ideja e të jetuarit në një shtet të vetëm kombëtar me popullsi homogjene, në të cilin do të bënin pjesë të gjitha territoret që mendohej t’i përkisnin një kombi për arsye historike ose demografike, ishte mbizotëruese në mendësinë kolektive të kohës. Kjo ishte arsyeja që përcaktimi i kufijve nga traktatet e ndryshme u konsiderua i padëshiruar dhe i përkohshëm. Një pjesë e madhe e gadishullit mbeti nën sundimin e sulltanit dhe ky territor konsiderohej nga shtetet fqinje si hapësirë për përfitime territoriale. Politikat mes këtyre shteteve rivale nxiteshin nga politikat e Fuqive të Mëdha për rajonin. Fuqitë e Mëdha mundoheshin të forconin ndikimin e tyre në gadishull, në rast të përplasjeve diplomatike ose ushtarake.

E ashtuquajtura ‘Çështje Lindore’ kishte qëndruar në krye të axhendave diplomatike që nga fillimi i shekullit të 19-të, nga frika e një lufte europiane dhe vendosmërisë për të ruajtur *status quo*-në. Përpjekja për të bashkëruar shpërbërjen e Perandorisë Osmane me baraspeshën europiane të fuqive, përftoi një numër të madh planesh për një zgjidhje të mundshme. Dy alternativat për të ruajtur ekzistencën e Perandorisë Osmane, ose ndarjen e saj midis Fuqive të Mëdha, u sfiduan nga politikat e shteteve të reja ballkanike, që e shihnin integrimin kombëtar nëpërmjet ekspansionit territorial. Pas Kongresit të Berlinit, Fuqitë e Mëdha u detyruan të përfshinin në politikën e tyre edhe të ardhmen e shteteve të Ballkanit, duke ndarë sferat e tyre të ndikimit.

Në shoqëritë ballkanike, politikat e qeverive ballkanike, të cilat synonin luftën, u kundërshtuan vetëm nga individë dhe grupe të vogla politike. Socialdemokratët ishin i vetmi grupim politik i mirorganizuar që kundërshtoi politikën e luftës. Ata hodhën idenë e një Federate Ballkanike, e cila mendohej se do të sillte zgjidhje të përgjithshme për të gjitha problemet politike dhe shoqërore në vendet e Europës Juglindore. Megjithatë, ndikimi i këtyre grupeve ishte i papërfillshëm dhe nuk përbënte një alternative reale kundrejt politikës mbizotëruese.

Që nga shekulli i 19-të, osmanizmi ishte përpjekur të siguronte bashkëjetesën paqësore të të gjitha kombësive të ndryshme në një Perandori Osmane të modernizuar. Megjithatë, regjimi autokratik i Abdul Hamitit, i cili shpërndau parlamentin e parë osman në vitin 1877, shkaktoi revolta dhe shënoi fillimin e kompleteve nga ana e nënshtetasve të tij të krishterë dhe myslimanë. Pas tridhjetë vjet sundimi autokratik, revolucioni i Turqve të Rinj solli zbatimin e sistemit të zgjedhjeve dhe lindjen e nacionalizmin turk; në këtë mënyrë, në vend që të arrinte pajtimin e nënshtetasve jomyslimanë me regjimin osman, ai ndikoi në shpërbërjen e Perandorisë. Irredentizmi ballkanas u përball me nacionalizmin turk të Komitetit për Bashkim dhe Përparim. Pasoja më afatgjatë e humbjes osmane në Luftërat Ballkanike ishte në fakt, braktisja e *osmanizmit* dhe përqaftimi i një nacionalizmi agresiv.

Ideologjitë paraprijëse nuk gjendeshin vetëm në nacionalizmat rivalë, por, gjithashtu, në ndryshimet ideologjike që u shfaqën kudo në Europë në fund të shekullit të 19-të. Kulti i rinisë, kërkimi për ‘njeriun e ri’, ideja e re e maskilizmit militant, darvinizmi social dhe, së fundi, imazhi pozitiv për luftën ishin disa nga prirjet ideologjike të cilat përgatitën shoqëritë europiane për një luftë që ishte parashikuar dhe pritej të fillonte.

Burimet në këtë kapitull nuk kanë si qëllim të dokumentojnë në detaje aspektet e shumta të politikës së brendshme të shteteve ballkanike ose të politikës së tyre të jashtme në kuadër të *Çështjes Lindore*. Ato nuk synojnë as të paraqitin prirjet ideologjike që u zhvilluan në rajon në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të. Megjithatë, na ndihmojnë të kuptojmë shumanshmërinë e faktorëve politikë dhe ideologjikë që çuan popujt e Ballkanit në luftë kundër njëri-tjetrit.

## Ila. Ideologjitë paraprijëse

Harta 1: Aspiratat kombëtare të vendeve të Ballkanit



Carnegie, f.38.

► Fig. 13. Sholla e Rumanisë (karikaturë rumune, 1913)

*Furnica*, IX, nr.20, 17 janar 1913, f. 1.



Përkthim

-O imzot, Karol, përse përpiqeni qaq shumë, më kot, për ta arnuar atë, nëse nuk do të rregulloni edhe shollën?

-Cilën shollë?

-Shollën e vendit, nuk e shikoni në ç'gjendje të mjerë është?!



- Auten, meglere Carol, degeaba le canalelele? sa'i pu peticu-ita : daca nu'i dregi sa itipa.  
- Ce itipa?  
- Talpa, lares nu vezi in ce hal e ajuns?!

**TABELA 13**  
**Statistika kontradiktore për Maqedoninë**

	STATISTIKAT BULLGARE (Z. Kantçev, 1900)	STATISTIKAT GREKE (Z. Deljani, 1904)*	STATISTIKAT SERBE (Z. Gopceviç, 1889)
Turq	499 204	634 017	231 400
Bullgarë	1 181 336	332 162	57 600
Grekë	228 702	652 795	201 140
Shqiptarë	128 711	—	165 620
Vlleh	80 767	25 101	69 665
Hebrenj	67 840	53 147	64 645
Romë	54 557	8 911	28 730
Serbë	700	—	2 048 320
Të ndryshëm	16 407	18 685	3 500
<b>GJITHSEJ</b>	<b>2 258 224</b>	<b>1 724 818</b>	<b>2 870 620</b>

\* (Nuk përfshihet vilajeti i Kosovës) Carnegie<sup>11</sup>, f. 28, 30.



Nuk ekzistonte asnjë ndarje administrative e quajtur Maqedoni dhe, për këtë arsye, statistikat kontradiktore mbështeteshin sipas përcaktimeve të ndryshme se cilat rajone gjeografike së bashku, njiheshin me emrin 'Maqedoni'. Në përgjithësi, Maqedonia mendohej të përbëhej nga vilajetet e Selanikut, Kosovës dhe Manastirit.



Përpikuni të shpjegoni përse, sipas statistikave bullgare, bullgarët përbëjnë shumicën e popullsisë; sipas atyre greke, grekët përbëjnë shumicën e popullsisë dhe sipas statistikave serbe, serbët përbëjnë shumicën. Përdorni Hartën 1 dhe përcaktoni territoret në të cilat interesat e vendeve ballkanike përkonin me njëri-tjetrin. Krahasoni këto tabela me tabelën 3, duke përfshirë provincat e Edrenesë dhe Shkodrës.

## II-1. Ajo çka priste një ushtar serb

Ushtari serb, ashtu si edhe ai grek, ishte tejet i bindur se në Maqedoni do të gjente bashkatdhetarë, njerëz të cilët mund të flisnin gjuhën e tij dhe t'i drejtoheshin atij me *zhivio* ose *zito*. Ai gjeti njerëz që flisnin një gjuhë të ndryshme nga e tia, dhe thërrisnin *urra!* Ai i keqkuptonte ose nuk i kuptonte aspak. Ato që kishte mësuar që i vogël për ekzistencën e një Maqedonie Serbe dhe një Maqedonie Greke, sigurisht që e zhgënjyen; por bindja e tij patriotike se Maqedonia duhej të bëhej greke ose serbe, nëse nuk ishte ende e tillë, mbeti e pandryshuar. Në kohën e Dushanit të Fuqishëm ose perandorëve bizantinë, pa dyshim që Maqedonia kishte qenë ajo që ai donte të bëhej përsëri. Ishin vetëm agjitorët dhe propagandistët bullgarë ata që përhapën në popull idenë e të qenit bullgarë. Agjitorët duhet të largoheshin nga vendi dhe, atëherë, ai do të kthehej përsëri si kishte qenë gjithmonë, serb ose grek.

Prandaj ata vepruan mbi këtë bazë.

Cilët ishin agjitorët që bënë popullin të harronte gjuhën greke dhe serbe? Së pari, këta ishin priftërinjtë; më pas, mësuesit e shkollave; së fundi, elementët revolucionarë, të cilët gjatë regjimit të vjetër kishin formuar ndonjë organizatë; krerët e bandave dhe anëtarët e tyre, fshatarët që i kishin furnizuar me para dhe ushqime, - me një fjalë, të gjithë meshkujt e vendit, të arsimuar dhe të ditur.

Carnegie, f.50-51.



Për çfarë ishin përgatitur ushtarët? Përpikuni të kuptoni përse ishin stërvitur në këtë mënyrë.

Si lidhet ky tekst me tabelat statistikore që paraqiten më sipër? A mund të gjeni ndonjë fakt në këtë Libër pune – ose diku tjetër – që të kundërshtojë përshkrimin e tekstit të mësipërm?

<sup>11</sup> *Komisioni Karnegi* u dërgua nga Fondacioni Karnegi për Paqe Ndërkombëtare për të hetuar mbi krimet e kryera gjatë Luftërave Ballkanike. Fondacioni u themelua nga Endrju Karnegi, një industrialist dhe mirëbërës amerikan. Anëtarët e Komisionit Hetimor Ballkanik ishin: Dr. Jozef Redlich, profesor i Të Drejtës Publike në Universitetin e Vjenës (Austri), baroni Estournelles de Constant, senator (Francë), Justin Godart, jurist dhe anëtar i Dhomës së Deputetëve (Francë), dr. Walther Schucking, profesor i Drejtësisë në Universitetin e Marburgut (Gjermani), Francis W. Hirst, redaktor i *The Economist* (Britani e Madhe), dr. H.N. Brailsford, gazetar (Britani e Madhe), profesor Paul Miliukov, anëtar i Dumës (Rusi), dr. Samuel T. Dutton, profesor në Kolegjin e Mësuesisë, Universiteti i Kolumbias (SH.B.A).

## II-2. Ideologjia e sakrificës e një ushtari rumun

Që një njeri, në lule të rinisë, të shkojë pa mëdyshje në fushën e betejës, duke ditur shumë mirë se mund të vdesë atje, që të heqë dorë nga instikti më i fuqishëm, për të shpëtuar veten, në mënyrë që të shkojë i qetë drejt grykës së pushkës, duhet të përmbushë disa kushte morale: të jetë i bindur se nëpërmjet kësaj sakrifice do të çlirojnë popullin e tij nga shtypja, ose që, sido që të ndodhë, të humbë ose të fitojë, gjaku i tij do t'i shërbejë vendit dhe bashkatdhetarëve të tij. Që kjo karakteristikë morale të zhvillohet tek një individ, kërkohet që ai të jetë në gjendje të mirë ekonomike, të ketë një shkallë të caktuar kulturore, të gëzojë disa të drejta qytetare; dhe një ushtri me të tillë njerëz, do të jetë e pamposhtur; ose mposhtja e saj do t'i kushtojë armikut një çmim të madh.

Popescu, f. 5-6.

❓ Për çfarë ideali burror flitet në këtë dokument? A mendoni se ushtarët shkonin pa asnjë 'mëdyshje' në fushën e betejës?

## II-3. Turqit dhe osmanizmi

### Parathënie

Këtë roman të shkurtër e shkrova pesë vite më parë. Qëllimi im nuk ishte të krijoja një vepër letrare. Doja vetëm të krahasoja idetë e çuditshme të njerëzve tanë të ndritur me realitetin shoqëror. Pas vendosjes së Kushtetutës kam njohur shumë nga njerëzit tanë të mëdhenj. Pothuajse të gjitha idetë e tyre mund të përmbledhen si më poshtë: "Të qenët osman, do të thotë të kesh një kombësi të përbashkët. Të qenët osman, s'do të thotë vetëm të jesh turk ose mysliman. Çdo individ që jeton nën juridiksionin osman, i përket kombit osman (*osmanli milleti*), pavarësisht nga përkatësia etnike ose besimi fetar (*bila tefrik-i cins-u mezheb*)". Megjithatë, kjo ide ishte veçse një iluzion në mendjet e atyre që, në periudhën e Tanzimatit, ishin produkt i sistemit jokombëtar të edukimit. Nuk kishte mundësi që të krijohej një komb i përbashkët me atë grup individësh të cilët kishin gjuhë, besim fetar, parime morale, histori dhe

kulturë të ndryshme dhe ishin krenarë për gjëra të ndryshme. A ishte 'osman' diçka tjetër, përveç emrit të shtetit tonë? Askush nuk mund t'i quajë gjermanët që jetonin në Austri 'kombi austriak ose kombi habsburgas'. Një gjerman mbetet gjerman, pavarësisht se ku jeton. Në të njëjtën mënyrë, ne që flasim turqisht ishim një komb, me një histori mijëra vjeçare dhe me një mitologji edhe më të lashtë. Ne ishim thjesht turq, kudo që jetonim, qoftë në Perandorinë Osmane, Kaukaz, Azerbajxhan, Turkistan, Buhara, Kashgar ose gjetkë... Nga ana tjetër, intelektualët tanë kishin pikëpamje politike kaq absurde dhe qëllime shoqërore kaq qesharake kur i jepnin kuptime mistike termit osman, sa që, kur i dëgjoje, të dilnin lot nga sytë!

Ömer Seyfeddin, *Ashab-Kehfimiz*.



Ömer Seyfedin (1884-1920) ishte autor tregimesh, propagandist, ithtar i turqishtes së folur popullore dhe nationalist modernist i zjarrtë. Ai krijoi demonologji të fortë. Në shumicën e veprave të tij, temat kryesore janë nacionalizmi dhe pakicat kombëtare. Disa nga romanet e tij flasin për Luftërat Ballkanike dhe krimet bullgare. Novela e tij "Shtatë gjumashët tanë" është shkruar në formën e një ditari të një ish-revolucionari imagjinar armen, i quajtur Hajikjan. Në parathënien e novelës, në vitin 1918, pak përpara se të vdiste, Seyfedini thekson se e shkroi novelën në vitin 1913. Megjithatë, sipas Halil Bertkajit, ajo u shkrua në vitin 1918, si një ndjesë jo e drejtpërdrejtë ose si mbrojtje ndaj akuzave në gjyqin për krime lufte që kishte filluar në Stamboll.



Ç'ishte ideologjia e osmanizmit? Përse Seyfedini beson që kjo ide ishte një 'iluzion'?

## II-4. Ndjenjat e fshatarëve të krishterë ndaj Turqve të Rinj në Maqedoninë Osmane

Fshatarit që jetonte në kasollen me baltë të një katundi të largët, nuk i bëhej vonë për integritetin a tërësinë territoriale të Perandorisë Osmane. Gjithçka ai dinte për Perandorinë gjendej brenda luginës ku ai jetonte. Atij i patën thënë që gjërat do të ndryshonin tani që ishte shpallur *hurrieti*<sup>12</sup>. Dhe shpresonte

<sup>12</sup> Liria

që kjo do të thoshte fundi i zhvatjeve nga ana e taksambledhësve, arrogancës së bejlerëve dhe vrazhdësisë së ushtarakëve. Ai pati shpresuar që, tashmë, do të mund të lëronte arën e tij, pa pasur frikë. Ndoshta do të mund të gëzonte një pjesë më të madhe të ushqimit për të cilin ai dhe familja e tij rraskapiteshin për ta prodhuar. Kështu e kuptoi ai *hurrietin*. Qetë, ato pak sende që kishte në kasolle, arën dhe kishën e tij – kjo ishte gjithë hapësira e perandorisë që ai donte të ruante.

Por nuk ishte e thënë. Ata kishin ardhur papritur dhe i kishin thënë se djali i tij duhej të shkonte ushtar, në ushtri me turqit. Më pas, një ditë ushtarët nga Anadulli kishin rrethuar katundin, kishin hyrë nëpër shtëpi, kishin hapur sënduqet dhe kishin grisur dyshekët me kashtë. Kishin thënë se po kërkonin për pushkë të fshehura. Kur u kishte thënë se nuk kishte, ata e kishin rrahur për vdekje dhe i kishin fyer gruan.

“*Kaurr*<sup>13</sup>”, i kishin thënë,” na jep armët ose do të të vrasim”. Fatmirësisht, ai kishte ca para dhe ua dha që ta linin të qetë.

Tani, priftin e kishës së fshatit në anën tjetër të malit e kishin arrestuar. Ata e kishin prangosur dhe e kishin çuar në *Konak*<sup>14</sup>. Askush nuk e dinte se për çfarë krimi akuzohej.

Jo, nuk mund t’u besohej turqve. Turq të rinj ose të vjetër, *hurriet* ose jo, ata ishin njëlloj! Ata donin që të krishterët të përulleshin në gjunjë.

Në vitin 1911, Turqit e Rinj dhe regjimi i tyre i ri ishin kthyer në një makth të vërtetë. Më kot ata u munduan të rifitonin simpatinë dhe besimin që kishin pasur në popull në fillim, duke sjellë sulltanin<sup>15</sup> e ri në Selanik dhe, më pas, të parakalonte në Shqipëri.

Sciaky, f. 248

## II-5. 14 Pikat e Hasan Prishtinës

Pikat janë këto:

- 1) Me perdorue në Shqypni nëpunës të praktikuem qi dijnë gjuhën e zakonet e vendit;
- 2) Me ba sherbimin ushtarak vetëm në Shqypni e Makedoni, per jashta kohës së luftës;

3) Me ba e me vu në zbatim ligjë tue u bazue ne ligjen e maleve (xhibal) për disa krahina në të cilat asht forcue me fakte se nuk mund të xierret kurrnji fryt prej organizmit të drejtsis.

4) Me i dhanë shqyptarve armët e nevojshme e moderne, mënyra e të damit të cilavet do t’i perkitte Qeveris. (Do t’u bajshin nder vende të randësishem deposita armësh, të cilat, në rasë të nevojës, do të mund t’i merrshin shqyptarët).

5) Me themelue e me hapë shkolla reale në të gjitha Prefekturat e qandrave të Kosoves, të Monastirit, të Shkodrës e të Janinës qi numrojnë ka nji popullsi ma se 300.000 frymesh; me hapë

edhe shkolla bujqsiye si të Salonikut, mbassi vendi me krejt kuptimin asht nji vend bujqsiye; si edhe me shti në program të mësimave gjuhen e vendit.

6) Me hapë shkolla theologjike moderne ndër vende ku asht nevoja;

7) Me kenë i lirëshëm në Shqypni të hapunit e të themeluemit e shkollave private;

8) Me u mësue gjuha e vendit në shkollat fillestare, qytetse e në gjymnaze;

9) Me i dhanë randsi të posaçme tregtis, bujqsis e punve botore si edhe me plotsue e me perhapë udhët e hekurit;

10) Me vu në veprim organizimin e krahinave;

11) Me u kujdesue me ruejtë ma fort se perpara zakonet e tradicjonet komtare;

12) Me çpallë amnistin (faljen e pergjithshme), pa vështrave klasë e racë, per të gjith othomanët qi kanë marrë pjesë ne kryengritje, per komandantat, oficerat, nepunesit e ushtaret qi kanë lanë ushtrit e vendet e veta si edhe per të liruemit e t’ikunit prej burgut ne kohen e kryengritjes;

13) Me u dhanë çdamim, mbas çmimit të vertetë, prej Qeveris Turke për të gjitha ato shpija qi u prishen ma para e nuk u kje dhane të zotve çdamimi si edhe për ato qi u prishen e u rrenuen kësaj here;

14) Me i marrë në gjyq të naltë pjestarët e kabinetvet të Haki e të Sait Pashes

*Hasan bej Prishtina, Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912, f. 19-20*

<sup>13</sup> Emër fyes me të cilin thirreshin të krishterët dhe që ka kuptimin ‘i pafe’.

<sup>14</sup> Ndërtesë e madhe, pallat. Ndërtesa e qeverisë vendore në Selanik.

<sup>15</sup> Mehmeti V Reshat (1911-1918), sulltani i 35-të dhe djali i Abdul Mexhidit. Ai pasoi vëllanë e tij të madh, Abdul Hamitin (1909) dhe, më pas, ia la tërë pushtetin KBP-së (Komitetit për Bashkim dhe Përparim) dhe politikanëve. Vdiq para përfundimit të Luftës së Parë Botërore.



Hasan bej Prishtina (1873-1933) lindi në Vushtrri (Kosovë). Ai ndoqi shkollën e mesme franceze të Selanikut dhe një kolegji për administrim në Stamboll. Emri i tij i vërtetë është Hasan Berisha. Fillimisht, qe mbështetës i *turqve të rinj* dhe në vitin 1908 u zgjodh deputet në parlamentin turk por, duke denoncuar me forcë masakrat osmane në parlament, ai e humbi këtë post në vitin 1912, ashtu si edhe të gjithë deputetët e tjerë shqiptarë. Ai ishte udhëheqësi i kryengritjes në Kosovë nga maji deri në gusht të vitit 1912 dhe në Shkup formuloi kërkesat për autonomi të shqiptarëve, që iu paraqitën qeverisë turke në gusht 1912, të njohura tashmë si katërmbëdhjetë pikat e Hasan Prishtinës.

► **Fig. 14. Komitë në krahinën e Kosturit, në fillim të shekullit të 20-të**



Papazoglou, f.106.



Në të djathtë, vojvoda (kapedani) Marko Ivanov nga Kailari (sot Foufa, në krahinën e Kosturit) lindi në vitin 1877 dhe vdiq në Sofje, në vitin 1933. Në mes, vojvoda Manol Rozov nga Bobista (Verga e sotme, në krahinën e Kosturit) lindi në vitin 1878 dhe u vra më 3 shtator 1903. Kjo fotografi duhet të jetë bërë pak përpara kryengritjes së lindenit.

## II-6. Ideja për një Lidhje Ballkanike nga Ivan Vazovi, poet bullgar

Tetë vjet më parë, kur takimet vëllazërore midis rinisë universitare e punonjësve kulturorë serbë dhe bullgarë u bënë të shpeshta, redaktori ynë iu drejtua shumë politikanëve, autorëve dhe figurave publike të njohura bullgare, duke u kërkuar një opinionin të përmbledhur rreth Lidhjes Ballkanike, gjë që në atë kohë ishte një ëndërr e patriotëve të të dyja palëve. Ja çfarë u përgjigj poeti më i shquar bullgar që jeton, Ivan Vazovi, rreth Lidhjes Ballkanike:

*“Lidhje Ballkanike është një fjalë që uroj nga zemra të përjetësohet dhe të bëhet realitet sa më shpejt të jetë e mundur.*

Por, përse nuk është bërë realitet ende? Ka shumë arsye për këtë: gabime nga historitë tona (serbe dhe bullgare), e kaluara jonë, e largët dhe e afërt; mungesa e mendimit politik të pjekur tek ata që drejtojnë fatet e kombeve tona, prirja për konflikte dhe rivalitet të ndërsjelltë, tipike vetëm për sllavët. Siç mund ta kuptoni, ka shumë pengesa për ta realizuar këtë ide.

Ne duhet të kemi guximin dhe të bëjmë lëshime të dyanshme; duhet të kemi guximin për të harruar të gjitha interesat e njëanshëm kombëtarë dhe të mendojmë vetëm për një gjë: që, të dy popujt, ai bullgar dhe serb, do të jenë të lirë, të fuqishëm dhe të mëdhenj, vetëm në marshim vëllazëror përpara, përmes një lidhjeje të qëndrueshme politike”.

*Balkanski rat u slici i reči,*  
nr. 6, 24 shkurt (9 mars) 1913.



Përpiquni të shpjegoni arsyet që, sipas Vazovit, popujt e Ballkanit e kishin shumë të vështirë të bashkoheshin.

A mendoni se do të kishte qenë e mundur për vendet fqinje të harronin të gjithë interesat e njëanshëm kombëtarë në fillim të shek. të 20-të? Po sot, a është e mundur kjo gjë?



## II-7. Bashkimi Ballkanik sipas idesë së Partisë Socialdemokrate Serbe

### A. Nga fjala e udhëheqësit të Partisë Socialdemokrate Serbe, Dimitrije Tucoviç, në një miting proteste kundër luftës, në vitin 1912

Përsa u përket pikëpamjeve rreth çlirimit kombëtar, ne socialdemokratët mbajmë një qëndrim të ndryshëm nga ai i borgjezisë. Sepse borgjezia kërkon çlirimin e popullit të saj, duke u hequr popujve të tjerë lirinë e tyre. Nëse Maqedonia do të aneksohej nga Bullgaria, atëherë, për çdo bullgar të çliruar, do të kishim një ose më shumë serbë, grekë, rumunë, turq etj. të robëruar. Nëse Serbia e Vjetër do të aneksohej nga Serbia, atëherë, për çdo serb të çliruar, do të kishim dy shqiptarë, turq etj. të shtypur.

*Ne kërkojmë lirinë e popullit tonë, duke mos shkatërruar lirinë e popujve të tjerë.*

*Ky qëllim mund të arrihet vetëm duke krijuar një bashkim politik në Ballkan, në të cilin të gjithë popujt – serbë, bullgarë, grekë, rumunë, malazet dhe romë – do të jenë plotësisht të barabartë, pavarësisht nga fakti se cili prijës sundoi në një zonë të caktuar disa shekuj më parë.*

### B. Nga fjala e deputetit socialdemokrat serb, D. Lapçeviç, në Asamblenë Kombëtare, më 7 (20) tetor 1912

*Ne, zotërinj, jemi kundërshtarë të status quo-së. Ne nuk përkrahim përjetësimin e feudalëve dhe kastës së perandorisë turke, në të njëjtën mënyrë siç kundërshtojmë edhe përjetësimin e perandorive ose mbretërive të tjera; ne jemi për heqjen e status quo-së në të gjithë Gadishullin Ballkanik, jemi për një revolucion demokratik, i cili do të jetë garanci jo vetëm për çlirimin dhe qëndresën tonë ndaj vendeve europiane kapitaliste, por, me dëshirën e mirë, edhe e vetmja mënyrë për të arritur bashkimin tonë kombëtar dhe bashkimin kombëtar të të gjithë popujve të Ballkanit. (...)*

Ndarja e Ballkanit në shtete të vogla të veçuara do të jetë pikërisht burim kontradiktash midis kombeve

*dhe shteteve të vogla të Ballkanit. Pas kësaj, serbët do të duan të çlirojnë serbët nën sundimin bullgar, dhe bullgarët do të duan të çlirojnë bullgarët nën sundimin serb dhe, më pas, kjo do të shkaktojë kontradikta të pafund. Popujt e vegjël të Ballkanit do të shuhën dhe Ballkani shkallë-shkallë, si një mollë e pjekur, do të bjerë në duart e kapitalistëve grykës europianë, të cilët kanë oreks imperialist dhe etje koloniale. (...)*

*Ne, zotërinj, jemi*

**Kundër luftës ndërmjet popujve të Ballkanit, jo vetëm se ajo do të ishte e përgjakshme dhe e tmerrshme për ne, do të na degradonte dhe shkatërronte, por sepse ajo, me pasojat e saj, do të kishte efekte të tmerrshme, në rast se fuqitë europiane nuk do të bënin marrëveshje për ndarjen e menjëhershme e drejtpërdrejt të Ballkanit.**

*Lapceviç, Rat i srpska socijalna demokratija, f. 61-66.*

## II-8. Raport i Komitetit Qendror të Partisë Socialdemokrate Punëtore Bullgare (krahu i majtë), drejtuar BNS-së<sup>16</sup>

*Sofje, 13.11.1912.*


Bashkimi i vendeve ballkanike, i cili është konsideruar si një utopi nga ana e udhëheqësve borgjezë, sot është fakt i kryer. Në fakt, jemi ende shumë larg nga bashkimi ekonomik, politik dhe kulturor, çka është dhe qëllimi i socialdemokratëve në Ballkan. Por marrëveshja e arritur nga qeveritë ballkanike i shkurajon kundërshtarët e idesë së bashkimit ballkanik. Nëse kjo marrëveshje do të zgjatë edhe pasi këto mbretëri të kenë mundur përfundimisht armikun e tyre të përbashkët, ky do të jetë një hap vendimtar drejt një bashkimi më të ngushtë dhe të fortë midis popujve të Ballkanit, drejt Federatës Ballkanike.

Gjithashtu, ne po përpiqemi që edhe Turqia të hyjë në bashkimin ballkanik, sepse nuk mund të ketë një bashkim përfundimtar të popujve të Ballkanit pa turqit si një komb i pavarur, sepse ata përbëjnë 4-5 milion njerëz që jetojnë në Ballkan. Megjithatë, borgjezia dhe dinastitë sunduese, në duart e të

<sup>16</sup> Byroja Ndërkombëtare Socialiste – një seksion i Internacionales së Dytë – që përfaqësonte Bashkimin dërkombëtar të Partive Socialiste, themeluar në vitin 1889 në Paris. Ajo pas Luftës së Parë Botërore u shpërbë.

cilave është sot pushteti në Ballkan, parapëlqyen një bashkim të krishterë të vendeve ballkanike kundër Turqisë.

D. Blagoev<sup>17</sup>, *Bulletin*, nr.9.

 Çfarë alternative japin partitë socialiste të Bullgarisë dhe Serbisë kundrejt ndarjes dhe aneksimit të Maqedonisë?

Krahasoni dy dokumentet II-7 dhe II-8. A gjeni ndryshime midis tyre? Nëse po, përpiquni t'i shpjegoni. Komentoni idenë mbi krijimin e një Federate Ballkanike. A ishte e mundur kjo gjë në atë kohë?

### II-9. Raport i Federatës Socialiste të Selanikut, dërguar BNS-së në vitin 1913

Duke u bazuar në faktet reale, edhe në mbështesim idenë sipas së cilës kombet që jetojnë në këto territore, po të lireshin të lirë të shfaqnin prirjet e tyre dhe të shprehnin dëshirat e tyre, kurrë nuk do të kishin luftuar kundër njëri-tjetrit: të gjitha kombet do të kishin luftuar kundër regjimit autokratik, të bashkuar dhe në mirëkuptim me popullsinë turke. Lufta midis tyre do të ishte e pamundur, sepse çdo komb s'do të mund të kënaqte interesat e tij duke iu imponuar një kombi tjetër, përkundrazi, do ta arrinte këtë duke pasur unitet të fortë dhe bashkëpunim të ndërsjelltë. Kombësitë e Ballkanit janë kaq të ndërthurura në të njëjtat territore, sa që për të plotësuar interesat e tyre, duhet të vendoset një regjim ku sigurohet barazia kombëtare.

[...]

#### *Ndarja e paarritshme*

Në këtë mënyrë, çdo zgjidhje e çështjes maqedone dhe trake, që ka si qëllim të ndajë këto provinca midis aleatëve ballkanikë, të rinj ose të vjetër qofshin këta, pra Bullgarisë, Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi, ose edhe midis këtyre tre të fundit, në vend që të sillte paqe, në vend që të lehtësonte fatin e popujve që kanë vuajtur kaq shumë, do të hapte një periudhë të re lëndimi për ta; dhe ky vend, më shumë se tani, do të kthehej në fushë anarkie

dhe rivaliteti. Ballkani do të përbënte një rrezik të vazhdueshëm për paqen në Europë, nëse provincat e vjetra të Turqisë Europiane do të ndaheshin.

Elefantis, f. 44, 48.



Federata Socialiste e Selanikut u themelua në vitin 1909 dhe vazhdoi veprimtarinë deri në vitin 1918, kur së bashku me organizata të tjera socialiste krijoi Partinë Socialiste Punëtore të Greqisë. Anëtarët e saj ishin kryesisht hebrenj, por u përfshinë në të edhe bullgarë dhe një numër i vogël grekësh e myslimanësh. Ndërkohë që socialistët bullgarë ndoqën modelin gjerman të Karl Kautskit, (që mbronte parimin e pavarësisë kombëtare) Federata, ashtu si dhe socialistët serbë, ndoqi modelin austriak të Karl Rennerit dhe Otto Bauerit, të cilët i shikonin si të ndara termat kombësi dhe territor kombëtar. Federata ishte kundër ndarjes së territoreve osmane në Europë dhe përkrahte rrëzimin e absolutizmit osman dhe vendosjen e socializmit. Kjo ishte arsyeja përse, ndryshe nga socialistët e tjerë të Ballkanit (p.sh. bullgarët), ajo mbështeti revolucionin e Turqve të Rinj, duke pritur nga KBP-ja (Komiteti për Bashkim dhe Përparim) modernizimin politik dhe shoqëror të Perandorisë Osmane. Pas Luftës së Parë Ballkanike dhe para Traktatit të Bukureshtit, Federata e ndryshoi qëndrimin e saj, këtë herë duke mbështetur idenë e një Maqedonie (dhe Trakie) autonome. Ky qëndrim i ri gjen jehonë në raportin e dërguar BNS-së me titull "Zgjidhja e Çështjes Ballkanike" dhe të firmosur në mënyrë të njëzëshme nga "Një Ballkan".



Duke përdorur tekstet II-7, II-8 dhe II-9, përshkruani dy zgjidhjet e sugjeruara nga socialistët ballkanas për të ardhmen e Ballkanit, në përgjithësi, dhe Maqedonisë, në veçanti. Bëni dy lista dhe vendosni në to argumentet për çdonjërin nga zgjidhjet.



#### **Pyetje të përgjithshme**

Krahasoni osmanizmin, idenë e një Maqedonie autonome dhe idenë e një Federate Ballkanike: a mund të gjeni elemente të përbashkëta dhe të ndryshme?

<sup>17</sup> Dimitar Blagoev (1856-1924), ishte themeluesi i lëvizjes socialiste bullgare në vitin 1891 dhe dheheqës i PSDPB (krahu i majtë). PSDPB-ja u nda në dy pjesë në vitin 1903. Në vitin 1919 ajo mori emrin Partia Komuniste Bullgare.

**TABELA 14**  
**Burimet njerëzore gjatë Luftërave Ballkanike 1912-1913**

Shteti	Popullsia (në mijëra)	Burra (në mijëra)	Rekrutimi masiv (në mijëra)	Fuqia maksimale e forcave të armatosura (në mijëra)
1. Bullgaria	4 430	2 253	800	67
2. Serbia	2 910	1 500	530	175
3. Greqia	2 630	1 350	480	90
4. Mali i Zi	247	127	60	30
<b>Gjithsej</b>	<b>10 217</b>	<b>5 230</b>	<b>1 870</b>	<b>902</b>
5. Turqia	23 000	12 000	4 200	400

G. Georgiev, *Burimet njerëzore të vendeve që morën pjesë në Luftën Ballkanike 1912-1913.*

? Krahasoni shifrat dhe dilni në një përfundim në lidhje me fuqinë ushtarake të vendeve ndërluftuese.

### II-10. Artikulli i një gazete malazeze, lidhur me qëllimet e luftës, 1912

Idealet e të gjithë udhëheqësve të krishterë sllavë, nga Selaniku deri në Beograd, nga Cetina në Varna, janë duke u përmbushur. Padrejtësitë dhe vuajtjet po bëjnë që kjo ngrehinë të shembet nga themelet. Mashtrimet, zhgënjimet dhe ndasitë fatale po u lënë vendin ideve përparimtare, shpresave të mëdha dhe dashurisë së ndërsjelltë. Vetëm një mendim, një dëshirë, një vullnet i përbashkët, flijimi për vëllezërit e robëruar, i ka bashkuar në një të vetme mbretëritë e krishtera ballkanike, të cilat kanë habitur botën me ndërgjegjësimin, guximin, maturinë, tolerancën, e për më tepër, me shpejtësinë e veprimit të tyre. Kështjellat e ngritura nga pushtuesit lindorë, në klimën e kundërshtimeve dhe mosmarrëveshjeve ballkanike, tashmë janë shembur, dhe shtetet ballkanike po i dalin zot vetes duke hedhur themelet e forta e të qëndrueshme të pavarësisë së tyre. [...] Ata nuk kanë aspak faj për atë që po ndodh tani. Ata nuk dëshirojnë asgjë tjetër përveç se përmirësimin e gjendjes së të krishterëve në Ballkan. Kjo është detyra e tyre. Por jo vetëm e tyre; kjo është edhe detyra e të gjithë Europës së qytetëruar. Nëse përmbushja e një detyre kaq fisnike dhe qytetëruese vihet në dyshim vetëm për të mos prishur paqen, atëherë do të ishte më mirë që një paqe e tillë të mos ekzistonte... Të prishësh këtë lloj paqeje, nën të cilën

shumohen krimbat e kalbëzimit, krimbat të cilët kanë ngrënë pemën e shëndetshme të *Krishtëritit Ballkanik*, nuk është vetëm e drejtë, por edhe detyrë e gjithësecilit që ka zemër të mbushur me dashuri për përparimin e njerëzimit... Mali i Zi, edhe kësaj here do të përmbushë detyrën e tij, ashtu siç ka bërë gjithmonë në raste të tilla.

*Cetinjski vjesnik (Lajmëtari i Cetinës),*  
 Nr. 76, 22 shtator 1912, f. 1.

🔑 “Lajmëtari i Cetinës” u botua në Cetinë midis viteve 1908-1915. Zyrtarisht kjo gazetë ishte organ i pavarur, por mbështetej nga qeveria malazeze. Ajo financohej fshehtësisht me fondet e Ministrisë së Jashtme malazeze.

? Krahasoni këtë dokument me atë III-32. Cilat janë elementet e përbashkëta ideologjike që vëreni?

### II-11. Gazeta bullgare e partisë në pushtet rreth konfliktit serbo-bullgar për Maqedoninë, 1913

Nga fillimi deri në fund, kjo luftë epike është e lidhur me fatin e Maqedonisë; nëse Bullgaria nuk do të kishte bërë paraprakisht një pakt me Serbinë, lidhur me ndarjen e territoreve në Maqedoni, ajo *kurrë, kurrë dhe në asnjë rrethanë s'*do të kishte filluar luftë

kundër Serbisë. Nëse do të bëhej fjalë për shkëputjen dhe dhënien e territoreve bullgare, shumë kohë më parë Bullgaria mund të kishte gjetur aleatë të tjerë, me ndihmën e të cilëve Serbia vetë mund të ishte ndarë. Ne besuam fjalën e nderit të Serbisë, e cila na u dha nga përfaqësuesit e saj zyrtarë me lot në sy. Bullgaria pati nënshkruar një marrëveshje me Serbinë e cila, kur të botohet, do të tregojë që ajo

pati më tepër interes për mirëqenien e Serbisë, sesa për çlirimin e të krishterëve nën zgjedhën turke.

*Mir*, 3887, 17 maj 1913, tek Kishkiloza, Балканските войни.


🔑 “Mir” ishte organi i Partisë Popullore, e cila drejtoi vendin gjatë Luftës Ballkanike; ky ishte një organ rusofil.

► Fig. 15. Shqipëria duke mbrojtur Shkodrën dhe Janinën nga Mali i Zi -majmuni, Greqia – tigri, dhe Serbia - gjarpri



Gazeta Dielli, 13 shkurt 1913, f. 3.

► Fig 16. Rumania paraqitet si bartëse e qytetërimit evropian



Gazeta Ilustrata, II,  
6 korrik 1913, f. 1.



Përkthim:  
Rumania - bartëse e qytetërimit evropian;  
bullgarët - barbarët e Ballkanit.



Përshkruani simbolet e paraqitura në figurat  
15 dhe 16. Si paraqiten fqinjët e secilit vend  
në to?

## II-12. Shpjegimi i interesave rumunë nga një historian profesionist bërë menjëherë pas Luftërave Ballkanike

Ky operacion, i quajtur *Veprimi Ushtarak i Rumanisë*, që synon realizimin e interesave jetësore rumune në Gadishullin Ballkanik, ishte për tri çështje të rëndësishme:

1. Rumanisë duhet t'i dëgjohet fjala në çastet vendimtare për Gadishullin Ballkanik.
2. Prirjet politike dhe administrative shtetërore të Rumanisë, si vend fqinjë me aleatët ballkanikë, dhe që ka interesa shoqërore dhe ekonomike për të ruajtur një baraspeshë të qëndrueshme.

3. Çështja kombëtare, e cila përbëhet nga:
  - a. sigurimi i territorit të Dobruhës;
  - b. sistemimi i bashkatdhetarëve nga Maqedonia.

Grunberg, f.7

❓ Cilat ishin interesat jetësorë rumunë në prag të Luftës? Sa ndryshojnë ato nga interesat e vendeve të tjera ballkanike ndërluftuese? A ka ngjashmëri ndërmjet qëndrimit të Rumanisë ndaj Bullgarisë dhe qëndrimit të kombeve të tjera ballkanike ndaj Perandorisë Osmane? A mund të imponoheshin interesat rumunë në prag të një lufte dhe të mos shkaktonin luftë?

### ❓ Pyetje të përgjithshme për kapitullin IIa

Kërkoni materiale që shprehin entuziazmin e ushtarëve për luftën në dy raste: (a) në fillim të Luftërave Ballkanike; (b) në fillim të Luftës së Parë Botërore. Krahasoni dokumentet ballkanike me ato europiane perëndimore dhe përpiquni të gjeni elementet e përbashkëta.

#### Lojë me role

Ndahuni në dy grupe dhe, duke përdorur dokumentet e këtij kapitulli, përpiquni të paraqisni argumentet tuaja: (a) pro luftës; (b) kundër luftës.

## IIb. Çështja Lindore

### II-13. Përshkrimi i Çështjes Lindore nga një historian francez, 1898

#### A. Islamizmi përballë krishterimit

Për një kohë të gjatë, çështja Lindore ishte përqendruar në marrëdhëniet midis Perandorisë Osmane dhe shteteve të krishtera të Europës. Nuk mund të ishte ndryshe, përderisa problemet e vetme me të cilat përballëshin politikanët europianë ishin pavarësia e principatave Danubiane<sup>18</sup> ose ajo e Greqisë, lufta midis Rusisë dhe Turqisë për sundim në Detin e Zi, autonomia e Egjiptit, organizimi i brendshëm dhe reformat administrative të Perandorisë Osmane nën ndikimin europian,

marrëdhëniet diplomatike mes fuqive të krishtera dhe sulltanit. [...] Kuptimi i shprehjes “Çështja Lindore” duhej të ishte më i gjerë. Mënyra më e mirë për zgjidhjen e problemeve të lartpërmendura është që t'i trajtojmë ato duke i vendosur në kontekstin historik të të gjithë botës islamike. Të gjitha problemet politike (dhe shoqërore) të periudhës sonë nuk shfaqen më si çështje europiane, por si çështje tërësore, globale, në të cilat Pekini, Kejp Tauni dhe Nju-Jorku përfshihen po aq sa edhe Parisi, Londra ose Berlioni. Ne jemi të detyruar t'i trajtojmë problemet politike sipas kontributit të tyre në zhvillimin global. [Këtu jepet] një përmbledhje e shkurtër dhe e qartë e çështjes lindore në kuptimin e saj më të gjerë, që

<sup>18</sup> Vllahia dhe Moldavia

parakupton historinë e marrëdhënieve midis islamit dhe botës së krishterë. Islami, nga shekulli i 7-të deri në shekullin e 17-të, në një periudhë prej një mijë vjetësh, u përhap në të gjithë Azinë Perëndimore dhe Jugore, Afrikën e Veriut dhe Europën Jugore, duke u vendosur si sundim fetar dhe politik. Gjatë Mesjetës, vetëm Spanja dhe disa ishuj në Mesdhe arritën t'i shpëtonin këtij sundimi. Përpjekja e Europës së krishterë për t'i bërë qëndresë pushtimit mysliman me anë të kryqëzatave doli e pasuksesshme dhe shtetet e krishtera kërkuan ta bënin aleat dhe partner Perandorinë Osmane. Por, që nga shekulli i 17-të dhe në vazhdim, Perandoria Osmane filloi të dobësohej, për shkak të shpërdorimeve që lidheshin me pushtetin dhe mirëqenien e saj; dhe për më tepër, për shkak se ajo s'mundi të asimilonte popujt e pushtuar; ajo nuk arriti as të formonte një popullsi kompakte, as t'i bashkonte ata me turqit, të cilët mbetën pushtues, të vendosur jashtë, në troje armike.

## B. Perandoria Osmane dhe popujt e Ballkanit

Përsa i përket Turqisë Europiane, mëtimet rivale të Bullgarisë, Serbisë, Greqisë dhe Austrisë bënë të pamundur mirëkuptimin midis këtyre Fuqive. Pati një periudhë kur ndër armiqtë e Turqisë grekët vështroheshin si trashgimtarë të natyrshëm të këtyre rajoneve europiane. Kishte grekë të cilët ëndërronin që Kostandinopoja të bëhej sërish greke. Ëndrrat e tyre u shkatërruan; dhe shumë grekë vetëm për shkak të urrejtjes ndaj rivalëve të krishterë do të kishin pranuar mbizotërimin turk, nëse turqit do të ishin në gjendje të organizonin një administrim të përshtatshëm. Sot bullgarët janë populli më luftarak në Ballkan, më të zhvilluarit, me qeverisjen më të qëndrueshme dhe aktive. Tashmë, ata zënë një pjesë të madhe të Trakisë dhe po shtrijnë krahët në të gjithë Maqedoninë. Megjithatë, ky popull fshatarësh, që nuk e ka të zhvilluar tregtinë dhe industrinë, është ende shumë i varfër. Ata nuk mund të përballojnë veprime ushtarake dhe mjaftohen me përfitimin e lëshimeve të bëra nga Sulltani, si rezultat i kërcënimeve për sulme të cilat, në të

vërtetë, nuk fillojnë kurrë. Bullgaria së bashku me Rumaninë i bllokojnë rrugën Rusisë, kështu që Rusia nuk është në gjendje të arrijë në Kostandinopojë nga toka. Ajo mund të arrijë në Kostandinopojë vetëm nëpërmjet Azisë së Vogël, por Rusia nuk do t'i lejojë kurrë bullgarët të vendosen në Bosfor. Ambicjet e bullgarëve ndaj Maqedonisë nuk bien edhe aq ndesh me interesat e Serbisë, e cila duket se nuk është në gjendje të ndërtojë Serbinë e madhe të ëndrrave të saj, por bien ndesh me interesat e Austrisë e cila, duke pushtuar Bosnjën, është e detyrur të shikojë nga Selaniku. Atëherë, Maqedonia do të shkëputej plotësisht nga Bullgaria dhe do ndahej midis Malit të Zi, Shqipërisë dhe Greqisë.

## C. Koncerti europian

Në këtë mënyrë, aleanca franko-ruse nuk luajti rol gjatë ngatërresave të fundit në Lindje. Ajo ishte vepruese vetëm si drejtuese e orkestrës në koncertin europian, koncert në të cilin instrumentet ishin në harmoni me njëra-tjetrën vetëm kur rrinin në heshtje. Në fund të fundit, nëse ndjekim mendimin egoist që rrjedh nga interesat tanë, kjo politikë për status quo-në është zgjidhja më bindëse për ne. Është e vetmja zgjidhje, e cila nuk rrezikon një luftë europiane, shtirjen, kohëzgjatjen dhe rezultatin e së cilës askush s'mund ta parashikojë.

Driault, f. 66-67; 72-73; 75.



Ky tekst është marrë nga parathënia e shkruar prej Gabriel Monodit për librin mbi *Çështjen Lindore* të studentit të tij, Edouard Driault. Gabriel Monod (1844-1912) ishte profesor në *Ecole Pratique des Hautes Etudes* dhe në *Collège de France*. Ai ishte themeluesi i historisë pozitivistike në Francë. Edouard Driault (1864-1947) ishte profesor i historisë dhe i gjeografisë në Universitetin e Sorbonës.



Sipas Gabriel Monodit, cili është kuptimi kryesor i *Çështjes Lindore*? Si paraqitet *Çështja Lindore* në tekstet tuaja shkollore?

► Fig 16. *Dordoleci i shkëlqyer* (karikaturë nga E. Muanovic, Beograd, 1912)



Botuar në gazetën ruse *Iskr*, 45, 1912.

🔑 Poshtëshkrimi: Austriakët: 'Roje! Hajdutët!'



► **Fig. 17. Lopa e qumështit**  
(karikaturë osmane e vitit 1909)



Kalem, 22 korrik 1909, tek Brummett, f. 172.

Poshtëshkrimi:  
Ushtari turk – Mjaft morët ju; lini pak edhe për të zotin!

? Shikoni dy karikaturat: ç'përfaqësojnë figurat e ndryshme? Si paraqitet politika e Fuqive të Mëdha ndaj Perandorisë Osmane?

#### II-14. Roli i Fuqive të Mëdha, përshkruar nga një revolucionar maqedonas prej Velesit

Por ata të gjithë dukeshin si të luajtur mendsh. Nuk mund ta imagjinonin që ushtria fitimtare bullgare mund të thyhej dhe besonin shumë në fitoren e saj. Unë ua theksova që Bullgaria do të kishte kundër Fuqitë e Mëdha të Antantës, të cilat në ato çaste zotëronin Europën. Përveç kësaj, po përpiquesha të vërtetoja që po ato Fuqi të Mëdha – në rast të fitores së Bullgarisë - nuk do të lejonin të rrezikoheshin

interesat e Serbisë dhe Greqisë. Në kundërshtim me këtë, ata pretendonin që Fuqive të Mëdha u interesonte fitorja e Bullgarisë, sepse, në këtë mënyrë, Bullgaria do të zinte një vend mbizotërues në Ballkan dhe mund të ruante paqen në këtë pjesë të Europës. Vetëm pas kësaj, Ballkani nuk do të ishte një burim luftërash dhe kryengritjesh. Unë nuk mund ta imagjinoja një idiotësi më të madhe sesa të mbështesje këtë qëndrim.

Martulkov, f.275-276.

? Sipas autorit, cili ishte roli i Fuqive të Mëdha në politikën ballkanike?

#### II-15. Qarkore e ministrit rus të Punëve të Jashtme, Sazonov, dërguar përfaqësuesve diplomatikë jashtë vendit, 18 tetor 1912

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME QARKORE PËR  
PËRFAQËSUESIT DIPLOMATIKË RUSË JASHTË  
VENDIT

Shën Peterburg, 18 tetor 1912

Që kur nisi të thellohej kriza në Ballkan, Ministrisë së Jashtme iu shtruan përpara dy çështjet e mëposhtme:

1. Që shpërthimi i luftës në Ballkan ishte pothuajse i pashmangshëm;
2. Ndërkohë që ishte e nevojshme të bëhej çdo gjë e mundur për të ruajtur paqen në rajon, njëkohësisht ishte e nevojshme të merreshin masa për lokalizimin e luftës, në rast se shpërthente.

Vetëm kur të përmbusheshin këto dy qëllime, do të mund të sigurohej kontakt i drejtpërdrejtë me qeverinë në Vjenë. [...]

Nëse vazhdojmë më tej, me një vlerësim të domethënies së këtyre veprimeve në këtë çast, së pari, duhet të tërheqim vëmendjen tek deklarata për paprekshmërinë e status quo-së territoriale dhe, së dyti, është gjithashtu e nevojshme të mbahen parasysh sugjerimet e mëposhtme:

Është shumë i njohur fakti se kjo deklaratë ishte e lidhur ngushtë me një faktor tjetër – që Fuqitë e Mëdha gjithashtu do të merrnin përsipër përgjegjësinë për përmbushjen e reformave. Por kush i pengonte ta arrinin këtë qëllim? A ishin vendet ballkanike që i ndalonin të arrinin qëllimin? Jo, ato vetëm kërkuan të dinin se ç'garanci jepte marrëveshja e sipërpërmendur. Në fakt, është krejt e kundërta. Deklarata që Fuqitë e Mëdha i drejtuan Turqisë, nuk ishte një deklaratë e prerë dhe Turqia iu përgjigj se nuk do të lejonte ndërhyrje të huaja dhe do të zbatonte vetë reformat e nevojshme. Në këtë mënyrë, çështja e dytë e deklaratës: *zbatimi i reformave nga Fuqitë e Mëdha* – binte poshtë, për shkak se Turqia nuk lejonte ndërhyrjen e huaj. Sipas mendimit tonë, kjo e bëri të pavlefshme pjesën e parë: - *deklaratën për paprekshmërinë e status quo-së territoriale*. Por megjithatë, nuk do të ngremë pengesa për vendet e Ballkanit lidhur me këtë çështje.

Duke u bazuar në këtë logjikë, për ne çështja e status quo-së nuk është çështje e një rëndësie parësore, por në rast të prishjes së saj, ne do të ngulmojmë shumë që të mbahen parasysh pikat e mëposhtme:

1. Fuqitë e Mëdha s'duhet të ndërhyjnë në zgjerimet territoriale të vendeve të Ballkanit;

2. Në kompensimet midis vendeve të Ballkanit, të mbahet parasysh parimi i 'baraspeshës', bazuar në marrëveshjet që paraprijnë aleancën e tyre.

Nënshkruar: Sazonov  
*Lufta Ballkanike ose Libri Portokalli Rus*, f. 19-21.

## II-16. Një "monark i mirë"

Në këtë krizë, perandori mbahet mirë, më mirë se në të gjithë [...] Ai është i qetë, i zgjidh problemet me vetëdijen dhe saktësinë e tij të natyrshme. Aftësia e tij për të marrë vendime në moshën 83-vjeçare është për t'u admiruar. Perandori kërkon paqe [...] Ai do që ta kapërcejë mosmarrëveshjen me Serbinë dhe ta justifikojë emrin Perandori i Paqes që i dha Europa. Por, nëse do të jetë e nevojshme, plakushi nuk do të ngurrojë...

*Hrvatski pokret*, 2 dhjetor 1912<sup>19</sup>.

? A e dini se cili ishte vërtet qëndrimi i perandorit Franc Jozef gjatë krizës ballkanike? A ishte ai i vendosur apo ngurronte? A e pranoni përshkrimin që i bëhet monarkut austriak në tekst?

## II-17. Artikull në një gazetë rumune, 16 qershor 1913 – dita e sulmit bullgar kundër Serbisë

### *Konflikti serbo-bullgar*

Përsa i përket Austrisë, ajo mbështet bullgarët, sepse është e interesuar që serbët të mos fuqizohen më shumë. Serbia është një lloj shtojce irredentiste për monarkinë habsburgase. Popullsia serbe në Hungari lufton ashpër kundër idesë së një shteti hungarez. Austria, duke aneksuar Bosnjën dhe Hercegovinën, ka ndikuar që të shtohet irredentizmi serb, prandaj mbështet bullgarët me të cilët nuk ka ndonjë konflikt për çështjet etnike.

*Viitorul*, VI, nr. 1921, 16/29 qershor 1913, f. 1.

## II-18. Pjesë nga libri i një politikani rumun

Me siguri, lufta midis aleatëve ballkanikë është përgatitur në Vjenë. Austro-Hungaria donte të parandalonte me çdo kusht zgjerimin e mëtejshëm të Serbisë. Konti Berhtold shpresonte të fitonte mbështetjen e mbretit Ferdinand të Bullgarisë dhe Karolit I të Rumanisë, sepse urdhri që Ferdinandi i dha ushtrisë për të sulmuar Serbinë, përkoi me garancinë që i dha Vjena, se do të ndihmohej nga rumunët...

Diaconescu, f. 34-35.

? Përse politika austro-hungareze ishte e rëndësishme për vendet e Ballkanit? Në periudhën e Luftërave Ballkanike, cili ishte roli i Austro-Hungarisë në marrëdhëniet ndërballkanike?

<sup>19</sup> Ky artikull doli në një gazetë austriake dhe u ribotua në *Hrvatski Pokret*.

## II-19. Ndarja e plaçkës së luftës

Disfata përfundimtare e Turqisë nuk do të sjellë fundin e tragjedisë ballkanike. Kjo është jashtë çdo dyshimi. Kombet që kanë krijuar aleancën ballkanike, kanë filluar betejën për pushtime dhe territore. Dhe është tepër e natyrshme që çasti më kritik në zhvillimin e ngjarjeve në jug të Danubit do të jetë kur aleatëve do t'u duhet të ndajnë plaçkën e luftës, kur njihet rivaliteti shekullor midis këtyre popujve

### ► Fig. 18. Europa dhe fëmijët e tërbuar (karikaturë rumune, 1913)



Furnica, IX, nr. 20, 17 Janar 1913, f. 9.

## IIc. Pritja dhe shpallja e Luftës

### II-20. Perandoria Osmane nuk e priste luftën

Askush në mjediset tona shoqërore nuk e besonte se do të kishte luftë me Bullgarinë, e aq më pak kundër të katra vendeve të Ballkanit. Nga të gjitha drejtimet,

dhe mendësia e tyre e ngurtë. [...] Nën gërmadhat e Turqisë Europiane ka mbetur një vullkan i ri, i cili do të lëkundë kurdoherë paqen europiane. Një situatë e tillë nuk mund të zgjidhet me masa gjysmake dhe ndërhyrje idealiste. Europa ka detyrimin moral që të shfaqë energji të mëdha, në mënyrë që t'u japë fund një orë e më parë ndeshjeve dhe luftimeve që mundojnë botën ballkanike.

Gazeta "Miscarea", Bukuresht, 20 mars/2 prill 1913.



Poshtëskrimi: Europa dhe fëmijët e tërbuar: Përse vjehrra nuk thotë asnjë fjalë rreth Luftërave Ballkanike?!



### Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin IIb

Si shihej dhe kuptohej nga popujt e Ballkanit roli i fuqive europiane në konfliktin ballkanik? Cila ishte politika e vendeve të ndryshme europiane për Ballkanin?

### Lojë me role

Ndahuni në dy grupe, që do të përfaqësojnë fuqitë e ndryshme europiane. Përpiquni të jepni interesat e secilit vend europian në lidhje me Gadishullin Ballkanik dhe pozicionin e tij në Çështjen Lindore.

çdokush thoshte: "Është bluf, është mashtrim!". Megjithatë, çdo gjë kishte qenë e qartë prej shumë kohësh. Këto shtete të vogla, së bashku me Rusinë dhe Austrinë, nuk mund të na linin kohë që një ditë të bëheshim shumë të fuqishëm. Nëse do të

kishte vazhduar regjimi i Abdul Hamitit, lufta nuk do të kishte filluar, sepse politikanët e fuqive të mëdha dhe të vogla ishin tepër të ndërgjegjshëm se ky regjim do të na çonte shumë shpejt në një përfundim që ata e kishin ëndërruar.

Izzet-Fuad pasha<sup>20</sup>, f.33.

? Sipas Izzet Fuad pashës, në cilat rrethana lufta nuk do të kishte shpërthyer? Cilët fajëson ai për luftën?

## II-21. Shpallja e luftës kundër Perandorisë Osmane nga George I<sup>21</sup>, 5 tetor 1912<sup>22</sup>.

### POPULLI IM

Detyra jonë e shenjtë ndaj vendit tonë të shtrenjtë, ndaj vëllezërve tanë të robëruar dhe ndaj njerëzimit kërkon që shteti, pas dështimit të përpjekjeve paqësore për të siguruar të drejtat njerëzore të të krishterëve nën sundimin turk, të rrokë armët për t'u dhënë fund vuajtjeve që ata kanë duruar prej shekujsh.

Greqia, së bashku me aleatët e saj që janë frymëzuar nga të njëjtat ndjenja dhe shtyrë nga të njëjtat detyrime, ndërmerr këtë luftë të shenjtë për drejtësi dhe lirinë e popujve të shtypur të Lindjes. Ushtria dhe marina jonë, plotësisht të ndërgjegjshme për detyrën e tyre ndaj kombit dhe krishterimit, duke pasur parasysh traditat e tyre kombëtare dhe krenarë për lartësinë e vlerave të tyre morale, hyjnë në luftë me besnikëri, të gatshëm për të derdhur gjakun e tyre të pastër për të çliruar ata që janë nën zgjedhë.

Greqia, së bashku me aleatët e saj, do të mbrojë këtë kauzë të shenjtë me çdo kusht; duke iu lutur Zotit të na ndihmojë në këtë luftë, plotësisht në emër të qytetërimit, ne thërrasim "Rroftë Greqia, Rroftë kombi!".

Gardika-Katsiadaki, Margaritis, *Egjeu*.

## II-22. Mbreti Ferdinand i Bullgarisë shpall luftën

*Deklaratë drejtuar popullit bullgar*

5 tetor 1912

Gjatë 25 vjetëve të mbretërimit tim kam punuar gjithmonë në mënyrë paqësore për përparimin, lumturinë dhe emrin e mirë të Bullgarisë. Dhe ky ishte drejtimi që unë doja të ndiqte populli bullgar. Por fati ka vendosur ndryshe. Ka ardhur koha kur i gjithë populli bullgar duhet të lërë jetën e tij paqësore dhe të rrëmbejë armët, për të përmbushur një detyrë të lavdishme. Përtej Rilas dhe Maleve Rodope, vëllezërit tanë të të njëjtit gjak dhe besim nuk kanë ende mundësi që të gëzojnë jetën me dinjitet si qenie njerëzore, edhe tani pas 35 vjetësh që ne jemi çliruar.

Me gjithë përpjekjet për të arritur këtë qëllim, nga Fuqitë e Mëdha si dhe nga qeveritë bullgare, nuk u arrit të krijohen kushtet që këta të krishterë të mund të kishin të drejtat dhe liritë njerëzore. Qëndrimi ynë paqësor mori fund... në mënyrë që të ndihmojmë popullin e krishterë të shtypur në Turqi, ne nuk na mbetet rrugë tjetër, veçse të rrokim armët. Tashmë është e qartë që kjo është rruga e vetme për t'i siguruar këtij populli mbrojtjen e jetës dhe të pasurisë. Gjithashtu, anarkia në Turqi ka rrezikuar edhe vendin tonë. Pas masakrës në Shtip dhe Koçani, qeveria turke urdhëroi mobilizimin e forcave të saj ushtarake, në vend që t'i jepte popullit të vuajtur të drejtat e tij dhe t'i plotësonte kërkesat, siç ngulmuam edhe ne. Kjo solli dhe fundin e durimit tonë të gjatë.

Ndjenja njerëzore e krishterë, detyra e shenjtë për të ndihmuar vëllezërit tanë, në një kohë kur ekzistenca e tyre kërcënohet, nderi dhe dinjiteti i Bullgarisë më ka ngarkuar detyrimin që të thërras për të shërbyer në ushtri djemtë e vendit, të cilët janë gati për ta mbrojtur atë.

Çështja jonë është e drejtë, e lavdishme dhe e shenjtë. Me besim dhe përlulje ndaj mbrojtjes dhe ndihmës së Zotit të plotfuqishëm, unë i deklaroj

<sup>20</sup> Izzet Fuad pasha ishte inspektor i përgjithshëm i Kavalerisë Osmane dhe ish-komandant i Armatës së Tretë Ushtarake të Trakisë.

<sup>21</sup> George I, 'mbreti i Helenëve' (1863-1913), ishte djali i dytë i mbretit të Danimarkës, Kristianit IX. Ai lindi në Kopenhagen, në vitin 1845 dhe u vra në Selanik, më 5/18 mars 1913, nga një i çmendur.

<sup>22</sup> Dokument origjinal, i firmosur nga mbreti George, E. Venizelosi dhe anëtarët e kabinetit.

popullit bullgar që shpall luftën për të drejtat njerëzore të të krishterëve në Turqi. Urdhëroj ushtrinë e guximshme bullgare që të pushtojë territoret e Turqisë! Bashkë me ne, kundër armikut tonë të përbashkët dhe me të njëjtin qëllim do të luftojnë dhe ushtritë e aleatëve tanë, shtetet ballkanike – Serbia, Greqia dhe Mali i Zi. Dhe në këtë luftë të Kryqit kundër Gjysmëhënës, lirisë kundër zgjedhës, ne gëzojmë simpatinë e të gjithë popullit, i cili do drejtësi dhe përparim.

Ferdinand<sup>23</sup>

Kishkilova, *Балканските војни*.

► **Fig. 20. Udhëtim për qejf**  
(karikaturë osmane, 5 tetor 1912)



*Cem* 41, 5 tetor 1912, f. 8, tek Heinzelmann, f. 221.

Revista e përjavshme “Cem” konsiderohet të jetë rivalja dhe gjithashtu, pasardhësja e revistës “Kalem” (“Laps”). Ashtu si dhe “Kalem”, “Cem” botohej pjesërisht në osmanisht dhe pjesërisht në frëngjisht. Emri “Cem” vjen nga mbiemri i botuesit të saj Mehmed Cemil Cem. U botua më 10 nëntor të vitit 1910.

Përkthim: Udhëtim për qejf!

-Më jep bileta për të udhëtuar në Sofje, Beograd, Cetinjë dhe Athinë; kthimin lëre të hapur.

-Sa bileta, ju lutem?

-Shtatë ose tetëqind mijë për momentin.

**II-23. Deklaratë drejtuar ushtarëve nga komandanti i Ushtrisë Lindore Turke, Abdullah pasha<sup>24</sup>**

8 tetor 1912

Vëllezër luftëtarë dhe bashkatdhetarë, Ne kemi vendosur ta mundim armikun, i cili po shkel tokën e shenjtë të vendit tonë. Për të gjithë myslimanët, nesër dhe pasnesër do jenë ditët e shenjta të Bajramit. Thyerja përfundimtare e armikut, që po trazon vendin dhe popullin tonë prej kaq shumë vitesh dhe nuk po lë të qetë vëllezërit tanë që jetojnë në Bullgari, duhet të konsiderohet detyrë e shenjtë për çdo mysliman. Ja përse çdo oficer dhe çdo vëlla ushtar duhet të luftojë deri në fund për të shpëtuar atdheun tonë, çdo grusht dhe i të cilit është lagur nga gjaku i të parëve tanë.

Shpëtimi i atdheut dhe popullit tonë do të varet nga trimëria dhe vendosmëria që do të tregoni ju gjatë këtyre dy ditëve.

Shokët e mi trima dhe të paepur! Unë besoj se dëshira për hakmarrje që ndieni në zemrat tuaja, është garancia që ju do ta përmbushni këtë detyrë. Nga përballja që kemi pasur këto ditë me armikun, mund të themi se ata janë frikacakë dhe se do të

<sup>23</sup> Ferdinandi I Saks-Koburggotski (1861-1948) ishte princi gjerman në krye të Principatës Bullgare që prej 1888-ës dhe cari i Bullgarisë, nga 1908 deri në 1918.

<sup>24</sup> Abdullah pasha ishte komandant i përgjithshëm i Ushtrisë Turke të Lindjes në fillim të Luftës së Parë Ballkanike.

largohen sapo të ndeshen me një fuqi të vërtetë. Ja përse urdhrat e dhënë duhet të zbatohen. Forca bijtë e mi të dashur!

Përpara!

Kujtoni se lumturia në tokë dhe parajsja e përtejme ju presin. Zoti është me ne, ashtu si dhe shpirti i Muhametit dhe lutjet e kalifit tonë mbi tokë – sulltanit tonë të dashur.

V. Georgiev-St. Trifonov.

❓ Krahasoni tekstet II-21, II-22 dhe II-23. Nënvizoni fjalët dhe shprehjet e përbashkëta. Çfarë ndjenjash frymëzojnë ato? Cilat janë qëllimet e luftës, sipas deklaratave zyrtare të të dy mbretërve? Cilat janë qëllimet e luftës, sipas komandantit osman?

► **Fig. 21. Ballkani kundër tiranit, 5 tetor 1912 (litografi greke)**



Litografi me ngjyra, e pikturuar mbi karton të fortë, 55x41cm / 62x47cm / Koleksioni IEEEE, nr. 4951/1 në Βαλκανικοί Πόλεμοι 1912-1913....., f. 57.

<sup>25</sup> Rilindja Bullgare: periudhë e historisë së Bullgarisë (fundi i shek. të 18-të - fillimi i shek. të 19-të), që u karakterizua nga zhvillimi kombëtar, ekonomik dhe arsimor.

<sup>26</sup> Sheinovo, Shipka, Slinvnitsa: vende historike, të njohura për fitoret bullgare gjatë shekullit të 19-të.

❓ Ç'përfaqësojnë personazhet në këtë poster? Përcaktoni simbolet që përputhen me fjalët celës në deklaratat e mbretërve të Greqisë dhe Bullgarisë.

A mendoni se Perandoria ishte vërtet viktima, ashtu siç paraqitet në figurë? Si ndikon ky poster në opinionin publik?

**II-24. Në Serbi pritet lufta, 8 tetor 1912**

*Beograd, 8 tetor 1912*

Lajme të papëlqyeshme u përhapën dje në qytet. –“Bie era paqe!” – njerëzit flisnin duke vënë shamitë në hundë. Nëse një serbi i duhet të zgjedhë: paqen ose kolerën? – ai do të përqafojë kolerën (...) “Kur do të nisë lufta?” - pyet çdokush; vetëm një erë e ftohtë që fryn nga Maqedonia e di përgjigjen; apo edhe tavolinat e ministrave, të cilët mbajnë llampat elektrike ndezur deri natën vonë; por asnjë nga ata nuk dëshiron të përgjigjet.

*Gazeta Hrvatski pokret, 9-31 tetor 1912.*

**II-25. Një bullgar përshkruan ndjenjat e popullit përpara luftës**

Më 5 tetor u mbajt një shërbesë publike solemne. Ferdinandi lexoi deklaratën e luftës dhe Metodi Kuseviç, peshkopi i përgjithshëm i Stara Zagorës mbajti një fjalim. I kujtoj ato çaste si një ëndërr. Ndërkohë që po largoheshim nga kisha, ishim shumë të prekur, por mbi të gjitha, ndienim një besim të madh se do të dilnim fitues. Përpjekjet e vazhdueshme gjatë Rilindjes<sup>25</sup>, të cilat kishin filluar me guxim dhe kishin dalë gjithmonë të suksesshme – shembulli më i fundit është bashkimi i Rumelisë Lindore me Principatën Bullgare në vitin 1885 - i kanë dhënë popullit bullgar shumë besim në vetvete, madje mund të them se e kthyen optimizmin kombëtar në një kult të ri. Nga ana tjetër, Sheinovo, Shipka dhe Slinvnitsa<sup>26</sup> treguan se

bullgarët kanë ruajtur të paprekur trimërinë, për të cilën të parët e tyre kanë qenë të njohur përgjatë shekujve. Ne kishim përballë një armik të fuqishëm, por e shpërfillëm fuqinë e tij. Sa e çuditshme: pasi kishim qenë nën zgjedhën turke për pesë shekuj, dhe pasi kishim sunduar turqit e Bullgarisë për vetëm 34 vjet, ne i diskreditoam ata. Në Bullgari, në popull qarkullonin zëra se Turqia, tashmë, ishte një shtet drejt shkatërrimit. Nëpër gazeta, sulltani paraqitej gjithmonë si një njeri i sëmurë, i fashuar rreth e qark kokës. Në ushtri, aq shumë bullgarë kanë qëlluar për nishan një dordolec me feste, sa që u mësuan ta konsiderojnë sulltanin viktimë të paracaktuar..

S. Radev<sup>27</sup>, Това което видях.

? Çfarë ndienin njerëzit e zakonshëm për luftën? Përse ishin ata aq të sigurtë për përfundimin me fitore të saj?  
Ç'rol luajti propaganda zyrtare për të krijuar një besim të tillë?

## II-26. Fragmente të shkëputura nga dy gazeta që botoheshin në shqip, jashtë vendit dhe që shprehin dy qëndrime të ndryshme ndaj Luftës së Parë Ballkanike

### A. Nga një gazetë e botuar në Boston

Mitingu i madh që patriotët mbajtën në Boston më 6 tetor 1912, është një ngjarje e shënuar për lëvizjen shqiptare. Takime të tjera që janë mbajtur në Amerikë, kanë shprehur patriotizmin dhe idealet e rinisë sonë. Por mitingu i 6 tetorit shfaqti diçka tjetër të papritur dhe shumë të veçantë, sepse ishte diçka e rrallë: dua të flas këtu për kuptimin e tij politik. Nuk ishte pa rëndësi, të kishë patriotët të mbledhur nga të katra anët e Amerikës dhe njëzëri të shpallnin se interesi i Shqipërisë është bashkimi i plotë me Turqinë, kundër vendeve të Ballkanit.

Shqipëria rrezikohet që të copëtohet dhe mund të shpëtojë vetëm nga mbështetësit dhe miqtë e saj. Ky miting është deri-diku arsyeja që ndikoi tek qeveria osmane, që ajo të mbronte të drejtat e Shqipërisë në Konferencën e Londrës. Nuk mund të mohohet se, nëse Turqia donte të hiqte dorë nga mbrojtja e Shqipërisë, do të ishte në interes të saj t'u jepte Greqisë, Serbisë, Malit të Zi çfarë këto vende kërkojnë, në mënyrë që të bënte paqe me mbretëritë e tyre dhe do t'i mbetej të përballej vetëm me Bullgarinë. Por veprimet tona të bashkuara e zbutën atë dhe politika që ne ndoqëm, bëri që ajo t'i kuptojë fajet dhe dëmet e shkaktuara në të shkuarën dhe, duke dashur të na e shpërblente, nguli këmbë që Janina, Shkodra dhe mundësisht edhe Manastiri, të ishin pjesë e Shqipërisë së re.

*Dielli*, 19 dhjetor 1912, f. 1.

### B. Nga një gazetë që botohej në Sofje

Ky program i katër Fuqive të bashkuara është një program i pëlqyeshëm, prandaj kombi shqiptar nuk duhet të bashkohet me Turqinë dhe të luftojë në krah të atij që është dënuar me vdekje. Ai duhet të ngrejë zërin dhe t'i kërkojë të drejtat e tij tek Fuqitë e Mëdha. Duhet të prezantohet në të gjithë botën se kombi shqiptar është nën zgjedhë dhe se ka 4 vjet, tashmë, që lufton dhe kërkon autonominë e Shqipërisë.

Liri e Shqipërisë,  
"Mbi Aleancën Ballkanike",  
12 tetor 1912, f. 1.

🔑 "Dielli" ishte një gazetë e përjavshme që botohej në Boston nga Faik Konica, një prej intelektualëve më të njohur shqiptarë. "Liri e Shqipërisë" ishte një tjetër e përjavshme që botohej në shqip, në Sofje, nga Kristo Luarasi, një tjetër patriot dhe intelektual shqiptar.

? Cilat ishin dy qëndrimet ndaj luftës dhe çfarë argumentesh përdoren në secilin artikull për të mbështetur qëndrimet përkatëse?

<sup>27</sup> Simeon Radev (1873-1967) – historian, publicist dhe diplomat bullgar.

► Fig. 22. Duke dhënë lamtumirën - në Sofje dhe në Stamboll



Krahasoni dy fotografitë. Cilat janë ndryshimet dhe ngjashmëritë midis tyre?



*L'illustration*, t. CXL (1 Korrik - 31 Dhjetor 1912), f. 301.

## II-27. Pjesë nga Traktati i Aleancës ndërmjet Mbretërisë së Greqisë dhe Mbretërisë së Serbisë, nënshkruar më 19 maj (1 qershor) 1913

### Neni 2

Kur të bëhet ndarja e territorit të Turqisë Europiane, i cili në fund të kësaj lufte do t'u jepet shteteve të Ballkanit nga traktati i paqes, [...] të dyja palët në këtë aleancë angazhohen që të mos nënshkruajnë marrëveshje të veçanta me Bullgarinë, që do të përkrahin njëra-tjetrën dhe do të veprojnë gjithmonë në mirëkuptim, duke mbështetur në mënyrë të ndërsjelltë pretendimet e tyre territoriale dhe kufijtë e përcaktuar si më poshtë.

### Neni 3

Dy palët kontraktuese, duke patur parasysh që është në interesin jetësor të të dyja mbretërive që asnjë shtet tjetër të mos shtrihet ndërmjet territoreve të tyre në perëndim të lumit Aksios (Vardar), deklarojnë që do të mbështesin njëra-tjetrën, në mënyrë që Greqia dhe Serbia të kenë një kufi të përbashkët. [...].  
Skoko, f. 405-408.



► **Fig. 23. Malazet të gëzuar prej shpalljes së luftës, 1912**



*Balkanski rat u slici i reči 6, 24 shkurt (9 mars) 1913.*

**II-28. Deklaratë e mbretit Nikolla të Malit të Zi, 27 korrik 1913**

Malazet!

[...] I entuziazmuar nga fitoret e arritura dhe nga lavdia e aleatëve të tij, bashkudhëtari ynë i katërt donte të merrte për vete, me forcë, plaçkën tonë të përbashkët të luftës, duke mos marrë parasysh drejtësinë e Zotit dhe gjykimin prindëror të *carit mbrojtës*<sup>28</sup> [...] bullgarët shkuan në rrugë të gabuar dhe u ndanë nga grigja jonë *sllave* [...] dhe sulmuan vëllezërit dhe aleatët e tyre. Bullgarët duhet të ndalen me të njëjtën mënyrë dhe të mësohen të respektojnë interesat e përbashkëta dhe solidaritetin sllav. Ky vendim më lëndon thellë në zemër, sepse njëri krah duhet të presë krahun tjetër, por ne s'mund të veprojmë ndryshe. Shpirti im mbushet me trishtim, sepse më duhet të nxis trimërinë tuaj që të zbrapsë sulmet bullgare, por unë ushqej shpresa se, pasi engjëlli i paqes do të hapë krahët mbi Ballkan, një pemë e re dhe e fortë e bashkimit sllav do të rritet nga gjaku ynë i përbashkët sllav [...]

*Nikolla (nënshkrimi) Cetinjë, më 27 korrik 1913.  
Balkanski rat u slici i reči 23, 14 (27) korrik 1913.*

**II-29. Deklaratë e mbretit Konstandin të Greqisë, 21 korrik 1913**

Populli im!

Ju bëj thirrje për një betejë të re.

Kur formuam aleancën me shtetet e tjera të krishtera për të çliruar vëllezërit tanë nën zgjedhje, ne patëm fatin të shikonim luftën tonë të përbashkët të arrinte fitore dhe t'i jepte fund tiranisë, të shikonim se si forcat greke triumfonin si në tokë, ashtu edhe në det. Perandoria e mundur hoqi dorë nga territoret e çliruara bashkërisht nga aleatët. Greqia, me drejtësinë e saj të zakonshme dhe në marrëveshje me dy nga aleatet e saj, dëshironte një ndarje miqësore të zonave të çliruara, sipas të drejtave të secilit komb dhe sugjeroi që çdo kontradiktë të zgjidhej me ndërmjetësim; megjithatë, aleatja e saj lakmitare, Bullgaria, refuzoi çdo bisedim ose marrëveshje dhe kërkoi të merrte shumicën e fryteve të fitores së përbashkët, duke mos marrë parasysh as të drejtat etnike dhe sakrificat e të tjerëve, dhe as ndonjë nevojë logjike për të pasur një baraspeshë. Duke përdorur çdo lloj mashtrimi dhe arbitrariteti dhe duke harruar qëllimin çlirimtar të luftës, detyrimet ndaj aleatëve të saj, përvojën e hidhur të popujve të krishterë të gadishullit, si pasojë e kontradiktave të shkuara, por edhe rezultatet e shkëlqyera, si rrjedhojë e bashkëpunimit tonë, Bullgaria shkoi aq larg, sa u përpoq të bëjë një luftë dritëshkurtër, duke u kthyer kundër aleatëve të saj, për të shkelur dhe rrëmbyer të drejtat e tyre dhe, në këtë mënyrë, duke përdhosur qëllimin e shenjtë të luftës së përbashkët.

Duke parë sjelljen e padenjë të Bullgarisë, detyra e aleatëve të tjerë ishte shumë e qartë. Ata duhej të shtrëngonin radhët përsëri dhe të ruanin unitetin për t'u përballur me grykësinë e pangopur të aleatit të tyre të mëparshëm, për të mbrojtur interesat e tyre thelbësore, duke zhdukur mëtimet hegjemoniste dhe duke siguruar barazinë ndërmjet *shteteve të Aemos* [mali Ballkan], kaq të nevojshme për bashkëjetesën e tyre paqësore. Populli grek, në solidaritet të ngushtë me Serbinë dhe Malin e Zi, dhe i bindur për qëllimin e shenjtë po rrok armët

<sup>28</sup> Cari i Rusisë.

përsëri, për një luftë të re për vatrën dhe altarin e tij. Ushtrisë dhe flotës sime, të cilat e kanë bërë Greqinë më madhështore, u bëhet thirrje të vazhdojnë luftën e tyre fisnike dhe të shpëtojnë ata që u çliruan nga tirania turke, nga rreziku i një robërie tjetër më të tmerrshme. [...]

Kjo betejë e dytë është shenjtëruar nga Zoti, po aq sa edhe e para dhe unë lutem për bekimin e tij, “sepse mbreti beson te Jezui dhe në mëshirën e Zotit që do na bëjë të fitojmë”. [...]

Baltsa, 20 qershor 1913<sup>29</sup>.

*Gazeta qeveritare e Mbretërisë së Greqisë 121, 21 qershor 1913.*

? Krahasoni tekstin II-28 me atë II-29: cili është kuptimi i fjalës ‘vëlla’ në secilin rast? Përcaktoni kuptimin e së njëjtës fjalë në tekstin II-22. Shpjegoni kuptimin e thënies “për të mbrojtur interesat e tyre jetësore, ...bashkëjetesë paqësore”. Krahasoni idenë që përçohet nga këto thënie me idenë e baraspeshës midis fuqive europiane në të njëjtën periudhë.

### II-30. Gazetat dhe opinioni publik në Rumani në prag të pushtimit të Bullgarisë nga Rumania, gjatë Luftës së Dytë Ballkanike

#### A. Ne duam luftë!

Nga të gjitha anët e vendit tonë ka vetëm një zë që buron nga të gjitha zemrat tona, dhe që buçet; *Ne duam luftë!*

Nuk ka forcë në Rumani që të ndalë luftën: çdokush që do të ngrihet kundër rrymës, do të shtypet nga vrulli i valëve të saj. [...]

Populli rumun – dhe çdo rumun i thjeshtë – e ndien se një Bullgari e madhe është një rrezik kombëtar: një rrezik politik, etnik dhe ekonomik për Mbretërinë Rumune dhe për të gjithë kombin rumun. [...]

Kjo është thjesht një luftë parandaluese. Ne duam të sigurojmë të ardhmen e vendit tonë, ne

duam të zhdukim rrezikun që mund ta kërcënojë atë; gjithashtu, ne duam të jetojmë në paqe që këtej e tutje, të zhvillohemi larg konkurrencës, të shkatërrojmë që në syth çdo rrezik të mundshëm. *Universul, XXXI, nr. 176, 29 qershor/12 korrik 1913, f. 1.*

#### B. Turma ishte gjigante

Turma ishte gjigante. Shumë parulla bënin thirrje për luftë dhe thirrja “*Mobilizim!*” dilte nga buzët e mijëra njerëzve. [...]

Shpallja e mobilizimit ngre një stuhë entuziazmi. Rezervistët nxitojnë për në Bukuresht nga qendrat më të largëta, trenat janë mbushur plot, njerëz mbi vagonë këndojnë plot gjallëri; dhe jemi ende larg nga lufta e madhe.

*Bacalbasa, f. 116.*

? Përse “fqinji i madh” ishte një rrezik kombëtar? A mendoni se kjo thënie është e vërtetë? Gjeni dhe shpjegoni ndryshimet që qëndrojnë ndërmjet këtyre teksteve dhe shpalljes së luftës kundër Perandorisë Osmane nga mbreti grek dhe ai bullgar.

### ► Fig. 24. Hora – valle tradicionale rumune. Ushtarë rumunë që kërcëjnë gjatë rrugës për në Bullgari



*Gazeta Illustrata, II, nr. 31, 13 korrik 1913, f. 4.*

<sup>29</sup> Dokument i nënshkruar nga mbreti Konstandin, kryeministri El. Venizelos dhe anëtarët e kabinetit.

### II-31. Artikull në një gazetë rumune, ku bëhen përpjekje të shpjegohen arsyet dhe qëllimet e pushtimit të Bullgarisë nga Rumania

Ne do të ishim gjithmonë nën kërcënimin e topave bullgarë dhe do ta kishim luftën në derë në çdo çast, për rrjedhojë, përparimi i kombit tonë do të pengohej; ndërsa tani, qysh në fillim, bullgarët do ta ndiejnë peshën e armëve tona të hekurta. Në trysinë e pushtimit tonë, ata do të heqin dorë përgjithmonë nga synimet e tyre të guximshme dhe të padrejta për një vend të dobët dhe ne, sigurisht që do t'i bëjmë ta kuptojnë këtë. Roli i Rumanisë së sotme është ai i një kirurgu të aftë dhe të guximshëm, të cilit i duhet të çajë mishin pa mëshirë, në mënyrë që të heqë, që nga rrënjët, gjithë të keqen që rrezikon jetën e tërë organizmit. Operacionet tona ushtarake, nga ana tjetër e Danubit, duhet të jenë operacione të plota kirurgjikale dhe jo thjesht qetësuese, të cilat do të ulnin temperaturën për një çast, por nuk do të shmangnin rrezikun që nesër ajo temperaturë të ngrihej shumë më e lartë.

*Miscarea*, V, nr. 152, 8/21 korrik 1913, f. 1.



Gjeni dhe analizoni mjetet shprehëse të propagandës në këtë tekst.

### II-32. Deklaratë e kryeministrit bullgar, S. Danev<sup>30</sup>, mbi pushtimin rumun të Bullgarisë

Pardje, kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, dr. Danev, bëri këtë deklaratë në Asamblenë Kombëtare:

Zonja dhe zotërinj, anëtarë të parlamentit! Që nga dita e djeshme, rreziqe të reja po i kanosen

Bullgarisë. Në orën 6 të mbrëmjes së djeshme, ambasadori rumun në Bullgari më njoftoi se qeveria rumune i kishte dhënë urdhër ushtrisë së saj të pushtonte Bullgarinë. Motivimi i tyre ishte se, nga njëra anë, Rumania ishte e lirë të ndërhynte në rast lufte ndërmjet vendeve të Ballkanit dhe, nga ana tjetër, lufta kishte shpërthyer dhe, për më tepër, ishte shkaktuar prej nesh.

Do të doja të thoja pak fjalë rreth marrëdhënieve tona me Rumaninë. Ju e dini se marrëdhëniet tona me Rumaninë kanë qenë gjithmonë shumë miqësore (...) Ja përse qeveria bullgare, duke pasur parasysh marrëdhëniet e mëparshme miqësore midis dy vendeve, i konsideron veprimet e Rumanisë si të pajustificuara. Sipas mendimit tonë, qeveria rumune, çfarëdo arsyesh të ketë pasur, nuk duhej të kalonte në këto veprime të skajshme, dhe ne nuk pranojmë asnjë përgjegjësi.

Zotërinj! Ushtria rumune, në këto çaste po pushton ato pjesë të largëta të vendit tonë, ku jetojnë vetëm pleq, gra dhe fëmijë. Në këtë situatë, nuk bëhet fjalë për qëndresë të armatosur. Pra, në mënyrë që të parandalojmë çdo veprim të këtij lloji, ne urdhëruam rojet tona të kufirit të tërhiqen dhe nëpunësit e shtetit të qëndrojnë dhe të përpiqen të qetësojnë popullin aq sa munden.

Përveç kësaj, ne vetëm mund të protestojmë kundër këtij pushtimi të pajustificuar të atdheut tonë. Duke qëndruar në këto pozita, të cilat janë pozitat e rendit dhe drejtësisë, ne ia parashtrijmë këtë çështje vendimit të ndërgjegjes publike të Europës dhe shpresojmë që të drejtat tona do të respektohen.

*Bulgaria*, nr. 230, 30 qershor 1913; *Mir*, nr. 3929; *Narodna Volya*, nr. 36, 1 korrik 1913;

*Narod*, nr. 15, 2 korrik 1913, tek Kishkilova, Балканските войни.



#### Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin IIc

Krahasoni figurat 22, 23 dhe 24. Ç'ndjesi përçojnë dhe çfarë ndjenjash kanë si qëllim të ngjallin ato? Përpiquni të gjeni foto të tjera nga vendi juaj, të cilat përçojnë ndjenja për luftën.

#### Lojë me role

Ndahuni në grupe: a) bullgarë, b) grekë, c) serbë dhe përpiquni të diskutoni rreth të drejtave tuaja pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Shpjegoni sipas ideologjisë suaj kombëtare, përse ju duhet të zini treva të caktuara të Perandorisë Osmane.

<sup>30</sup> Stojan Danevi (1858-1949) ishte jurist, profesor, politikan, udhëheqës i Partisë rusofile Liberal-Përparimtare dhe kryeministër (01.06 – 04.07.1913).



## KAPITULLI III: Shoqëritë gjatë Luftës

Gjatë çdo lufte, shoqëritë që marrin pjesë në të, janë në të njëjtën kohë të bashkuara dhe të ndara. Në fillim të luftës, përgjithësisht shoqëria është e bashkuar rreth qëllimit përfundimtar dhe përpiket të arrijë fitoren, por pak nga pak, ajo përballet me mizoritë e luftës. Në të njëjtën kohë, shoqëria nuk është e ndarë vetëm nga bindjet politike, por gjithashtu, prej realitetit: ndërkohë që shumica e meshkujve janë në front, gratë, fëmijët dhe pleqtë qëndrojnë në shtëpi, duke patur frikë të vazhdueshme se mos humbasin të afërmit e tyre. Përpjekjet për të bërë jetë të zakonshme janë thjesht të pamundura. Praktikisht, lufta ka ndikim të madh mbi çdo gjë. Në front ose në prapavijë, të gjithë bëjnë përpjekje maksimale për të përmbushur detyrën që shoqëria, me dëshirë ose jo, ka marrë përsipër.

Frontet e luftës kanë qenë gjithmonë vendi ku është bërë historia zyrtare e luftës. Përshkrime të hollësishme të fitoreve dhe humbjeve, të manovrave mjeshtrorë ose shkatërrimtare janë vetëm njëra anë e asaj që në të vërtetë ndodh në frontet e luftës. Edhe fitoret, edhe humbjet krijojnë një galeri heronjsh të idealizuar, të mbinatyrshëm ose situata që përbëjnë mitologjinë e çdo lufte. Luftërat Ballkanike nuk bëjnë përjashtim nga kjo. Në të njëjtën kohë, është ana e tmerrshme e luftës që mbizotëron në çdo kujtim vetjak: mijëra të vdekur, të plagosur dhe të gjymtuar, lodhje shkatërruese, shpërthime dhune.

Grupe të ndryshme paraushtarake – shpesh banda ose grupe jo të rregullta të armatosura – kanë luajtur rol të rëndësishëm në tablonë e përgjithshme të Luftërave Ballkanike. Ndryshe nga ushtritë e rregullta ku zbatohet disiplina ushtarake, këto grupe ishin shkaktarët kryesorë të shumicës së akteve të dhunës ndaj civilëve në zonat e luftimit. Djegia e fshatrave të “të tjerëve”, grabitjet e zakonshme, si edhe konvertimi dhe shpërnguljet me forcë kanë qenë, gjithashtu, pjesë përbërëse e historisë së luftërave.

Ky kapitull jep mundësi të hidhet një vështrim më i baraspeshuar mbi jetën e ushtrive në front dhe të civilëve në front e në prapavijë, gjatë Luftërave Ballkanike. Këtu vihet theksi tek përvoja e luftës e ushtarëve të kombësive të ndryshme. Në këtë mënyrë, paraqiten të përbashkëtat e vuajtjeve, por gjithashtu, edhe e veçanta e luftës si një përvojë e përditshme që përfton ndjenja shoqërore.

Roli i grave në periudhë lufte dokumentohet, gjithashtu, nga dy këndvështrime: (a) gruaja e idealizuar – si nënë ose heroinë dhe (b) gratë në front ose në prapavijë si infermiere, nëna dhe bashkëshorte.

Për më tepër, përplasjet në front janë pasqyruar në pozitat e pakicave kombëtare prapa frontit. Të krishterët në Perandorinë Osmane dhe myslimanët në shtetet kombëtare të Ballkanit kanë qenë pre e pasigurisë dhe e shpërnguljes me forcë.

Në shumicën e burimeve, këndvështrimet e kundërta me njëri-tjetrin janë sjellë për çmimizimin e rrëfimeve kombëtare heroike për luftërat dhe për paraqitjen e këtyre luftërave në kompleksitetin e tyre.

### Illa. Frontet e Luftës

► Fig. 25. Ushtria bullgare



L'ILLUSTRATION  
**L'ARMÉE BULGARE**

CROQUIS ET IMPRESSIONS D'UN PEINTRE MILITAIRE FRANÇAIS EN THRACE

**INFANTERIE EN CAMPAGNE**

Tambours. — Officier monté. — Jeune clairon du 1<sup>er</sup> régiment. — Officiers et soldats (réserve).

Page de croquis en couleurs de LUCIEN SCOTT

L'illustration, janar-dhjetor 1913, f. 249.

### III-1. Përshkrim i fitores së ushtrisë serbe në Kumanovë

Beteja zgjati dy ditë dhe një natë. Turqit kishin zënë pozicione jashtëzakonisht të mira, të cilat i kishin fortifikuar shumë mirë dhe i kishin maskuar me mjeshtëri në kohën e duhur. Atashetë ushtarakë të fuqive të huaja që pas betejës, për qëllime studimi analizuan pozicionet e Kumanovës, thanë se, duke gjykuar nga zgjedhja e pozicioneve dhe mënyra e fortifikimit të turqve, mund të shihet qartë se turqit kishin komandantë të shkëlqyer, të cilët njihnin me detaje të gjitha rregullat e luftimit modern dhe i zbatuan ato në çdo aspekt dhe me ndërgjegje të plotë në betejën e Kumanovës. Fakti që serbët i mundën kaq shkëlqyeshëm dhe i dëbuan me forcë nga këto pozicione të fortifikuara, është provë e aftësisë së oficerëve serbë dhe guximit të pashoq të ushtarëve serbë, mendimi kryesor i të cilëve ishte *Hakmarrje për Kosovën!* Do të tregoheshim të padrejtë me kundërshtarin, nëse nuk do të përmendnim me respektin që i takon guximin e trupave turke. Për dy ditë dhe një natë – në raste të panumërta duke shpërfillur vdekjen - ata u përpoqën të çanin radhët tona me sulme dhe arritën shumë herë të përmbanin sulmet tona, derisa ushtarët tanë, përgjatë gjithë frontit, filluan të sulmojnë me bajoneta, me vendosmërinë që t'i jepnin fund betejës me luftime trup me trup, si një herë e një kohë për Kosovën, e të vendosnin se kujt i takonte fitorja. Në këtë çast, afërsisht njëqind mijë serbë kishin vetëm një qëllim - fitore ose vdekje, njëlloj si vdekja e martirëve të Kosovës. Turqit, guximi i të cilëve nuk mund të mohohet në asnjë mënyrë, nuk mund t'i bënin ballë kësaj vale, e cila do të ishte e papërballueshme për çdo ushtri sepse, kur njëqind mijë heronj vendosin të shkojnë drejt vdekjes dhe zjarrit me vendosmërinë dhe idenë që "ne kurrë s'do të kthehemi të gjallë!", armiku do të mposhtet, pavarësisht nga forca e tij."

*Balkanski rat u slici i reči 2, 27 janar (9 shkurt) 1913.*

### ► Fig. 26. Përshëndetja e fundit (Beteja e Kumanovës)



Albumi i luftës i Rista Marjanoviçit 1912-1918.



Krahasoni tekstin me fotografinë. A përputhet fotografia me përshkrimin e betejës?

### III-2. Ushtria greke merr Selanikun

TELEGRAM QË NJOFTON MARRJEN E SELANIKUT  
MBRETI ËSHTË RRUGËS PËR ATJE , ME NJË TREN  
TË POSAÇËM

#### *Marrja e Selanikut*

Marrja e Selanikut pritej gjatë 24 orëve të shkuara, por njoftimi se dje ushtria greke marshoi në qytet, shkaktoi një shpërthim emocionesh dhe gëzimi, sepse në fillim Athina, dhe më pas e gjithë Greqia ndien një lehtësim të papërshkrueshëm, si ai që pason të gjitha ngjarjet e mëdha dhe buron drejtpërdrejt nga shpirti i kombit. Askush nuk besonte se në këtë luftë të nisur kundër Turqisë, ushtria greke do të hynte triumfalisht në qytetin më të madh maqedon kaq shpejt. Dhe kjo fitore – rëndësia e së cilës i justifikon humbjet e shkaktuara pas një rruge të gjatë dhe të lodhshme, sidomos në këtë periudhë të vitit kur urat e shkatërruara nga armiku gjatë tërheqjes dhe vërshimet e lumenjve vështirësonin akoma më shumë përparimin tonë – bëhet edhe më domethënëse, duke pasur parasysh ironinë me të cilën opinioni publik european e priti në fillim deklaratën e luftës greko-turke, dhe numrin

e qartë të forcave armike kundër të cilave ushtria jonë duhej të luftonte.

Tashmë, qyteti i parë maqedon u çlirua prej bajonetave greke, ashtu si edhe provincat e tjera, më parë turke, por gjithmonë absolutisht greke; edhe popullsia që deri dje kishte qenë nën zgjedhën turke, mund të thithë ajrin e lirisë; skllëvërit mund të ngrenë kryet dhe të festojnë çlirimin. Gjaku grek, i derdhur për këtë qëllim, erdhi si një pikë vese për të ringjallur lulet e fishkura të lirisë maqedone. Askush nuk është i hidhëruar për këtë. Prindërit të cilët morën vesh për humbjen e djemve të tyre në luftën e shenjtë për atdheun, bekuan fatin e tyre; edhe nëse nënat derdhën lot, ato e bënë këtë sepse mësuan që vdekja e të dashurve të tyre u dha lirinë mijëra vëllezërve tanë; motrat e tyre nuk mbajtën zi; edhe nëse vëllezërit e tyre të vegjël shprehën

hidhërim, kjo ndodhi se fati i mbajti larg këtë triumf fisnik. Ndërkohë, realizimi i idealeve të kombit, të paktën për një pjesë të bashkatdhetarëve tanë, sjell një ndjenjë gëzimi të pakufi; çdo zemër greke, çdo mendje greke, kudo që ndodhet nëpër botë, është drejtuar nga fushat e Maqedonisë.

Duke hyrë në Selanik, forcat greke i shtuan edhe një faqe tjetër të lavdishme historisë së tyre dhe fituan nder dhe respekt për fuqinë e tyre.

Gazeta *Embros*, Athinë, 27 tetor 1912.

❓ A shikoni ngjashmëri midis përshkrimit të Betejës së Kumanovës dhe marrjes së Selanikut? A mund të përcaktoni teprimet? Për çfarë qëllimi shërbejnë ato?

► **Fig. 27. Princi trashëgimtar i fronit të Greqisë marshon në Selanik**



Fig. 27

Litografi me ngjyra, pikturuar mbi karton të fortë, 42x62cm / 44x62cm / Koleksioni IEEEE, nr. 4951/99 në *Βαλκανικοί Πόλεμοι 1912-1913...*, f. 103.

❓ Të ç'kombësie janë njerëzit që mirëpresin princin trashëgimtar të Greqisë?



► Fig. 28. Mbretit Nikolla të Malit të Zi i dorëzohet flamuri turk, pasi trupat e tij futen në Shkodër, prill 1913.



Živko M. Andrijašević,  
Šerbo Rastoder,  
*Istorija Crne Gore...*, f. 283.


► Fig. 29. Mbreti bullgar Ferdinandi, mbi gërmadhat e kalasë së Kavallës



*L'illustration*, janar-dhjetor 1913. f. 17.

? Krahasoni figurat 28 dhe 29.  
Si paraqiten dy personalitetet?  
Cili është kuptimi simbolik i të dyja  
fotove?

## ► Fig. 30. “Vëllazëria” greko-bullgare



*Adevarul*, XXV, nr. 8353, 11 dhjetor 1912, f. 1.

## III-3. Një ushtar serb ndihmon fëmijët turq

*Si është një ushtar serb?*

*Ai është zemërdhembshur me kundërshtarin.* Në zonat e sapoçliruara, të gjitha qytetet e mëdha janë plot me turq të gjorë, në kushte të mjera, të zhveshur e të zbatshur, të etur dhe të uritur. Ata që mbanin dhe mbronin familjen, hynë në ushtri për të mbrojtur Perandorinë, ndërkohë që gratë, pleqtë dhe fëmijët mbetën pa mbrojtje. Nga frika e armikut, ata lanë shtëpitë e tyre dhe çdo gjë tjetër në to dhe u larguan drejt qyteteve, duke shpresuar që atje do të ishte më e lehtë për të gjetur mbrojtje. Uria bëri që të lypnin një copë bukë. Për këtë arsye, në qytetet e sapoçliruara nuk mund të ecësh në rrugë pa u shqetësuar nga turq të mjerë, të cilët kërkojnë t'u japësh diçka sa për të blerë ushqim.

Një oficer më përshkroi këtë skenë nga Kavadarci: “Kavadarci është mbushur me turq të varfër, të cilët po vdesin urie. Në një qoshe, një ushtar i thjeshtë serb u ul mbi një gur, mori dy fëmijë turq në prehër, duke i ulur secilin në njërin gju dhe i përqafoi me të dyja krahët. Në njërin dorë ai mbante bukën e

**Përkthim:**  
Në Selanik, mbreti i Bullgarisë është puthur me mbretin e Greqisë. Bullgarët kanë mbushur kodrat përfaq Selanikut me topa! (lajmet e marra me telegraf)  
Ferdinand: *Le të puthemi, por ju mund t'i jepni Selanikut puthjen e lamtumirës.*

ushtrisë dhe në tjetrën, bajonetën; me bajonetë ndau një copë bukë dhe ia dha njërit prej djemve turq, të dytën ia dha djalit tjetër; dhe për vete mori të tretën. Unë po i vështroja nga një cep i rrugës dhe më erdhi keq që nuk kisha një aparat, të bëja një fotografi nga kjo skenë e mrekullueshme dashurie dhe dhembshurie e ushtarit serb për fëmijët e armikut të mundur, nga kjo skenë dhembshurie për fatkeqësinë e tyre.”

*Balkanski rat u slici i reči 12, 7 (20) prill 1913.*

❓ A janë veprime të tilla njerëzore, karakteristike e një kombi të caktuar?

Çfarë tregojnë ato?

A besoni se shfaqje të tilla dhembshurie janë të mundura në kohë lufte?

A keni lexuar në librat tuaj shkollorë rreth ndonjë akti të tillë njerëzor, të ndërmarrë nga “krah kundërshtar”?

Mendoni se kjo është një ngjarje e vërtetë, apo mund të jetë një histori e sajuar për qëllime propagande?

► Fig. 31. Fëmijë turq duke nderuar ushtarët serbë, 1912



Titulli: Në «skajet» e luftës. Fituesit nderohen nga fëmijët, të pandërgjegjshëm për humbjen.

L' *Illustration*, t. CXL, (1 korrik-31 dhjetor 1912), f. 373.

#### III-4. Riza Nuri shpjegon shkaqet e humbjes së osmanëve

##### *Rreth betejës në Ljule Burgas*

Thuhet se pranë komandës, disa ushtarë thirrën: "Vraponi..., përse qëndroni këtu? Çdo gjë mbaroi. Secili të shpëtojë kokën!" Kështu, disa ushtarë e lanë frontin. Një panik i panevojshëm pasoi këtë ngjarje. Ushtarët që nisën këto thashetheme ishin bullgarë. Mendoj se kjo ishte e vërteta. Kishte grekë dhe bullgarë në ushtrinë tonë, ata ishin nënshtetasit tanë, por ata të gjithë ishin tradhtarët e turqve. Për vite me radhë, shumë prej tyre kanë luftuar kundër nesh. Ky ishte një mësim që qeveria autokrate duhet ta ketë provuar me mijëra herë të tjera, kështu që nuk duhet të rekrutonte ushtarë të tjerë, përveç

myslimanëve. Sigurisht, kjo kishte një arsye. Ata (unionistët) thonë: "Kështu thotë kushtetuta. Nuk mund të ketë një ndarje të tillë. Ata janë të gjithë qytetarë. Ata janë partnerë, në të mirë dhe në të keqe." Kjo, gjithashtu është e vërtetë, por situata ishte e tillë, ishin turqit që gjithmonë paguanin me gjakun e vet; ishin ata që dhanë jetën. Kombi turk po zhdukej. Sigurisht që elementët e kombësive të huaja gjithashtu do të zhdukeshin, kjo është e vërtetë, por ata e shkaktuan një katastrofë kaq të madhe. Disa mendojnë se ky panik u shkaktua nga unionistët, të cilët thuhet se thërrisnin 'Vraponi..., ushtria jonë e Rumelisë u mund nga serbët, ajo u tërhoq thellë në Shqipëri'. Ata thanë se batalionet shqiptare e lanë frontin. Në fakt, shqiptarët vepruan në këtë mënyrë, të mashtruar nga serbët. Kjo është

e vërteta. Grekët rrethuan Janinën. Atje, Vehip pasha dhe vëllai i tij, Esad pasha, ngritën një mbrojtje të pathyeshme. Shefi i Shtabit, Ali Fuati, u tregua trim dhe u plagos. Ushtarët shqiptarë dezertuan edhe në Janinë. Ushtarët turq ishin të uritur dhe të sëmurë. Për një kohë të gjatë, ushtarët e mbrojtën Janinën heroikisht, por më pas, edhe ajo ra. Hasan Riza pasha tregoi heroizëm të madh në Shkodër. Falë tij, rrethimi i Shkodrës vijoi për një kohë të gjatë. Hasan Rizai ishte një ushtarak shumë i zoti. Në fund, shqiptari Esad pasha, i cili një herë e një kohë detyroi Abdul Hamitin të hiqte dorë nga fronti, vrau Hasan Rizanë. Vdekja e tij është një humbje e madhe për turqit. Esadi ishte një faqezi. Më vonë, pas shpalljes së pavarësisë, shqiptarët e vranë atë, por ç'e do? Shkodra kishte rënë. Komandanti i Selanikut, shqiptari Tahsin pasha e dorëzoi Selanikun pa luftime dhe pa kushte. Thonë se ai u pagua nga grekët për këtë. Ky varg ngjarjesh tregon se ishin shqiptarët ata që shkaktuan këto katastrofa. Çfarë prove e mirë, për të treguar se çdo të thotë të punësosh elementë të huaj në poste të larta! Kjo qeveri ishte me të vërtetë e marrosur.

Riza Nur, *Memoirs [Kujtime]*.

? Sipas autorit të këtyre kujtimeve, cilat ishin shkaqet e humbjes? Përse thotë ai se ushtarët duhet të jenë vetëm myslimanë?

### III-5. Major Milovan Gavriloviçi përshkruan mënyrën se si kapi Shukri pashën<sup>31</sup>

Regjimenti im, regjimenti i 20-të, kishte detyrë të merrte kodrën Kazan. [...] Ai u përball me një qëndresë të fortë, veçanërisht me zjarrin e artilerisë. [...] Megjithatë, regjimenti vazhdoi të sulmonte vullshëm përpara, në një rreze të gjerë, duke e detyruar këmbësorinë turke përballë tij të hynte në luftim trup me trup, dhe e shpartalloi atë. S'dyshohej më për fitoren tonë. Dhe me të vërtetë, flamurë të vegjël të bardhë filluan shumë shpejt të valëviteshin nëpër kulla, dhe një i dërguar i Shukri pashës iu drejtua një oficeri të regjimentit të 20-të, duke i

kërkuar shprehimisht që komandanti i ushtrisë serbe, gjenerali Stepa Stepanoviç, të negocionte kushtet e dorëzimit me të [...]

Oficeri më udhëhoqi nëpër disa strehime të errëta dhe më çoi përpara zyrës së Shukri pashës. Sapo u hap dera e zyrës, unë hyra brenda. Shukri pasha u çua në këmbë me gjithë stafin e tij. Iu afrova, e përshendeta ushtarakisht dhe në këtë çast që s'do ta harroj kurrë, iu drejtova me fjalët:

-Shkëlqesia juaj! Majori i ushtrisë serbe, Milovan Gavriloviç, ka nderin t'ju informojë se që nga ky çast jeni nën mbrojtjen e ushtrisë serbe.

Qëllimisht doja të shmangia terma të vrazhdë si "rob luftime". Menjëherë i kërkova që, bashkë me oficerët e tij, të pranonte komplimentet tona më të sinqerta për mbrojtjen heroike të Edrenesë.

-E dija dhe më parë që populli serb kishte njerëz të mirë dhe trima,- tha Shukri pasha me një zë të emocionuar. -Gjatë kësaj luftime u binda personalisht për këtë gjë.

Menjëherë ai më prezantoi me gjeneralët e tjerë dhe me të gjithë shpurën e tij, dhe m'u lut të ulesha. Akti më solemn i marrjes së Edrenesë kishte përfunduar. [...]

Nuk kishte kohë dhe mua më duhej ta ndërprisja këtë bashkëbisedim të këndshëm. I kërkova leje për t'u larguar, Shkëlqesisë së tij, dhe dola jashtë. Sapo dola jashtë, një oficer bullgar, toger, erdhi në kala dhe më tha se kishte urdhër për të marrë me vete Shukri pashën.

-Me urdhër të kujt, - e pyeta unë.

-Me urdhër të gjeneralit Ivanov.

-A ke dokument identifikimi?

-Jo!

-Unë nuk ju njoh, - i thashë qetësisht.

-Ne jemi të gjithë nën komandën e gjeneralit Ivanov, - u përgjigj ai.

-Kjo është e drejtë. Të gjithë oficerët janë nën komandën e gjeneralit Ivanov, por kush më siguron se ti je oficer. Dua dokumente dhe autorizim që të ta dorëzoi Shukri pashën. [...]

Shkova tek Shukri pasha përsëri.

-Shkëlqesia juaj, - i thashë - ka ardhur një oficer bullgar, i cili thotë se selia e Shkëlqesisë suaj është

<sup>31</sup> Shukri pasha ishte komandanti i ushtrisë turke që ishte e rrethuar në Adrianopojë.

gati. Nëse Shkëlqesia juaj dëshiron të shkojë, mund të shkoni menjëherë. Nëse jo, ... nëse Shkëlqesia juaj dëshiron të qëndrojë këtu sonte për t'u kujdesur për punët e tij, jeni i lirë ta kaloni natën këtu. [...] Kështu u bë. Shukriu e kaloi natën në kalanë tonë, aty ku u kap.

*Balkanski rat u slici i reči 13; 14 (27) prill 1913.*



Pas një rrethimi prej pesë muajsh dhe sulmesh të ashpra nga ana e ushtrisë bullgare dhe dy divizioneve serbe, si dhe pas mbrojtjes heroike nga ana e garnizonit osman, kalaja kryesore osmane në Traki, Edreneja/Adrianopoja, u mor nga aleatët, më 13 mars 1913. Si oficerët e lartë bullgarë, ashtu edhe ata serbë deklaruan se vijat e mbrojtjes u thyen nga ushtarët e tyre, të cilët ishin 'fitimtarët' e vetëm të luftës. Polemika të tilla lindën lidhur me vende të ndryshme që u pushtuan, dhe që më pas ndikuan në opinionin publik dhe historiografitë e shteteve të Ballkanit.

### III-6. Raport i atasheut ushtarak francez në Sofje, ku shpallet marrja e kalasë së Edrenesë nga ushtria bullgare

22.04.1913.

Tani, marrëdhëniet midis bullgarëve dhe serbëve janë shumë të tendosura dhe provë për këtë janë raste të ndryshme.

Një nga këto raste është pushtimi i Adrianopojës. Pas luftimesh të ashpra, njësitë bullgare mundën të merrnin pozicionet kryesore vetëm në pjesën lindore. Vetëm falë këtij veprimi u dorëzuan turqit edhe në pjesët e tjera, lanë pozicionet e tyre dhe ia dorëzuan kalanë armikut që po sulmonte.

Shqyrtimi i këtyre pozicioneve provon se, përveç anës lindore, në të gjitha pjesët e tjera turqit patën kohë të shkatërronin materialet e tyre.

Është e qartë se ata patën kohë të mjaftueshme të shkatërronin çdo gjë në pjesët e tjera, ndërkohë që materialet në pjesën lindore janë të padëmtuara, sepse sulmi i ashpër bullgar nuk u la kohë t'i shkatërronin ato.

Megjithatë, gazetatat serbe pretendojnë që, në pjesët e tyre të sulmit, divizionet serbe i morën pozicionet kryesore pa ndihmë.

Gjithashtu, ato pretendojnë se Shukri pasha u dorëzua tek regjimenti i 20-të serb. Por, sipas deklaratës së tij, bërë për Z. Nekludov, ambasadori rus në Serbi, ai u kap më 13/26, në mëngjes, nga koloneli Marholev, komandant i regjimentit të Gardës Bullgare. Vetëm më vonë, regjimentit të 20-të serb iu vu detyrë që ta ruante atë.

Mathareli<sup>32</sup>

*Lufta Ballkanike në këndvështrimin e një francezi.*



Sipas major Gavriloviçit, dhe më tej sipas Matharelit, kush e mori Adrianopojën? A dini ndonjë rast tjetër debatesh rreth çështjes se kujt i përket fitorja?

### III-7. Adrianopoja ra! (artikull në një gazetë rumune)

Rënia e kësaj fortese, pas pothuaj pesë muajsh izolimi të ushtrive turke të rrethuara nga armiqtë, me ushtarë të uritur dhe të detyruar të dorëzohen vetëm prej mungesës së ushqimit dhe sigurisht mungesës së municioneve, nuk mund të quhet fitore as për bullgarët.

Edhe turqve nuk ka përse t'u vijë turp, sepse ky qytet i shenjtë nuk u dorëzua, por u përfshi nga stuhia, pas një luftimi të ashpër, që do ta bëjë emrin e spikatur të Shukri pashës të kujtohet përgjithmonë. Në një farë mënyre, qëndresa heroike e qytetit të Adrianit e ka ringjallur Perandorinë Osmane, e cila ishte tepër e rënë moralisht për shkak të humbjeve fatkeqe dhe e lënduar për shkak të pothuajse përjashtimit të saj nga Europa.


*Adevarul, XXVI, nr. 8443, 15/28 mars 1913, f. 1.*



Si e shpjegon autori rënien e Adrianopojës? Cilët simpatizon autori? Përpikuni të shpjegoni përsenë.

<sup>32</sup> Major Mathareli, atashe ushtarak në Sofje nga maji 1912 deri në prill 1913.

► Fig. 32. Zgjidhja e konfliktit turko-bullgar (karikaturë rumune, 1913)



*Furnica*, IX, nr. 52. 29 gusht 1913, f. 12.



Përkthim: Zgjidhja e konfliktit turko-bullgar. Turqia që lëshon nga duart e saj Adrianopojën... Së bashku, fuqitë europiane kanë vendosur t'ia kthejnë përsëri atë.

## IIIb. Jeta në front

### III-8. Nga Mali Starac në Manastir: Ditari i një ushtari në Njësinë Mjekësore Danubiane paraqet gjendjen e ushtrisë serbe (Beteja e Kumanovës)

12 tetor (1912)

[...] Këtu ka vetëm pak infermiere; dhe ato që ishin, u tërhoqën në spital dhe nuk u shërbejnë më këtyre njerëzve të mjerë, të cilët sakrifkuan për atdheun jetën e tyre dhe qetësinë e të afërmeve që lanë në shtëpi.

Tani, vetëm mendoni se si ndihen këta njerëz të mjerë, që shohin shokët e tyre t'u bjerë të fikët aty pranë jo nga plagët ose dhimbjet, por nga të ftohtët e natës dhe pa ndihmën e atyre që e kanë për detyrë të kujdesen për ta. Këta ushtarë që sakrifkuan çdo gjë për të mirën dhe lavdinë e atdheut, përfshirë dhe jetën e tyre, u luten infermiereve që të kujdesen për ta. Por ç'të bësh, ata që ishin përgjegjës, nuk e vranë mendjen shumë për këtë.

Kështu kaloi e gjithë dita. Mjeku i njësisë sonë, dr. Medjera, vraponte pa u lodhur nga njëri i plagosur tek tjetri, pavarësisht se kishte detyra të tjera në Njësi, dhe në fund ua lehtësoi gjendjen të plagosurve të gjorë aq sa mundte [...]

Të plagosurit lëshonin britma të forta, pasi plagët e tyre po ftoheshin. Rënkimi i tyre i trishtueshëm të thyen zemrën.

Komandanti urdhëron që atyre t'u jepet ujë, sepse këta njerëz të mjerë, siç thanë edhe vetë, nuk kishin pirë as një pikë ujë për të shuar etjen. Rënkimet e të plagosurve thyenin vazhdimisht qetësinë e natës.

13 tetor

Të plagosurit bërtasin në mënyrë të tmerrshme. Me një tenxhere gjelle përgatitëm pak çaj dhe ua çuam të plagosurve për t'u shuar etjen, secilit nga një filxhan.

Eh, sa mirënjohës na ishin këta të shkretë.

"Zoti ju dhëntë gjithë të mirat!", "Qenka vërtet i mirë!", thanë shumë prej tyre. Shumë nga ata që nga mundimet nuk mundnin as të flisnin, na shihnin

me një lloj mirësie dhe ëmbëlsie, sa që mund t'ua lexoje mirënjohjen në sy.

Gjatë natës e deri në të gdhirë, shumë vdiqën nga të ftohtët dhe shiu që binte rrebesh.

Një djalë i gjorë vdiq ulur mbi kutinë e municioneve, mbështetur mbi bërryla. Ai dukej sikur ishte ulur aty dhe ishte përpirë nga mendimet. Major Milan Popoviçi, duke menduar se ai ishte gjallë, iu afrua dhe i zgjati çajin, por kur nuk mori asnjë përgjigje, e vështroi më nga afër dhe e kuptoi se kishte vdekur. Iu afrova për të parë se kush ishte dhe, në medaljonin që i varej në gjoks, pashë se ishte një fshatar nga Zharkovo<sup>33</sup>. Pak më tej, një ushtar i plagosur turk që dergjej me ushtarët tanë, me duart mbledhur na u lut që t'i jepnim ujë, duke thënë: "Aman kardash, aman" dhe diçka tjetër që nuk e kuptuam. I dhashë edhe atij një filxhan çaj dhe e mbulova me kashtë dhe mushama. [...]

*Balkanski rat u slici i reči 7, 3 (16) mars 1913.*

**?** Çfarë mendoni për autorin që ndihmon ushtarin turk?

Përse ushtarët e plagosur nuk po merrnin ndihmën për të cilën kishin nevojë?

### III-9. Përshkrim i vuajtjeve të kuajve, bërë nga një toger turk<sup>34</sup>

Që dje, shiu nuk ka pushuar. Ne e kaluam natën nën tendë dhe kuajt i kishim lidhur; ishim bërë qull, deri në mish. Kafshët kishin vuajtur shumë. Pas marshimeve të gjata dhe manovrave që bëmë, këto kafshë të gjora duhet të meritojnë pak më shumë kujdes, por ç'mund të bëjmë?

[...] Unë përfitova nga kjo ditë pushimi për të përfunduar shënimet e mia dhe për t'u kujdesur për pelën time të bukur, Kara Çebek, majmunin tim të zi. Kafsha e gjorë, qysh tani dukej e lodhur, ndërsa unë do të kaloj gjithë fushatën hipur në kurrizin e saj.

*Selim, f. 28-29.*

<sup>33</sup> Fshat pranë Beogradit.

<sup>34</sup> Toger Selim beu shkroi një ditar, ku përshkruan veprimet ushtarake në Traki, nga tetori deri në dhjetor të vitit 1912. Ditari i tij u botua frëngjisht në vitin 1913.

► **Fig. 33. Transportimi i ushtarëve të plagosur nga porti i Selanikut**



Η Αθήνα των Βαλκανικών Πολέμων 1912-1913.

**III-10. Gjendja e ushtrisë bullgare në Traki, përshkruar nga një francez**

24. 03. 1913. Duke qenë të rraskapitur, njerëzit sëmureshin lehtë. Gjendja shëndetësore e disa njësive ishte edhe më e mjeruar kur arritën në Turqi; sapo kaloi kufirin, regjimentit të 7-të të këmbësorisë iu desh të izolohej në kampe, pasi kishte pasur 30 raste tifoje në radhët e ushtarëve të tij. Por situata u bë vërtet serioze, kur ushtria që po shkonte në Çatalxha zëvendësoi ushtrinë turke në kampe, ku kishin vdekur shumë njerëz për shkak të sëmundjes. Duke mos treguar kujdes, komanda bullgare la në harresë masat kryesore higjienike parandaluese: nuk kishte banja pranë kampeve; gjendeshin shumë kufoma dhe trupa të shtrirë rreth e qark, në vend që të groposeshin. Me pak fjalë, disa ditë pasi ushtria jonë kishte mbërritur në Çatalxha, shpërtheu kolera. Ka njoftime se pati 15 000 raste me kolerë, por vetëm pak prej tyre vdiqën.

U morën masa të menjëhershme: u ndryshuan dhe u përmirësuan kampet; u lëshua një urdhër i prerë që të pihej vetëm ujë i zier – ata që nuk i bindeshin këtij urdhri, do të pushkatoheshin; njerëzve iu dha pushim.

Sot duket se shpërthimi i kolerës është kapërcyer: njerëzit që pushuan pak, janë tani në gjendje të kryejnë detyrat e tyre.

Sa për të plagosurit, bullgarët i trajtuan ata me po aq pakujdesi dhe moskokëçarje, si dhe në pjesën tjetër të fushatës. Sigurisht, disa masa u morën për

ta, por shumica e mjekëve që duhej të zbatonin këto masa nuk e vranë mëndjen aspak dhe të plagosurit u trajtuan kur u gjend koha.

Gjatë luftës ka pasur skena të panumërta mizore. Bullgarët do të paguajnë për këtë, sepse shumë njerëz të cilët mund të kishin shpëtuar, vdiqën për shkak të moskokëçarjes për të plagosurit. Numri i të vdekurve gjatë të gjithë fushatës është rritur nga 30 000 në 32 000; nga 50 000 vetë që ishin plagosur, një pjesë e madhe u bënë invalidë prej mungesës së kujdesit. Kjo është një humbje e dukshme, po të mbajmë parasysh që Bullgarisë do t'i duhen këta njerëz për zhvillimin e saj ekonomik pas luftës.

*Lufta Ballkanike në këndvështrimin e një francezi.*

► **Fig. 34. Mjeku çek, dr. Jan Leviti, në spitalin “Rrethi i Motrave Serbe”**



*Balkanski rat u slici i reči 2, 27 janar (9 shkurt) 1913.*

**III-11. Një mjek kroat shpreh ndjenjat e tij pas një vizite në fushën e betejës pranë lumit Marica**

*Rrugës për në Drinopojë*

“Pasi morëm lejen e kalimit nga ndihmësi i gjenerals Stepanoviçit dhe pasi pyetëm për udhëzimet, filluam të ecim drejt Drinopojës. Janë rreth 35 kilometra nga Mustafa-pasha për në Drinopojë [...] Pas një ore e gjysmë rrugë, një karro ushtrie bosh, me kuaj shumë të mirë, po vinte pas nesh. Karrocieri, një ushtar serb, na mori me shumë gëzim me vete dhe pas një ore e gjysmë arritëm në një fshat të quajtur Kemli, ku ishin vendosur trupat e para serbe; ata që ndërjuan urën mbi lumin Marica. Komandanti ushtarak i



këtyre trupave, kapiten Ruziçi, që e gjetëm duke lexuar gazetën në çadrën e tij, pasi u prezantua dhe i treguam lejet e kalimit, na priti me shumë mirësjellje. Ai na çoi të shikonim vendstrehimet (llogoret e nëndheshme), ku ushtarët, në disa kazanë të mëdhenj, po gatuanin fasule për drekë. Këto vendstrehime janë shumë të rehatshme; në çdonjërin prej tyre ka vend për rreth 12 ushtarë, janë pak më të lartë se gjatësia e njeriut, madje kanë dritare dhe shishe të mëdha që përdoren në vend të xhamave për dritaret; në dysheme gjenden dyshekë kashte. Ushtarët që takuam aty ishin aktivë dhe të gëzuar [...]

Kur u kthyem në kamp nëpërmjet urës, kapiteni urdhëroi një djalë me kapele që të përgatiste një makinë dhe të na çonte në pozicione. Makina është në dispozicion të gjeneral Rasiçit, dhe djali i shpjegoi kapitenit se gjenerali ia kishte ndaluar të merrte cilindo në makinë, pa lejen e tij; por kapiteni e urdhëroi të na çonte: "Të dashur vëllezër, kudo që të dëshironi, jeni nën përgjegjësinë time."

#### *Rreth e qark Drinopojës me makinë*

Ushtarët i gjetëm jo shumë larg nga topat, duke ecur dhe pirë duhan, duke pastruar rrobat dhe duke sjellë ujë. Koha ishte e mirë, ajri pak i freskët, por jo i ftohtë, dielli ishte i nxehtë, kështu që deshëm të qëndronim deri të nesërmen dhe të kalonim natën në vendstrehim; sigurisht që do të kishim qëndruar, nëse mjeku në Mustafa-pasha nuk do të na thoshte se do të na fuste në karantinë, po të qëndronim edhe një ditë tjetër. Ushtarët që vizituam ishin shumë të gëzuar dhe, për të na bërë qejfin, na treguan se si mbushen topat me gjyle dhe predha; na dhanë edhe disa pjesë të paplasura nga gjylet turke, për kujtim. Ushtarët na treguan se, tashmë, pas një praktike dhe kontrolli të gjatë, nga të dyja krahët goditet tepër mirë; megjithatë, shumë pak vetë vriten dhe një numër i vogël topash dëmtohen, sepse janë strehuar mirë. Por, sapo ushtarët dalin, armiku qëllon me egërsi. Kushdo që do të dalë mbi kodër, nuk mund të fshihet në asnjë vend, sepse e gjithë zona rreth e qark Drinopojës nuk ka asnjë pemë ose shkurre ku mund të fshihesh, vetëm pak bar. Gjatë luftimeve të natës, çdo gjë ndriçohet nga reflektorët turq, nga të cilët vetëm njëri është thyer deri tani; por edhe serbët ndriçojnë pozicionet e turqve.

Gjatë armëpushimit, ata takohen shpesh me ushtarët turq në zonën asnjënjëse. Turqit u japin atyre cigare dhe ata, në këmbim, u japin bukë. Duke biseduar me ta, u mor vesh se ushtarët turq mendonin që ushtria turke ka marrë Nishin dhe Plovdivin dhe ka rrethuar ushtrinë bullgare në Mustafa-pasha; ushtarëve turq thjesht nuk u besohet që Drinopoja është tërësisht e rrethuar. Gjetëm shumë ushtarë serbë, duke biseduar miqësisht me ushtarët bullgarë. Nga pozicionet e serbëve, ne shikonim ushtarë turq, të cilët gjendeshin vetëm dyqind metra larg dhe vrisnin kohën në të njëjtën mënyrë si ushtarët serbë. Ushtarët trima na treguan shumë rreth betejave në Drinopojë dhe Kumanovë, dhe ne do t'i kishim dëgjuar edhe më gjatë, nëse nuk do të na duhej të ktheheshim shpejt në Mustafa-pasha.

*Gazeta Hrvatski pokret, 28 dhjetor 1912.*



Gjatë Luftërave Ballkanike, disa mjekë kroatë dhe sllovenë shkuan vullnetarë në vendet e Ballkanit për të mjekuar të plagosurit. Dr. T. që është autori i këtij teksti, shkoi në Adrianopojë me rekomandim të administratorit të Kryqit të Kuq Bullgar, së bashku me një mjek slloven dhe një bullgar.



Përshkruani jetën e ushtarëve në front, gjatë armëpushimit. A ishte e njëjta situatë gjatë betejës?

Si e mendoni jetën në vendstrehim? A ishte ajo e "rehatshme", siç e përshkruan dr. T.? Për ç'arsye mjekët shkolin në fushën e betejës? Cili ishte mendimi i dr. T. për këtë luftë dhe luftën në përgjithësi? Si priteshin mjekët nga ushtarët?

### **III-12. Izet Fuad pasha<sup>35</sup> përshkruan mungesën e bukës për ushtarët turq**

*15 dhjetor*

Në të njëjtën kohë, nga burime të ndryshme dëgjova se ushtarëve tanë, qysh prej dy ditësh nuk u kanë shpërndarë bukë... Menjëherë fillova të hetoj: e vërteta më ishte mbajtur e fshehur dhe mësova se "indiferenti"<sup>36</sup> i Hademqoit kishte

<sup>35</sup> Për Izet Fuad pashën, shiko shënimin nr. 20.

<sup>36</sup> Ky është emri që i kam vënë inspektoratit tonë. (shënim i autorit).

grumbulluar ushqime që të luante pikërisht këtë rreng kundër nesh! Dhe ushtarët tanë të gjorë, deri në çastin e fundit nuk u ankuan. Eh, burrat trima. Në fakt, buka vërtet e mirë ishin ata vetë. Pasi të nënshkruhet paqja, do të zhvillohet një ndeshje e madhe ushtarake futbollit midis nesh, ndërmjet Abdullahistëve<sup>37</sup> dhe Nazimistëve<sup>38</sup>, lidhur me përgjegjësitë. Çfarë shansi, çfarë gëzimi të mos jesh në asnjërën palë. Kjo histori, që buka nuk është shpërndarë, vërtetohet gjithmonë e më tepër. Nga të gjitha krahët, nga të gjitha trupat e ushtrisë çdokush po sulmon "indiferentin" e Hademqoit. Kjo ka dalë jashtë kontrollit. Komandanti është çmendur, komandatët e trupave janë çmendur, ne të gjithë jemi çmendur. Ka njerëz të cilët s'kanë ngrënë bukë që prej tri ditësh. Hekurudha është aty dhe kryeqyteti gjendet pas nesh.

#### 16 dhjetor

A keni qenë ndonjëherë në jetën tuaj i rrethuar nga 21 000 njerëz të cilëve nuk u është dhënë bukë prej katër ditësh? Ja, unë gjendem në këtë situatë.

Izzet Fuad pasha, f. 255.

? Përse Izzet Fuad pasha e quan inspektoratin ushtarak, "indiferenti"?

### III-13. Fragment nga kujtimet e një ushtari rumun

Më në fund vendimi u mor, dhe mua më kishte mbetur aq forcë morale, sa të mos e ndërlikoja më shumë gjendjen. Me një zë të thjeshtë dhe të trishtuar dikush më tha: "Kjo është kolerë aziatike!" Shokët e mi ushtarë u larguan dhe më shihnin me vështrim të frikësuar. E kuptova që në sytë e tyre, papritur unë isha kthyer në një bishë vdekjeprurëse. [...] Por, kur atij që kisha pranë, ndoshta për herë të fundit i lashë amanetet dhe e ngarkova me porosi për të gjithë të afërmit që më prisnin, pashë në sytë e tyre dhimbje të vërtetë dhe keqardhje..., pavarësisht nga kjo, askush nuk ma dha dorën kur u largova. [...] Shkova në dhomën e karantinës. Mund të them se nuk isha as i pashpresë, dhe as tepër i

<sup>37</sup> Abdullah pasha, komandant i Ushtrisë së Lindjes.

<sup>38</sup> Nazim pasha, ministër i Luftës.

trishtuar. Ishte vetëm një ndjenjë që më pushtoi të tërin. Shikoja veten dhe prisja. [...]

Isha me fat që u ktheva shpejt në regjimentin tim dhe tek shokët e mi ushtarë.

Sadoveanu, f. 276-277.

? A mund të gjeni se si u përhap kolera në Gadishullin e Ballkanit? Nga erdhi ajo? Përse ishin edhe ushtarët, dhe civilët kaq të frikësuar nga kjo sëmundje e veçantë?

### ► Fig. 35. Kamp grek në rrethinat e Ksanthit



Η Αθήνα των Βαλκανικών Πολέμων 1912-1913.

### III-14. Fragment nga ditari i Vasilis Surapasis, vullnetar grek

Ne u nisëm dhe arritëm në një fshat bullgar. Atje gjetëm një kotec pulash, rosash, gjelash deti dhe patash. Vrapuam drejt tyre me gurë dhe me shpata në dorë, dhe shumë shpejt, çdokush në batalion kishte dy ose tri shpendë, vezë dhe gjëra të tjera. Unë kapa një gjel deti, të vetmin që ishte aty. Vazhduam të ecnim drejt urës. Ishte një skenë që duhej parë. Disa therën shpendët, të tjerë po u hiqnin puplat dhe disa thyen radhët për të kapur ndonjë shpend. Një subjekt i shkëlqyer filmi. Më në fund arritëm tek ura, ku një batalion i regjimentit të 19-të bënte roje. Tani ishte radha jonë për të bërë roje; ngritëm kampin dhe ndezëm zjarre për të pjekur ato që kishim kapur. Unë ndeza një zjarr të madh dhe poqa gjelin e detit; nuk kisha kripë,

kështu që e mbusha me djathë dhe ai u poq për mrekulli. Peshonte rreth 5 okë. Hëngra pak nga gjeli në orën tetë, dhe pjesën tjetër e futa në çantën e shpinës, me një gëzim prej fëmije. Na urdhëruan të fiknim zjarret dhe të ktheheshim, dhe kështu bëmë. Në orën 2 pas mesnate, na zgjoi kapteri. Disa nga ne u çuan dhe shkuan të dyfishonin rojet, sepse në anën tjetër të lumit ishin dëgjuar zhurma.

*Trichas, f. 175, 187-188.*



Vasilis Surapasi emigroi në Amerikë në moshën tetë vjeç. Kur shpërtheu lufta, në vitin 1912, ai u kthye në Greqi për të hyrë në ushtri. Pas lufte ai u kthye në Amerikë.



Nëse do të xhirohej një film, bazuar në tekstin e mësipërm, ç'loji do t'i përkiste?

A përputhet ky episod me përshkrimin tradicional epik të Luftërave Ballkanike? Plaçkitja që përshkruhet në këtë dokument, ishte një akt dhune apo çështje mbijetese?

### III-15. Morali i ushtrisë bullgare (Analizë e shefit të Shtabit të Ushtrisë Bullgare, disa vite pas luftës)

Morali i ushtrisë sonë nuk ishte aspak i lartë. Duke i munguar shumë gjëra dhe duke vuajtur nga sëmundjet për një kohë të gjatë, ushtria jonë ndihej e dëshpëruar. Negociatat e tejzgjatura politike i bënë ushtarët tanë të mos ndihen të qetë. Të gjithë i kishte marrë malli për shtëpinë dhe dëshironin të ktheheshin atje, sa më shpejt të ishte e mundur. Përveç kësaj, ideja e fillimit të një luftë kundër aleatëve tanë nuk përkrahej aspak nga ushtarët dhe ata të gjithë donin që kjo të shmangej.

Vazhdimisht oficerët e fshehën faktin se kishte pasur demonstrime dhe turbullira kundër luftës nëpër njësitë e tyre, sepse zëvendëskomandanti i përgjithshëm i kishte kërcënuar se do të shkarkoheshin nga detyra, nëse lejonin trazira.

Pra, askush nuk mund të tregonte të vërtetën. Sigurisht që pati edhe propagandë të kundërt nga elementët ekstremistë, por kjo nuk ishte po aq e rrezikshme sa bindja e brendshme e çdo ushtari që

kjo luftë vëllavrasëse nuk do të sillte asgjë të mirë. Tërmeti në Veliko Tërnovë dhe Gorna Oriahovica e shtoi më tepër dëshpërimin.

*Fichev, Vepra të zgjedhura.*



Përse Fiçevi e quan luftën 'vëllavrasëse'?

### III-16. Kalimi i një ure të varur ushtarake mbi Danub, në Korabia (Nga kujtimet e një oficeri rumun)

Një numër i pafund rumunësh shkuan të luftonin diku, kudoqoftë; çfarë dinin ata për vendin ku po shkonin dhe për çfarë do të luftonin?! Po i shikoja me vëmendje kur po ecnin mbi dërrasën e fundit të urës, për në tokën bullgare. Disa prej tyre nisën të këndojnë dhe të thërrasin, duke hedhur kapelet në ajër, të tjerë vështronin përpara me pikëllim në sy. E megjithatë, shumica e tyre, dhe këtë e them pa u gabuar, besoj tetë nga dhjetë prej tyre bënë kryqin me shpejtësi, sikur Zoti ynë të mos ishte, gjithashtu, edhe Zoti i bullgarëve, sikur Ai do të ishte në gjendje të merrte një vendim dhe do të ruante jetën e atyre që shkonin në luftë.

[...]

*Gane, f. 27-28.*



Krahasoni tekstet III-13 dhe III-16: a mendoni se ka ndryshime në sjelljen e ushtarëve lidhur me faktin se në rastin e parë po nisin një luftë të pasuksesshme dhe në të dytin, po nisin një luftë 'fitimtare'?

Në të dyja tekstet, a mund të gjeni të dhëna rreth elementeve të përbashkëta ndërmjet 'armiqve'?

### III-17. Takimi i ushtarëve turq me ata malazez në Shkodër, pasi qyteti ishte dorëzuar

24 prill 1913

Duke zbritur për në pazar, malazeztë takoheshin me ushtarët turq, të cilët po shkonin drejt urës nga ku do të niseshin. Ata ndalen dhe flasin pak; malazeztë u japin bukë të bardhë dhe turqit e pranojnë me mirënjohje, dhe ndonjëherë shkëmbejnë me cigare. Shpesh, armiqtë e djeshëm i japin dorën njëri-tjetrit.

Episode të tilla të shkurtra përsëriteshin shpesh në sytë e popullit, i cili nuk përzihej dhe as tregonte ndonjë shenjë prekjeje nga kjo. Më vonë, pas mesditës, ushtarët turq zbritën nga kodra duke ecur në rresht dhe u larguan përfundimisht nga qyteti.  
Berri, f. 252.

## IIIc. Lufta paralele

### III-18. Letër nga Ipokrat Papavasiliu, dërguar gruas së tij, Aleksandrës

*Sneftsi, 23 qershor 1913*

Gruaja ime e shtrenjtë,  
Gjatë fushatës turke të dërgoja letra nga fshatrat turq. Tani, në fushatën bullgare, po të shkruaj nga territore bullgare. Të shkrova edhe dy ditë më parë, e dashur, menjëherë pas betejës së Kilkisit - këtij triumfi të madh. Kilkisi ishte strofkulla e komitëve guerrilas dhe qytet i shenjtë për bullgarët. Ai ishte edhe vendlindja e Danevit. Pas betejës i vunë flakën. Ishte një spektakël i rrallë; vazhdoi të digjet për dy ditë; njerëzit, të gjithë bullgarë, ishin larguar. E dashura ime, ushtria jonë po përparon vazhdimisht me hap të shpejtë, duke ndjekur bullgarët burracakë, të cilët ikin si lepuj, të poshtrit. Ata vrapojnë shumë shpejt, por ne do t'i kapim – do t'u duhet të ndalen diku. E dashur, ti s'mund ta imagjinosh tablonë që paraqet kjo luftë. Kudo që shkojmë, hasim shkatërrim dhe mjerim; turqit, të cilët duken se kanë vuajtur shumë nën sundimin bullgar, po hakmerren duke djegur fshatrat dhe prodhimet e tyre. Gjithmonë shohim fshatra që digjen. Bullgarët janë larguar; nuk ka më bullgarë në Maqedoni; përbindëshat janë larguar një herë e mirë; dhe duhet t'i shikosh se çfarë qaramanësh janë: të gjithë robërit që kapim, dridhen nga frika. Sa i gëzuar jam që kjo luftë na i hoqi qafe një herë e përgjithmonë këto njerëz të trashë, na bëri ta njohim njëri-tjetrin, dhe bëri të

### Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin IIIb

Cilat ishin përvojat e ushtarëve në front? Përpiquni të përcaktoni përvojat negative dhe ato pozitive.

Përse jeta e përditshme në front i bën armiqhtë në luftë të shfaqin edhe shenja miqësie?

Në këto kumete, gjeni arsye të ndryshme për pakënaqësitë e ushtarëve.

Bëni krahasime me kapitullin IIc: a përforcohej entuziazmi i paraluftës nga përvoja në luftë?

mundur që t'u çjerrim lëkurën prej luani dhe t'i nxjerrim açik ashtu siç janë, sepse me paturpësi kanë gënjyer botën, e cila këta njerëz qesharakë dhe budallenj i ka quajtur 'prusianët e Lindjes!' Të pakënaqur me çfarë kishin, mashtruesit e paturp donin të merrnin pjesën që u takonte aleatëve të tyre, atyre të cilët i ndihmuan në pushtimet e tyre dhe pa të cilët do të ishin zhdukur prej kohësh nën sundimin turk. Tani do të humbasin gjithçka kishin. E meritojnë këtë. Janë një shembull i vërtetë i historisë së qenit me mishin.

Ndiej se je gjithmonë pranë meje, ti dhe fëmijët tanë. Kam mall për ty, por fitorja më ngushëllon dhe më lehtëson, sepse do të thotë që ndarja jonë nuk do të zgjasë edhe shumë. Nuk besoj se lufta do të zgjasë më shumë se dy javë të tjera. Ç'do të thotë tani Evgeniosi për bullgarët, të cilët i admironte kaq shumë?

Me gjithë dashurinë time, Bashkëshorti yt

*Trichas, f. 318-319.*



Papavasiliu studioi në Shkollën Ushtarake, në Athinë dhe në Akademinë Luftarake, në Berlin. Ai mori pjesë si oficer në luftën greko-turke të vitit 1897 dhe në Luftërat Ballkanike. Mbretëresha Olga dhe princi trashëgimtar Konstandin ishin shoqëruesit e nuses dhe dhëndrit në dasmën e tij (1909). Më vonë, ai u largua nga ushtria për pak kohë, për shkak të bindjeve të tij monarkiste. U caktua ministër i Çështjeve të Marinës në qeverinë diktatoriale të J. Metaksasit (1936-1941).

? Përse ishte e rëndësishme fitorja për Papavasilin?

Cili ishte imazhi i bullgarëve në shoqërinë greke përpara Luftërave Ballkanike?

Çfarë do t'i kishit shkruar në letër familjes suaj, nëse do të ishit ushtar në front?

Përpikuni të gjeni letra të ushtarëve që morën pjesë në luftëra të tjera të shekullit të 20-të dhe krahasoni përmbajtjen e tyre.

### III-19. Komisioni Karnegi për Paqe Ndërkombëtare komenton humbjet 'paralele' nga djegia e fshatrave dhe nga eksodi i njerëzve

Djegia e fshatrave dhe eksodi i popullsisë së mundur është ngjarje normale dhe e përsëritur në të gjitha luftërat dhe kryengritjet ballkanike. Ky është zakoni

i këtyre njerëzve. Kur u vjen radha, ç'kanë vuajtur vetë, ata ua shkaktojnë të tjerëve. Kjo mund të ishte shmangur vetëm me urdhra të prerë nga Athina, Beogradi dhe Sofja; edhe atëherë, vetëm nëse kisha dhe organizatat kryengritëse do t'i kishin mbështetur vendimet e qeverive. Një apel i përgjithshëm për humanizëm u botua nga organizata kryengritëse maqedonase "Organizata e Brendshme"<sup>39</sup> por, me sa duket, kjo pati pak ndikim.

*Carnegie, f. 73.*

? A ishte djegia e fshatrave dhe eksodi i popullsisë së mundur, në të vërtetë, një veprim normal dhe i zakonshëm?

A bashkoheni me mendimin që "djegia e fshatrave" dhe eksodi i popullsisë së mundur (a) është një zakon ballkanik; (b) nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër të Europës apo botës?

#### ► Fig. 36. Rrënojat e Serresit



*Carnegie, fig. 7, 8 dhe 9, f. 86-87.*

<sup>39</sup> OBRMO (Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase-Odrin) – u krijua në Selanik në vitin 1893, me këtë qëllim kryesor: fitoren e autonomisë së plotë të Maqedonisë dhe Trakisë së Adrianopojës.

### III-20. Largimi i myslimanëve, tetor 1912

Nisëm të ecnim, por ishte e pamundur të vazhdonim me rregull. Rruga ishte zënë nga qerre, tufa bagëtish, gra dhe fëmijë që ecnin të shpërndarë; kjo është popullsia jonë myslimane që po tërhiqet në brendësi të vendit. Njerëzit e gJORË! Janë të gjithë të përbotur, sepse po lënë pronat dhe shtëpitë e tyre: tashmë, tmerri i luftës kishte filluar.

*Selim, f. 24.*

### III-21. Ekzarkati Bullgar përpiqet të konvertojë myslimanët bullgarishtfolës në të krishterë

Duhet përmendur këtu edhe praktika e ndjekur nga bullgarët, në një trevë të madhe, për kthimin me forcë të pomakëve në të krishterë. Pomakët janë bullgarë në racë dhe në gjuhë, që u konvertuan me forcë në myslimanë, në një kohë të caktuar të pushtimit osman. Ata nuk flasin turqisht dhe ruajnë disa kujtime tradicionale nga e kaluara e tyre e krishterë; por rëndom, rrethanat i kanë bërë ata muhamedanë fanatikë. Numri i tyre në territoret e sapopushtuara është të paktën 80 000 veta, dhe kryesisht janë të përqendruar në veri dhe në lindje të Nevrokopit.

Sinodi i Shenjtë Bullgar kishte në plan t'i konvertonte në masë, dhe shpeshherë u mbështet në përkrahjen e autoritetve ushtarake dhe civile, pa përmendur këtu bandat paraushtarake. Përgjithësisht nuk ishte e nevojshme të përdorej dhuna; kërcënimet dhe demonstrimi i forcës, që tregonte se këto kërcënime mund të viheshin në jetë, zakonisht mjaftonin për të çuar fshatra të tërë drejt ceremonisë së pagëzimit. Kjo politikë u zbatua në mënyrë të vijueshme. Madje, shumë kohë para shpërthimit të Luftës së Dytë Ballkanike, në shumicën e krahinave dukej se pomakët ishin pajtuar me kishën bullgare dhe dëgjonin me bindje shërbesat e priftërinjve dhe murgeshave të dërguara nga Sinodi i Shenjtë për t'u mësuar atyre doktrinën e krishterimit.

Kjo lajthitje, që bie në kundërshtim të hapur me tolerancën që zakonisht ka treguar Mbretëria Bullgare me myslimanët brenda kufijve të saj, duhet të etiketohet si një nga vrazhdësitë më të pajustificuara të luftës. Sinodi i Shenjtë e argumentoi

këtë veprim në këtë mënyrë: meqë ishte përdorur forcë për të konvertuar pomakët në myslimanë, atëherë ishte e drejtë të përdorej forcë për procesin e kundërt.

*Carnegie, f. 77.*



Në Malet Rodope, Ekzarkati Bullgar, me ndihmën e grupeve paraushtarake u përpoq të konvertonte myslimanët bullgarishtfolës në të krishterë. Nëse në fillim këto veprime mbështeteshin nga intelektualë të ndryshëm nacionalistë, më vonë kjo u kthye në një politikë shtetërore.



Përse kjo praktikë u zbatua gjatë Luftës së Parë Ballkanike?

Cili ishte roli i fesë në procesin e formimit të kombeve në Ballkan? Përpiquni të gjeni në *Librin e punës 2* dokumente që kanë lidhje me rolin e saj.

### ► Fig. 37. Një karvan i Kryqit të Kuq Bullgar



*Carnegie, fig. 23, f. 217.*

### III-22. Raport mbi konvertimin e myslimanëve në të krishterë në Malin e Zi, 1913

Pasi autoritetet tona u vendosën në Pejë, disa njerëz filluan t'u drejtohen atyre me dëshirën për t'u konvertuar në besimin e krishterë ortodoks. Administratori i zonës, Jovan N. Plamenaci, u tregua fillimisht i matur dhe deshi të zbatonte procedurën e zakonshme që zbatohet kur dikush donte të ndryshonte fenë. [...] Por kjo procedurë

më vonë filloi të zbatohej rrallë. [...] masat represive për mbledhjen e armëve... dhe, në të njëjtën kohë, fushata jo e drejtpërdrejtë, por shpeshherë edhe e drejtpërdrejtë për konvertimin në të krishterë, u bë gjithmonë e më e ashpër. Për shembull, nëse policia ekzekutonte disa vetë në një fshat, të gjithë fshatarët e tjerë do të deklaronin se dëshironin të ktheheshin në të krishterë. [...] në mënyrë që të ruante disi reputacionin e saj, administrata e qarkut do të urdhëronte kreun e komunës që ishte i emëruar në fshat dhe zakonisht i përzgjedhur nga radhët e ushtrisë, që të dërgonte grupe të mëdha myslimanësh – burra dhe gra, pleq e fëmijë, banorë të komunës – në Pejë, ku ata do të “deklaronin dëshirën e tyre” për të ndërruar fenë; më pas, të mbledhur në grupe të mëdha, atyre do t’u kërkohej publikisht nëse vërtet donin të ktheheshin në ortodoksë; dhe pasi ta pohonin këtë me anë të një thirrjeje, ata do të çoheshin për t’u pagëzuar, ceremoni që kryhej në mënyrë kolektive. [...] Të konvertuarit dukeshin në pamje të parë si të krishterë, por ishte mëse e qartë që shumë prej tyre, fshehtas, vazhdonin të praktikonin ritet e besimit mysliman. [...] Kur pothuasje i gjithë stafi i nëpunësve tanë në zonën e Pejës dhe Gjakovës u zëvendësua në fillim të majit të këtij viti, dhe kur gjenerali Radomir Veshoviçi mori drejtimin e punëve publike, ai shpalli lirinë e besimit dhe theksoi që kushdo mund t’i lutej Zotit ku të donte: në kisha ose në xhamia. [...] atëherë myslimanët e kthyer në të krishterë filluan t’i rikthehen përsëri islamit. [...] Në përfundim dëshirojmë të theksojmë se rezultati i punës sonë investiguese është shumë i qartë për të gjithë popullatën e atyre zonave. Ky rezultat shihet në bindjen që ka popullata myslimane kudo që ne e hasëm atë, se Cetina nuk ishte përgjegjëse për padrejtësitë që u ishin bërë dhe për të cilat ata ankoheshin. Ata e dinin se asgjë nuk ishte nxitur nga autoritetet tona qendrore dhe se nëpunësit tanë atje kishin vepruar me kokën e tyre dhe për këtë ata do të mbanin përgjegjësi.

Živko M. Andrijašević, Zoran Stanojević, Pokrštanje muslimana ..., f. 184-190.



Kjo është një pjesë e shkëputur nga raporti i Komisionit Hetimor malazez, i ngarkuar të hetonte mbi abuzimet e autoriteteve vendore në zonën e Pejës, Rozhajës dhe Gjakovës në vitin 1913. Konvertimi i myslimanëve në të krishterë u zhvillua nga janari deri në mars të vitit 1913, në disa nga zonat e sapoaneksuara nga Mali i Zi. Llogaritet që të kenë qenë rreth tre mijë myslimanë të konvertuar në krahinën e Plavës dhe Gucisë dhe rreth shtatë deri në dhjetë mijë myslimanë të konvertuar në zonën e Pejës. Myslimanët përbënin rreth 80% të popullsisë në këto krahina. Pas marrjes së këtyre krahinave, qëllimi kryesor i autoriteteve malazeze ishte çarmatimi i popullsisë myslimane. Ushtria dhe policia malazeze përdorën forcën ndaj myslimanëve të cilët nuk deshën të dorëzoheshin armët. Duke patur frikë për jetën dhe gjënë e tyre, shumë myslimanë u konvertuan në ortodoksë. Gjithashtu, edhe autoritetet malazeze i detyruan myslimanët të konvertohen në ortodoksë. Ky proces konvertimi u zbatua në mënyrë arbitrare nga autoritetet vendore, të cilat përbëheshin kryesisht nga popullsia vendore ortodokse. Në raportimet e tyre, ata deklaronin se “konvertimi i myslimanëve në të krishterë zhvillohej me dëshirë”. Myslimanët dërguan një përfaqësi tek mbreti Nikolla për të kërkuar mbrojtje prej tij. Autoritetet qendrore ngritën dy komisione hetimore për zbardhjen e çështjes dhe ndëshkimin e fajtorëve.

### III-23. Deklaratë zyrtare e Shtabit të Përgjithshëm Bullgar kundër akteve të dhunës

URDHËR Nr. 69, I ZËVENDËSKOMANDANTIT SUPREM, GJENERAL M. SAVOVIT<sup>40</sup>, LIDHUR ME SIGURINË E JETËS, PRONËS DHE NDERIT TË POPULLSISË NË TERRITORET E ÇLIRUARA

*Lozengrad, 13 dhjetor 1912*

Në shtab kanë mbërritur informacione që na bëjnë të dyshojmë se njerëz dhe oficerë të caktuar kanë guxuar t’i hyjnë rrugës së plaçkitjeve dhe dhunës kundër popullsisë civile në territoret e pushtuara. Për shkak se, nga njëra anë, këto veprime tepër të dënueshme dhe jonjerëzore njollosin kombin bullgar, dhe nga ana tjetër, lëkundin besimin e

<sup>40</sup> Gjeneral Mihail Savovi (1857-1928) – ishte një figurë e shquar ushtarake në Bullgari; ai kishte qenë ministër i Luftës disa herë dhe kishte kontribuar shumë në krijimin e ushtrisë bullgare. Gjatë Luftërave Ballkanike ai u caktua zëvendëskomandant i përgjithshëm (komandant i përgjithshëm ishte vetë car Ferdinandi); ai ishte një nga nismëtarët dhe nxitësit e Luftës së Dytë Ballkanike.

nënshtetasve tanë të ardhshëm, sidomos të popullsisë civile myslimane, në aftësinë që ka vendi ynë për të siguruar nderin, pronën dhe jetën, urdhëroj:

1. Komandantët dhe drejtuesit ushtarakë duhet të marrin masa të shpejta dhe të rrepta, që të fillojë ndjekja penale për veprime të tilla të kryera në zonat e pushtuara nga ushtritë e tyre; fajtorët duhet të nxirren menjëherë përpara gjyqit, pavarësisht nga grada dhe pozita që kanë. Të gjithë komandantët paralajmërohen se duhet t'i ndëshkojnë veprime të tilla kriminale pa mëshirë, në rast të kundërt, do të mbajnë vetë përgjegjësi.

2. Masa të rrepta duhet të merren për të vendosur rregull dhe disiplinë në prapavijë. Çdokush që nuk është në ushtri ose që nuk punon në të, duhet të nisët mbrapsht në Bullgari. Ata që janë në ushtri, por që konsiderohen të dyshimtë për njollosjen e shërbimit në prapavijë, duhet të çohen në vijën e frontit.

3. Të paralajmërohen ushtarakët e çdo niveli, që popullisa civile në territoret e pushtuara, pavarësisht nga kombësia dhe besimi fetar, është nën mbrojtjen e ligjeve tona ushtarake dhe çdo përdorim dhune i pajustificuar dhe padrejtësi e bërë kundër saj do të ndiqet penalisht, me të njëjtat ligje ushtarake. Në mënyrë që të arrijmë këtë, u bëj thirrje të gjitha autoriteteve ushtarake dhe civile që të bashkëpunojnë.

4. Si përfundim, do të doja t'ju kujtoja që e kemi nisur këtë luftë në emër të një ideje të lartë njerëzore: "të çlirojmë këta njerëz nga një regjim që ushtron dhunë dhe padrejtësi të padurueshme". Zoti i ndihmoftë bijtë e guximshëm bullgarë që të arrijnë me sukses këtë qëllim fisnik! Në këto çaste, u bëj thirrje që të mos lejojnë disa nga shokët e tyre që me veprime të tilla të njollosin, në sy të botës së qytetëruar, këtë akt të madh dhe të lavdishëm heroik.

V. Georgiev-St. Trifonov.



Për civilët, cilat ishin rreziqet kryesore në territoret e pushtuara?

Urdhra të tillë ushtarakë, a kanë ndikim të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e bandave paraushtarake apo njësive të veçanta ushtarake? Nëse po, në cilat raste?

Duke pasur parasysh datën kur është lëshuar ky urdhër, a nënkupton kjo se deri në atë çast dhuna ishte lejuar?

### III-24. Shkatërrimet e shkaktuara nga lufta në fshatrat pranë Shkodrës dhe vuajtja e njerëzve që përpiqen të gjejnë një arsye "bindëse" për mjerimin e tyre (Rrëfim nga Meri Edit Durham)

Disa zona ishin aq të mëdha, sa që m'u deshën tri ditë për t'i vizituar dhe më pas, për t'u kthyer në Shkodër, duke bërë dhjetë ose dymbëdhjetë orë udhëtim me kalë në ditë. Pranë Shkodrës vizitova gjithsej 1022 shtëpi të djegura. Gjëja që të vinte më shumë keq ishte se pak nga këto viktima të dëshpëruara e kishin idenë se përse kjo fatkeqësi kishte rënë mbi ta. Gra, me fëmijët që po u vdisnin urie, pyesnin: "Përse Mbretërit e Mëdhenj i lejuan ushtarët të vinin të na grabitnin dhe të na vrisnin? Ne nuk po bënim asgjë të keqe, ndërsa ata na morën dhentë dhe dhitë – çdo gjë, çdo gjë... Dhe kur im shoq u përpoq që të ruante bagëtitë, ata e qëlluan. Shtëpinë na e dogjën. Po vdesim urie, në rrugë të madhe."

M. Edith Durham, f. 296.



Meri Edit Durham ishte anëtare e Institutit Antropologjik Mbretëror të Britanisë.

Gjithashtu, ishte anëtare e Institutit Mbretëror për Çështjet Ndërkombëtare dhe autore e disa librave. Në moshën 37 vjeçare, Durhami udhëtoi për në Cetinjë, kryeqytetin e Malit të Zi. Gjatë këtij udhëtimi, zbuloi prirjen e vet të natyrshme për të udhëtuar dhe njohur popuj, zakone, tradita. Për 20 vjet, ajo udhëtoi shpesh në Ballkanin Jugor, duke punuar për organizata të ndryshme humanitare. Pikturoi me bojëra uji skena të ndryshme nga jeta në fshat dhe mbledhi e regjistroi folklor, doke, zakone. Për dy dhjetëvjeçarët që pasuan, shkroi shtatë libra për çështjet e Ballkanit. "Lufta për Shkodrën" është rrëfim që autorja e ka bazuar në ngjarjet ku ishte vetë dëshmitare, përpara, gjatë dhe pas Luftës së Parë Ballkanike.



► **Fig. 38. Njerëz të varfër e të uritur, të cilët pushtuan kopshtin e Konsullatës Italiane në Shkodër (mesi i janarit 1913)**



*Beri, f. 149.*

► **Fig. 39. Bullgarët shpërndajnë bukë për popullin e uritur të Andrianopojës, prill 1913**



*L'illustration, janar-dhjetor 1913, f. 347.*

## III. Në prapavijat e frontit të luftës

### III-25. Përshkrimi i Beogradit nga një korrespondent i një gazete kroate

*Duke hyrë në Beograd*

“Iu ngjitëm rrugës së famshme me kalldrëm të Beogradit, shtruar me gurë të rrumbullakët qysh në kohën e Turqisë. Të ecje mbi të, të dukej se ecje mbi pjata të përmbysura.

Kur arritëm te disa shkallë, pamë një ushtar me këmbë gjysmë të zbathura që i dilnin nga çizmet. Për të shmangur pyetjet e kureshtarëve, ai thërriste: “Dje i leva me dhjamë, kështu që m’i hëngrën minjtë!” – dhe shpejtoi t’i ndërronte. Duke ecur nëpër rrugët e gjera paralele, me shtëpi të vogla, në çdo hap pamë ushtarë të veshur me kostume gri ose blu, me mushama gri dhe me *opanak*<sup>41</sup>. Meqë ishim mësuar t’i shihnim ushtarët me këpucë të lustruara dhe çizme të rënda, u çuditëm kur pamë këmbësorinë serbe me *opanak*, ashtu siç paraqiten nëpër revistat e Vjenës. Por pasi i shikon më nga afër, e kupton se epërsia e *opanakut* ndaj këpucëve është shumë e madhe. *Opanaku* (unë i veshja vetë) është më praktik, sepse uji dhe balta nuk të hyjnë në këmbë nga pjesa ku sholla bashkohet me pjesën e sipërme të këpucës; për më tepër, ato janë të lehta (...) Nëse një ushtar, i rritur me *opanak* do të vishte këpucë të rënda ushtrie ose çizme, ai do të ecte sikur kishte veshur arka.

Gjatë gjithë rrugës takonim ushtarë dhe njerëz që shkonin të visheshin ushtarë. Të tjerë, me pantallona bojëkafë, të bëra me cohë vendi dhe që në Zagreb do t’i merrnin për turq, ecin ngadalë, të ndjekur nga gratë e tyre të veshura me xhaketa të shkurtra fshatarësh dhe ngrenë fustanet për të mos u bërë me baltë (...) Gjithëfarë lloj ushtarësh po vijnë; në rresht dhe duke ecur të shkujdesur, trazojnë baltën e rrugëve të Beogradit. Hane të vogla dhe të errëta janë të mbushura me fshatarë, ndërkohë që gratë qëndrojnë në rrugë, duke priturr burrat që të dalin jashtë (...)

Çdokush këtu është mësuar të jetë gati për luftë, kështu që përgatitjet dhe nxitimi janë diçka e

zakonshme, megjithëse në hane, në rrugë, edhe kur hanë, njerëzit flasin vetëm për luftën. Opinioni i përgjithshëm është që luftë *duhet të bëhet*, dhe jo *mund të bëhet*. Në një qoshe të tregut, një djalë katërbëdhjetëvjeçar i thotë me shqetësim shokut të tij: “Ah, sikur Franca të mos i prishë planet (për luftë)” (...) Populli është i përfshirë nga entuziazmi i luftës. Në “Mbrotjtjen kombëtare”, një farë shërbyeseje ngulte këmbë të regjistrohej në *Rrethin e Motrave*, në mënyrë që ta çonin në front, duke protestuar kundër faktit që vetëm gratë e mira po çohen në front dhe, siç thotë ajo, vetëm ato do të marrin medalje më vonë (...)

Tepër i trishtueshëm dhe domethënës ishte rasti i major Keserikut, që vrau veten sepse nuk e morën në ushtri për shkak të moshës (...)

*Beograd, 9 tetor 1912*


“Dje pasdite, në rrugë u përballa (...) me kalorës të ushtrisë serbe. Ata mbushën rrugën, nga njëri cep në tjetrin, e rruga dukej sikur të ishte det.


Duke kalëruar mbi kuaj të mirë dhe me shpatulla të fuqishme, siç kemi parë në fotografitë që paraqesin luftërat turke në të shkuarën, këta ushtarë duken të qetë dhe fakti se do të shkojnë në luftë, e bën skenën misterioze dhe solemne. Kur kalojnë para Ministrisë së Luftës, trumbetat e madhësive të ndryshme bien solemnisht. Muzika e luftës më emocionoi shumë, dhe bëri që të më vlonte gjaku. Kishte përlojtje, gëzim dhe hidhërim në këta tinguj; mund të dëgjoje gjëmime topash, klithma lufte dhe tingullin e lehtë të lahutës<sup>42</sup>, që u jepte guxim ushtarëve në luftë (...) Unë shkova drejt stacionit të trenit, i cili ruhej nga ushtarë. Hapësira përpara stacionit modern dhe të bukur është mbushur me fshatarë, burra dhe gra që po përcjellin djemtë e tyre. Nuk pashë lot në sytë e grave; por mes tyre dallova një grua që nga veshja dukej se i përkiste shtresës së mesme; ajo ishte mbështetur pas një shtylle druri dhe vështronte trenat që niseshin dhe fishkëllenin vazhdimisht. Sytë e saj të mëdhenj, të zinj, shkëlqenin nga lotët.”

*Gazeta Hrvatski pokret, 9 deri 31 tetor 1912.*

<sup>41</sup> Këpucë të fshatarëve ballkanas, opinga.

<sup>42</sup> Vegël muzikore ballkanase me një tel.

 Gazeta “Hrvatski pokret” dërgoi korrespondentin e saj, Slavko Vorosin, në Serbi, në fund të vitit 1912. Në një sërë artikujsh (botuar nga 9 tetori deri më 31 tetor 1912), me titull “Rruga për në fushëbetëjen ballkanike”, ai përshkroi Beogradin në prag dhe në fillim të Luftës së Parë Ballkanike. Me sa duket, ai nuk shkoi në fushën e betejës. “Hrvatski pokret” botoi rreth dhjetë artikuj shumë tërheqës rreth Beogradit në periudhën e luftës.

 Përshkruani atmosferën në Beograd përpara fillimit të luftës. Përse njerëzit uronin që lufta të fillonte? Komentoni rastin e major Keserikut. Si përshkruhet nga autori kjo atmosferë ushtarake, por edhe “heroike” në të gjithë Beogradin? A e mbështeste ai luftën? A ishte ai i vetëdijshëm për tmerret e luftës? Shpjegohuni. Përshkruani sjelljen e grave. Përse autorit i bëri përshtypje kjo sjellje?

### III-26. Përshkrim i Stambollit nga një gazetar francez

#### A. Në nëntor 1912

Mendonim se do të gjenim një Kostandinopojë të shkretuar, por nuk kishte shumë ndryshim; më pak makina, më pak tramvaje, por vetëm pak. Këto ditë po ndaloheshin të gjithë, edhe shpurat e zotërinjve. Na u desh të jepnim parrullën e kalimit, në mënyrë që të mos na konfiskoheshin kuajt; nëse s’do të kishim në duar dokumentet, i gjithë grupi zbritej nga kuajt me shpejtësi, kuajt merreshin; edhe karrocieri, edhe udhëtarët ishin të lirë të tërhiqnin karrocën, në mes të të qeshurave dhe miratimit të turmës. Përfundimi: s’kishte më kuaj. Megjithatë, me ndihmën e një veterineri arrita të zbuloj dy kuaj që mbaheshin të fshehur, dhe që unë i doja për të shkuar në fushëbetëje; nuk po e shpik një gjë të tillë: i zoti i tyre i kishte mbyllur në qilar, nga frika e konfiskimit.

Si zakonisht, në rrugët e Peras gjendej një botë gjigante, një botë kozmopolite, që dukej se qëndronte indiferente në lidhje me luftën, të paktën sipërfaqësisht: të njëjtat kinema, të njëjtat koncerte nëpër bare, të njëjtat grupe teatrale si vitin që shkoi, ose të paktën aq të ngjashme, sa mund t’i quaja të njëjta; në repertorët e tyre të ndryshëm,

asgjë në lidhje me luftën; shikoj posterat: Të *Mjerët, Magda, Fëmija i dashurisë* etj... Kishte grekë midis turmës, pavarësisht prej luftës; italianë, pavarësisht prej dëbimit; malazez, pavarësisht prej fitoreve të tyre të fundit; këta të fundit janë çaukë, kavazë, shërbëtorë, kjo është e vërtetë. Megjithatë, ata janë veshur me uniformat e tyre kombëtare ushtarake. Të gjithë këta njerëz, përzier me turqit, dëshirojnë ndershmerisht asgjësimin e turqve dhe pa e prishur indiferentizmin e tyre. Nëse batalionet kalojnë aty, askush nuk mundohet ta fshehë një buzëqeshje gëzimi: *Zoa! Zoa! (Ata janë kafshë)* po thoshte dhe një grek, pranë një mikut tim turk i cili e vuri atë në një situatë të vështirë kur e shtyu dhe i tha: “A do që t’ua përsëris atyre fjalët e tua?”. Greku iku, pa thënë asnjë fjalë tjetër. Por është e qartë që më shumë se gjysma e perandorisë, e urren shumë pjesën tjetër. Qyteti kozmopolit është i vështirë për t’u drejtuar, dhe vështirë se mund të krijohet një pasion i përbashkët për një ideal të njëjtë; dhe tani, nuk e di nëse ka mbetur më një ideal i fortë tek turqit, në mënyrë që të kundërpeshojë armiqësinë që ata kanë grumbulluar kundër vetes në vendin e tyre.

Georges Rémond “Impressions de Constantinople”,  
*L’Illustration*, 3636, 2 nëntor 1912, f. 320.

#### B. Në mars 1913

##### *Karnavale dhe zjarre të mëdhenj*

Ç’qytet i çuditshëm! Dhe ç’kontraste të panumërta të shfaq! Karnavalet janë në kulmin e tyre; bëhen pesë ballo në javë; njerëz me maska dhe pelerina kalojnë në rrugët e mëdha të Peras, të përzier me të plagosur dhe njerëz të sëmurë, të sjellë nga vija e frontit në Çatalxha ose Galipoli; njerëz me këmbë të ngrira, me duar të paralizuara, dhe askush nuk u kushton vëmendje. (...) Dhe përveç fytyrave të patriotëve, të trazuara nga pasiguria e çastit e të mbuluara me trishtim e frikë se negociatat e reja për paqe, sipas shumë zërave, do të kërkojnë dhënien e Adrianopojës... , e përveç shprehjes në sytë e një të plagosuri, të cilin një shok po e çon në spital, duke ecur mbi kalë, në mes të indiferencës publike, pothuajse asgjë tjetër nuk e tradhton këtë grumbull humbjesh, rezultatesh tragjike, këtë pafundësi njerëzish që dynden në qytet. Shkurt, askush nuk e shikon këtë.

Georges Rémond “A Constantinople”,  
*L’Illustration*, 3655, 15 mars 1913, f. 237.

► Fig. 40. Shpërndarje ndihmash për familjet e ushtarëve të mobilizuar në luftën rumuno-bullgare, 1913



*Gazeta Ilustrata*, II, nr. 31, 13 korrik 1913, f. 9.

### III-27. Situata në Shkodër gjatë rrethimit të qytetit, e përshkruar nga një gazetar italian

13 nëntor 1912

Sot në mëngjes çmimi i bukës është rritur përsëri; ajo kushton tri piastra shqiptare një kile, që do të thotë rreth 60 cent. Kush nuk është në gjendje ta blejë, gjen punë të çastit dhe si shpërblim merr një faturë që mund ta paraqesë në furrat e bukës. Arsyeja e rritjes së çmimit të bukës nuk është vetëm mungesa e miellit. Në depo ka disa mijëra thasë: thuhet shtatë ose tetë mijë. Mungon lënda djegëse për ta pjekur bukën; nuk ka as dru, as qymyr; nëpër fshatra u mbledh aq dru sa ishte e mundur, por tashmë, kjo s'është e mundur.

[...]

21 nëntor 1912

Sot është dita e vetme e Bajramit. Duhet të ishin katër ditë, por u reduktuan në një, duke pasur parasysh rrethanat. Guvernatori ka urdhëruar që të mbyllen të gjitha dyqanet, edhe ato të të krishterëve. Topat qëlluan pesë herë, nga njëzet e një gjyle. Valiu bëri pritje për fisnikët dhe në mëngjes, u luajt pak muzikë ushtarake, përpara Konakut [bashkisë]. Mbyllja e dyqaneve nuk solli ndonjë rezultat: ceremonitë ishin të ftohta dhe baruti shkoi dëm. Edhe për një ditë të vetme, popullsia myslimane nuk arriti t'i festonte Pashkët e saj në mënyrë solemne, ashtu siç e do feja dhe zakoni. Çdo gjë mungonte, nuk gjendej pothuajse asgjëkundi, njëlloj si ditët e tjera të rrethimit.

[...]

Edhe nëse kishe arritur të blije një copë buke, kjo nuk do të thoshte se ishe i sigurtë që do ta mbaje atë; ata që ishin shtyrë ose që mëtonin se i kishin shtyrë, ua kërkonin bukën atyre që kishin arritur ta blinin; në përlëshjet që pasonin, fitonte më i forti. Gjatë këtyre episodeve të dhunshme, kishte raste kur ndërhyenin patrullat e xhandarëve: por ata vetëm mund të ndalonin sherrin, por s'mund ta zgjidhnin çështjen, që s'ishte e lehtë për t'u kuptuar. Tek furra pranë Konakut, një grua që u përlësh me guxim, po ecte me bukë në dorë.

Papritur, një djalë i ri iu afrua, ia mori mallin e vyer dhe u largua me vrap. Përpara se të largohej, ai i hodhi paratë në tokë. Fatkeqja ngriu me duart bosh, ia hodhi sytë ngultaz njeriut që u largua dhe, ndërsa njerëzit përçark po qeshnin me të, ajo shpërtheu në lot. Sonte ajo s'do të çojë gjë në shtëpi. Ajo u ul në gjuhë për të mbledhur në baltë paratë e hedhura. Por paratë tani nuk kanë asnjë vlerë.

*Berri, f. 9, 35, 38-39.*



Xhino Berri ishte gazetar i ri italian dhe korrespondent luftime, që hyri në qytetin e Shkodrës përpara se të bëhej rrethimi përfundimtar i qytetit dhe qëndroi atje përgjatë gjashtë muajve që zgjati rrethimi. Në këtë libër ngjarjet janë shkruar kronologjikisht, bazuar në ditarin që Berri mbante gjatë luftës.

### III-28. Gruaja serbe

“Gruaja serbe”

Ajo ua kalon të gjitha grave më të shquara të të gjitha kombeve në botë.

Ajo përcolli për në luftë babanë e saj, burrin e saj, vëllanë e saj, djalin e saj, me lule dhe e gëzuar. Ajo u tha të gjithëve se Atdheu është më i shtrenjtë sesa jeta. Ajo ia fali dashurinë prej nëne, dashurisë për Atdheun. Ajo e kuptoi se vetëm një grua e lumtur serbe, mund të jetë një nënë e lumtur. Ajo është e bindur se atdheu është më i rëndësishëm se çdo gjë. Ajo punoi në ara dhe e mblodhi prodhimin vetë. Ajo lëroi, mbolli, korri dhe shiu, ajo i bëri vetë të gjitha punët në arë, që të ushqente fëmijët, që t'u çonte diçka edhe luftëtarëve, që të bënte bukën

### ► Fig. 41. Në Cetinjë – gra, fëmijë dhe ushtarë të plagosur



*L'illustration t. CXL, (1 korrik-31 dhjetor 1912), f. 293.*

tradicionale për të festuar ditën e shenjtit mbrojtës të familjes dhe të ishte në gjendje të paguante taksat e qeverisë. Ajo i bëri të gjitha këto, duke treguar një qëndresë të pashoqe.

Me zemër të pastër, qepi çorape e ndërresa dhe ua dërgoi ushtarëve që ishin larg.

Ajo mjekoi me shumë përkushtim të plagosurit, bij të vendit të saj, por edhe të ushtrisë armike.

Ajo ruajti ndershmërinë e gruas dhe të gjitha virtytet e saj.

Ata që mund të luftonin, por që nuk shkuan në luftë, ajo i quajti të pamoralshëm dhe i përbuzi me gjithë forcën e saj.

Urime për ty, grua serbe! Ti je e lavdishme! Ti ua ke kaluar të gjitha grave më të shquara të të gjithë popujve në botë.

Burra serbë, gratë tuaja janë forca juaj. Ato janë shtylla e shtëpisë suaj dhe shtylla e vendit tuaj. Vajza të dashura e të shtrenjta! Ligjet e kësaj bote janë të padrejta me ju.

Në këto luftëra, në këto ditë të mëdha historike, me qëndrimin tuaj shembullor ju keni treguar që ligjvënësit dhe pushtetarët tanë nuk e njihnin shpirtin tuaj të madh...

Bashkëshortët dhe shteti duhet të tregojnë dhe ta provojnë tani, që ju meritojnë, që janë të denjë për ju. Këtu qëndron interesi i tyre i madh moral dhe material.

Xhaxha Miloslavi

*Balkanski rat u slici i reči 27, 11 (25) gusht 1913.*

Me ç'qëllim është shkruar ky tekst? Krahasoni cilësitë e figurës heroike femërore, me ato të mashkullit hero (lexoni tekstin II-2).

### III-29. Një grua greke e shtresës së lartë shërben si infermiere dhe shkruan për këtë përvojë

Oh, ditën e parë u përpoqa shumë që të mësohesha me mjedisin. Tabloja e mjerimit këtu ishte më e gjallë se kudo. Pacientët që vinin ishin të shtresave të ulëta, të pistë dhe të leckosur, dhe era që lëshonin ishte kaq e keqe sa që më përzihej.

[...]

Pas dy ose tri ndalesash arritëm në Larisa. Na duhej të qëndronim diku, por nuk kishte asnjë vend. Për princshën, në stacion ishte përgatitur me ngut një dhomë e vogël. Ne të tjerëve na u desh të flinim nëpër vagona. Unë vendosa të merrja një karrocë dhe të vizitoja disa spitale. Gjendja ishte e tmerrshme! Spitalet ishin të sajuara, me numër të pamjaftueshëm shtretërish, infermieresh... – çdo gjë ishte e pamjaftueshme. Ne dëgjonim vetëm rënkime, psherëtimë dhe vajtime. Askush nuk u përgjigjej thirrjeve të pacientëve fatkeqë. Një infermier vinte rrotull i vetëm dhe i përgjumur, duke mos qenë në gjendje të bëjë asgjë, përveçse të shkelte mbi disa nga ata që ishin në dysheme. Disa prej tyre ishin plagosur rëndë. Ne i ndihmuam aq sa mundëm gjithë natën dhe në mëngjes u kthyem në stacion.

*Trichas, f. 32, 35.*



Fragmente nga ditari i Aspasia Mavromihali-Ralli, i vitit 1912. I jati, pastaj i shoqi ishin kryeministra grekë. Menjëherë pas mobilizimit usharak, ajo shërbeu si infermiere për të plagosurit e frontit. Pas një trajnimit të shkurtër, shoqëroi princshën Eleni në udhëtimin e parë të trenit-spital dhe mbajti shënime për përvojën dhe përjetimet e atyre kohëve.



Ç'rol mund të luante gruaja gjatë luftës? Si u ndie kjo grua e shtresës së lartë kur u përball me realitetin e luftës? Krahasoni këtë tekst me tekstin III-25, veçanërisht me paragrafin "Në 'Mbrotjen kombëtare' ... më pas medalje".

### ► Fig. 42. Gra serbe që mësojnë përdorimin e armëve, 1912



*Vojska na Balkanu, [Lufta në Ballkan], Lubjanë, 1912.*

### ► Fig. 43. Infermiere me pacientë ushtarakë, rreth vitit 1913



Arkivi Historik i Muzeut Benaki, Athinë, tek Fotopoulos, f. 266.

► **Fig. 44. Gra turke që shërbejnë si infermiere në Stamboll**



*L'illustration t. CXL, (1 korrik - 31 dhjetor 1912), f. 372.*

🔑 Sqarim: Gra turke të Gjysmëhënës së Kuqe në spitalin e Gjylhanesë. [...] Kjo fotografi dëshmon se gratë turke të shtresave të larta, të fejuara e të martuara, nëna të dhembshura, vendosën të shërbenin në spitale, pavarësisht nga traditat myslimane [...]

► **Fig.45. Të burgosur shqiptarë në Beograd, 1912**



KRONIKË E ILUSTRUAR E LUFTËS  
1389-1912/13  
Vëllimi 15, faqe 122  
Përgatitur nga dr. Kamenko Subotiq

### III-30. Incident midis civilëve bullgarë dhe ushtarëve të armatosur rumunë në një tavernë në Bullgari (Përshkruar nga një oficer rumun)

Në Orhania, varur në murin e një taverne, gjeta një hartë të Bullgarisë që m'u duk me interes. E shumta, duhet të kishte kushtuar një lei, por unë i dhashë dy. Ai s'donte të ma shiste. Atëherë i dhashë pesë. Ai përsëri s'donte të ma shiste. Unë desha ta vjedh. Ata më panë dhe katër bullgarë u mblodhën përpara hartës, gati për t'u zënë nëse unë e prekja. Taverna ishte e mbushur plot me ushtarë rumunë të armatosur, ndërsa ata ishin të paarmatosur. Dhe donin të përlësheshin me ne! Paturpësia e tyre ishte pothuajse heroike, por gjithsesi, mbetej vetëm paturpësi...

Gane, f. 90.

❓ Sipas mendimit tuaj, përse harta në tavernë ishte kaq e rëndësishme për bullgarët? Çfarë paraqiste kjo hartë sipas jush? Cili është qëndrimi i autorit? Nëse do të ishit në vend të tij, cili do të ishte reagimi juaj?

### III-31. Turqit dhe hebrenjtë në Beograd gjatë Luftës së Parë Ballkanike

#### *Përpara xhamisë turke*

Meqë është një ditë e bukur vjeshte, njerëzit po shëtisin pranë mureve të Kale Megdanit dhe në Topçider. Kale Megdani është mbushur plot, por vetëm me gra, kështu që nuk ndihesh mirë të shëtisësh mes grave që s'kanë shumë që kanë nisur burrat dhe djemtë e tyre në luftë. Papritur gjendem në një rrugicë të vogël, përballë xhamisë turke. Xhamia është goxha e madhe, por e thjeshtë, dhe i ngjan një oxhaku të madh ose një furre buke; ngrihet e qetë në qendër të qytetit, populli i të cilit mori armët për të luftuar kundër tiranëve të vëllezërve të tyre; turqit do t'i masakrojnë ata në emër të profetit, gjysmëhëna e të cilit shndrin mbi majën e hollë të minares.

Njerëzit thonë se çdo të premte në mbrëmje, kur hoxha plak shfaqet në ballkonin e minares për t'iu falur Allahut, një turmë fëmijësh mblidhen përpara xhamisë dhe qëllojnë me gurë drejt faltores turke. Që kur tensioni midis Turqisë dhe Serbisë ka arritur kulmin, hoxha plak nuk del më dhe emri i Allahut nuk dëgjohet mbi shtëpitë e vogla të Beogradit. A mos i vjen turp Profetit të Madh nga veprimet e turpshme të bijve të tij në Serbinë e Vjetër dhe Maqedoni?

Për një kohë të gjatë qëndrova përballë mbetjeve të pushtetit që na ka shtypur ne dhe vëllezërit tanë prej shekujsh dhe, në një farë mënyre, nuk ndihesha i qetë kur mendoja për hoxhën plak që fshihej brenda atyre mureve, si pula përpara stuhisë.

#### *Hebrenjtë*

Jo shumë larg nga xhamia turke gjendet një sinagogë hebrenjsh. Atëherë m'u kujtua se këto ditë, në Beograd, hebrenjtë mblodhën shuma të mëdha parash për familjet e atyre që shkuan në luftë. E njëjta gjë po ndodh në provincë. A do të ketë hebrenj të tillë në vendin tonë, që të bëjnë të njëjtën gjë në çaste kritike? Besoj se do të ketë...

*Gazeta Hrvatski pokret, 9 deri 31 tetor 1912.*

❓ Cili ishte qëndrimi ndaj këtyre dy minoriteteve në Beograd? Përpiquni të shpjegoni arsyet e veprimeve përkatëse të tyre.

### III-32. Fëmijë që luajnë luftash në Beograd

Beograd, 16 tetor

Në rrugët e Beogradit çamarrokët kanë filluar, tashmë, të luajnë luftash. Grupet e fëmijëve në lojë ndahen në serbë dhe turq. Deri tani ata kanë dëgjuar njerëzit të flasin në përgjithësi rreth luftës serbo-turke, kështu që s'janë të sigurtë se si luhet ajo. Por fëmijët kanë marrë vesh mjaft gjëra për çetnikët<sup>43</sup>, për të cilët njerëzit këtu flasin shumë dhe i quajnë "komitë"<sup>44</sup>. Jeta e tyre plot rreziqe, me ngjarje heroike në betejat kundër turqve, fryt i imagjinatës së njerëzve të thjeshtë, ka ndikuar shumë tek fëmijët.

<sup>43</sup> Luftëtarët guerrilas dhe më pas, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore, militantët nacionalistë serbë.

<sup>44</sup> Luftëtarë guerrilas.



Më së shumti, këta luftëtarë të vegjël takohen në sheshin e gjelbëruar midis rrugës “Knjaz Mihajlo” dhe rrugicës ku ndodhet hani “Tek fuçia e artë”, vend që ka qenë dhe është ende qendra për bohemët dhe artistët e Beogradit. Ndoshta ky shesh është Fushë Kosova, sepse është mbushur me fëmijë që thërrasin

“Rroftë Isa Boletini, qëllo mbi turqit!” “Turqit” ishin më të paktë në numër dhe, sigurisht, ata fshiheshin pas qosheve të hanit “Tek fuçia e artë” jo sepse ishin të frikësuar nga serbët, por sepse duhej të luanin rolin e turqve.

*Gazeta Hrvatski pokret, 9 deri 31 tetor, 1912.*

► **Fig. 46. Fëmijë që luajnë luftash në Vranjë, Serbi**



*L'illustration t. CXL, (1 korrik - 31 dhjetor 1912), f. 346.*

❓ Si ndikoi lufta në lojërat e fëmijëve? Përse vetëm pak fëmijë në tekstin III-32 luanin rolin e “turqve”? Kujtoni lojëra të ngjashme nga fëmijëria juaj. Po sot, a luajnë fëmijët luftash? Cilët janë ‘armiqtë’ në to?

► Fig. 47. Fëmijë që shërbejnë si infermierë në Podgoricë



*L'illustration t. CXL,*  
(1 korrik - 31 dhjetor 1912), f. 346.

► Fig. 48. Komiteti i grave serbe të Kryqit të Kuq në Nju-Jork, që u themelua për të ndihmuar në mbledhjen e ndihmave për të plagosurit



*Balkanski rat u slici i reči 35, 20*  
tetor (13 nëntor) 1913.

### III-33. Veprimtari për grumbullimin e parave në Kroaci, për “vëllezërit sllavë të jugut”

#### ZAGREBI PËR KRYQIN E KUQ TË KOMBEVE TË BALLKANIT

Sot në orën 4 pasdite, në mbledhjen e këshillit bashkiak do të propozohet që Zagrebi, metropoli i Mbretërisë Kroate, nga fondet e tij të caktojë një shumë prej 20 000 K (njëzet mijë kuna) për Kryqin e Kuq të Kombeve të Ballkanit.

Ky propozim do të pranohet patjetër. Deri tani, kjo është shuma më e madhe e dhënë nga një këshill bashkiak. Zagrebi do të kishte dhënë edhe më tepër, nëse do të ishte në gjendje më të mirë ekonomike. *Kolo*<sup>45</sup>

Të enjten, në provat e ‘Kolo-së’, shoqërisë kroate të këngës, zëvendëskryetari i saj, Z. Prilepiç, deklaroi se mbledhja e fondeve për Kryqin e Kuq të Kombeve të Ballkanit do të nisë shpejt, dhe se ‘Kolo’ do të marrë pjesë në këtë veprimtari. Ky lajm u prit me shumë entuziazëm. Të gjithë duartrokritën dhe brohoritën. Më pas u deklarua se koncerti do të bëhej të enjten, më 7 nëntor, dhe të ardhurat do t’i shkonin Kryqit të Kuq.

*Gazeta Hrvatski pokret, 4 nëntor 1912.*



Në shenjë mbështetjeje për vendet dhe kombet sllave të Jugut, populli i Kroacisë dhe i Sllovenisë organizoi disa veprimtari për mbledhje fondesh. Lajmet e këtyre veprimtarive botoheshin rregullisht në faqet e para të gazetave. Në të gjitha territoret e Austro-Hungarisë që populloheshin nga sllavë, u mbledhën ndihma për “vëllezërit sllavë të Jugut”.



Për ç’arsye u bënë këto akte bamirësie në Zagreb?

Përse autorët e këtij njoftimi ishin kaq të sigurtë se paria e qytetit do ta mbështeste këtë donacion? A ishte pjesëmarrja në këto veprimtari çështje prestigji shoqëror?

### ► Fig. 49. Vullnetar qipriot në Luftërat Ballkanike



Katia Hadjidemetriou, f. 331.

### III-34. Vullnetarë dhe ndihma në para nga Qiproja<sup>46</sup>

Natën, nga *Rojter*, mbërriti një telegram që njoftonte disfatën e plotë të bullgarëve. Ky lajm u përhap si vetëtimë tek të gjithë fqinjët. Grupet e para të njerëzve filluan të zbresin duke brohoritur, nga kafenetë e Jamudës drejt qytetit. Ndërtesat dhe shtëpitë private ishin zbukuruar me flamurë. Nga të gjithë flamurët, ai i Serbisë dhe Malit të Zi valëviteshin bashkë me flamurin grek. Papritur dhe shumë shpejt u bë një demonstratë gjigande dhe e veçantë. Orkestra filarmonike, 7 studentë të së cilës po luftonin në vijën e frontit, e udhëhequr nga mjeshtri Z. Kalligeri, ishte vendosur në krye të turmës së njerëzve dhe interpretonte këngë luftime. Orkestra u kthye në rrugën “George I” dhe, duke qëndruar përpara ndërtesave qeveritare, luajti

<sup>45</sup> Valle rrethore, që ishte shumë popullore në periudhën e Rilindjes Kombëtare.

<sup>46</sup> Qiproja dërgoi rreth 1 500 vullnetarë në Luftërat Ballkanike; 776 emra vullnetarësh janë mbledhur nga P. Papapoliviu..

himnin kombëtar. Pararoja e demonstratës ishin tek “Ateneon” dhe turma shtrihej deri tek rruga “Konstandin Paleologu”.

Rroftë Konstandini XII<sup>47</sup>! Rroftë ‘Vulgaroktoni’<sup>48</sup>! Rroftë Enosis!

Dy mijë veta e shoqëronin muzikën duke kënduar himnin. Një flamur i madh kaloi nëpër turmën e demonstruesve dhe u shoqërua me brohoritje të zjarra entuziazmi. Njerëzit hidhnin kapelet e tyre në ajër dhe shumë prej tyre puthnin simbolet e shenjta të atdheut.

Demonstrata që u ndez më tej nga fishekzjarret, kaloi nëpër rrugën “George I” dhe vazhdoi nëpër rrugën “Evagoros”, rrugët “Shën Andrea” dhe “Kritis”, dhe u kthye tek ndërtesat qeveritare. Në mesnatë, demonstrimi mbaroi. Megjithatë, disa grupe vazhduan demonstratën edhe pas mesnatës, duke mbushur rrugët dhe duke kënduar këngë patriotike.

Ditën tjetër, në “Shën Napa”, përpara turmës së njerëzve u mbajt një ceremoni ku peshkopi i Kitionit mbajti një fjalim që ngjalli sërish emocione dhe entuziazëm. (...)

Të dielën, qyteti filloi të mbledhë para të tjera për të shtuar fondet për nevojat kombëtare. Qindra të rinj nga qyteti dhe rrethinat janë gati të nisen. Limasoli, duke ruajtur të paprekur në kujtesë traditat e lavdishme, do ta bëjë nisjen e bijve të tij fisnikë sa më të lehtë. Qyteti është krenar, sepse përmes akteve të lavdishme, kurdoherë që është e nevojshme provon që di mirë se si t’u shërbejë idealeve të mëdha të popullit.

Gazeta *Alitheia* [E vërteta], 5 korrik 1913, tek Papapolyviou f. 73.



Në Kongresin e Berlinit (1878) administrimi i Qipros iu besua Britanisë. Ishulli qëndroi nën sundimin osman deri në vitin 1914. Meqë Perandoria Osmane kishte hyrë në Luftën e Parë Botërore në krahun e Fuqive të Qendrës, sipas Traktatit të Lozanës (1923) Turqia njohu aneksimin e Qipros nga ana e Britanisë. Në vitin 1925, Qiproja u shpall koloni e Kurorës. Ideja e ‘enosis’ [bashkimit] me Greqinë u përhap në Qipro, në përputhje me irredentizmin grek dhe Idenë e Madhe. Nën sundimin britanik u ngrit një lëvizje e fortë për bashkim.



Krahasoni tekstet III-33 dhe III-34: a gjeni ngjashmëri? Ç’lloj solidarizimi shprehet në to? Cilat ishin, respektivisht, shpresat e kroatëve dhe qipriotëve?

### III-35. Shitësit bullgarë të qumështit në Stamboll

Pra, ne jemi në gjendje lufte të përhershme me bullgarët dhe e gjithë bota është njohur me krimet që ky popull i vrazhdë dhe i lig ka kryer kundër nesh. A ka ndonjë fshat që nuk e kanë djegur, një xhami që nuk e kanë shembur? A ka gra dhe fëmijë që ata nuk i kanë therur apo robër që nuk i kanë vlarë ende? Megjithëse kështu janë punët, ka me mijëra shitës bullgarë qumështi që punojnë në Stamboll, që kanë guxim të veshin kalpak<sup>49</sup> dhe që nga turqit s’kanë pasur as keqtrajtimin më të vogël. Kjo është e mjaftueshme për t’i provuar të gjithë botës perëndimore madhësitinë e popullit fisnik osman. Dikur, për të mbuluar krimet e tyre, bullgarët kanë thënë se edhe ne kemi kryer krime kundër tyre, dhe këto i kanë bërë të njohura nëpërmjet shtypit evropian.

Në të vërtetë, çdokush mund ta kuptojë se të gjitha këto janë gënjeshtër. Askund në Europë, që konsiderohet si bota e qytetëruar, qytetarët e dy shteteve në luftë nuk kanë mundur të jetojnë në shtetin kundërshtar. Gjatë luftës franko-gjermane<sup>50</sup> nuk kishte gjermanë në tokën franceze, ashtu siç nuk kishte francezë në Gjermani. Dhe nëse do të kishte, njerëzit do t’i kishin bërë copash.

Po të krahasosh gjendjen këtu me atë në Europë, e kupton se qumështi osman është më i shëndetshëm se qumështi i keq i bullgarëve. Prandaj jemi krenarë për këtë ndjenjë drejtësie. Dhe po presim të shohim se për çfarë janë krenarë këta kriminelë!

“Sütçülerimiz” (*Shitësit tanë të qumështit*),  
Kolona: Hasb-i Hal (E debatit miqësor),

Karagöz 548, 23 gusht 1913, tek Heinzelmann, f. 246-47.

<sup>47</sup> Mbreti Konstandin I i Greqisë thirrej Konstandini XII, që nënkuptonte se ai ishte pasardhësi i Konstandinit XI Paleologut, perandorit të fundit bizantin.

<sup>48</sup> ‘Vrasësit e bullgarëve’: këtu aludohet për perandorin bizantin, Vasili II (976-1025), që u quajt më vonë ‘Vrasësi i bullgarëve’

<sup>49</sup> Kapelë në formën e festes prej gëzofi.

<sup>50</sup> Nënkuptohet lufta mes Gjermanisë dhe Francës në vitet 1870-1871.

🔑 “Karagjoz” u botua nga 10 gushti 1908 deri në vitin 1951, dy herë në javë. Emri “Karagjoz” vjen prej figurës komike, disi banale të teatrit tradicional osman. Gjatë historisë së saj të gjatë, revista ndërroi dy herë botues. Ali Fuati, themeluesi i saj, e botoi revistën “Karagjoz” deri kur vdiq, në vitin 1919. Atë e pasoi e motra, Fatma, që në vitin 1935, ia shiti revistën Cumhuriyet Halk Partisi [Partisë Popullore Republikane].

### ► Fig. 50. Reklamë qumështi në Greqi



Η Αθῆνα των Βαλκανικων Πόλεμων 1912-1913.

🔑 **Përkthim:** Gjatë luftës së fundit ballkanike, ushtarët e guximshëm grekë pinë shumë qumësht “VLAHAS”, që u dha forcë dhe shëndet.

? Si e shfrytëzon kjo reklamë përvojën e Luftës Ballkanike? A shihni sot ndonjë reklamë që përdor si subjekt ushtarët? Kush mund të ishte protagonist në një reklamë të tillë? Si e shpjegoni këtë?

### ? Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin III

1. Krahasoni tekstet dhe figurat që kanë të bëjnë me rolin e gruas gjatë luftës. Përcaktoni stereotipat dhe situatat e vërteta. Kërkoni në *Librin e punës 4*, dhe përmes materialeve të shqyrtuara, krahasoni rolin e grave që spikat në brendinë e këtyre teksteve, me rolin e grave në Luftën e Dytë Botërore: a mund të gjeni ndryshime ose anë të përbashkëta me Luftërat Ballkanike?

2. Në këtë libër (*Libri i punës 4*), përpikuni të gjeni të gjitha pamjet ku paraqiten fëmijët; përshkruani mënyrat e ndryshme të ndikimit që pati lufta në jetën e fëmijëve.

3. Ndani tekstet në tri grupe: (a) ato që flasin për periudhën përpara luftës; (b) gjatë luftës; (c) pas luftës. A mund të bëni një përshkrim të imazhit të luftës në çdonjërin prej rasteve?

4. Gjeni dokumente që kanë lidhje me përvojat e grumbulluara në vendet e ndryshme të Europës Perëndimore gjatë Luftës së Parë Botërore, dhe përpikuni të gjeni ngjashmëritë.



## KAPITULLI IV: Fushat e betejës dhe spektatorët

Shpërthimi i Luftërave Ballkanike shkaktoi reagime dhe ndjenja të ndryshme në popujt e gadishullit. Të dyja palët ndërluftuese kishin mbështetës të zjarrtë dhe kundërshtarë po aq të zjarrtë. Në këtë konflikt të armatosur, asnjëra e shpallur zyrtarisht nga ana e Antantës dhe Fuqive të Qendrës u shoqërua, në të njëjtën kohë, me mbështetje entuziaste për “vëllezërit e të njëjtit besim dhe së njëjtës luftë”.

Luftërat Ballkanike nxitën një raund të ri diskutimesh politike dhe diplomatike rreth së ardhmes së rajonit. U rishfaqën plane për krijimin e shteteve të reja në provincat europiane të Perandorisë Osmane. Ndërkohë që qarqet politike po përpiqeshin ta shfrytëzonin këtë situatë të re për qëllimet e tyre, njerëzit e zakonshëm prekeshin nga shkatërrimet e luftës dhe nga pasiguria e vendosjes së paqes, ku fituesit mund të impononin kushtet e tyre, pa respektuar nevojat e të tjerëve. Ndjenja e solidaritetit ndërmjet popujve të etnive të ndryshme, dhe veçanërisht ndërmjet popujve sllavë, nga qarqet drejtuese të vendeve fqinje joluftuese u pa si rrezik serioz, dhe i tillë mbeti edhe shumë vite pas luftërave.

Burimet historike në këtë kapitull kanë si qëllim të pasqyrojnë qëndrimin e popujve të Ballkanit që gjendeshin nën regjime të ndryshme politike, ndaj Luftërave Ballkanike. Ato luhaten nga përfshirja e plotë në atmosferën e luftës, duke mbledhur dhe angazhuar trupa vullnetare, deri tek moskokëçarja dhe humori i mirë. Paralelisht me këto kundërveprime të natyrshme, shfaqeshin edhe plane kontradiktore, të një politike afatgjatë.

### Iva. Provincat ballkanike të Perandorisë Osmane

Në provincat ballkanike të Perandorisë Osmane, Luftërat Ballkanike u pritën me shpresa jo të njëjta. Disa popuj u bashkuan me ushtrinë osmane, duke shpresuar të shkatërronin armiqtë dhe të ruanin integritetin e Perandorisë, ndërkohë që të tjerë po luftonin për shtetet e tyre kombëtare.

**SHQIPËRIA.** Meqë Shqipërisë i ishte dhënë autonomi e pjesshme, pak kohë përpara shpërthimit të Luftërave Ballkanike, qëndrimi i saj ndaj palëve luftuese nuk ishte i njëjtë. Qëllimi kryesor ishte të sigurohej, dhe po të ishte e mundur, të rritej shkalla e autonomisë në të gjitha tokat shqiptare. Kjo mund të arrihej duke vepruar në anën e fituesve dhe me mbështetjen e Fuqive të Mëdha. Humbjet osmane në Luftën e Parë Ballkanike i detyruan shqiptarët të hiqnin dorë nga strategjia e tyre tradicionale për autonomi; tashmë ata duhet të përpiqeshin për pavarësi të plotë. Megjithatë, interesat kontradiktore të Fuqive të Mëdha e bënë Shqipërinë e re që për disa vite të ndihej e pasigurtë, në qerthullin e intrigave diplomatike dhe sulmeve të armatosura.

#### IV-1. Vendime në lidhje me qëndrimin që duhet të mbajë Shqipëria në rast të një lufte ballkanike

– Shkup, më 14 tetor 1912

Dega e Komitetit “Shpëtimi” në Shkup, bashkë me atë të “Shoqnis së Zezë”, më 14. 10. 1912 mbajtën një mbledhje të jashtëzakonshme, me këtë urdhër dite: “Turqia ka për të bjerrë luftën. Pra, si me shpëtue Shqipnjin?”

Vendimet qenë:

- Me u drejtue nji proklamacion Fuqive të Mëdha.
- Me shënue nji delegacion për me shkëputë Malet e Shkodrës prej lidhjes që patën ba me Mal të Zi.
- Ky delegacion ka me pasë dhe një kompetencë të plotë për m’u marrë vesh me krahinat e tjera të Shqipnis e me shpëtue Shqipnjin prej rrezikut të coptimit.

Proklamacioni që u dha më 16. 10. 1912 me vulë të “Shoqnis së Zezë”, përmbante në disa rreshta këtë: “Shoqnia e Zezë”, përfaqësuese e popullit shqiptar, ka nderin me ju lajmëruë që Shqipnia i ka kapë armët jo për me forcue dominacionin e Turqisë ndër Ballkan, por për me i dalë zot tanësisë toksore e lirisë së Shqipnisë. Pra, qysh prej sodit, po Ju deklarojmë se sidoqë të jetë fati i armëve, shqiptarët nuk kanë me pranue për katër vilajetet, veçse një formë politike e një formë sundimi”.

*Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, f. 255-256*



“Shoqëria e Zezë për Shpëtim” (1911-1912) ishte një organizatë shqiptare kryengritëse dhe patriotike, e cila ishte aktive në disa qytete, si Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Manastir, Shkup etj. Qëllimi i saj kryesor ishte bashkimi i vilajeteve të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës në një njësi të pavarur politike, me administratë shqiptare dhe parlament të veçantë. Ishte një shoqëri me pikëpamje radikale dhe kryengritjen e armatosur e konsideronte si mjetin më të efektshëm për të arritur qëllimet e saj. Në vitet 1911-1912, ajo luajti një rol të rëndësishëm për organizimin dhe bashkërendimin e kryengritjeve kundër sundimit osman në Shqipëri. Gjithashtu, ajo mbajti lidhje të ngushta me shoqëritë patriotike jashtë vendit.

#### IV-2. Herbert Adams Gibonsi (një i ri që ndiqte studimet për histori, por që udhëtoi në Ballkan kur punonte për Kryqin e Kuq gjatë Luftërave Ballkanike) shkruan për mbrojtjen e Shkodrës nga shqiptarët

Shkodra ishte e rrethuar, por malazezve, që kishin mobilizuar jo më shumë se tridhjetë mijë veta, iu desh të angazhohen përgjatë gjithë dimrit. Kalaja e madhe e Taraboshit, malit të lartë që ngrihet mbi qytetin e Shkodrës dhe në pjesën jugore të liqenit ishte shumë e fortë për ushtrinë dhe artilerinë e tyre. Brenda qytetit të Shkodrës ishin shqiptarët dhe jo turqit që luftonin për kombin e tyre; ata organizuan dhe bënë një qëndresë mbrojtëse të shkëlqyer.

*Gibbons, f. 274-275.*



Përse në fillim të luftës shqiptarët mbështetën Perandorinë Osmane? A luftonin ata për sulltanin në Stamboll apo për çështjen e tyre kombëtare?

Cilat ishin anët pozitive dhe negative të kësaj politike?

#### ► Fig. 51. Përpara se të largoheshin nga Shkodra: një nënë malazeze dhe i biri i saj përpara varrit të të atit, maj 1913



*L'illustration, janar-dhjetor 1913, f. 449.*



Shikoni me kujdes këtë fotografi. A mendoni se është një foto e natyrshme apo është pozuar enkas për kamerën?

### IV-3. Telegram i Kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, drejtuar ministrave të Punëve të Jashtme të Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë, më 29 nëntor 1912

Shpejtoj të vë në dijeni të Shkëlqesisë Suaj një ngjarje me një rëndësi të posaçme për jetën kombëtare të shqiptarëve.

Delegatët e tërë krahinave shqiptare, pa ndryshim feje, të mbledhur dje në formë asambleje kombëtare në qytetin e Vlorës, kanë shpallur Pavarësinë e Shqipërisë dhe kanë ngritur një Qeveri të Përkohëshme.

Shqiptarët gëzohen që mundën të hyjnë në familjen e popujve të lirë t'Orizitit e, duke mos pasur për qëllim tjetër veçse të jetojnë në paqë me të gjitha shtetet fqinje, shpresojnë që ky ndryshim i jetës kombëtare edhe Qeveria e Përkohëshme kanë për t'u njohur prej Qeverisë së Madhërisë së Tijë Mbretërore;

Se çdo veprim armiqësor nga ana e ushtrive të Tij brenda në tokën kombëtare të tyre ka për të pushuar së vepruari edhe, se gjithë viset thjeshtë shqiptare të pushtuara sot prej ushtrive të Aleatëve kanë për t'u lëshuar prapë.

KRYETARI I QEVERISË SË PËRKOHËSHME

Ismail Qemali.

*Qeveria e Përkohëshme e Vlorës... f. 42-43.*

### ► Fig. 52. Kryengritës shqiptarë nga Mirdita që përgatiten të shkojnë në luftë kundër ushtrisë turke, 1912 (përpara Luftës Ballkanike)



*Gjurmë të historisë kombëtare në Fototekën e Shkodrës, f. 127.*

### IV-4. Relacioni i konsullit austro-hungarez, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Perandorisë Austro-Hungareze, Vlorë 30 Nëntor 1912

Me rastin e bisedimit që u bë sot në konsullatën tonë me Ismail Qemal beun<sup>51</sup>, në të cilin merre pjesë edhe kolegu italian, i pari na siguroi se me vazhdimin e derisotëm të veprimeve administrative ai ishte shumë i kënaqur. Autoriteti i tij në pjesët e papushtuara të Shqipërisë po njihet pa kundërshtim, bile dhe vetë trupat dhe gjeneralët turq në këto

<sup>51</sup> Ismail bej Qemali (1844-1919) lindi në Vlorë, në një familje të pasur feudale. Ai ndoqi shkollën fillore në qytetin e lindjes dhe më pas shkoi në kolegjin "Zosimea" të Janinës. Në vitin 1859, bashkë me familjen e tij u vendos në Stamboll, ku nisi një karrierë të shquar në administratën osmane; ai, gjithashtu, kontribuoi së tepërmi në fitoren e pavarësisë së Shqipërisë. Mori pjesë aktive në lëvizjen e Xhon Turqve, por e kundërshtoi politikën e tyre, kur ata vendosën regjimin e tyre autokratik. Me gjithë përpjekjet e Xhon Turqve kundër kandidaturës së tij për deputet, në dhjetor të vitit 1908 Ismail Qemali u zgjodh anëtar i parlamentit osman për sanxhakun e Beratit. Pas shpërthimit të Luftës së Parë Ballkanike, së bashku me një grup patriotësh të tjerë shqiptarë, ai organizoi një sërë takimesh me diasporën shqiptare, për të diskutuar çështjen shqiptare. I bëri publike pikëpamjet e tij lidhur me të ardhmen e Shqipërisë në disa artikuj dhe intervista, dhënë për gazetat e huaja. U kthye në Shqipëri më 19 nëntor dhe pas një mbledhjeje me përfaqësues nga të gjitha krahinat e banuara prej shqiptarësh, më 28 nëntor 1912 shpalli pavarësinë e Shqipërisë nga sundimi turk dhe u bë, kështu, kryeministri i parë shqiptar. Në vitin 1914 qeveria e tij dha dorëheqjen dhe nga fuqitë europiane u vendos si mbret i Shqipërisë një princ europian. Ismail Qemali vdiq në vitin 1919, në Itali dhe u varros në qytetin e tij të lindjes, Vlorë.

vise po mbajnë një qëndrim krejtësisht neutral. [...] Prej armatës turke të perëndimit ndodhen kontigjente të mëdha në Lushnjë nën Mahmut Pashën, në Këlcyrë nën Seit Pashën, në Berat nën Xhavit Pashën, në Leskovik nën Ali Riza Pashën. Këta trupa qenkan krejtësisht të demoralizuar, të lodhur dhe të zhveshur prej të gjitha gjërave të nevojshme.

Ismail Qemali (Përmbledhje dokumentesh)  
1888-1919, f. 246-47.



Si ishte gjendja në tokat shqiptare në fund të luftës?

Përse po kërkonte *Qeveria e Përkohshme* të vendoste marrëdhënie të mira me aleatët ballkanikë?

A kishte kontradikta midis kërkesave të shqiptarëve, serbëve, bullgarëve dhe grekëve?

#### IV-5. Rreziqet që mund të sillte për paqen në Europë përcaktimi i kufijve të Shqipërisë, këndvështrim francez

*Përfshirja e Europës në Çështjen Shqiptare*

Në ç'mënyrë mund të kërcënojë paqen në Europë përcaktimi i kufijve të Shqipërisë tani? Arsyeja e këtij rreziku është e thjeshtë.

**MAQEDONIA.** Gjendja në Maqedoni<sup>52</sup> ishte shumë më e ndërlikuar sesa në Shqipëri. Ndërkohë që pjesë të popullsisë kërkonin mundësinë për t'u bashkuar me shtetet kombëtare fqinje, ideja e autonomisë, sipas artikullit 23 të Traktatit të Berlinit të vitit 1878, u ngrit edhe një herë nga disa qarqe politike në emigracion.

#### IV-6. Memorandum i një grupi intelektualësh maqedonas që jetonin në Shën Peterburg, më 7 qershor 1913, drejtuar "Qeverive dhe shoqërisë së shteteve aleate të Ballkanit"

[...] Në emër të ligjit natyror, në emër të historisë, në emër të zgjidhjes praktike, vëllezër, ne ju lutemi të pranoni për informimin tuaj sa më poshtë vijon: Maqedonia popullohet nga një popull homogjen sllav, i cili ka historinë dhe mënyrën e vet të jetesës; në të kaluarën ka patur shtetin e tij, idealet e tij, e për rrjedhojë, ka të drejtën e vetëvendosjes;

Austro-Hungaria, e cila nuk mori pjesë në luftë, në të vërtetë nuk ka të drejtë të ndërhyjë në ndarjen e Turqisë Europiane midis aleatëve që kërkojnë të drejtën si pushtues dhe të kompensojnë sakrificat e mëdha njerëzore dhe financiare që bënë. Megjithatë, projekti për Shqipërinë, paraqitur nga qeveria e Vjenës, ka si qëllim vetëm t'u shkëpusë malazezve, serbëve dhe grekëve rezultatet kryesore të fitores. Fuqitë e Mëdha i dhanë shumë Austro-Hungarisë, duke miratuar parimisht një Shqipëri autonome, por është e qartë se kjo Shqipëri do të jetë e kufizur në madhësi, në mënyrë që të pajtojë dëshirat e Austrisë, me të drejtat e aleatëve fitimtarë ballkanikë.

Por, nëse ambicjet e Austrisë mbështeten pak a shumë nga Gjermania dhe Italia, aleatët ballkanikë kanë si mbështetje të natyrshme fuqitë e Antantës tripalëshe, doktrina e të cilave u shpall më 9 nëntor 1912 nga Z. Askuith, kryeministri britanik. Në banketin e shtruar nga kryetari i bashkisë, ai tha: "Fituesve nuk duhet t'u hiqet e drejta nga një fitore kaq e kushtueshme". Për rrjedhojë, dy grupet e rëndësishme të politikës europiane po grinden mes tyre mbi çështjen e Shqipërisë.

André Chéradame, *L'Illustration*, 3650, 8 shkurt 1913, f. 115.

Maqedonia duhet të jetë një shtet i pavarur, brenda kufijve të saj etnografikë, gjeografikë dhe kulturorë-historikë, me një qeveri përgjegjëse para një asambleje kushtetuese;

Shteti maqedonas duhet të jetë i veçuar dhe i barabartë, brenda një *bashkimi ballkanik* me kufij doganorë të përbashkët; në çështjet kishtarë, në Maqedoni është e nevojshme të rivendoset kisha e vjetër autoqefale e Ohrit, që më pas do të vendosë marrëdhëniet e saj kishtarë me kishat e tjera ortodokse: greke, ruse, bullgare, serbe, rumune dhe siriano-arabike;

<sup>52</sup> Siç përkufizohej sipas qëndrimeve të ndryshme: shiko tabelën 13.

Në mënyrë që të vendosim një rregullim të brendshëm më të mirë të shtetit maqedonas, një autoritet përfaqësues (*asamble kombëtare kushtetuese*), i dalë nëpërmjet zgjedhjeve të përgjithshme, të mbikëqyrura nga vendet e tjera, duhet të mblidhet sa më shpejt të jetë e mundur në Selanik.

Vëllezër aleatë – çlirimtarë! Shpresojmë se fjalët tona do të mbërrinë në zemrat dhe mendjet tuaja dhe ju, duke ndjekur shembullin e shtetit bujar të Rusisë dhe në interes të së ardhmes suaj, do ta mbështetni krijimin e menjëhershëm të një shteti të pavarur maqedonas, me anë të të cilit do të ruani paqen dhe harmoninë ndërmjet jush. Sa më shpejt, aq më mirë për ne të gjithë. Një zgjidhje e tillë rrjedh nga realizimi i idesë së madhe sllavo-helenike për një aleancë ballkanike; dhe kjo është, gjithashtu, ajo ç'kërkon nga ju kultura dhe drejtësia botërore.

Nënshkruar nga Dimitar Çupovski (mendohet të jetë autori), Gjorgji A. Georgov, G.K. Konstantinoviç, Nace D. Dimov, I.G. Georgov.

*Odbrani tekstovi za istorijata na makedonskiot narod, f. 810-812.*

? Cilat janë idetë politike kryesore në këtë dokument?

Sipas jush, përse ata po i referohen 'Rusisë bujare'?

Krahasoni tekstet II-4, II-6 dhe II-7: përpikuni të kuptoni se ç'kuptim ka '*bashkimi ballkanik*' në secilin nga këto raste.

? **Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin IVa**

Cilat janë elementet e përbashkëta në pretendimet e qarqeve politike në Shqipëri dhe Maqedoni, në fund të Luftërave Ballkanike?

A kanë këto pretendime ndonjë gjë të përbashkët me ato të kombeve të tjera ballkanike dhe nëse po, në ç'aspekt?

Vini në dukje ndryshimet që ekzistojnë te këto pretendime dhe përpikuni të gjeni "zgjidhjen më të mirë".

► **Fig. 53. Diplomata dhe përfaqësues ushtarakë grekë e serbë në malin Kajmakçalan për të biseduar caktimin e kufijve për caktimin e Maqedonisë**



**IV-7. Ideja e një Maqedonie autonome, e vënë në pikëpyetje nga një gazetar francez, gusht 1912**

A do ta vëmë në jetë këtë zhvillim që çon në autonominë e Maqedonisë? Ideja e një Maqedonie për maqedonasit ka përparuar këto pak vitet e fundit dhe synon të zëvendësojë idenë e një copëtimi më të rrezikshëm të Maqedonisë, dhe ndarjen e saj ndërmjet shteteve të ndryshme ballkanike. Por trazirat që e kanë shqetësuar vazhdimisht këtë provincë, duket se e kanë zanafillën tek një lëvizje bullgare, më shumë sesa tek një lëvizje maqedonase. Në këto kushte do të ishte e vështirë të organizohej autonomia e Maqedonisë, pa favorizuar krahun bullgar dhe duke sakrifikuar pjesë të tjera etnike. Kjo do të shkaktoje haptazi qëndresë të dëshpëruar, madje edhe në zemër të Maqedonisë. Së fundi, ne s'duhet të harrojmë se grekët dhe Kocovllehtë (rumunët) e Maqedonisë, nga frika e hegjemonisë së elementëve sllavë, mbështesin status quo-në. [...] Në këtë çast, një luftë ballkanike do të ishte me rrezik të madh për Europën. Europa, me mjetet që ka, duhet të bëjë përpjekje për ta shmangur këtë rrezik. Nuk ka gjë më të logjikshme se kjo.

Alberic Cahuet, "La situation en Turquie et la proposition Berchtold", *L'illustration*, 3626, 24, gusht 1912, f. 123.

## IVb. Territoret ballkanike të Austro-Hungarisë

Sipas deklaratës zyrtare të shpallur në Vjenë, provincat ballkanike të Austro-Hungarisë duhej të qëndronin asnjëherë; por për shumë arsye, popullsia e tyre u ndie e përfshirë në këtë situatë shumë më tepër sesa kabineti qeveritar në kryeqytetin perandorak.

**SLLOVENIA.** Sllovenët treguan interesim të madh për Luftërat Ballkanike dhe ishte e qartë simpatia e tyre për kombet sllave të Jugut. Kjo luftë u paraqit si një luftë e kombeve të shtypur kundër zgjedhës turke, si një luftë kulturore dhe fetare (krishterimi kundër islamit) dhe gjithashtu, si një luftë për bashkimin e kombeve sllave të Jugut. Megjithëse politika e partive politike sllovene nuk kishte si qëllim të gjente mënyra për zgjidhjen e çështjes kombëtare sllovene jashtë kufijve të Austro-Hungarisë, ato besonin se çlirimi i kombeve sllave të Jugut do të forconte pozitat e kombeve sllave brenda Perandorisë Austro-Hungareze.

### IV-8. “Lufta në Ballkan 1912/13”, libër i botuar në vitin 1914, bën një analizë të hollësishme të kombeve të përfshira në luftë, të shkaqeve dhe pasojave të luftës

*Përpara Luftës – shkaqet e Luftës*

#### ...Dëshira e Serbisë për dalje në det

Është e qartë se Serbia nuk mund të zhvillohet siç duhet brenda këtyre kufijve. Nëse ajo do të marrë Serbinë e Vjetër, nga ku për të dalë në Adriatik rruga më e shkurtër kalon nëpër luginën e lumit Drin, për në portin e Shën Gjinit, Lezhës e Durrësit atëherë, asaj do t'i krijoheshin kushtet e nevojshme për një jetë dhe zhvillim ekonomik normal. [...]

#### ...Bullgaria do t'i çlirojë maqedonasit

Edhe maqedonasit janë ngritur në këmbë, tani që vëllezërit e tyre ballkanas, më me fat, shkuan në luftë për t'u çliruar nga robëria e tmerrshme. Ata i harruan kontradiktat midis palëve dhe përqafuan njëri-tjetrin me një frymë vëllazërore, për të luftuar për vendin amë. Disa prej tyre hynë në ushtrinë bullgare si vullnetarë, të tjerë dolën në mal; ata po luftojnë për lirinë që kanë kaq shumë kohë që e dëshirojnë dhe për të cilën kanë derdhur kaq shumë gjak. Ata u ngritën në këmbë për t'u hakmarrë ndaj padrejtësive dhe mizorive të panumërta, për t'u hakmarrë për nënat dhe baballarët, gratë dhe fëmijët e tyre. Tani nuk janë tërhequr në male për t'u fshehur nga turqit, ata u tërhoqën nga një shkëlqim i fortë që i lajmëronte një jetë të re në liri vendit amë. Për ta, dita e madhe kishte ardhur. [...]

#### ...Greqia kërkon Kretën

Arsyeja që i bëri grekët të bashkohen me shtetet e Ballkanit në luftë kundër Turqisë, ishte ishulli i Kretës. [...]

Sidoqoftë, Greqia kishte edhe një sërë arsyesh të tjera për të sulmuar. Ashtu si dhe sllavët, grekët kishin vuajtur nën sundimin turk. Sidomos në Epir, turqit dhe shqiptarët i masakruan ata vazhdimisht. Paqe nuk kishte as në ishuj; pak përpara luftës, një kryengritje e ashpër kishte filluar në ishullin Samos.

*Vojska na Balkanu [Lufta në Ballkan], f. 27, 42.*



Sipas sllovenëve, cilat ishin shkaqet kryesore për shpërthimin e Luftërave Ballkanike?

A janë ata në dijeni të problemeve në Ballkan? Megjithëse sllovenët paraqesin interesat e shteteve kombëtare në Ballkan, përse ata nuk paraqesin edhe interesat e Perandorisë Osmane?

### IV-9. Këndvështrim slloven mbi situatën në Maqedoni


*Një mosmarrëveshje rreth Maqedonisë*

Sigurisht sllovenët janë miq të popujve sllavë në Ballkan. Ata i kanë për zemër të gjithë këta popuj. Për këtë arsye u vjen shumë keq që serbët dhe bullgarët po grinden me njëri-tjetrin. Sllovenët nuk mbajnë anën e askujt dhe sillen si asnjëherë. Sidoqoftë, kjo s'do të thotë se ata janë shikues indiferentë të kësaj

mosmarrëveshjeje; sepse e dimë mirë që ajo që ka rëndësi këtu nuk është vetëm fati i grupeve të veçanta etnike, por fati i Ballkanit, i të gjithë sllavëve të Jugut dhe sllavëve në përgjithësi. Asnjë sllav nuk do të donte që të nxishte me tej këtë grindje; as edhe rusët, si vëllezërit më të mëdhenj, nuk ndërhyjnë drejtpërdrejt si arbitra në këtë konflikt. [...] “Fjala ruse” [“Ruskoje Slovo”] paralajmëron haptazi serbët – dhe nënkupton edhe bullgarët – se “në rast (luftë), ata nuk duhet të kërkojnë mbështetjen e Ruisë dhe as përkrahjen e Antantës... Një luftë tjetër ballkanike nuk duhet të zhvillohet në asnjë mënyrë. Fuqitë e Mëdha i kanë të gjitha mjetet e nevojshme për t’u dhënë fund kontradiktave dhe kokëfortësive të kota të njërës ose tjetrës palë. Një masë e mundshme është edhe pavarësia e Maqedonisë – është e qartë se një masë e tillë do të merret vetëm në rastin më të skajshëm, kur të

gjitha mjetet e tjera të mos jenë të suksesshme”. Opinioni i gazetës ruse nuk është diçka e re për botën. Nga qarqe më të ngushta në Ballkan dihej prej muajsh se ekziston një grup – pak a shumë i rëndësishëm – që kërkon të krijojë një Maqedoni të pavarur; ky është grupi i separatistëve. Ata veprojnë në fshehtësi dhe është e qartë përse. Por, nëse sigurojnë mbështetjen e një krahu të fortë siç është Rusia, ata mund të marrin zemër dhe shpejt mund të shtojnë radhët e përkrahësve dhe e ardhmja mund t’u buzëqeshë papritur.

*Slovenec, 122, 31 maj 1913.*


 Autori i këtij artikulli është Anton Bezensheku, një stenograf e përkthyes sloven që jetonte në Sofje. *Slovenec* [Sllloveni] ishte një gazetë e përditshme katolike.


**KROACIA**, duke qenë më pranë kombeve aleate të Ballkanit, i shihte më nga afër dhe më konkretisht Luftërat Ballkanike. Krahas materialeve analizuuese, disa kroatë botuan nëpër gazetatat e Zagrebit përshtypjet e tyre vetjake rreth vendeve ndërluftuese. Në të njëjtën kohë, të dyja këndvështrimet e vendeve ndërluftuese ishin subjekt kritikash, të shprehura nëpër karikatura.

#### IV-10. “Obzor” [Horizonti], gazetë e përditshme në Zagreb, 10 tetor 1912

##### LUFTA NË BALLKAN

Sigurisht që vendet e Ballkanit nuk hyjnë në luftë vetëm për të fituar një premtim të vogël për reforma në Turqi, por gjithashtu, me shpresën se do të fitojnë autonomi të plotë për provincat e krishtera ose të paktën, se do të zgjerojnë territoret e tyre (...) Sigurisht, suksesi përfundimtar i vendeve të Ballkanit varet nga gatishmëria që ata kanë për luftë, mirëkuptimi dhe vënia në jetë e interesave të përbashkëta. Nëse kjo Lidhje ka baza të forta, suksesi është i siguar; ata do të jenë në gjendje t’u bëjnë ballë si një bllok i vetëm, si një autoritet i ri, të gjitha përpjekjeve të jashtme.

 “Obzor” [Horizonti], që u botua midis viteve 1860-1941, ishte një nga gazetatat e përditshme më të lexuara në Zagreb. Në kohën kur shpërthyen Luftërat Ballkanike, redaktor i saj ishte Slavko Vodvarka.

 Duke u mbështetur në tekstin e mësipërm, thoni cili është qëndrimi i opinionit publik kroat ndaj Aleancës Ballkanike dhe ndaj Perandorisë Osmane?

► Fig. 54. Karikaturë kroate, 1912

RAT JE OBJAVLJEN!...



Koprive [Hithra] Revistë satirike, 1912.

🔑 Përkthim:  
 -"He, hej, u shpall lufta!"  
 -"Do t'jua tregoj unë se ç'është lufta e vërtetë!"

❓ Përse disa kroatë janë kaq entuziastë prej shpalljes së Luftës Ballkanike?  
 A pasqyrohet asnjëherë zyrtare e Austro-Hungarisë në materialet e mësipërme?  
 Ç'ngjashmëri dhe ç'ndryshime shikoni në qëndrimet e kroatëve dhe sllovenëve?

**BOSNJË-HERCEGOVINA**, si provincë e re e Austro-Hungarisë qysh nga viti 1908 dhe si pjesë e Perandorisë Osmane prej shekujsh, gjendej në një situatë të veçantë kur filluan Luftërat Ballkanike. Qeveria vendore duhej të qëndronte asnjëherë, por populli nuk ishte kaq i përmbajtur.

#### IV-11. Autoritetet vendore habsburgase morën masa të veçanta në Bosnjë-Hercegovinë

Që nga fillimi i Luftërave Ballkanike, kreu i qeverisë së vendit në Bosnjë-Hercegovinë, Oskar Potçioreku ka marrë shumë masa në Bosnjë dhe Hercegovinë, me qëllim që të përgatitet për luftë kundër Serbisë dhe Malit të Zi. Ai vetë, si dhe ministri i Luftës i Austro-Hungarisë kanë shumë dëshirë që kjo luftë të fillojë. Kështu që po presin për një arsye të vlefshme. Potçiorekut i janë shtuar funksionet ushtarake dhe është ngjitur në postin e inspektorit ushtarak dhe gradën e gjeneral-komandantit. Ka filluar mobilizimi i rekrutëve. Edhe përpara Luftës

së Parë Ballkanike, Potçioreku kishte përgatitur zbatimin e të ashtuquajturave masa speciale në Bosnjë dhe Hercegovinë, për të siguruar shpinën në rast të një lufte të mundshme kundër Serbisë. Kriza në Shkodër ishte një arsye e mirë për të vendosur këtë status special në Bosnjë dhe Hercegovinë, duke rënë dakord me ministrin e përbashkët të Financave, Bilinskin, dhe ministrin e përbashkët të Punëve të Jashtme, Bertholdin. Miratimi i perandorit për këtë veprim u dha më 1 maj dhe qysh më 3 maj 1913 u afishuan postera me informata rreth masave speciale në të gjithë Bosnjë-Hercegovinën. Me masat speciale, liritë e një pjese të qytetarëve u kufizuan ose u hoqën: disa nene të kushtetutës boshnjake u shfuqizuan, liria e veprimit dhe liria

e shtypit janë kufizuar. Ky status ka efekte shumë negative mbi të gjithë popullsinë e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Madzar, *Balkanski ratovi i iznimne mjere u Bosni i Hercegovini ...*, f. 64-65.

? Ç'lloj masash u zbatuan në Bosnjë-Hercegovinë nga autoritetet habsburgase? A u morën këto masa vetëm për shkak të shpërthimit të Luftërave Ballkanike apo kishin edhe qëllime të tjera? Përse populli mbajti qëndrim negativ ndaj kësaj politike shtetërore?

#### IV-12. Ndalim i manifestimeve për mbledhjen e vullnetarëve në Bosnjë-Hercegovinë

Pas shoqërimit publik të 300 ushtarëve që shkuan vullnetarë në ushtrinë turke, në tetor 1912 manifestimet publike për të mbledhur vullnetarë u shpallën të jashtëligjshme. Në atë rast, së bashku me vullnetarët, një grup prej disa mijëra demonstruesish myslimanë marshoi nën flamujt e gjelbërt deri në stacionin hekurudhor. Ministria e përbashkët protestoi ndaj kësaj mbështetjeje publike për një nga palët e përfshira në luftë. Nëpër institucionet vendore u dërgua menjëherë një urdhër sipas të cilit, qysh nga 14 tetori, mbledhja e vullnetarëve ishte e ndaluar. Që nga kjo kohë, vullnetarët kaluan kufirin vetëm ilegalisht.

Ekmečić, *Utica j balkanskih ratova...*, f. 416.

#### IV-13. Vullnetarë serbë në Bosnjë-Hercegovinë

Nuk ishte e lehtë të bëheshe anëtar i njësie vullnetare, veçanërisht kur bëhej fjalë për një njësi speciale. Për pranimin në njësitë e udhëhequra nga vojvodat [komandantët] Vojislav Tankosiç dhe Vuk Popoviç, kriteret ishin rreptësisht të përcaktuara, por shumë serbë donin të bënin pjesë në këto njësi. Megjithatë, vetëm burrat e gjatë mund të pranoheshin në këto njësi. Ndaj, para komandës së çetës së Tankosiçit kishte shumë situata të gëzueshme dhe të dëshpëruara. Sigurisht, i gëzuar ishte ai që pranohej dhe të dëshpëruar, madje edhe në vaj, ata që nuk pranoheshin për arsye të ndryshme, sidomos për shkak të moshës dhe gjendjes fizike. Në mes të atyre që nuk u pranuan nga vojvoda Tankosiç ishte edhe një djalë i shkurtër, i zeshkët. Ai ishte Gavril Principi.

Micevic, *Srpski dobrovoljci u ratovima ...*, f. 15-16.

? Përse të rinjtë shkojnë vullnetarë në një luftë ku vendi i tyre nuk merr pjesë? Krahasoni këtë prirje, me grumbullimin e vullnetarëve gjatë Luftës së Parë Botërore. A dini ndonjë rast kur të rinjtë dolën vullnetarë për të shkuar në luftë për arsye të tjera, përveç asaj të kombësisë (nga Europa Perëndimore në vendet e Ballkanit)?

#### ? Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin IVb

Përse disa nga popujt e provincave ballkanike të Austro-Hungarisë u përpoqën të merrnin pjesë drejtpërdrejt në Luftërat Ballkanike, ndërkohë që të tjerë veçse ndoqën me interes ato zhvillime, pa marrë pjesë drejtpërdrejt?

Në ç'masë ekziston tek ata ndjenja e përkatësisë së përbashkët apo besnikërisë së përbashkët për vendin ku jetojnë?

A mund ta krahasojmë këtë gjendje të tyre emocionale me ndjenjat e popujve që jetonin në provincat ballkanike të Perandorisë Osmane apo në shtetet kombëtare ballkanike?

**? Pyetje të përgjithshme për kapitullin IV**

Cilët ishin faktorët kryesorë që ndikuan për formimin e opinionit publik në Ballkan në fillim të Luftërave Ballkanike?

A mund të kishte besim Perandoria Osmane apo ajo Austro-Hungareze në besnikërinë e të gjithë qytetarëve të saj?



## KAPITULLI V: Pas Luftës

Zakonisht, rezultatet e çdo lufte vlerësohen nga këndvështrimet e fituesve dhe humbësve të saj. Këto rezultate politike mund të vërehen lehtë tek kufijtë e rinj në hartat politike, të llogariten nëpërmjet të dhënave për territoret ose nëpërmjet të dhënave për shtimin a pakësimin e popullsisë. Krahas këtyre pasojave zyrtarisht të matshme, për shumë e shumë vite luftërat shkaktojnë një çrregullim të plotë të jetës së çdo shteti, të çdo shoqërie dhe të çdo familjeje. Shkatërrimi, sëmundjet, dëmtimet materiale janë probleme relativisht afatshkurta, që çdo shtet dhe çdo shoqëri i kapërcen në një kohë relativisht të shkurtër. Çka nuk mund të kapërcehet në jetën e një brezi të tërë është trauma psikologjike – “tmerret e luftës”, siç quheshin zakonisht në atë kohë. Aty përfshihen jo vetëm kujtimet nga incidentet më të shëmtuara dhe jonjerëzore, por gjithashtu dhimbjet për humbjen e të afërmeve, humbja e qytetit ose fshatit tënd, humbja e “atdheut” nga qindra mijëra refugjatë. Kujtimet traumatike transmetohen në brezin pasardhës dhe shpesh kthehen në rrëfim historik, dhe në këtë mënyrë përjetësohen për një kohë të gjatë.

Pasojat e Luftërave Ballkanike nuk bëjnë përjashtim nga kjo prirje. Në përfundim, ato lanë pas dhimbje dhe frikë; njerëzit emigruan, duke lënë pas fshatrat e tyre të djegur, ndërkohë që njerëzit të cilët mbetën në rajonet që u bënë pjesë e një shteti tjetër, kaluan një periudhë të vështirë për t’u mësuar. Kalimi në *shtete kombëtare* nuk ishte thjesht një çështje politike.

Pasojat u bënë edhe më të theksuara për shkak të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, vetëm një vit pas përfundimit të Luftërave Ballkanike. Vendet që ndiheshin fituese në Luftërat Ballkanike u bashkuan me krijesit e *bashkimit ballkanik*, Antantën, ndërsa ata që u ndien të fyer, u bashkuan me kundërshtarët e tyre, Fuqitë e Qendrës. Disa vende nuk patën mundësi të zgjidhnin, duke qenë se u pushtuan nga ushtritë e huaja. Ky është shkaku përse shumë bashkëkohës dhe historianë e vlerësojnë Luftën e Parë Botërore si “lufta tjetër ballkanike”.

Ky kapitull nuk ka si qëllim të dokumentojë me hollësi të gjitha pasojat e mundshme afatshkurtra dhe afatgjata të Luftërave Ballkanike. Këtu paraqitet vetëm një përmbledhje burimesh që ndihmojnë nxënësin të kuptojë natyrën e ndërlikuar të pasojave të pasluftës dhe rrjedhojat e tyre afatgjata.

### Va. Pasojat politike

**TABELA 15**  
**Sipërfaqja dhe popullsia e shteteve të Ballkanit para dhe pas Luftës**

	Sipërfaqja në milje katror		Llogaritja e popullsisë	
	Para luftës	Pas luftës	Para luftës	Pas luftës
<b>Shqipëria</b>	—	11 317	—	850 000
<b>Bullgaria</b>	33 647	43 310	4 337 516	4 467 006
<b>Greqia</b>	25 014	41 933	2 666 000	4 363 000
<b>Mali i Zi</b>	3 474	5 603	250 000	500 000
<b>Rumania</b>	50 720	53 489	7 230 418	7 516 418
<b>Serbia</b>	18 650	33 891	2 911 701	4 527 992
<b>Turqia Europiane</b>	65 350	10 882	6 130 200	1 891 000

Carnegie, f. 418.

**Harta 2 dhe 3: Ndryshimet territoriale në Ballkan  
Traktati i Londrës dhe Traktati i Bukureshtit**



T.W.

? Studioni hartat dhe tabelën dhe gjeni ndryshimet territoriale.  
Cili ishte përfundimi kryesor i Luftërave, krahasuar me gjendjen përpara tyre?  
Krahasoni hartat 1, 2 dhe 3: si është raporti midis synimeve fillestare dhe rezultatit përfundimtar?

### V-1. *Finis Turquiae?* – koment i një gazetari francez, shkurt 1913

Në këtë dhomë ndenjeje mondane, me mobilje europiane, këtë plak të drobitur, me një këmbë në varr, po e ndihmon të ecë një shërbëtor dhe hoxha po lutet në gjunjë, me fytyrë nga Lindja. Këto dy hije ngjajnë me njerëz të shekullit të 15-të dhe po pijnë duhan në shkallët e pallatit, me një gjest kaq të hijshëm; por nga të gjitha zbulimet materiale dhe morale të kësaj skene, papajtueshmërisë së një pjese armiqësore të Europës, tradhtisë së pjesës tjetër, tek e cila ata kishin patur besim, indiferentizmit të njerëzve, urrejtjeve politike – e vetmja gjë që kishte gjallëri, ishin anijet luftarake të Fuqive të Mëdha që ruanin pallatin, që ruanin qytetin. A nuk shprehej qartë e gjitha kjo me këto pak fjalë: *Finis Turquiae?*

Georges Rémond, "Les angoisses et les convulsions de Constantinople", *L'illustration* 3649, 1 shkurt 1913, f. 79.



Ky përshkrim është bërë më 22 janar, pas mbledhjes së "Divanit të Madh", ku ministri Qamil pasha u autorizua që t'ua dorëzonte Adrianopojën aleatëve ballkanikë. Të nesërmen, më 23 janar, ministri i Luftës, Nazim pasha u vra në parlament dhe një grusht shteti, i organizuar nga Xhon Turqit rrëzoi qeverinë osmane.

### V-2. Fragment i shkëputur nga një artikull i një gazete bullgare, 26 korrik 1913

#### U NËNSHKRUA TRAKTATI I PAQES

Traktati i Paqes u nënshkrua në Bukuresht, por në Ballkan nuk do të ketë aspak paqe. Nuk mund të ketë paqe aty ku ka dhunë. Traktati i Paqes, nënshkruar në Bukuresht, është miratim i dhunës më të ashpër. Bullgaria nuk do të pajtohet kurrë me të. E cinguar, e zvogëluar në kufij, e grabitur, e ndrydhur, e përdhunuar, ajo do të fillojë të punojë

brenda kufijve të saj për të forcuar dhjetëfish forcën e saj ekonomike, kulturore dhe fizike, në mënyrë që sa më shpejt të jetë e mundur, të marrë atë që i takon, sipas të drejtës kombëtare dhe historike.

Народна Воля [*Narodna Volja*]<sup>53</sup>, nr. 58, 26 korrik 1913, tek Kishki-lova, Балканските войни.

? Përpiquni të shpjegoni reagimin në Bullgari.  
A jeni dakord me thënien "nuk do të ketë aspak paqe në Ballkan"?

### V-3. Nga fjalimi i Jovan Skerliçit, shkrimtar dhe deputet në Asamblenë Kombëtare të Serbisë, më 18 tetor 1913

(...)

Kur themi "rezultat", dalin një numër pyetjesh paraprake që duhen diskutuar. Së pari, është e nevojshme të vendoset: *a është ky një rezultat përfundimtar*; në Traktatin e Bukureshtit, me gjendjen në të cilën ndodhet sot, me aleancat që mbizotërojnë tani në Ballkan, a mori Serbia gjithshka që mund të mernte, a është gjendja e saj më e mirë dhe më e sigurtë se më parë? Pas sulmit të fundit shqiptar, pas ultimatumit të ashpër nga Austria që ne të largohemi nga Shqipëria, mund të kemi dyshime rreth rezultateve përfundimtare. Por edhe nëse supozojmë se këto rezultate janë idealisht të mira, ato përsëri mbeten të diskutueshme. Nuk është e mjaftueshme të tregohen territoret e shtuara, është e nevojshme të shikohet se si janë arritur këto rezultate, duhet të vlerësohet nëse ato mund të ishin arritur me më pak humbje dhe duhet të vendoset se kush ka meritë për këto suksese.

Skerlić, *Feljtoni, skice i govori*, f. 343, 347, 354.

? Përpiquni të përcaktoni ndjenjat e përçuar nga ky fragment.

<sup>53</sup> Gazetë opozitare e Partisë Demokratike Radikale.

► Fig. 55. Çlirimi i Greqisë së robëruar



Litografi me ngjyra, punuar mbi karton të fortë, 57x41/ 64x45/ Koleksioni IEEEE, nr. 4951/14 tek Βαλκανικοί Πόλεμοι 1912-1913..., f. 203.

🔑 Pikturë alegorike popullore e kryeministrit Eleftherios Venizelos, por që u kushtohet të gjithë atyre të cilët kontribuan në çlirimin e krahinave greke të robëruara.

Kjo vepër përmban simbole historike, figura alegorike dhe forma që përfaqësojnë Idenë e Madhe, të pranishme edhe në piktura të tjera popullore të kohës së Luftërave Ballkanike. Kjo pikturë u botua përpara luftës greko-bullgare.

🔑 Përkthim: Kryeministri Eleftherios Venizelos, me Princin Trashëgimtar që udhëheq ushtrinë tonë guximtare, këpusin vargonjtë dhe u sjellin lirinë motrave tona të zëna rob.

❓ Gjeni simbolet dhe kuptimin e tyre. A mund të gjeni simbole që përfaqësojnë Idenë e Madhe? Diskutoni të "drejtat historike" të Greqisë për të patur Stambollin brenda kufijve të saj.

► **Fig. 56. Konferenca e Paqes e Bukureshtit (karikaturë rumune)**



*Furnica, IX, nr. 48, 1 gusht 1913, f. 12.*



Përkthim:

Konferenca e Paqes e Bukureshtit (foto të çastit)

Gjatë takimit.

Mbyllja e takimit.

#### V-4. Pasojat e Luftërave Ballkanike për Rumaninë, sipas vlerësimit të historianit rumun Konstantin Kiritesku

Negociatat për paqen, të drejtuara me shumë autoritet nga Maioresku, çuan në përfundimin e Traktatit të Paqes në Bukuresht, në vitin 1913; sipas fjalëve të gjeneral Fiçevit, përfaqësues ushtarak i Bullgarisë, vendi i tij duhej të paguante faturën për lakminë dhe dritëshkurtësinë e tij. Përsa i përket vendit tonë, në përfundim të këtyre ngjarjeve, doli

me të gjitha territoret e tij, përfshirë edhe Dobruhxhën Jugore, me reputacion shumë të ngritur në Europë, por gjithashtu, me një armik të papajtueshëm, të cilit e gjithë urrejtja i shkaktohet nga zilia, nga zhgënjimi dhe poshtërimi që pësoi; dhe kjo urrejtje u bë shumë e zjarrtë.

*Kiritescu, Istoria razboiului..., f. 96.*



Cili është "armiku i papajtueshëm" i Rumanisë sipas tekstit?

Cilat janë pasojat politike të luftërave për Rumaninë?

► **Fig. 57. Flamurët e Fuqive të Mëdha mbi Kalanë e Shkodrës, maj 1913**



► **Fig. 58. Ushtria serbe në Manastir**

Marzanovic, Albumi i Luftës.

### V-5. Kujtimet e Martulkovit në lidhje me kontaktin e parë që ushtria serbe pati me qytetarët e qytetit të tij të lindjes, Veles, në vjeshtë të vitit 1912

Që në fillim, aleatët ballkanikë – ‘çlirimtarët’ – shënuan fitore të mëdha ndaj Turqisë. Kur ushtria serbe pushtoi qytetin tonë, Velesin, ne banorët e tij i pritëm ‘çlirimtarët’ në mënyrë shumë festive. Duhet pranuar që, në ditët e para të luftës, pjesa më e madhe e popullit – me pak përjashtime – ishte tejet e lumtur. Tashmë u kishte ardhur fundi pesë shekujve të sundimit turk! Ishim gjithë shpresa

se do kishim kushte më të përshtatshme për një jetë më të mirë dhe për të rindërtuar vendin, do t’i jepnim fund të shkuarës së vështirë, duke mbrojtur interesat e popullit maqedonas. Por fatkeqësisht, që në ditët e para mund të dalloje erërat që frynin ndërmjet aleatëve ‘çlirimtarë’, dhe të papriturat e mundshme që priteshin të vinin prej tyre në të ardhmen e afërt...

Çliruesit tanë nuk i fshihnin synimet e tyre për Serbinë e Madhe. Kur fillonin një bisedë me ndonjë qytetar, pyetja e parë ishte ‘Çfarë jeni ju?’

– dhe nëse merrnin përgjigje se ai ose ajo nuk ishte serb, ata vazhdonin: ‘Kështu ishte deri tani, por në të ardhmen do të ndryshojë. Bullgarët u përpoqën shumë që t’ju bëjnë bullgarë. Por tani ju do të bëheni serbë të mirë... Duhet ta dini se ‘ku shkel këmba e serbit, aty do të bëhet tokë serbe’.

Martulkov, *Moeto učevstvo...*, f. 243-4.

❓ Përpiquni të shpjegoni arsyet që çuan në ndryshimin e qëndrimit ndaj ‘çlirimtarëve’ në Maqedoni.

A mendoni se ky ndryshim ishte i njëjtë për të gjithë njerëzit në Maqedoni?

Cilat fraza kanë të bëjnë me idetë e ndryshme kombëtare në Maqedoni?

Komentoni fjalinë e fundit. Sugjeroni mënyrat se si mund të ndryshohet vetidentifikimi kombëtar i dikujt.

► **Fig. 59. Ndryshimet e emrave: nga Uskub në Skopje**

*L'illustration*, t. CXL (1 janar–31 dhjetor 1912, f. 373).

❓ Shqyrtoni toponiminë e krahinës suaj dhe përpiquni të gjeni emrat e ndryshëm që qyteti juaj dhe qytetet fqinje kishin a) gjatë periudhës osmane; b) pas krijimit të shtetit kombëtar. Si mendoni, përse ndryshuan këta emra, nëse ato kanë ndryshuar.

## V-6. Mbreti Petar i Serbisë u premtom të drejta të barabarta të gjithë njerëzve që jetojnë në territoret e aneksuara nga Serbia, pavarësisht se mund të kenë origjinë të ndryshme etnike

*Nga deklarata e mbretit Petar të Serbisë*

*Popullit tim të dashur, në territoret e çliruara dhe të aneksuara, Me anë të kësaj deklarate, bazuar në marrëveshjet e arritura ndërkombëtare, vendet tuaja janë aneksuar nga Mbretëria e Serbisë... Do t'i përqendroj të gjitha përpjekjet e mia... për të siguruar që të gjithë ju, pavarësisht nga besimi fetar ose origjina juaj, të jeni të kënaqur në çdo aspekt, të emancipuar dhe të mbrojtur nga drejtësia e siguria që do t'ju garantohet nga regjimi i Serbisë së lirë. Ju do të jeni të gjithë të barabartë përpara ligjit dhe autoriteteve. Besimi fetar, prona dhe jeta e secilit do të respektohet si e shenjtë. Qeveria ime do të punojë vazhdimisht për zhvillimin tuaj arsimor, ekonomik dhe të të gjithë fushave të tjera. Ju vetë duhet t'i përvisheni punës me gjithë fuqitë tuaja, duke flakur tej gabimet e mëparshme, përplasjet dhe mosmarrëveshjet dhe, së bashku, me një përqafim vëllazëror, të fshini nga vendi ynë të gjitha pasojat e robërisë së gjatë.*

Nënshkruar nga mbreti Petar

25 gusht 1913, në Ribarska Banja

(pasuar nga nënshkrimet e anëtarëve të qeverisë serbe)

*Balkanski rat u slici i reči 29, 31 gusht (13 shtator) 1913.*

? Krahasoni këtë tekst, me atë të mëparshmin. A gjeni ndonjë ndryshim?

## V-7. Mbreti Nikolla i Malit të Zi premtom tolerancë fetare për katolikët dhe myslimanët, pas nënshkrimit të Traktatit të Londrës, më 21 Nëntor 1913

Unë jam i bindur se nënshtetasit e mi të rinj do të jenë faktor paqeje dhe zhvillimi dhe se ata do të lenë mënjanë të gjitha mendimet e gabuara dhe kontradiktat që mund t'u lindin nga ideja e një qeverisjeje të huaj, dhe se ata do të frymëzohen vetëm nga ideja e lumturisë dhe madhësisë së

atdheut tonë të dashur, Malit të Zi, ku do të jenë krah për krah me vëllezërit e tyre në kufijtë e vjetër të Malit të Zi. Unë dhe qeveria ime angazhohemi me të gjitha forcat se do të sigurojmë pronën dhe mbrojtjen për të gjithë, sistem gjyqësor të drejtë, sistem arsimor bashkëkohor dhe do të krijojmë kushte për të ardhmen më të mirë në të gjitha degët e ekonomisë. Liria fetare e gjithësecilit do të respektohet dhe mbrohet në mënyrë absolute. Ndjenjat e mia personale dhe parimi që familja ime ka zbatuar tradicionalisht "Vëllain duhet ta duash, pavarësisht nga besimi i tij", janë garanci për këtë gjë. U garantoj nënshtetasve të mi, të besimit katolik, liri të plotë të besimit të tyre, në frymën e tolerancës së përgjithshme fetare dhe në bazë të *Konkordatit* të nënshkruar me Vatikanin<sup>54</sup>. Sëbashku me grigjën ortodokse dhe atë myslimane, ata do të jenë pjesë e qenësishme e bashkësisë sonë kombëtare dhe themeli i forcës së shtetit tonë. Besimtarët myslimanë do të gëzojnë mbrojtjen e vazhdueshme timen dhe të institucioneve të mia.

Branko Pavićević, Radoslav Raspopović, f. 502.

? Krahasoni deklaratën e mbretit Petar me atë të mbretit Nikolla. Sipas jush, përse të dy premtojnë tolerancë për nënshtetasit e tyre, pavarësisht nga origjina etnike apo besimi fetar?

## V-8. Artikulli në një gazetë rumune që flet për reagimin e popullit në krahinën e sapoaneksuar të Dobruhës Jugore, në përfundim të Luftës së Dytë Ballkanike

*Nga Kuadrilateri*

Në verë të vitit 1913, në një fshat në Kuadrilater, një grup rumunësh, përfshirë këtu edhe ushtarë, u strehuan nga një familje e pasur bullgare. "Që këtej tutje, ju do të jeni ushtarë rumunë", u thamë njerëzve në atë familje; më të riut i thamë se do të shërbente në ushtrinë rumune. Kur dëgjoji këtë, djali i ri na pa sikur ishte goditur nga rrufeja. Ata shpresonin se Rumania do ta pushtonte Kuadrilaterin vetëm përkohësisht dhe që trupat do të tërhiqeshin pasi të nënshkruhej paqja. Por kur u shpjeguam se ky


<sup>54</sup> *Konkordati* mes Malit të Zi dhe Vatikanit u nënshkrua në vitin 1886.

territor do t'i përkiste përgjithmonë Rumanisë, mundëm të shihnim pikëllim në fytyrat e tyre. Gratë, gjithashtu, kërkuan shpjegime dhe nga vështrimi i trishtuar i syve të tyre dukej se edhe ato e kishin kuptuar të vërtetën e hidhur.

[...]

Bullgarët kishin parë me dëshpërim se si territori i tyre i kishte kaluar Rumanisë, por shumë tartarë dhe turq e kishin mirëpritur një gjë të tillë. Aq sa të ngrysura dhe armiqësore ishin vështrimet në sytë e bullgarëve, po aq miqësore ishin ato në sytë e myslimanëve dhe të turqve.

*Universul XXXI, nr. 213, 5/18 gusht 1913, f. 1.*

 Përpiquni të shpjegoni ndryshimet ndërmjet reagimit të bullgarëve, në përjasje me atë të turqve dhe tartarëve në Kuadrilater. A ndryshoi dhe si ndryshoi jeta e njerëzve pasi territoret kaluan nga një vend në vendin tjetër?

## V-9. Interesat kombëtarë bullgarë

### DEKLARATË E KRYESISË SË PËRGJITHSHME TË PARTISË POPULLORE MBI POLITIKËN E JASHTME BULLGARE

Sofje, 4 janar 1915

[...] duke bërë një vlerësim të paanshëm dhe të matur të interesave të Bullgarisë, mendojmë se e vetmja rrugë e mundshme për zgjidhjen e problemeve të vendit në mënyrë të kënaqshme, është ajo me ndihmën e Fuqive të Antantës Tripalëshe. Së pari, pas çdo dite që kalon, shanset për të fituar të aleancës austro-gjermane bëhen gjithmonë e më të pakta. Pas pushtimit të pajustificuar dhe të pamoralshëm të Belgjikës asnjëherë, imperializmi ushtarak gjerman hasi kundërshtim jo vetëm nga ana e armiqve të tij, por iu desh gjithashtu të përballej edhe me ndërgjegjen e botës së qytetëruar. Ky kundërshtar i paparashikuar provoi se ka fuqi të mjaftueshme për ta dënuar aleancën austro-gjermane dhe ta lërë atë në një gjendje plotësisht të izoluar. Për shtetet asnjëherë ishte moralisht e pamundur të ndërhynin në dobi të Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë. Në

fakt ndodhi pikërisht e kundërta; ndërhyrja kundër Austro-Hungarisë u përkrah gjithmonë e më shumë nga masat e popullit dhe u bë më e shpeshtë.

Interesi më i madh i Bullgarisë është që të sigurojë bashkimin kombëtar të sa më shumë territoreve. Kjo mund të ndodhë, nëse i kthehen tokat fqinje që iu morën nga marrëveshjet e bëra në Bukuresht dhe në Stamboll. Për më tepër, vetëm Antanta Tripalëshe është në pozita të tilla që të detyrojë kthimin e këtyre tokave. Kjo, sepse disa vende, krahinat e të cilave do t'i nënshtrohen këtij procesi, janë armiq të e saj, ndërkohë që të tjerë janë aleatët e saj (sepse ato shpresojnë se Antanta Tripalëshe do të kënaqë synimet e tyre kombëtare).

Qëllimi tjetër që Bullgaria duhet të punojë për ta arritur, pasi të përfundojë kjo krizë e tanishme europiane, është që të jetojë në paqe me vendet fqinje, dhe nëpërmjet kësaj paqeje, të jetë në gjendje t'i përkushtohet tërësisht zhvillimit të saj kulturor dhe ekonomik. Me fjalë të tjera, në themel të politikës bullgare duhet të qëndrojnë elemente të pajtimit me vendet fqinje. Kjo do të përbëjë një hap drejt solidaritetit të plotë dhe afrimit të interesave të përbashkëta kulturore, ekonomike dhe politike të vendeve të ndryshme. Kjo mund të arrihet vetëm me anë të zgjidhjes paqësore të pretendimeve bullgare, me ndërhyrjen e Antantës Tripalëshe.

Interesi i tretë i rëndësishëm për Bullgarinë është ruajtja e pavarësisë së Ballkanit. Ky interes është në përputhje me qëllimet dhe interesat politike të vendeve anëtare të Antantës Tripalëshe. Këto vende synojnë të krijojnë shtete të lira dhe të fuqishme në Ballkan, në mënyrë që këto shtete të shërbejnë si pengesë kundër synimeve ekspansive të imperializmit gjerman në Lindje. Ato e shprehën qartë këtë shpresë, nëpërmjet qëndrimit të tyre ndaj aleancës së parë ballkanike. [...]

Për shkak të arsyeve dhe vlerësimeve të bëra më sipër, Partia Popullore, besnike e idealeve të saj politike, ka bindjen e plotë që zgjidhja e problemeve tona kombëtare mund të arrihet nëse ka një mirëkuptim të sinqertë midis Bullgarisë dhe shtetit çlirimtar të Ruisë dhe aleatëve të saj – Anglisë dhe Francës.

*Gazeta Mir, 4451, 1 janar 1915 tek V. Georgiev dhe St. Trifonov. f. 258-259.*



## Vb. Pasojat ekonomiko-shoqërore

**TABELA 16**  
**Të vrarët dhe viktimat në Luftën Ballkanike**

Shteti	Popullsia (në mijëra)	Fuqia maksimale e forcave ushtarake (në mijëra)	Të vrarë dhe të vdekur (në mijëra)	Koeficienti i civilëve të vrarë (në %)	Koeficienti i ushtarakëve të vrarë (në %)
1. Bullgaria	4 430	607	30	0,68	4,9
2. Serbia	2 910	175	5	0,17	2,8
3. Greqia	2 630	90	4,75	0,18	5,2
4. Mali i Zi	247	30	2	0,80	6,6
Gjithsej (mesatarisht për koeficient)	10 217	902	41,75	0,46	4,9
5. Turqia	23 000	400	50	0,22	12,5

Georgiev, G. Burimet njerzore të vendeve që morën pjesë në Luftën Ballkanike 1912-1913. Përmbledhje e historisë ushtarake, 1983, vëll. 1.

► **Fig. 60. Apoteoza e Luftës Ballkanike – karikaturë rumune**



*Furnica, IX, nr. 49, 8 gusht 1913, f. 1.*



Përkthim: Apoteoza e Luftës Ballkanike  
- Vdekja: "Gëzuar dhe ju faleminderit!  
Nëse s'do kishit qenë ju, do të kisha vdekur nga  
etja këtë verë!"

## V-10. Humbjet e ushtrisë serbe në Luftërat Ballkanike

Në datën 13 shkurt 1914, ministri serb i Luftës deklaroi në Skupshtina (parlament) shifrat e mëposhtme lidhur me humbjet e ushtrisë serbe gjatë dy luftërave të fundit:

Në luftën serbo-turke: 5 000 të vdekur; 18 000 të plagosur.

Në luftën serbo-bullgare: 7 000 deri 8 000 të vdekur; 30 000 të plagosur. Dy mijë e pesëqind ushtarë vdiqën si pasojë e plagëve të marra, 11 000 deri në 12 000 nga sëmundjet dhe 4 300 nga kolera. Prej këtyre të fundit, 4 000 vdiqën gjatë luftës serbo-bullgare.

*Carnegie, f. 395.*

❓ Përderisa ekonomia e shteteve të Ballkanit ishte kryesisht bujqësore, mendoni për përmasat dhe pasojat që sollën humbjet në njerëz.

Gjeni informacione të tjera rreth gjendjes ekonomike në vendet e Ballkanit pas Luftës.

## V-11. Lufta e Parë Botërore: Luftë e një lloji tjetër

[...] Përballja në masë me vdekjen, ndoshta është përvoja më thelbësore në luftë. [...] Gjatë luftës moderne, shumë veta për herë të parë e panë sy më sy vdekjen e organizuar në masë. [...] Në Luftën e Parë Botërore vdiqën në luftime ose për shkak të plagëve dy herë më shumë njerëz sesa ishin vrarë në të gjitha luftërat e mëdha nga viti 1790-1914. Disa shifra do t'ju ndihmojnë të kuptoni pasojat që pati përballja me vdekjen në masë, që mbizotëron në kujtesën e asaj Luftë. Rreth 13 milionë njerëz vdiqën gjatë Luftës së Parë Botërore, ndërkohë që Napoleoni, në luftën kundër Ruisë, në fushatën më të përgjakshme deri në atë kohë humbi 400 000 veta – ishin 600 000 të vrarë nga të gjitha palët në betejën pa ndonjë përfundim, në Somme, në vitin 1916. Lufta më e madhe e shekullit të 19-të, Lufta franko-prusiane (1870-1871) pati 150 000 francezë të vdekur, ndërkohë që ranë në betejë 44 780 prusianë. Në kohën e Luftës së Parë Botërore kujtesa për

humbjet e mëdha të *luftërave napoleonike* po shuhej dhe humbjet në luftërat e shekullit të 19-të nuk mund të krahasoheshin me ato që do të vinin. Përmasat e reja të humbjeve në luftë kërkonin një përpjekje shumë më të madhe për ta maskuar dhe kapërcyer vdekjen në luftë, sesa ishte kërkuar gjatë gjithë periudhës së mëparshme.

Lufta e Parë Botërore pati gjithashtu përmasa të tjera të reja, të cilat ndikuan në mënyrën sesi burrat dhe gratë e perceptuan atë. Kjo ishte një luftë në epokën e teknologjisë, në epokën e mjeteve të reja dhe më të efektshme të komunikimit, të cilat ndihmuan në përhapjen e imazhit të luftës dhe nxitën imagjinatën. Megjithatë, më e rëndësishme nga të gjitha ishte futja e një mënyre të re luftimi në Frontin Perëndimor, çka përcaktoi rishtaz kuptimin që do kishte lufta për jetën e shumicës së ushtarëve. Lufta në llogore përcaktoi jo vetëm perceptimin e luftës nga ata që luftuan, por gjithashtu, edhe mënyrën se si do të kuptohej ajo nga brezat e ardhshëm. [...] Fronti Perëndimor, me stilin e tij të veçantë dhe të vetëm në mënyrën e luftimit, mbizotëroi prozën dhe poezinë, si dhe albumet me fotografi dhe filmat rreth luftës; ai vendosi se çfarë do të bënin me luftën bashkëkohësit dhe brezat e ardhshëm.

*Mosse, f. 3-4.*

❓ Krahasoni shifrat në tabelën 16, me shifrat e përmendura në tekstin e Mosesit: si ndryshojnë shifrat e të vrarëve në Luftërat Ballkanike me ato në Luftën e Parë Botërore?

## V-12. Serbia e Re – Rezultatet nga regjistrimi i popullsisë

Sipas regjistrimit të popullsisë, bërë në qytetet e Serbisë së Re nga autoritetet ushtarake, qytete të caktuara në zonat e sapoçliruara të Serbisë, kanë këtë popullsi:

Bitola 59 856, Shkupi 47 384, Markov Prilep 21 783, Prizreni 21 244, Prishtina 18 174, Velesi 16 624, Gjakova<sup>55</sup> 14 500, Novi-Pazari 13 434, Ohri 11 038, Dibra 10 199, Tetova 10 070, Mitrovica e Kosovës 9 354, Pljevlja 7 935, Krushevo 7 903, Gjevgjelija 6 000, Kavadari 5 861, Vuçiterni 5 749, Kiçevo 5 400,

<sup>55</sup> Në artikull ka një pasaktësi, Pljevlja dhe Gjakova janë përfshirë në listën e vendeve që Serbia mori në vitin 1913, kur në fakt këto territore u bënë pjesë e Malit të Zi. Vetëm pas 1945-ës, Gjakova u bë pjesë e Kosovës.

Krivoreçka Palanka 4 893, Resani 4 756, Orahovaci 4 593, Sjenica 4 539, Kumanova 4 421, Ferizaj (Uroshevaci) 4 405, Gostivari 4 384, Struga 4 120, Negotini 4 050, Prijepolje 3 355, Kratovo 3 020 dhe Nova Varoshi 2 909. Disa qytete të tjera, siç janë Dojrani, Gjilani, Presheva, Priboji etj. nuk qenë në listë. Popullsia urbane e Serbisë së Re arrin në mbi 400 000 vetë.

*Balkanski rat u slici i reci 34, 13 (26) tetor 1913.*

? Në ç'mënyrë mund të ndikonte në jetën ekonomike të Serbisë së Re rritja e popullsisë urbane? A mund të shkaktohte kjo gjendje një lloj krize ekonomike dhe, nëse po, pse?

### ► Fig. 61 dhe fig. 62 Refugjatë



*Carnegie, fig. 43 dhe 48, f. 253, 256.*

### V-13. Numri dhe sistemimi i refugjatëve në Bullgari, sipas raportit të Kryeministrit V. Radoslavov<sup>56</sup> në Asamblenë e 17-të Kombëtare

*Sofje, 21 prill 1914*

[...] 10 000 më pak, 10 000 më shumë, ata janë gjithsej rreth 150 000 veta. Disa prej refugjatëve janë strehuar vetë, pa ndihmën e komisionit, sepse s'duan që t'i zbatojnë urdhrat e komisionit. Ata kanë zgjedhur disa fshatra dhe ne i kemi lënë të qetë. I lejova të qëndrojnë, pavarësisht se kemi hasur shumë vështirësi, pasi vendësit nuk i duan, nga frika se mos refugjatët zënë tokat e tyre. Duhet ta pranoj se vendësit ose i kanë inat, ose tremben se mos në të ardhmen ata u marrin pronat, prandaj nuk i presin refugjatët me shumë bujari. Ka pasur ankesa, se në disa fshatra refugjatët janë nxjerrë nga shkollat, në një kohë kur ishte tepër ftohtë, kështu që na u desh të ndërhyjmë dhe të marrim masa për të siguruar jetën e tyre.

V. Georgiev, St. Trifonov.

? Cilat ishin shkaqet që shtuan fluksin e refugjatëve pas Luftërave Ballkanike? A mund të bëni ndonjë lidhje midis çështjes së refugjatëve dhe proceseve ekonomike? Sipas jush, përse njerëzit tremben nga refugjatët? Gjeni informacion lidhur me ardhjen e refugjatëve në vendin tuaj.

### V-14. Refugjatë myslimanë në Selanik

Nr. 5. Më 1 shtator, zyrtarët e Komitetit Islamik të Selanikut na njoftuan se në qytetet dhe rrethinat e tij kishin ardhur 135 000 refugjatë muhamedanë, shumica e të cilëve kishin ardhur qysh nga Lufta e Dytë. Prej tyre, gjashtë ose tetë mijë ishin larguar, kishin shkuar tashmë në Azinë e Vogël, kryesisht në Mersina, Adalia dhe Skënderun. Qeveria greke kishte premtuar se do të sillte pesë anije dhe këto ditët e fundit, 3 000 veta kanë prerë bileta. Komiteti i kujtoi

<sup>56</sup> Vasil Radoslavov (1854-1929) – jurist dhe politikan bullgar, udhëheqës i Partisë Liberale (radoslavistët) që ishte e orientuar kundër Europës Perëndimore. Ai u caktua disa herë kryeministër.

qeverisë greke se tashmë ishte ajo përgjegjëse për refugjatët në Selanik, përderisa i kishte detyruar ata të linin shtëpitë e tyre. Komiteti i kërkoi qeverisë që t'i furnizonte këta refugjatë me bukë, sepse po shpenzonte 50£ në ditë për bukë. Në përgjigje të pyetjeve të bëra, komiteti nuk besonte se një numri të konsiderueshëm refugjatësh do t'u jepej tokë në Maqedoninë greke. Disa mund të marrin në Kukush, por jo më shumë se një mijë ose dy mijë veta do mund të punojnë në bujqësi.

*Carnegie, f. 278.*

**TABELA 17**

**Emigrantët ballkanas në Turqi**  
(Kryesisht nga Trakia dhe Maqedonia)

Viti	Numri i emigrantëve
1912-1913	177 352
1914-1915	120 566
1916-1917	18 912
1918-1919	22 244
1919-1920	74 848
<b>Gjithsej</b>	<b>413 922</b>

*Burime: Cem Behar, Osmanli İmparatorluğunun ve Türkiyenin Nüfusu (Popullsia e Perandorisë Osmane dhe Turqisë) 1500-1927, Ankara 1996 ; Daniel Panzac, 'L'enjeu du nombre. La population de la Turquie de 1914 à 1927', Revue du Monde Musulman et de la Méditerranée, 1988, 4, f. 45-67; Justin McCarthy, 'Muslim refugees in Turkey' in the Balkan Wars, WWI, and the Turkish War of Independence. Essays in honor of Andreas Tietze ['Refugjatët myslimanë në Turqi' në Luftërat Ballkanike, Luftën e Parë Botërore dhe Luftën Turke për Pavarësi. Ese për nder të Andrea Tice], Stamboll 1993.*

### V-15. Pasojat ekonomike për Selanikun, sipas këndvështrimit të "Federatës Socialiste të Selanikut", 1913

Pasi e kemi shqyrtuar këtë çështje nga pikëpamja e interesave të kombësive të ndryshme, do ta analizojmë, tashmë, nga pikëpamja ekonomike, sepse çështja e Turqisë Europiane është një çështje kombëtare dhe ekonomike, dhe në të vërtetë, është më shumë ekonomike sesa kombëtare. Vendet aleate të Ballkanit nuk ishin të interesuara as për të zgjidhur problemet kombëtare, dhe as për të përmirësuar gjendjen e popullsisë të krishtera

në këto provinca. Ato ishin të interesuara vetëm të zgjeronin territoret e tyre.

Ndaj, nëse e shikojmë këtë çështje nga ky këndvështrim, do të vërejmë se territoret e pushtuara që (aleatët) duan t'i ndajnë, nuk do të arrijnë kurrë nivelin ekonomik që kishin në të shkuarën. Dhe ky pohim është i vërtetë, përse i përket gjendjes ekonomike në Selanik. Ky qytet furnizonte të gjitha vilajetet e Turqisë Europiane, përveç vilajetit të Adrianopojës. Pothuajse të gjitha importet dhe eksportet e provincave maqedonase dhe të një pjese të mirë të Shqipërisë kalonin nëpër portin e Selanikut. Pas ndarjes së provincave të Turqisë Europiane, disa industri do të shkatërrohen – kryesisht industria e kultivimit dhe përpunimit të duhanit, që është një industri jetësore për vendin: në të janë punësuar 160 000 punëtorë, shumica e të cilëve janë organizuar në sindikata të fuqishme. Nëse ndarja e territoreve bëhet realitet, krahinave që furnizoheshin nga Selaniku do t'u duhet të gjejnë një rrugë tjetër. Zonat e brendshme të Selanikut do të kufizohen shumë, çka do të sjellë shkatërrimin e qytetit më të madh të Turqisë Europiane, një shkatërrim që është i paracaktuar të ndodhë, nëse nuk vendoset bashkimi doganor mes Aleatëve. Por, a pritet të ndodhë një bashkim i tillë ekonomik në Ballkan pas kësaj lufte të tmerrshme dhe pas kaq shumë masakrash të shkaktuara nga palët ndërluftuese?


Siç e përmendëm edhe më sipër, zgjidhja e vetme e këtij problemi është autonomia e provincave të Turqisë Europiane, e garantuar nga një marrëveshje ndërkombëtare. Në këtë rast, bashkimi i kombeve të Ballkanit do të bëhet realitet në një kohë të shkurtër. Për më tepër, provincat e Turqisë Europiane duhet të bashkohen në një Federatë Ballkanike. Me anë të kësaj Federate, jo vetëm që do të bëjmë të mundur zhvillimin kulturor dhe përparimin ekonomik, por gjithashtu, do të shmangim një luftë të re për hakmarje, një luftë të re "kombëtare" dhe "çlirimtare". Vendet e Ballkanit nuk do të detyrohen të kërkojnë ndihmën e mbrojtësve të shtirur të popujve të Ballkanit, si Austrisë dhe Ruisë. Përkundrazi, vendet e Ballkanit, duke qenë të bashkuara, do të përbëjnë një fuqi që do të jetë në gjendje t'u bëjë ballë me sukses trysnive nga ana e Ruisë dhe Austrisë; kjo fuqi do të jetë në gjendje të shmangë çdo rrezik pushtimi.

*Elefantis, f. 49.*

## Vc. Pasojat ideologjike

### V-16. Pjesë nga një libër për klasat e pesta të shkollës fillore, më 1914

Dy armiqtë më të mëdhenj të kombit grek kanë qenë bullgarët dhe turqit. Të parët janë më të rrezikshëm dhe çnjerëzorë. Në historinë tonë ka tregime të tmerrshme për ashpërsinë dhe llahtarinë e shkaktuar nga këta njerëz të egër, që e quajnë veten të krishterë. Ata janë tartarë dhe kanë lidhje me turqit. Ata kaluan Danubin dhe kërkuan mikpritje në vendet tona. Ne u dhamë tokë për ta mbjellë, siguri, drejtësi, si dhe besimin e krishterë, në mënyrë që të mund të shpëtonin shpirtërat e tyre, por kjo që e gjitha e kotë; ata mbetën tartarë.

 Ky libër u botua nga Galatia Kazanzaki, një shkrimtare dhe autore e njohur e letërsisë për fëmijë. Titulli i tij ishte "Ushtari". Në kopertinën e librit kishte simbole që i referoheshin edhe Antikitetit, edhe Bizantit, ishte dhe thënia e lashtë spartane 'Kthehuni fitimtarë ose të vdekur', të cilën sipas traditës, nënat spartane ua thoshin bijve të tyre kur shkolin në luftë; gjithashtu, në kopertinë gjendej edhe shqiponja dykrenare.

### ► Fig. 63. Kopertina e një libri shkollor për klasat e pesta



### V-17. Koment kritik për librat shkollorë grekë, marrë nga një raport i pedagogut dhe mbështetësit të gjuhës së folur, D. Glinos, shkruar më 1926

Duke përmbledhur konstatimet e përgjithshme që dolën nga ky studim, mund të themi se:

1. Në fillim të shekullit të 19-të, arsimi grek frymëzohej nga një ndjenjë e zjarrtë patriotike. Por Ideja e Madhe e grekëve, synimi i tyre për të çliruar të gjithë grekët nga sundimi turk dhe rikrijimi i *shtetit bizantin*, me Kostandinopojën kryeqytet, drejtohej vetëm kundër turqve. Të krishterët e tjerë në Ballkan – të cilët ende nuk kishin shfaqur shenja të forta të rilindjes kombëtare, me përjashtim të serbëve – shiheshin më tepër si vëllezër të përvojatur dhe nxiteshin që të ngriheshin në luftë për liri (Rigas Fereos). Ky ideal kombëtar kundër turqve ka mbetur i pandryshuar deri në ditët e sotme. Katastrofa në Azinë e Vogël dhe shpërngulja e popullsisë greke nga Azia e Vogël dhe Trakia mund ta zbehë këtë ide, nëse status quo-ja e tanishme e marrëdhënieve në Lindje mbetet e pandryshuar.

2. Pas mesit të shekullit të 19-të dhe veçanërisht nga 1870-ta e në vazhdim – kur bullgarët, të ndihmuar nga rusët filluan të kërkojnë trashëgiminë e tyre kombëtare dhe u ngritën kundër turqve, por gjithashtu, me shumë vrull edhe kundër grekëve – kujtimet e konflikteve mesjetare midis grekëve dhe bullgarëve shkallë-shkallë filluan të rishfaqen, dhe përfundimisht, urrejtja racore është më e fortë se urrejtja kundër turqve. Arsimi grek u ndikua shumë nga kjo situatë.

3. Në periudhën e Luftërave Ballkanike, dhe menjëherë pas tyre, kjo urrejtje që vetëm përkohësisht u pakësua gjatë aleancës greko-serbo-bullgare, u bë edhe më e fortë. Suksesi i Greqisë gjatë këtyre luftërave që e sollën atë më pranë përmbushjes së Idesë së Madhe, shtoi patriotizmin, krenarinë kombëtare, si dhe idealet nacionaliste. Kjo shpjegon faktin përse librat shkollorë të çdo lënde, nga viti 1914 deri 1917, arritën kulmin në përhapjen e nacionalizmit dhe antagonizmit racor.

4. Në vitin 1917, refoma e sapozbatuar në shkollat fillore – e frymëzuar nga një frymë liberale, ba-

zuar në njohjen më të mirë të botës së fëmijëve, u përqendrua në forcimin e elementëve pozitivë të një qytetërimi paqedashës dhe më fisnik – mundësoi të futen në përdorim një seri librash për katër klasat e para, të cilët nuk kishin si qëllim të forconin nacionalizmin e verbër, përjashtues ose të nxisnin pasionet racore, por frymëzonin tek nxënësit një dashuri pozitive për atdheun dhe kulturën greke, për lirinë kombëtare dhe pavarësinë. Ideali kombëtar mund të forcohet pa ushqyer neveri dhe urrejtje për popujt e tjerë. Këta libra janë agimi i vërtetë i një dite të bukur. Ata janë të kulluar dhe njerëzorë. Në të njëjtën kohë, sistemi i notave i pandikuar nga reforma mbetet nën ndikimin e sistemit të vjetër.

5. Reforma në arsim u ndërpre në vitet 1920-22, gjatë ripërtëritjes së monarkisë nga mbreti Konstantin, dhe rifilloi në vitin 1923, duke vazhduar deri më 1926, por duke mos ndikuar në klasat më të larta se klasa e katërt e shkollës fillore. Klasat më të larta, dhe për më tepër arsimi i mesëm, nuk kanë pësuar asnjë ndryshim që nga viti 1914 deri tani.

Fragmentet e shkëputura nga libri dhe raporti janë marrë nga:

F. ΙΙ-ίου, “Σχολικά εγχειρίδια και εθνικισμός. Η προσεγγίση του Δημητρη Γληνου” [Nacionalizmi dhe tekstet shkollore. Qëndrimi i D. Glinosit], tek Η Ελλάδα των, f. 271, 277-8.



Dimitrios Glinosi mori pjesë në përgatitjen e politikës arsimore të qeverisë së E. Venizelosit në vitin 1917, por më vonë u bë komunist. Komentet kritike të mësipërme shpjegojnë, ndër të tjera, përse librat më të këqij shkollorë ishin ata të shkruar menjëherë pas Luftërave Ballkanike, kur grekët mendonin se ishte koha për të përmbushur Idenë e Madhe.



Si edukoheshin nxënësit në Greqi pas Luftërave Ballkanike? Cilat mund të jenë pasojat e këtij lloj shkollimi? Sipas jush, a është e përshtatshme që sistemi arsimor të propagandojë këtë lloj imazhi të popujve fqinj? Gjenerali shkollorë të vendit tuaj, të botuar menjëherë pas Luftërave Ballkanike dhe shikoni se cili ishte imazhi përkatës i fqinjëve tuaj në ta?

## V-18. Artikull në shtypin malazez rreth dorëzimit të Shkodrës Fuqive të Mëdha, prill 1913

Shkodra nuk mund të jetë e jona. Nuk do të mund të ishte edhe sikur të flijoheshim të gjithë për të. Forca e padrejtësisë e hoqi atë nga duart tona. Më të fortët, të cilët janë të një mendimi, vendosën që gjërat të jenë kështu. Ata patën parasysh interesin e paqes së përgjithshme, kur morën këtë vendim. Ata janë të mendimit që në kushtet e tanishme, është e pranueshme për një shtet të vogël, që të bëjë një sakrificë kaq të madhe, në mënyrë që të ruajë paqen. Historia ka dëshmuar vetëm pak raste padrejtësish si kjo që po i ndodh tani Malit të Zi... Gjaku i derdhur për Shkodrën do të lëkundë nga themelet vendimin që ky qytet i lashtë mos të jetë i yni. Ky është gjaku i një kombi kalorsiak, i cili la mijëra djem, nga më të mirët, të vrarë në dyert e Shkodrës. Këta të vrarë do të jenë aleatë të fortë në arritjen e aspiratave tona, të cilat për tani për tani po mbeten të paplotësuar... Reputacioni i Malit të Zi në të gjithë botën mbetet i lartë, ashtu siç ka qenë gjithmonë. Ai e ka kryer detyrën e tij të vështirë në luftë në mënyrë të shkëlqyer. Padrejtësia që iu bë atij duke i marrë Shkodrën, vetëm sa i ka sjellë famë. *Cetinjski vjesnik [Lajmëtar i Cetinës], Nr. 33, 25 prill 1913, f. 1.*



Si e paraqiste humbjen e Shkodrës, Mali i Zi? Si e komentoni ju përpjekjen për të zgjidhur konfliktet duke “ndrequr padrejtësitë historike”?

## V-19. Radikalizimi i ndjenjave kombëtare në Bullgari sipas poezive të Ivan Vazovit

### A. Kjo Luftë (nëntor 1912)

Nga Lozengradi i stuhishëm deri në brigjet e Egjeut,  
mbushur me kufoma, fushat dhe luginat, dhe  
rruga jonë, një rrugë ngritur mbi varre. Mbi  
fshatra të djegur, mbi varre njerëzish. [...]  
Lufta, një e keqe e tmerrshme, diçka e egër,  
Një fshikullimë shfarosëse, një gjëmim zemërimi,  
vajtimesh,  
Luftë e pamëshirshme, një det lotësh, dhimbjesh,  
O Zot – por përsëri një luftë e shenjtë!

### **B. A është kjo, ajo për të cilën po luftojmë? (prill 1913)**

Grumbuj trupash të gjakosur,

të varrë në luftën për liri vëllazërore,  
një bëmë e madhe dhe e mrekullueshme  
në përleshje të tmerrshme me armikun, me  
kushtet, natyrën;

[...]

a është kjo arsyeja që djemtë tanë trima  
mblodhën dafina dhe mbollën me varre fushat  
dhe dëborën trake,  
për të parë robërit e dikurshëm përsëri robër sot?  
[...]

Për Bullgarinë ju dhatë këto varre heronjsh. A është  
kjo për të cilën ju derdhët me trimëri Gjakun më të  
pastër tuajin?

A është kjo për ç'ka ne luftuam?

### **C. Për Maqedoninë (maj 1913)**

[...]

Ne nuk do t'ju braktisim! Mallkimet rënshin nga  
lart, mbi kokat dhe emrin tonë,  
Nëse nuk do të këpusim vargonjtë e rinj të  
vëllezërve tanë të mjerë,  
me grushtet tanë të fuqishëm. [...]

Ivan Vazov, f. 52, 152, 153-4.



Krahasoni poezitë e Vazovit me idetë e tij  
mbi Aleancën Ballkanike (teksti II-6).

### **V-20. Fragment nga kujtimet e Mihail Magjarovit, politikan bullgar i Partisë Popullore, ku shpreh hidhërimin për vdekjen e djalit të tij**

Në mbrëmjen e 23 qershorit, një oficer bullgar erdhi  
në shtëpinë time dhe kërkoi të bisedonte me mua  
privatisht. E pranova kërkesën e tij. Ai ishte në siklet  
dhe i turbulluar. Më tha se kishte marrë pjesë në  
betejat e Lahanasë, në frontin e Selanikut. Tashmë  
ushtria jonë ishte mundur. Gjatë kësaj beteje, djali  
im, togeri Iv. Magjarovi ishte plagosur nga një  
granatë. Ai ishte ndihmës e adjutant në batalionin

e dytë të regjimentit të 25, Dragoman. Në atë kohë  
djali im po zëvendësonte një nga komandantët e  
vrrarë dhe po udhëhiqte kompaninë, kur një granatë  
e rrëzoi përdhe. Oficeri nuk m'i tregoi saktësisht  
rrethanat në të cilat kishte ndodhur ngjarja, por  
më la përshtypjen se djali im ishte lënë në fushën  
e betejës dhe, nëse do t'i dërgoja një telegram  
Venizelosit, do të kujdeseshin për të. Nuk është e  
nevojshme të them se sa tronditëse ishte kjo për  
mua dhe familjen time. Për disa ditë qarkulluan zëra  
shqetësues nëpër Sofje lidhur me fatin e dy djemve  
të mi, por në këtë pikë, nuk ka dyshim se po kaloja një  
situatë tmerrësisht të rëndë. I dërgova me shpejtësi  
telegramin Venizelosit dhe bashkë me telegramin  
i bëra edhe një kërkesë që të më njoftonin nëse e  
kishin gjetur djalin në mes të të plagosurve të zënë  
rob në frontin e Selanikut. Pas pak ditësh mora një  
telegram nga kryeministri grek, me të cilin njiheshim  
dhe ishim miq që nga Konferenca e Londrës. Në  
telegram më njoftonte me dhimbje të madhe se  
djali im nuk ishte në mes të plagosurve të zënë rob.  
E humba edhe shpresën time të fundit. Që nga ai  
çast isha njeri i pushtuar nga hidhërimi. Çdo gjë  
rreth meje më dukej e zymtë. I gjithë mjerimi dhe  
hidhërimi i Bullgarisë më dukej dyfish më i madh.  
Çdo send në shtëpinë time më kujtonte lumturinë  
e humbur. Ngushëllimet e miqve dhe të afërmve të  
mi më mbushnin me më shumë pikëllim dhe mund  
të them, se edhe më acaropin. Kisha nevojë të rrija  
vetëm. Çdo bisedë me miqtë dhe të afërmit e mi  
përfundonte me histori njerëzish të varrë. Të dukej  
sikur vazhdimisht të lëndohej një plagë torturose.  
Vetëm mbyllja dhe përqendrimi brenda vetes më  
sillnin pak qetësi. Hidhërimi im i thellë përputhej me  
hidhërimin e Bullgarisë. Bullgaria po humbte, në të  
njëjtën mënyrë si unë, gjithçka që ishte e dashur dhe  
e shtrenjtë për të. Në këtë gjendje të pikëlluar në të  
cilën isha katandisur, mund të mbyllja një sy për të  
gjitha gabimet dhe krimet e bëra nga car Ferdinandi  
dhe organet e pushtetit të tij. Në fakt, zemërimi im  
u drejtua kryesisht kundër aleatëve të djeshëm, që  
i kishin marrë atdheut tim atë që i takonte, dhe e  
kishin çuar në këtë fund të hidhur, duke mos i dhënë  
Bullgarisë gjithçka për të cilën kishin rënë dakord  
më parë zyrtarisht dhe që thuhej në marrëveshjet  
e arritura. Përpara se të arrinim në këtë pikë, kisha  
dënuar mendjemadhësinë dhe verbërinë tonë, por  
kur pashë ligësinë e fqinjve tanë, e kuptova se këto

ndjenja ishin të përbashkëta për ne të gjithë. Më pas, në mënyrë të pavullnetshme, më lindi në mendje dëshira që t'i shikojta të gjitha palët të poshtëruara, në mënyrë që ta kuptonin edhe ata se sa shumë të qenët zemërgjerë dhe përfillës është e nevojshme jo vetëm për individët, por edhe për kombet.

Madjarov, f. 185.



Mihail Magjarov (1854-1944) ishte politikan bullgar, anëtar i Partisë Popullore, ishte diplomat, gazetar dhe figurë publike. Në vitet 1912-1915, ai ishte ambasador i plotfuqishëm në Londër dhe Shën Peterburg. Pas Luftërave Ballkanike, mbështeti këto ide: të mbaheshin lidhje të ngushta me Rusinë dhe Antantën, të nënshkruhej një marrëveshje bullgaro-serbe, të bëhej pajtimi me Greqinë dhe Rumaninë, nëpërmjet një politike të bazuar në arsyen politike dhe jo në ndjenja dhe fanatizëm. Megjithatë, ky fragment i veçantë nga kujtimet e tij shfaq brengën dhe hidhërimin e tij vetjak, kur merr vesh humbjen e djalit të tij në frontin e Selanikut, në qershor të vitit 1913. Ndjenja të tilla ishin shumë të përhapura në këtë kohë.

### V-21. Një shkrimtar shumë i njohur kroat, Antun Gustav Matos<sup>57</sup>, bën një përshkrim të fillimit të Luftës së Parë, në të cilin përzier hidhërimin për humbjen e miqve të tij serbë që vdiqën në luftë, me interpretime ideologjike tepër të skajshme

“Po vështroj katër nga shokët e mi, të shtrirë përpara meje dhe katër plagë janë hapur në trupin tim. Shikoj një kokë me flokë të verdhë, me mjekër si të Krishtit, që është e shokut tim, Branko Lazareviçit, që ka qenë krenaria e brezit të ri të kritikës letrare serbe. Sot Lazareviç ka vdekur; e lumtur është toka që e rriti dhe gjiri që i dha qumësht. Ai ishte kritik dhe gazetar, tani është hero.

Dhe Vladeta Kovaceviçi im, djali i ministrit dhe historianit të madh Kovaceviç, i afërmi i poetit Rakiç. O Zot, edhe ai ra!

<sup>57</sup> Antun Gustav Matos (1873-1914): poet, shkrimtar tregimesh, eseist, publicist dhe kritik kroat. Jetoj në Zagreb, Beograd, Paris dhe Mynih. Matosi konsiderohet si një nga themeluesit e letërsisë moderne kroate. Ai ishte poet lirik, por edhe shumë aktiv në jetën politike përmes artikujve kritikë shoqërorë.

<sup>58</sup> Miloshi dhe Lazari janë heronj legjendarë serbë, që nga periudha e luftërave kundër osmanëve.

<sup>59</sup> Kosova ishte vendi ku u zhvillua një betejë e madhe midis osmanëve dhe serbëve në vitin 1389, dhe ku Serbia humbi (megjithëse disa historianë ende mendojnë se përfundimi i betejës nuk ishte shumë i qartë).

Ai vishej me shumë finesë atje në Paris, kujdesej për veten siç bëjnë femrat, kështu që edhe ne e donim, siç do të kishim dashur një vajzë të re, të bukur dhe të dashur. Unë jam gjallë sot, ndërsa ata dergjen të vdekur, pranë Miloshit dhe Lazarit<sup>58</sup> (...) Gjithë këto plagë vërtet dhembnin, por jo atij që e di se këto plagë janë mjekimi më i mirë për një plagë të madhe të dhimbshme – Kosovën.<sup>59</sup>”

Antun Gustav Matos, *Zivi i mrtvi [I vdekuri dhe i gjalli]*, botuar për herë të parë në gazetën *Obzbor* më 3 nëntor 1912, nr. 303, f. 1-2; ribotuar në *Pjesme / Pecalba [Poezi / Të punosh jashtë vendit]*, Samobor, 2003.



A pajtoheni me autorin, se vdekja e shokëve të tij do të shërojë “plagën e dhimbshme të Kosovës”?

A mendoni se është e drejtë të “merret hak” për ngjarje të tilla historike?

Çfarë do të mendonit dhe ndienit ju në një situatë të ngjashme?

### V-22. Rezultatet e Luftës sipas Komisionit Ndërkombëtar për Hetimin e Shkaqeve dhe Zhvillimin e Luftërave Ballkanike


Komisioni, nga ç'ka parë dhe dëgjuar, nuk është optimist në lidhje me të ardhmen e afërme politike të Maqedonisë. Tashmë, Serbia është në luftë me Shqipërinë, Bullgaria mendon për atë që ajo e quan trajtim të padrejtë që i është bërë, dhe Greqia nuk është ende e sigurtë në zotërimin e disa pjesëve të territoreve të reja. Asnjë nga këto shtete nuk mund të zvogëlojë ushtrinë e saj për të arritur marrëdhënie paqësore, sepse fqinjët e tyre janë të gatshëm për t'i shkelur marrëveshjet, po aq sa janë të gatshëm për t'i bërë ato. Padyshim që rreziku më i madh për moralin dhe marrëdhëniet shoqërore të shteteve të Ballkanit, është prirja në rritje për militarizim, që i bën ato pre të prodhuesve të armëve dhe materialeve të tjera luftarake, që kërkojnë shpenzime kolosale dhe që sjellin varfërimin kombëtar.

Tashmë është përmendur efekti i natyrshëm psikologjik që kanë këto krime ndaj drejtësisë dhe



njerëzimit. Çështja bëhet serioze, kur mendojmë se kombet e kanë përvetësuar atë në vetë jetën e tyre - si një lloj virusi i cili, nëpërmjet rrugëve të zakoshme të qarkullimit, ka infektuar të gjithë vendin. Në këtë fakt mund ta përqendrojmë të gjithë çështjen - shpërdorimi i frikshëm ekonomik, vdekja e parakohshme e një pjese jo të vogël të popullsisë, një masë terrori dhe dhimbjeje e cila mundet vetëm pjesërisht të perceptohet dhe të vlerësohet, si dhe ndërgjegjja kolektive kombëtare për krimet më të mëdha që ka shënuar historia. Kjo është një trashëgimi e frikshme që u lihet brezave të ardhshëm. Nëse kërkojmë të lehtësojmë shkaqet e këtyre gabimeve të mëdha përpara njerëzimit dhe ligjit, duhet t'i kërkojmë ato në fillesat e këtyre kombeve, papjekurinë e karakterit kombëtar dhe qytetar, si edhe në kushtet që gjendeshin gjatë periudhës së gjatë të vasalitetit. Jeta ishte pa vlerë; asgjë nuk ishte plotësisht e mbrojtur ose e sigurtë; veprimet e padrejta dhe dhuna ishin ngjarje të zakonshme në jetën e tyre të përditshme; rreziqe të ndryshme ishin zakonisht të pranishme. Ngjarjet, sado revoltuese, harrohen shpejt nga bota e jashtme, por ndërgjegjja e brendshme, shkatërrimi moral dhe humbja e respektit për veten do t'i bëjnë kombet që të vuajnë.

*Carnegie, f. 272.*

 Diskutoni rreth komenteve të Komisionit. A pajtoheni me pohimet mbi arsytet dhe pasojat e Luftës?  
A janë këto komente objektive? Argumentoni opinionin tuaj!

## V-23. Rajoni i Kilkisit, pas Luftërave Ballkanike

### A. Ndjenjat e një turku, Ibosh Agës

Ulur këmbëkryq në divan, duke thithur qetësisht cigaren e tij me një çibuk të gjatë, na tregoi përvojën e pak ditëve më parë.

“Atje tej, afër Kilkisit, gjendeshin bullgarët”, tha ai. “Shumica ishin komitë dhe disa ushtarë me topa. Nga kjo anë, ‘Runët’, grekët, mbanin stacionin

hekurudhor.” Ai kishte ngecur midis dy zjarresh dhe gjatë gjithë ditës, ndërkohë që plumbat dhe gjylet fluturonin mbi kokën e tij, kishte qëndruar ulur duke u lutur, pikërisht në këtë dhomë.

Më pas, grekët kishin hyrë në oborrin e tij dhe vazhdonin të qëllonin, duke u mbrojtur pas mureve. Ata i kishin thirrur që t’u çonte ujë dhe ai kishte shkuar tek pusi dhe kishte mbushur shtamat e baltës.

“Vallahi<sup>60</sup>, Judeko”, tha ai me dorën mbi kraharor. “Mendova se Azraëli, Engjëlli i Vdekjes, kishte ardhur pranë meje.” Mendueshëm, drodhi dhe një cigare tjetër. “Ditët e njeriut janë të numëruara si rruazat e tespieve”, komentoi ai. Ora e tij ende nuk kishte ardhur, dhe ai falënderoi Allahun për mëshirimin e tij.

“Po, tymi që nxinte qiellin në verilindje, ishte Kilkisi duke u djegur”, i kishin thënë ushtarët, kur një ditë më parë kishte qenë tek stacioni.

Ishim ulur aty në qetësi, në dhomën e mbushur me hijet e muzgut, duke dëgjuar Iboshin. Ai nuk fliste me gjaknxehtësi ose me urrejtje. E gjitha kjo ishte vullneti i Allahut! Dhe Ai i dinte punët e Tij! Vetëm një herë e përmedi humbjen e Turqisë. “Kur plaket luani, - tha ai duke psherëtirë, - e sulmon ujku.” [...]

### B. Takim me një bullgar


Ishim rrugës për në Sarigël, pasi ishim larguar me shpejtësi nga fantazma e Kilkishit kur, duke rënë muzgu, u ndeshëm me atë grup të vogël të mjerësh. Një fshatar bullgar tërhoqte një gomar të dobët, mbi samarin e drunjte të të cilit qëndronte një fëmijë me këmbët zbatthur, e që i vareshin nga njëra anë. Se si i kishte shpëtuar vdekjes që e ndiqte për kaç shumë ditë, ishte një mister që as gjyshi dhe as unë nuk donim ta zbulonim. Mjerimi, agonia e gjatë e frikshme në sytë që përpëliteshin, në fytyrën e vrrarë, mbuluar me mjekër të verdhë, ishin vetë mishërimi i frikës dhe dëshpërimit njerëzor. Jo, jonjerëzor. Ishte frika e bagëtisë në thertore, vështrimi i egër, i ngrirë nga tmerrri i kafshës së strukur në një qoshe. Ishte një vështrim që po ta ndieje një herë, të bënte të rrudheshe nga turpi dhe poshtërimi, turpi që ai vështrim kishte qenë në sytë e një njeriu.

Gjyshi nuk bëri asnjë pyetje. Me kujdes, e drejtoi për tek shtëpia e Kara Mahmudit, në Asha Mahalle.

<sup>60</sup> Për atë Zot!

“Bjeri nga rruga e pasme”, i tha ai. “Nuk do të hasësh njeri.” Dhe ndërkohë, kur burri ndoshta kujtoi se si bullgarët i kishin trajtuar turqit gjatë pushtimit, qëndroi në rrugë i hutuar dhe i pavendosur. Gjyshi e siguroi. “Çdo gjë do të shkojë mirë. Ai do të kujdeset për ty dhe për të voglin.”

Sciaky<sup>61</sup>, f. 267, 269.

 Përshkruani ndjenjat e turqve dhe të bullgarëve. Përse duhet ta ndihmonte Kara Mahmuti fshatarin bullgar?

## V-24. *Frika*. Roman nga Nexhati Xhumali, mbi pasojat e Luftërave Ballkanike

Unë i numërova; një, dy, pesë, tetë ushtarë, me një rreshter në krye. Largësia ndërmjet nesh dhe atyre ishte dyqind ose dyqind e pesëdhjetë hapa. Ata i kishin varur armët në krahë, dhe i ngjiteshin kodrës pa u nxituar. Duhet ta kenë kaluar natën në Sorovic dhe të jenë nisur herët në mëngjes. Megjithatë dukeshin të lodhur, sikur kishin ditë që ecnin. Ata po shikonin përpara, në drejtimin tonë. Na kishin parë, me siguri. Asgjë s’kishte ndryshuar në veprimet e tyre. Kuptuam, nga mënyra sesi lëviznin kokat dhe duart, se disa prej tyre po këndonin. Ata nuk e ndalën këngën. Ndjeva pak frikë. Ata ishin të krishterë, ne ishim myslimanë; ata ishin grekë, ne ishim turq. Kuletat tona ishin plot. Unë kisha ca para me vete. Për më tepër, rreshteri dhe tetari i tyre po ecnin në këmbë, ndërsa ne kishim kuaj. Nëse do të binin dakord në mes tyre që ta mbanin sekret, çfarë do t’i pengonte një rreshter dhe një tetar grek që të vrisnin dy turq në atë humbëtitë, dhe kështu të mos ecnin më në këmbë, në atë të nxehtë?

[...] Ata vazhduan të ecin, ne u afruam më tepër – ishim dyzet ose pesëdhjetë hapa larg. Ne nuk po flisnim më. Ata ende i kishin duart mbi qytat e pushkëve që vareshin nga supet. Fillova ta lëvizja kalin nga rruga, që ata të kalonin. Rreshteri u tregua më i shpejtë dhe doli anash rrugës, përpara meje. Ushtarët e ndoqën pas. Ata ishin të gjithë djem të rinj. Rreshterit i rrinte e madhe uniforma e xhandarit. Ai ngriti dorën tek kapelja, në formë përshëndetjeje.

U lehtësova dhe buzëqesha. Ngrita dorën sipër kokës, dhe më pas e vura në gjoks:

- Përshëndetje zotëri!
- Përshëndetje, rreshter!
- A ke zjarr?

I dhashë paketën time të cigareve dhe kutinë e shkrepes.

[...] Isha trembur. Dhe kisha të drejtë të trembesha. Kishte vetëm dy vjet që kishte mbaruar Lufta Ballkanike. Shumë veta ishin vvarë, shumë të tjerë kishin ikur kot në këto anë. Kush e di sa të rinj kishin humbur jetën e tyre, pikërisht në tokën ku po kalonim hipur mbi kuaj. Malet ishin ende të mbushura me dezertorë. Në qytete, gratë ende ndërronin rrugë kur shikonin një ushtar, dhe fëmijët do të vraponin në shtëpi për t’u fshehur. [...] Ne u takuam si qenie njerëzore në qetësinë e mëngjezit, buzë një pylli të zbrazët. Askush nuk tha “qëllo” ose “vrit”. Ata nuk menduan si ushtarë dhe as nuk na panë si armiq!

[...] Gëzimi kishte vendosur të kthehej këtu përsëri, duke shpalosur flamujt dhe duke ngritur balonat e tij për të filluar një festë. Është e mrekullueshme të ndiesh besim dhe dashuri kur je mes njerëzve! Është e mrekullueshme kur njerëz të armatosur që flasin gjuhë të ndryshme dhe kanë besim të ndryshëm fetar, takohen në male, shkëmbejnë cigare dhe i urojnë njëri tjetrit “Udhë të mbarë!”

N. Cumali, “The Fear” [*Frika*], përkthyer nga Hercules Millas tek Eideneier-Toker, f. 540, 541, 542, 543.



Nexhati Xhumali (1921-2000) lindi në Follorinë dhe emigroi në Turqi gjatë shkëmbimit të popullsisë. Ai jetoi në Izmir dhe studioi në Ankara. Si autor dhe poet, shkroi, gjithashtu, librin *Maqedonia*, 1900. Është ndër rastet e rralla që një autor turk si ai, t’i referohet

Ballkanit si “një atdhe i humbur”.

Në këtë roman të titulluar “Frika”, Mustafai, një mbledhës taksash dhe Jasini, qehajai i tij, po udhëtojnë në krahinë e Follorinës, në gusht të vitit 1914.



Çfarë po mendonin ushtarët grekë kur takuan dy turqit? Si mendoni, në ç’gjuhë komunikuan palët mes tyre?

<sup>61</sup> Mbi autorin Leon Sciaky, shiko tekstin I-4.

**? Pyetje të përgjithshme mbi kapitullin V**

Në vendin tuaj ose në qytetin tuaj, a ka ditë pushimi që lidhen me Luftërat Ballkanike? Ç'ngjarje përkujtojnë ato?

A dini ndonjë roman të frymëzuar nga Luftërat Ballkanike? Cila është panorama që paraqitet në to?

### Harta 4: Europa Juglindore pas Luftërave Ballkanike

#### SHTETET BALLKANIKE

Kufijtë e Rinj sipas Marrëveshjes së Londrës, Kostandinopojës dhe Bukureshtit.



Vini re ngjyrat!

Marrja e territoreve të reja tregohet me ngjyra më të errëta

## Bibliografia

- *Gazeta Adevărul* 8353, 11 dhjetor 1912; 8443, 15/28 mars 1913.
- *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878- 1912, Përgatitën: Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1978.*
- Constantin Bacalbaşa, *Bucureşti de altădată [Bukureshti i vjetër]*, vëll. IV, Bukuresht, 1933.
- *Балканската война през погледа на един французин. Сборник от документи [Lufta Ballkanike në këndvështrimin e një francezi]*. Përmbledhje dokumentesh, Sofje, 1977.
- *Балканската война или руската оранжева книга (дипломатически документи, издадени от руското външно министерство, докосващи се до събитията на балканския полуостров - август 1912г. - юли 1 913 г. ) [Lufta Ballkanike ose Libri Portokalli Rus. Dokumente diplomatike, botuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Rusisë, mbi ngjarjet në Gadishullin e Ballkanit, gusht 1912 - korrik 1913]*, Sofje, 1914.
- *Βαλκανικοί Πόλεμοι 1912-1913. Ελληνική λαϊκή εικονογραφία [Luftërat Ballkanike 1912-1913. Pamje popullore greke.]* Athinë, Shoqata Historike dhe Etnologjike e Greqisë – Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë, 1992.
- *Balkanski rat u slici i reči* 2, 27 janar (9 shkurt) 1913; 6, 24 shkurt (9 mars) 1913; 7, 3 (16) mars 1913; 12, 7 (20) prill 1913; 13, 14 (27) prill 1913; 29, 31 gusht (13 shtator) 1913; 35, 20 tetor (13 nëntor) 1913, përgatitur nga Dušan Mil. Šijački, 2. izdanje (botimi II), Beograd, 1922
- Cem Behar, *Osmanli imparatorluğunun ve Türkiyenin Nüfusus [Popullsia e Perandorisë Osmane dhe Turqisë] 1500-1927*, Statistika historike, vëll.2, Ankara, 1996.
- Gino Berri, *L'Assedio di Scutari. Sei mesi dentro la citta accerchiata [Rrethimi i Shkodrës. Gjashtë muaj brenda qytetit të rrethuar]*, Milano, Editori Fratelli Treves, 1913.
- D. Blagoev, *Bulletin Périodique du Bureau Socialiste International*, Bruxelles, nr. 9.
- Palmira Brummett, *Image and Imperialism in the Ottoman Revolutionary Press, 1908/1911, [Imazhi dhe imperializmi në shtypin revolucionar osman]*, 1908/1911. New York, State University of New York Press, 2000.
- Carnegie Endowment for International Peace, *Report of the International Commission To Inquire into the Causes and Conduct of the Balkan Wars, [Fondi Karnegi për Paqe Ndërkombëtare, Raport i Komisionit Ndërkombëtar për Hetimin e Shkaqeve dhe Zhvillimin e Luftërave Ballkanike]* Uashington D.C., 1914.
- Chr. K. Christodoulou, *Τα φωτογενή Βαλκάνια των αδελφών Μανιάκη [Ballkani fotogjenik i vëllezërve Manak]*. Selanik, 1989.
- Emil Diaconescu, *România și Marile Puteri după congresul de la Berlin până la 1914 [Rumania dhe Fuqitë e Mëdha pas Kongresit të Berlinit deri në vitin 1914.]* Jassy, 1937.
- *Gazeta Dielli*, 13 shkurt 1913.
- Ed. Driault, *La question d'Orient depuis ses origines jusqu'a la paix de Sèvres (1920), përkthyer në greqisht nga Lina Stamatadi, Athinë, 1997.*
- M. Edith Durham, *The Struggle for Scutari, [Beteja për Shkodrën]*. Londër, Edward Arnold, 1914.
- Niki Eideneier, Arzu Toker (red.), *Kalimerhaba. Griechisch-Deutsch-Türkisches Lesebuch*, Köln, 1992.
- Milorad Ekmečić, *Uticaj balkanskih ratova 1912- 1913. na društvo u Bosni i Hercegovini [Impakti i Luftërave Ballkanike 1912-1913, në shoqërinë e Bosnjë dhe Hercegovinës] u Radovi iz istorije Bosne i Hercegovina XIX veka [në vepra mbi historinë e Bosnjës dhe Hercegovinës në shekullin XIX]*, Beograd, 1997.
- Angelos Elefantis, „Η Φεντερασιόν Θεσσαλονίκης και το εθνικό ζήτημα. Από την αλληλογραφία της

- Eργατικής Σοσιαλιστικής Ομοσπονδίας Θεσσαλονίκης με το Γραφείο της Β' Σοσιαλιστικής Εργατικής Διεθνούς“ [*Federata e Selanikut dhe çështja kombëtare. Dokumente nga korrespondenca e Federatës Socialiste Punëtore e Selanikut me Byronë e Dytë të Punonjësve Socialistë Ndërkombëtarë*], 1979, f. 34-49.
- Gazeta *Embros*, Athinë, 27 tetor 1912.
  - Gjenerali Ivan Fichev, *Избрани произведения* [*Vepra të zgjedhura*], Sofje, 1988.
  - Dionyssid Fotopoulos, *Athenian Fashions at the turn of the 19th century*, [*Moda e Athinës në fund të shekullit të 19-të*], Athinë, 1999.
  - *Furnica*, IX, nr. 20, 17 janar 1913; 48, 1 gusht 1913; 49, 8 gusht 1913; 52, 29 gusht 1913.
  - Constantin Gane, *Amintirile unui fost holerici* [*Kujtimet e një ish të sëmurit me kolerë*], botimi II. Bukuresht, 1915.
  - E. Gardika-Katsiadaki, G. Margaritis (red.), *To Aιγαίο των Βαλκανικών Πολέμων 1912-1913* [*Egjeu i Luftërave Ballkanike 1912-1913*], Athinë, Ministria e Egjeut, ELIA, 2002.
  - *Gazeta Ilustratë* II, 6 korrik 1913, 13 korrik 1913; 10 gusht 1913; 24 gusht 1913.
  - Georgiev, G. *Human resources of the countries which took part in the Balkan War 1912-1913, A Collection of Military History* [*Burimet njerëzore të vendeve që morën pjesë në Luftërat Ballkanike*] 1912-1913, Përmbledhje nga Historia Ushtarake, 1983, vëll. I.
  - V. Georgiev dhe St. Trifonov, *История на българите в документи* [*Historia e Bullgarisë në dokumente*], vëll. II: 1912-1918, Sofje, 1996.
  - *Gjurme te Historise Kombetare ne Fototekën e Shkodres* përgatitur nga Kahreman Ulqini. Tiranë, 1982.
  - Elias Grunberg, *Ocupatiunea mijloc de dobândirea proprietății după Dreptul International Public* [*Pushtimi, mjeti për të përfutur toka në bazë të së Drejtës Publike Ndërkombëtare*], Jashi, 1913.
  - *Η Αθηνά των Βαλκανικών Πολέμων 1912-1913. Αναμνηστικό Λεύκωμα* [*Athina gjatë Luftërave Ballkanike 1912-1913*], Athinë, Bashkia e Athinës – ELIA, 1993.
  - *Η Ελλάδα των Βαλκανικών Πολέμων 1910-1914* [*Greqia gjatë Luftërave Ballkanike 1910-1914*]. Athinë, ELIA, 1993.
  - Katia Hadjidemetriou, *A History of Cyprus* [*Historia e Qipros*], Nikozia, 2002.
  - Ch. Hadjiiosif, (red.) *Ιστορία της Ελλάδος του 20 ού αιώνα 1900-1922 Οι Απαρχές*, [*Historia e Greqisë në shek. e 20-të. 1900-1922. Fillimet*], vëll. A2. Athinë, Vivliorama, 1999.
  - Tobias Heinzelmann, *Die Balkankrise in der osmanischen Karikatur. Die Satirezeitschriften Karagöz, Kalem und Cem 1908-1914*, Stamboll, 1999.
  - *Gazeta Hrvatski pokret* [*Lëvizja kroate*], 9-31 tetor 1912; 2 dhjetor 1912, 28 dhjetor 1912.
  - *L' Illustration*, t. CXL [1 janar -31 dhjetor 1912], janar-dhjetor 1913.
  - *Ismail Qemali (Përmbledhje dokumentesh) 1888-1919*. Përgatitur nga Teuta Hoxha, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit.
  - Charles Issawi, *The Economic History of Turkey 1800-1914* [*Historia ekonomike e Turqisë 1800-1914*], Çikago dhe Londër, University of Chicago Press, 1980.
  - Izzet-Fuad pasha, *Paroles de Vaincu...Après le désastre - avant la revanche*, Paris, 1913.
  - Kemal H. Karpat, *Ottoman Population 1830- 1914. Demographic and Social Characteristics*, [*Popullsia osmane, 1830-1914. Karakteristika demografike dhe sociale*], The University of Wisconsin Press, 1985. The University of Wisconsin Press, 1985.
  - Constantin Kiritescu, *Istoria războiului pentru întregirea României 1916-1919* [*Historia e luftës për integritimin e Rumanisë 1916-1919*], Botimi 3, vëll. I. Bukuresht, 1989.

- P. Kishkilo, *Балканските војни по страниците на българският печат 1912-1913* [Luftërat Ballkanike në gazetata bullgare 1912-1913], Sofje, 1999.
- *Revista satirike Koprive, [Hithra], 1912.*
- Christina Koulouri, *Ιστορία και γεωγραφία στα ελληνικά σχολεία (1834-1914). Γνωστικό αντικείμενο και ιδεολογικές προεκτάσεις. Ανθολόγιο κειμένων. Βιβλιογραφία σχολικών εγχειριδίων* [Historia dhe Gjeografia në shkollat greke 1834-1914. Përmbajta dhe ndërlikimet ideologjike. Antologjia e teksteve. Bibliografia e teksteve shkollore,] Athinë, 1988.
- M. Jackson and J. Lampe, *Balkan Economic History, 1550-1950* [Historia ekonomike e Ballkanit, 1550-1950], Bloomington, 1982.
- Драгиша Лапчевић, *Рат и српска социјална демократија* [Lufta dhe social demokracia serbe] Slovo Ljubve, Beograd, 1978.
- *Gazeta Liri e Shqipërisë, 12 tetor 1912.*
- *Mir, [Mir], Nr. 3887, 17 maj 1913.*
- Mihail Madjarov, *Дипломатическа подготовка на нашите војни. Спомени частни писма, шифровани телеграми и поверителни доклади* [Përgatitjet diplomatike të luftërave tona, kujtime, letra private, telegrame të koduara, raporte sekrete]. Sofje, 1998.
- Vozo Madzar, *Балкански ратови и изнимне мјере у Босни и Херцеговини 1912-1913. године* [Luftërat Ballkanike dhe masat speciale në Bosnjë dhe Hercegovinë 1912-1913] u *Godisnjak Drustva istoricara Bosne i Hercegovine XXXV* [në Enciklopedinë e Shoqërisë së Historianëve të Bosnjës dhe Hercegovinës XXXV]. Sarajevë, 1984.
- *Rista Marjanović's War Album 1912-1918* [Albumi i Luftës i Rista Marjanoviçit] 1912-1918, "Deçije novine" - Arhiv Srbije, Beograd, 1987.
- Alekso Martulkov, *Moeto učevstvo vo revolucionernite borbi na Makedonija, [Pjesëmarrja ime në luftërat revolucionare të Maqedonisë]*, Institut za Nacionalna istorija, Skopje, 1954.
- Антун Густав Матош, *Pjesme/Pecalba* [Poezi/ Të punosh jashtë shtetit]. Samobor, 2003.
- Martin Mayer, *Grundshülen in Serbien während des 19. Jahrhunderts..* in Norbert Reiter, Holm Sundhausen (ed.), *Allgemeinbildung als Modernisierungsfaktor. Zur Geschichte der Elementarbildung in Südosteuropa von Aufklärung bis zum Zweiten Weltkrieg*, Berlin, 1994.
- Justin McCarthy, "Muslim Refugees in Turkey" ["Refugjatët myslimanë në Turqi"] gjatë Luftërave Ballkanike, gjatë Luftës së Parë Botërore dhe Luftës turke për pavarësi. Ese për nder të Andreas Tietze,] Stamboll, 1993.
- Yannis Megas, *Souvenir. Images of the Jewish Community, Salonika 1897-1917* [Pamje nga komuniteti hebre në Selanik 1897-1917,] Selanik, 1993.
- Slavko Mika Micevic, *Srpski dobrovoljci u ratovima 1912-1918* [Vullnetarë serbë në luftërat e 1912-1918]. Banja Luka, 1998.
- *Gazeta Mişcareea. Bukuresht, 20 mars/2 prill 1913; 8/21 korrik 1913.*
- George L. Mosse, *Fallen Soldiers. Reshaping the Memory of the World Wars* [Ushtarët e rënë. Kujtime nga luftërat botërore,] Oxford, Oxford University Press, 1990.
- Riza Nur, *Hayat ve Hatiratim* [Jeta dhe kujtimet e mia]. Stamboll, 1992.
- Odbrani tekstovi za istorijata na makedonskiot narod [Tekste të zgjedhura për historinë e popullit maqedonas], pjesa II, Universiteti Kiril i Metodij, Shkup, 1976.
- Daniel Panzac, «L'enjeu du nombre. La population de la Turquie de 1914 à 1927», *Revue du Monde Musulman et de la Méditerranée*, 1988, 4, f. 45-67;
- P.Papapolyviou, *Η Κύπρος και οι Βαλκανικοί Πολέμοι. Συμβολή στην ιστορία του Κυπριακού εθελοντισμού* [Qiproja dhe Luftërat Ballkanike. Kontribut për historinë e vullnetarëve qipriotë], Nikosia, 1997.
- Leonidas Papazoglou, *Photographic portraits from*

*Kastoria and its vicinity at the time of the Macedonian Struggle. Collection of George Goolobias [Portrete fotografike nga Kosturi dhe rrethinat e tij në kohën e luftës maqedonase.] Koleksioni i George Golobias, Muzeu i Fotografisë Selanik; Selanik, 2004.*

■ Constantin Popescu, *Din impresiile unui mobilizat [Përshtypjet e një ushtari]*. Bukuresht, 1913.

■ *Qeveria e Përkohëshme e Vlorës dhe Veprimtaria e Saj, Nentor 1912- Janar 1914*, Përgatitur nga: Dh. Kotini, Xh. Struga, F. Veizi, M. Shuteriqi, K. Dedi, Tiranë, 1963.

■ St. Radev, *Това, което видях от Балканската война* [Çfarë pashë nga Lufta Ballkanike], Sofje, 1993.

■ Mihail Sadoveanu, *44 zile in Bugaria [44 ditë në Bullgari]*, Bukuresht, 1916.

■ Leon Sciaky, *Farewell to Salonica. City at the Crossroads [Lamtumirë Selanik. Qyteti në Udhëkryq]*. Philadelphia: Paul Dry books, 2003.

■ Selim bay lieutenant, *Carnet de campagne d'un Officier Turc (Octobre-Decembre 1912) De Sul- Oglou a Tchataldja*, Paris-Nancy, 1913.

■ Omer Seyfeddin, *Ashab-Kehfimiz - Bir Ermeni Gencinin Hatralar [Shtatë gjumashët tanë. Kujtimet e një të riu armen]*, 1918.

■ Jovan Skerlić, *Feljtoni, skice i govori [Fejtone, skica dhe fjalime]*, Beograd, 1964.

■ S. Skoko, *Drugi balkanski rat 1913 [Lufta e Dytë Ballkanike 1913]*, Beograd, 1968.

■ *Slovenec [Sloveni]* 122, 31 maj 1913.

■ Holm Sundhaussen, *Historische Statistik Serbiens 1834-1914 Mit europäischen Vergleichsdaten*, Munich, R.Oldenbourg Verlag, 1989.

■ L. Trichas (red.), *Ημερολόγια και γράμματα από το μέτωπο. Βαλκανικοί Πόλεμοι 1912-1913 [Ditare dhe letra nga fronti i Luftërave Ballkanike 1912- 1913]*, Athinë, ELIA, 1993.

■ Ivan Vazov, *Събрани съчинения [Vepra të zgjedhura]*, vëll.III. Sofje, 1943.

■ Ev. C. Vlachos, *The Assimilation of Greeks in the United States [Asimilimi i grekëve në Shtetet e Bashkuara]*, Athinë, 1968.

■ *Universul*, XXXI, 176, 29 qershor/12 korrik 1913; 213. 5/18 gusht 1913.

■ *Vojska na Balkanu* [Lufta në Ballkan], redaktuar nga Anton Sušnik dhe Vinko Šarabon, profesorë mbretërorë në Katoliška bukvarna v Lubljan, Lubjanë, 1914.

■ Andrijašević M. Živko, Rastoder Šerbo, *Istorija Crne Gore od najstarijih vremena do 2003 (Historia e Malit të Zi nga kohët e lashta deri në 2003)*, Podgoricë, 2006.

■ Andrijašević M. Živko, Stanojević Zoran, *Pokrštavanje muslimana 1913 (Konvertimi i myslimanëve në të krishterë 1913)*, Podgoricë, 2003.

■ Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1990.

■ *Cetinjski vjesnik (Lajmëtari i Cetinës)*, Nr. 33, 25 prill 1913; Nr. 76, 22 shtator 1912.

■ Đurović Mirčeta, *Trgovački kapital u Crnoj Gori u drugoj polovini XIX i početkom XX vijeka (Kapitali tregtar në Malin e Zi në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të dhe gjysmën e parë të shekullit të 20-të)*, Titograd, 1959.

■ Hasan bey Prishtina: *Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912*. Shkrue prej Hassan Prishtinës (Shkodra: Shtypshkroja Franciskane, 1921.)

■ *Pedeset godina na prestolu Crne Gore 1860-1910 (Pesëdhjetë vite të mbretërisë së Malit të Zi 1860-1910)*, Podgoricë, 1998.

■ Pavićević Branko, Raspopović Radoslav, *Crnogorski zakonici (Ligjet e Malit të Zi)*, V, Podgoricë, 1998.

■ Pejović D. Đordije-Đoko, *Iseljavanje Crnogoraca u XIX vijeku (Emigracioni malazes në shekullin e 19-të)*, Podgoricë, 2003.



## **JEPNI VLERËSIMIN TUAJ PËR KËTË LIBËR!**

Mendimi juaj si lexues është me shumë rëndësi për ne, në mënyrë që të vlerësojmë punën e bërë dhe të planifikojmë nismat tona të ardhshme. Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore (CDRSEE), së bashku me një numër kolegësh dhe bashkëpunëtorësh kanë kryer një punë të madhe dhe kanë shfrytëzuar burime të çmuara për projektin “Mësimdhënia e Historisë Moderne të Europës Juglindore”, rezultat i të cilit është ky libër që keni në duar. Në mënyrë që të vlerësojmë frytshmërinë e metodës së përdorur, dobinë e kësaj sipërmarrjeje dhe vlerën e punës sonë, do të dëshironim që të jepnit vlerësimin tuaj për këtë projekt. Ju lutemi, na jepni opinionin tuaj të sinqertë, duke na kushtuar pak kohë dhe kujdes nga ana juaj.

Pasi ta lexoni këtë libër ose ta keni përdorur në klasë, ju lutemi, shkoni në faqen tonë të internetit, dhe tek seksioni “Librat e Punës të Historisë” plotësoni një formular vlerësimi. Formularin e vlerësimit mund ta gjeni në adresën: <http://www.cdsee.org/jhp/index.html>

Nëse dëshironi, mund të na shkruani në adresën elektronike: [info@cdrsee.org](mailto:info@cdrsee.org) dhe komentet tuaja do t’i dërgohen drejtpërsëdrejti njërit prej koordinatorëve të PHP-së.

Gjithashtu, mund të na shkruani edhe në adresën postare:

Center for Democracy and Reconciliation in Southeast Europe (CDRSEE)  
Krispou 9, Ano Poli, 54634 Thessaloniki, Greece